



PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL RAHOVEC

Nëntor, 2011

PËRMBAJTJA:

I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL – FAZA E PARË

I.1. HYRJE

I.1.1. SISTEMI I PLANIFIKIMT HAPËSINOR NË KOSOVË

I.1.2. PËRFITUESIT E PROJEKTIT

I.1.3. BURIMI I TË DHËNAVE PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

I.1.4. ROLI DHE NATYRA E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

I.2. ROLI I PJESMARRËSVE

I.2.1. ROLET – VENDIMMARRËSE / JO-VENDIMMARRËSE

I.2.2. QEVERISJA KOMUNALE

I.2.3. NDARJA ADMINISTRATIVE DHE QEVERISJA E KOMUNËS

I.3. POZITA GJEOGRAFIKE, KUFINJËT, MADHËSIA DHE MIKROPOZITA E RAHOVECIT

I.4. ZHVILLIMI DEMOGRAFIK

I.4.1. NUMRI I POPULLSISË

I.4.2. DENDËSIA E POPULLSISË

I.4.3. SHTIMI NATYROR I POPULLSISË

I.4.4. STRUKTURA E POPULLSISË

I.5. ÇËSHTJET SOCIALE

I.5.1. ARSIMI

I.5.2. SHËNDETËSIA

I.5.3. SHËRBIMET SOCIALE

I.5.4. PAPUNËSIA NË RAHOVEC

I.5.5. VARFËRIA NË RAHOVEC

I.6. VENDBANIMET, BANIMI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

I.6.1. TIPOLOGJIA E VENDBANIMEVE

I.6.2. SHTRIRJA HAPËSINORE E VENDBANIMEVE

I.6.3. KARAKTERISTIKAT MORFOLOGJIKE-URBANISTIKE TË VENDËBANIMEVE

I.6.4. FUNKSIONALITETET I VENDBANIMEVE

I.6.5. RRJETI I VENDBANIMEVE

I.6.6. VENDBANIMET JO FORMALE

I.6.7. BANIMI

I.6.8. SHFRYTËZIMI I TOKËS

I.7. KARAKTERISTIKAT FIZIKO-GJEOGRAFIKE DHE MJEDISI

I.7.1. NDËRTIMI GJEOLOGJIK

I.7.2. TEKTONIKA

I.7.3. KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE

I.7.4. BONITETI I TOKAVE

I.7.5. KARAKTERISITKAT SEIZMIKE

I.7.6. EROZIONI

I.7.7. VËRSHIMET

I.7.8. KAREKTERISTIKAT KLIMATIKE

I.7.9. HIDROGRAFIA

I.7.10. BOTA BIMORE DHE SHTAZORE

I.7.11. LIVADHET DHE KULLOSAT

- I.7.12. NDOTJA E UJIT
- I.7.13. NDOTJA E AJRIT
- I.7.14. DEGRADIMI I TOKËS
- I.7.15. TRASHËGIMIA KULTURORE
- I.7.16. TRASHËGIMIA NATYRORE

I.8. ZHVILLIMI EKONOMIK

- I.8.1. BUJQËSIA
- I.8.2. BLEGTORIA DHE SHPEZTARIA
- I.8.3. TREGTIA
- I.8.4. PUNËSIMI
- I.8.5. ZHVILLIMI I INDUSTRIË DHE BIZNESEVE
- I.8.6. TURIZMI

I.9. INFRASTRUKTURA FIZIKE, LEVIZSHMËRIA DHE SHËRBIMET PUBLIKE

- I.9.1. INFRASTRUKTURA RRUGORE
- I.9.2. RRJETI HEKURUDHOR
- I.9.3. TRANSPORTI PUBLIK
- I.9.4. TELEKOMUNIKACIONI
- I.9.5. RRJETI ENERGJETIK
- I.9.6. FURNIZIMI ME UJË
- I.9.7. SISTEMI I KANALIZIMIT
- I.9.8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

I.10. KAPACITETET INVESTIVE

I.11. VLERËSIMI I GJENDJES NË KOMUNË

I.12. SFIDAT E IDENTIFIKUARA

I.13. POTENCIALET LOKALE TË IDENTIFIKUARA

II. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET - FAZA E DYTË

- II.1. PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS
- II.2. VIZIONI PËR KOMUNËN E RAHOVECIT
- II.3. PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT
- II.4. PARIMET E QEVERISJES SË MIRË
- II.5. QËLLIMET AFATGJATE TË ZHVILLIMIT
- II.6. PRIORITETET STRATEGJIKE

III. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË KOMUNËS

III.1. KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR

- III.1.1. SKENARET E ZHVILLIMIT HAPËSINOR
- III.1.2. ZONAT DHE FUNKSIONET E TYRE
- III.1.3. QENDRAT DHE ORGANIZIMI FUNKSIONAL
- III.1.4. RRJETI I TRAFIKUT

III.2. STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

- III.2.1. ZHVILLIMI EKONOMIK
- III.2.2. POPULLSIA DHE VENDBANIMET
 - III.2.2.1. PARASHIKIMI DEMOGRAFIK
 - III.2.2.2. ZHVILLIMI I VENDBANIMEVE
 - III.2.2.3. ADMINISTRIMI TERRITORIAL
- III.2.3. INFRASTRUKTURA SOCIALE
 - III.2.3.1. ARSIMI
 - III.2.3.2. INSTITUCIONET SHËNDETËSORE
 - III.2.3.3. SHËRBIMET SOCIALE

- III.2.3.4. ZVOGËLIMI I PAPUNËSISË DHE VARFËRISË
- III.2.4. MOBILITETI DHE RRJETI I TRAFIKUT
 - III.2.4.1. RRJETI RRUGOR
 - III.2.4.2. RRJETI HEKURUDHOR
- III.2.5. RRJETI ENERGJETIK DHE TELEKOMUNIKACIONIT
- III.2.6. SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM
- III.2.7. MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS
- III.2.8. FATKEQËSITË ELEMENTARE DHE MASAT MBROJTËSE
- III.2.9. TRASHËGIMIA NATYRORE

IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT KOMUNAL

- IV.1. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SOCIAL DHE ADMINISTRATËS
- IV.2.STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË VENDBANIMEVE DHE NDËRTIMEVE ME PLAN
- IV.3. MBROJTJA E MJEDISIT DHE SHFRYTËZIMI RACIONAL
- IV.4. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
- IV.5. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS
- V. DISPOZITAT PËR ZBATIM
 - v.1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME
 - v.2. DETYRAT DHE MASAT PËR ZBATIMIN E PLANIT
 - v.3. KUSHTET PËR PËRCAKTIMIN E DESTINIMIT TË SIPËRFAQEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS
 - V.4. KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS
 - V.5. ZHVILLIMI I VENDBANIMEVE DHE NDËRTIMET TJERA JASHTË TYRE
 - V.6. ZHVILLIM SOCIAL DHE ADMINISTRATË EFIKASE
 - V.7. MJEDIS I PASTËR DHE ATRAKTIV
 - V.8. ZHVILLIMI EKONOMIK I KOMUNËS
 - V.9. KUSHTET PËR VENDOSJEN E KORRIDOREVE APO TRASEVE, SIPËRFAQEVE KOMUNIKUESE DHE SISTEMEVE TJERA TË INFRASTRUKTURËS
 - v.10. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

TABELA E SHKURTESAVE:

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BPV (GDP)	Bruto Produkti i Vendit (Gross Domestic Product)
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
FMN (IMF)	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GND	Të ardhurat nacionale në dispozicion
KKSH	Kuvendi Komunal i Rahovecit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
ZHEL	Zhvillimi Ekonomik Lokal
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post - Telekomunikacionit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
PSZHAKSH	Plani Strategjik Zhvillimor Afatmesum komunes Rahovec
KKR	Kuvendi Komunal Rahovec
ZKK	Zyra Komunale për Komunitete
UNHCER	United nation Development program Programi i kombeve të Bashkuara për zhvillim
UNDP	United Nations High Commissioner for refugees Komisioni i lartë i kombeve të bashkime për refugjat

I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL – FAZA E PARË

I.1. HYRJE

Komuna e Rahovecit ka marrë vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal me datën 17.03.2010, dhe me datën 13.07.2010 u nënshkrua kontrata në mes Komunës së Rahovecit dhe **N. Sh. P. Data-GIS-cosulting**.

Qëllimi i projektit – Qëllimi kryesor i këtij projekti është që komuna e Rahovecit të ketë një plan zhvillimor komunal modern, efikas dhe të bazuar në norma e standarde evropiane. Ky projekt do të jetë në harmoni të plotë me objektivat e „Ligjit për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor” si dhe harmonizim të plotë me Planin Hapësinor të Kosovës.

Plani Zhvillimor Komunal do të sigurojë një bazë për një zhvillim të qëndrueshëm për komunën e Rahovecit. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk nënkupton vetëm ruajtjen e mjedisit kryesor, por edhe shfrytëzimin e përkohshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe, balancimin e zhvillimeve hapësinore. Kjo do të thotë që të ri koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike, kështu që të kontribuojnë në balancimin e zhvillimeve hapësinore.

Plani zhvillimor është dokument, që hartohet për territorin e komunës për periudhën e ardhme kohore deri në vitin 2020 dhe jep udhëzime konkrete për veprimet që duhet të ndërmerren: Pse duhet ndërmarr ato veprime, po ashtu, sqaron se si duhet të realizohen veprimet e tilla?. Veprime këto që do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës së Rahovecit, duke ndikuar në ngritjen e kualitetit social, ekonomik dhe fizik të hapësirës përkatëse.

Plani Zhvillimor komunal jep mundësi të vazhdimësisë së planifikimit edhe për të ardhmen (pas periudhës së caktuar). Në dokumentin e planit merren vendime afatgjate, por gjithmonë duke pasur parasysh fleksibilitetin e planit, kur dihet se: në të ardhmen mund të paraqiten rrethana të reja që kërkojnë modifikime të vazhdueshme (kërkesat e ndryshme të popullsisë, ndryshimet në politikën qeveritare, parimet ndërkombëtare etj.).

PZHK sot orientohen kah procesi dhe veprimi, fillon me konsensus mbi çështjet, është seleksionuar dhe i fokusuar duke adresuar përparësitë dhe mangësitë. Është proces në të cilin përfshihet edhe ajo që është e paplanifikuar. Këtij procesi i paraprinë, një vizion realist dhe i qëndrueshëm. Me aprovimin e dokumentit, i cili do të jetë i hartuar përmes procesit të konsultimeve publike dhe, i bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, resurseve potenciale, duke identifikuar çështje apo fusha ku duhet ndërmarrë veprime urgjente, me qëllim të mbrojtjes, kultivimit dhe zhvillimit të vlerave socio-ekonomike dhe mjedisore të komunës së Rahovecit.

Rezultat i përfundimit të Planit do të jetë informata përmbajtjesore për gjendjen demografike-sociale, ekonomike, infrastruktura, mjedisi në Rahovec. Në shtrirjen hapësinore të dukurive, do të duken qartë, caqet e zhvillimit të Komunës dhe, zonat me prioritet për intervenim nga do të rrjedhin propozimet për zhvillimin e ardhshëm hapësinor dhe, mënyrën se si do të arrihet ky zhvillim.

I.1.1. SISTEMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOSOVË

Sistemi i planifikimit në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nivelet e planifikimit në bazë të Nenit 9 ndahet në dy nivele:

1. Planifikimi për territorin e Kosovës
2. Planifikimi për territorin e Komunave

Llojet e planeve në bazë të Nenit 10 .2 në nivel të Komunës janë:

1. Plani zhvillimor i komunës
2. Plani zhvillimor urban
3. Planet rregulative urban


Në bazë nenit 13.1 secila komunë është përgjegjëse për përgatitjen e Planit zhvillimor të Komunës, i cili mbulon territorin e saj. Ky plan është strategjik dhe muti-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Plani zhvillimor i komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale të komunës.

Në bazë të Nenit 14.1 Komuna përgatitë Planin Urban për të gjitha territoret urbane brenda territorit të komunës.

PZHK bazohet në gjendjen ekzistuese sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe është proces gjithëpërfshirës, transparent me pjesëmarrje publike në vendimmarrje. Pjesëmarrja publike nënkupton involvimin e të gjithë faktorëve relevant në interes të komunës: Drejtoritë komunale, Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, Institucionet shkencore dhe hulumtuese, Organizatat e shoqërisë civile, komunale etj.

Më poshtë është dhënë skema e mobilizimit institucional të pjesëmarrjes në procesin e hartimit të PZHK-së

Skema 1. Skema e mobilizimit institucional



PZHK bazohet në:

- Parimet e përcaktuara me Ligj
- Vizionin dhe caqet strategjike
- Raportet e sektorëve të rëndësishëm

- Strategjitë zhvillimore të sektorëve të ndryshëm
- Elemente tjera të përcaktuara me akte të veçanta

Si i tillë, Plani përcakton, parimet dhe qëllimet afatgjate të planifikimit hapësinor për periudhën deri në vitin 2020. Gjithashtu përcakton afatet kohore reale dhe implikimet buxhetore.

Korniza për hartimin e PZHK përbëhet nga pesë faza:

- Faza I -Përgatitja e profilit dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese
- Faza II - Vizioni, Parimet dhe Caqet
- Faza III - Korniza e Zhvillimit Hapësinor
- Faza IV - Strategjitë dhe veprimet për zbatim
- Faza V- Dispozitat për zbatim

- **Faza e parë e Planit është hartimi i profilit-** dokumenti mbi gjendjen ekzistuese të zhvillimit hapësinor në Komunë. Ky është dokumenti bazë për njohjen dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të zhvillimeve në hapësirë, si dhe, përcakton orientimet themelore për hartimin e PZHK-së
- **Fazës së dytë të Planit** - dokumentit strategjik Vizioni, parimet dhe caqet strategjike të zhvillimit hapësinor të Komunës.
- **Fazat e tretë e Planit** - Korniza e zhvillimit Hapësinor shpreh parashikimet e dëshiruara hapësinore për territorin e komunës.
- **Faza e katërt** - është Strategjia dhe veprimet për zbatim - Kjo fazë formulon pakon e strategjive dhe veprimet për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet kohore, implikimet financiare dhe kornizën institucionale.
- **Faza e pestë** - Përfshin elementet e Zbatimit obligativ, që ndërlidhen me nivelin komunal.

Gjatë hartimit të PZHK-së, struktura e projektit do të ndahet në katër fusha kryesore:

1. Popullsisë, çështjeve sociale, banimit dhe vendbanimet.
2. Mjedisit, përfshirë trashëgiminë kulturore, natyrore, peizazhet etj.
3. Zhvillimin ekonomik, industrinë, turizmin, rekreacionin, tregtinë, bujqësinë
4. Infrastrukturës - transportit komunal, komunikimet.
5. Përveç katër fushave kryesore të projektit janë edhe komponentët tjerë që fuqizojnë planin për zbatim gjithëpërfshirës dhe implementus:
 1. Plani Zhvillimor Komunal (përgatitja e dokumentit final dhe pranimi i planit nga asambleja komunale).
 2. Rregullimi afatgjatë i zhvillimit hapësinorë dhe ekonomik i komunës duke u bazuar në koncepte të ndryshme të zhvillimit hapësinor.
 3. Bashkëpunimi i ngushtë dhe trajnimi i stafit të qeverisë lokale gjatë hartimit të Planit zhvillimor komunal, si dhe do të mundësohet atyre për të vazhduar detyrimet dhe përgjegjësit të cilat dalin nga plani zhvillimor komunal.
 4. Trajnimi i stafit të selektuar nga komuna në GIS, i cili do të ofroj njohuri të mira në GIS, si dhe do të jetë ndihmë e madhe në implementimin e projektit.
 - ✓ Paketën e GIS sofverit (me të cilën kompania e realizon projektin) komuna mund ta propozoj, ndërsa kompania Data GISconsulting do ta siguroj brenda ofertës së vet solucionin e MapInfos v. 8.0.

5. Ofrimin e konceptit për GIS infrastrukturë dhe menaxhimin e të dhënave me GIS.

I.1.2. PËRFITUESIT E PROJEKTIT

Ky projekt është gjithëpërfshirës dhe shumë dimenzional. Andaj, përfitimet janë shumë të rëndësishme nga fakti se do të planifikohet një zhvillim i përgjithshëm në përputhje të plot me interesat e qytetareve të komunës së Rahovecit. Projekti, gjithashtu do të jetë në harmoni të plotë me politikat e zhvillimit dhe mbrojtës që ka Qeveria e Republikës së Kosovës dhe vet Qeveria lokale, e që do të jenë në harmoni të plotë edhe me qëllimin e politikave të Unionit Evropian.

Perspektiva evropiane e zhvillimit hapësinor është e orientuar drejt një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm të territorit të vet Unionit Evropian.

Ministrat përgjegjës për Planifikimin Hapësinor në Shtetet Anëtare të Unionit Evropian dhe anëtari i Komisionit Evropian, përgjegjës për Politikën Regjionale, theksuan në Potsdam se: qëllimi i politikave të zhvillimit hapësinor është që të punohet drejt një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm të territorit të Unionit Evropian. Sipas pikëpamjes së Ministrave, është e rëndësishme që të arrihen barabar tri qëllimet fundamentale të politikës evropiane në të gjitha regjionet e UE-së:

- ✓ Kohezioni ekonomik dhe social;
- ✓ Ruajtja dhe menaxhimi i resurseve natyrore dhe i trashëgimisë kulturore;
- ✓ Konkurrencë më e balancuar e territorit evropian.

Në përputhje me këto politika, është edhe Plani hapësinor i Kosovës, që ka për synim arritjen e një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm. Harmonizimi i politikave të tilla zhvillimore ka një rol të rëndësishëm edhe për komunën e Rahovecit, e cila gjatë këtij procesi, do të arrij të krijoj një bazë të mirë të planifikimit hapësinor në përputhje me këto politika.

Plani Zhvillimor Komunal që do të hartohet në përputhje të plotë me interesat e qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe që do të bëhet në harmoni me politikat e zhvillimit hapësinor të Kosovës dhe të Unionit Evropian, paraqet një përfitim real dhe afatgjatë për të ardhmen e komunës. Në këtë kontekst, përfituesit kryesor të këtij projekti do të jenë: Komuna e Rahovecit, Institucionet e Kosovës, komuniteti, sektori shoqëror, sektori privat, OJQ-ët, , grupet e interesit.

I.1.3. BURIMI I TË DHËNAVE PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

Mbledhja e të dhënave si bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal është element i domosdoshëm. Gjatë hartimit të profilit komunal si dhe për vlerësimin i gjendjes ekzistuese janë shfrytëzuar burime dhe metoda të ndryshme për grumbullimin, sistemimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme. Grumbullimi i të dhënave është

bërë nga strukturat komunale të Rahovecit dhe stafi i kompanisë përmes një bashkëpunimi të ngushtë mes grupeve punuese.

Sektorët e Qeverisë komunale kanë bërë grumbullimin e të dhënave bazë në fusha të caktuara duke qenë në përputhje me kërkesat e kompanisë. Të gjithë sektoret komunal që kanë patur raportet dhe projektet e tyre për zhvillimin e deri tanishëm dhe të ardhshëm të fushave përkatëse, janë shqyrtuar dhe inkorporuar në dokumentin e Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit.

Të dhënat bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal janë shfrytëzuar nga burime të ndryshme:

- Të dhënat zyrtare nga sektorët e Qeverisë Komunale – plotësimi i veglave të punës.
- Të dhënat nga zyrat komunale dhe regjionale të Qeverisë së Kosovës (Zyra e Punës dhe punësimit, Zyra për mirëqenie sociale, ESK etj.)
- Të dhënat nga sektorë të ndryshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Të dhënat nga kompanitë publike komunale.
- Plani detal urbanistik – i hartuar nga Enti për Urbanizëm, Prishtinë
- Parcelat kadastrave – zyra komunale për Kadastër.
- Hartat topografike: 1: 50 000, 1:25 000
- Orto-fotot (prodhim: viti 2000 dhe 2004) - zyra komunale për Kadastër.
- Puna në terren (ekipet e kompanisë kanë vizituar të gjitha vendbanimet e komunës).
- Aplikimi i GIS dhe GPS
- Literatura shkencore.

Në vazhdimësi të procesit të hartimit të planit, do të grumbullohen të dhëna të reja dhe të rëndësishme, që do të inkorporohen në dokumentin e profilit. Kjo nënkupton plotësimin e profilit me të dhëna të reja në të ardhmen deri në përfundimin e projektit.

I.1.4. ROLI DHE NATYRA E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

a) Promovon interesat e përbashkëta të popullatës në katër fushat kryesore:

- Popullsia dhe zhvillim social
- Mjedis dhe shfrytëzim të tokës
- Zhvillim ekonomik dhe
- Infrastrukturë

b) Plani Zhvillimor Komunal duhet të:

- Mundësojë që, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, të përcaktojë kahet e zhvillimit social, shfrytëzimin mjedisor, mbrojtjes mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe infrastrukturë për qasje dhe lidhje më të mirë e mbi të gjitha rritjen e kualitetit të jetesës.
- Ndikojë në vendimet politike, lidhur me investimet publike në infrastrukturë, për t'i përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve;
- Përkrahë zhvillimin e balancuar në mes të zonave urbane dhe zonave rurale me zhvillim ekonomik më të ulët;

- Të jetë udhëzues në hartimin e Planit Zhvillimor Urban
 - Identifikojë lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të komunës;
 - Aprovojë vendimet lidhur me zonat e industrisë dhe biznesit, banimit, shërbimeve, turizmit dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
 - Identifikojë rolin e zonave kryesore brenda qytetit dhe atyre rurale, në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik dhe kulturor të komunës.
- c) Roli i qeverisë lokale - si vendimmarrëse dhe implementuese e vendimeve të marruara, duke u mbështetur në parimet kryesore
- Pjesëmarrja publike;
 - Sundimi i ligjit;
 - Transparenca;
 - Përgjegjësia;
 - Konsensusi;
 - Barazia dhe gjithë përfshirja;
 - Efikasiteti dhe
 - Llogaridhënia

I.2. ROLI I PJESËMARRËSVE

Në respektim të parimeve ndërkombëtare të rekomanduara me ligj, e posaçërisht të Agjendës 21 dhe Agjendës së Habitatit, procesi tenton të përfshijë një numër sa më të madh të pjesëmarrësve në fazën përgatitore për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, në mënyrë që parimet e gjithë-përfshirjes, transparencës, efikasitetit, barazisë dhe qëndrueshmërisë, të promovohen dhe zbatohen në praktikë nga Komuna.

Në bazë të Ligjit për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal është plan multi-sektorial, i cili merr parasysh zhvillimet e sektorëve që menaxhohen nga komuna, involvimi, i të gjithë pjesëmarrësve të cilët mund të kenë ndikim ose të jenë të ndikuar nga plani esencial për të zbatuar parimet e pjesëmarrjes publike dhe transparencës së procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

I.2.1. ROLET - VENDIMMARRËSE / JO-VENDIMMARRËSE

Roli në vendim- marrje përveç qeverisë lokale duhet të jetë transparent edhe për pjesëmarrësit të tjerë në proces siç janë shoqëria civile, sektori privat, OJQ, shoqatat e ndryshme të fermerëve, bletarëve, ekspertëve të pa varur, e institucioneve të ndryshme që involvohen në proces të planifikimit.

Pjesëmarrësit nga niveli qendror, përfaqësues të ministrive të Qeverisë së Kosovës me të dhënat, raportet dhe strategjitë e sektorëve përkatës e plotësojnë përmbajtjen e dokumentit

Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave rrjedhin nga sektori jo-qeveritar, analizat dhe raportet e të cilëve në të shumtën e rasteve kanë shërbyer për krahasim, e në disa raste edhe si të vetmet burime të dhënave.


I.2.2. QEVERISJA KOMUNALE

Pas përfundimit të Luftës në qershor të vitit 1999 Kosova ka hy nën administrimin ndërkombëtar të Kobëve të Bashkuara. UNMIK-u shtriu ndikimin e vet edhe në qeverisjen lokale, ku sipas Nenit 3 të rregullores së vet Nr. 2000/45, komunave ju ndanë rolet dhe përgjegjësit, si dhe rolin në ofrimin e kushteve themelore bazike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Procesi i decentralizimit në Kosovë qartësojë edhe kompetencat për vetëqeverisje lokale. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 në Kreu III Kompetencat komunale, Neni 15 Parimi i subsidiaritetit – Komunitat ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit dhe, Neni 16 –Komunitat ushtron kompetenca vetjake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin.

Organet komunale janë: Kuvendi që është organi më i lartë në komunë dhe, Kryetari që kryen udhëheqjen komunale të ekzekutivit.

Skema 2. Struktura organizative e komunës së Rahovecit



I.2.3. ORGANIZIMI ADMINISTRATIV DHE QEVERISJA E KOMUNËS SË RAHOVECIT

Komuna e Rahovecit zë sipërfaqen prej 275.5 km², në të cilin territor shtrihen 36 vendbanime, me vetëm një qendër urbane.

Territori i komunës së Rahovecit ndahet në 35 zona kadastrale, ndërsa brenda një zone kadastrale ndodhet një vendbanim, me përjashtim të vendbanimit Sarosh i cili ndodhet në zonën kadastrale të vendbanimit Çifllak:

Tabela 1. Zonat kadastrale në komunën e Rahovecit

1	Bellacerkë	19	Opterushë
2	Bërnjak	20	Pastaselë
3	Bratotin	21	Pataçan i Epërm
4	Brestovc	22	Pataçan i Ulët
5	Celinë	23	Petkoviq
6	Çifllak-Sarosh	24	Polluzhë
7	Dabidol	25	Radostë
8	Dejnë	26	Rahovec
9	Drenoc	27	Ratkoc
10	Gexhë	28	Reti e Ulët
11	Hoçë e Madhe	29	Retijë
12	Hoçë e Vogël	30	Sapniq
13	Kaznik	31	Senoc
14	Kramovik	32	Vrajakë
15	Krushë e Madhe	33	Xërxë
16	Mrasor	34	Zatriq
17	Nagavc	35	Zoçishtë
18	Nushpal		

Organizimi administrativ i komunës së Rahovecit mbështetet në një qendër komunale dhe 8 qendra lokale.

Tabela 2. Organizimi administrativ i Komunës së Rahovecit

1.	Rahovec	Rahovec, Bërnjak
2.	Çifllak	Çifllak, Mrasor, Kramovik, Petkoviq, Polluzhë, Sarosh
3.	Ratkoc	Ratkoc, Radostë, Dejnë, Dabidol, Vrajakë, Bratotin
4.	Drenoc	Drenoc, Zatriq, Kaznik, Pastaselë, Senoc, Nushpal, Pataçan i Epërm
5.	Xërxë	Xërxë, Gexhë, Bellacerkë, Sapniq, Pataçan i Ulët
6.	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe, Celinë, Nagavc
7.	Hoçë e Vogël	Hoçë e Vogël, Hoçë e Madhe, Brestovc
8.	Opterushë	Opterushë, Zoçishtë, Retijë, Retijë e Ulët

Harta 1. Zonat kadastrale në komunë



Pjesëmarrës kyç në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Nga Kuvendi Komunal Rahovec

Grupi strategjik : 1.Smajl Latifi –Kryetar i Komunës - Rahovec
 2.Hazer Tara -Nënkrytar i Komunës
 3.Musa Cena – Koodinator i Projektit
 4.Ramadan Gashi zv.Koordinator i Projektit

Grupet punuese komunale:

Demografi dhe zhvillim social
1. Florije Boshnjaku-Drej. Shendet ssi dhe mireqenje sociale 2. Lenhard Hamza -Drejt.për Administrat 3. Besa Hoxha -BeqiriDrejt.per Arsim 4. Arben Zeka-Drejt.Kultures rinis dhe sportit
Mjedisi dhe shfrytëzimi i Tokës
1. Fatmir Iska – Drejt.Pron kadaster dhe gjeodezi 2. Artan Zenuni - Drejt.i Bujqesise 3. Shemsi Ibrahimimi - drejtor per Inspektion
Zhvillimi ekonomik
1. Musa Cena drejt.per ekonomi dhe zhvillim 2. Afrim Limani -drejt.per Bugjet dhe financ 3. Artan Zenuni -Drejt.per Bujqesi
Infrastruktura
1. Perparim Krasniqi -derjt.per shërbime publike 2. Ramadan Gashi -drejt.per Urbanizem

Këshilli i ekspertëve

Emri dhe Mbiemri	Profesioni
1. Selim Metkamberi	Ing. i dip. i Ndert.
2. Vahdet Kadir	Ing. i dip. i Ndert.
3. Ramadan Kadiri	ecc i dip.
4. Sulejman Daka	Ing. i dip. i Ndert.

5. Nysret Shala	Ing.i dip.-Magjister i Bujeqesis
6. Ali Hoxha	Gjeograf i dip.
7. Mehdi Shehu	Sanitar
8. Bjondina Rama	Spec. për Mjedis
9. Masar Vuqiterna	Spec. i Komunikacionit
10. Ramadan Rama	Specialist social-Defektolog
11. Bilbil Oruqi	Jurist i dip.
12. Agim Kadiri	Mjek-spec. Pediater
13. Kapllan Gashi	Jurist i dip.
14. Ymret Reshiti	Jurist i dip.
15. Fadil Bugari	E mesme

Grupet punuese nga kompania:


1. Menaxher i projektit – Prof. Dr. Sc. Ibrahim Ramadani, Urbanist
 2. Tomor Qela – Udhëheqës administrativ
- Udhëheqësit e grupeve punuese:
- a. Popullsia dhe zhvillimi social – Hazer Dana demograf -planer
 - b. Mjedis dhe shfrytëzimi i tokës – Prof. Dr. Sc. Gani Gashi
 - c. Zhvillimi ekonomik – Prof. Elvida pallaska, ing. arkitekturës
 - d. Infrastruktura –Msc. Idriz Shala- GIS expert
3. Stafi profesional:
- a. Mr. Sc. Burbuqe Nushi-Latifi , specialist i shëndetit publik
 - b. Bajram Kafexholli, GIS ekspert
 - c. Ecc. Luljeta Krasniqi, ekonomiste
 - d. Mr. Sc. Ecc. Mic Avdullahu
 - e. Ramush Aliu Ing. ndertimtarisë.
 - f. Izjah Celaj- Prof.Lektor

I.3. POZITA GJEOGRAFIKE KUFINJËT, MADHËSIA DHE MIKROPOZITA E RAHOVECIT

Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.5 km², që shtrihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, në V-L me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në J-L me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në J me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në P me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km. Ekziston lidhje të mira komunikative në mes komunave dhe në Lindje të komunës kalon magjistralla Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren –Pejë.

Territori i komunës shtrihet në hemisferën në mesë shkallës 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjerësia gjeografike veriore dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë gjeografike lindore. Vendbanimet në komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 m Krusha e Madhe deri në 920 m. lartësi mbidetare Zatriqi

Harta 2. Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit



Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshorë, kodrinore dhe malore.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lugina ose rrafshina janë këto: (310 – 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m. që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshinave.)

Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 – 1.000 m. e këto janë: Zatriqi, Kazniku dhe Drenoc.

I.4. ZHVILLIMI DEMOGRAFIK I KOMUNËS SË RAHOVECIT

I.4.1. NUMRI I POPULLSISË

Në komunën e Rahovecit jetojnë rreth 71522 banorë¹. Dihet se të dhënat për popullsinë mungojnë jo vetëm për komunën e Rahovecit por edhe në nivel të Kosovës. Në vitin 2011 është realizuar Regjistrimi i popullsisë, por të dhënat nga ky regjistrim ende nuk janë përpunuar dhe publikuar.


Vlerësimi i numrit të popullsisë së komunës së Rahovecit është bërë nga Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me kompaninë DATA Gis Consulting. Për vlerësimet dhe analizat demografike të komunës së Rahovecit janë shfrytëzuar të dhënat e vitit 1991, të dhënat nga aktuale që ka Komuna e Rahovecit, pastaj të dhënat nga ortofotot, analiza e rritjes mesatare demografike në komunë dhe sipas vendbanimeve etj. Literaturë tjetër që janë shfrytëzuar gjatë këtyre analizave janë edhe hulumtimet e ndryshme që janë realizuar nga Enti i Statistikës së Kosovës (ESK).

Që nga viti 1948 e deri më sot komuna e Rahovecit ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Në vitin 1948 Rahoveci kishte 20287 banorë, ndërsa në vitin 2010 ka rreth 71522 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (62 vjeçare) numri i popullsisë është rritur për më shumë se tri herë.

Tabela 3. Numri i popullsisë sipas regjistrimeve

Vitet	Nr. i popullsisë
Regjistrimi 1948	20287
Regjistrimi 1961	26763
Regjistrimi 1971	35188
Regjistrimi 1981	46396
Vlerësimi 1991	59625

¹ Vlerësim i numrit të popullsisë për komunën e Rahovecit për vitin 2010, nga komuna në bashkëpunim me Kompaninë DataGISConsulting.




Grafiku 1. Numri i popullsisë së Komunës sipas regjistrimeve

Numri i popullsisë në komunën e Rahovecit ka shënuar një rritje të konsiderueshme me rreth 51235 banorë prej vitit 1948 deri në vitin 2010. Pra në bazë të kësaj rritje del se mesatarisht popullsia ka shënuar rritje prej 826 banorë në vit. Brenda periudhë kohore 62 vjeçare popullsia e Rahovecit është rritur për më tepër se tri herë. Bazuar në indeksin bazik dhe vargor të rritjes së popullsisë në komunën e Rahovecit mund të vërejmë periudhat kohore kur ka pasur rritje më të theksuar të popullsisë.


Tabela 4. Popullsia në komunën e Rahovecit sipas indeksit

Vitet	Nr. i popullsisë	Indeksi bazik	Indeksi vargor
1948	20287	100	100
1961	26763	132	132
1971	35188	173	131
1981	46396	228	132
1991	59625	294	128
2010	71522	353	120



Grafiku 2. Popullsia në komunën e Rahovecit sipas indeksit

Sipas të dhënave nga tabela dhe grafiku vërehet se deri në vitet e 60-ta komuna e Rahovecit ka shënuar rritje demografike, por shkallët e kësaj rritje kanë qenë më e vogla nga fakti se kishte shkallë të larta të natalitetit dhe mortalitetit ku si pasoj kishte shtim të ulët natyror. Pas viteve të 60-ta gjegjësisht viteve të 70-ta kemi një rritje më të theksuar të popullsisë si pasojë e zvogëlimit të shkallëve të mortalitetit dhe në anën tjetër shkalla e natalitetit mbetet ende e lartë ku si pasojë kemi shkallë më të lartë të shtimit natyror. Popullsia e komunës së Rahovecit jeton në gjithsej 36 vendbanime, prej tyre 35 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 21354 banorë që do të thotë se rreth 30 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 50168 banor apo rreth 70 %.



Grafiku 3. Numri i popullsisë sipas vendbanimeve

Pjesa më e madhe e vendbanimeve të komunës së Rahovecit kanë më tepër se 1000 banorë. Numër më të madh të popullsisë ka vet qyteti i Rahovecit (21354 banor). Sa i përket vendbanimeve rurale, numër më të madh të banorëve kanë vendbanimet: Krushë e Madhe (5004), Ratkoc (4034), Bellacerka (3462), Xërxë (2943), Optrush (2832), Radost (2818). Ndërsa vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë janë: Bërnjak (35), Mrasor (312), Nashpall (318), Kaznik (427).

I.4.2. DENDËSIA E POPULLSISË

Dendësia e popullsisë në komunën e Rahovecit është rreth 260 banorë në 1 km², ku rreth 71522 banorë jetojnë në 275.5 km². Kjo është një dendësi relativisht e lartë e popullsisë, që në krahasim me mesataren e Kosovës ajo është më e lartë.

Brenda territorit të komunës së Rahovecit ekzistojnë dallime të theksuara sa i përket dendësisë së popullsisë. Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël. Kjo është në raport edhe me hapësirën e vendbanimit, ku disa vendbanime që kanë hapësirë më të vogël (zona kadastrale e vendbanimit është e vogël), dendësia e popullsisë është më e madhe.

Tabela 5. Dendësia e popullsisë

Nr.	Vendbanimet	Nr. i pop. 2010	Sip_km2	Banorë në 1 km2
1	Bellacerka	3462	11	315
2	Bërnjak	35	4.5	8
3	Bratotin	687	3.1	222
4	Brestovc	2081	5.5	378
5	Celinë	2419	5.7	424
6	Çifllak	1490	4.8	310
7	Dabidol	699	3.5	200
8	Denjë	1731	6.4	270
9	Drenoc	2098	8.1	259
10	Gexhë	563	3.2	176
11	Hoçë e Madhe	624	13.5	46
12	Hoçë e Vogël	1600	7	229
13	Kaznik	427	8.3	51
14	Kramovik	1399	10.3	136

15	Krushë e Madhe	5004	10.4	481
16	Mrasor	312	3.2	98
17	Nagavc	917	3.2	287
18	Nashpall	318	0.6	530
19	Opterushë	2832	9	315
20	Pastaselë	1114	5.4	206
21	Pataçan i Epërm	618	2.3	269
22	Pataçan i Ulët	954	5.5	173
23	Petkoviç	722	10	72
24	Palluzhë	1029	5.7	181
25	Radostë	2818	10.3	274
26	Rahovec	21354	49	436
27	Ratkoc	4034	11.3	357
28	Reti e Ulët	688		0
29	Reti	1820	9.8	186
30	Sapniç	1155	5	231
31	Sarosh	0		0
32	Senoc	950	4.4	216
33	Vrajakë	1013	5	203
34	Xërxë	2943	10.1	291
35	Zatriq	494	15.2	33
36	Zoçishtë	1118	5.2	215
TOTAL		71522	275.5	260

Dendësia më e lartë e popullsisë paraqitet në vendbanimin Nashpall me 530 banor në km², kjo për shkak se ky vendbanim ka një sipërfaqe me më pak se një km². Vendbanimet tjera me dendësi më të madhe janë Krusha e Madhe ku mesatarisht jetojnë rreth 481 banorë në një km², Rahoveci me 436 b/km², Celina me 424 b/km² etj.


Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Zatriqi (33 b/km²), Hoqa e Madhe (46 b/km²), Kaznik (51 b/km²).

I.4.3. SHTIMI NATYROR I POPULLSISË

Veçori themelore e popullsisë së Komunës së Rahovecit është se shtimi natyror në tërë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore ishte faktor primar i rritjes së përgjithshme të numrit të popullsisë. Në periudhën e pasluftës, krahas shkallës së lartë të natalitetit, edhe mortaliteti ishte mjaft i lartë për shkak të mortalitetit të lartë infantil, si rezultat i nivelit të ulët të zhvillimit social e mjekësor. Gjatë periudhës 1971 - 1981, krahas rënies së natalitetit, bie dukshëm edhe mortaliteti e me këtë zvogëlohet edhe shtimi natyror i popullsisë. Përkundër zvogëlimit, shkalla e natalitetit mbetet ende shumë e lartë (rreth 30 promil), ndërsa rënia rapide e mortalitetit ndikoi që shtimi natyror dhe rritja e përgjithshme e popullsisë në komunën e Rahovecit të mbetet e lartë. Kjo periudhë njëherit është edhe periudha kur popullsia e Rahovecit kishte rritje më të lartë të popullsisë, dhe një rritje e tillë ka ndikuar në krijimin e një popullate me moshë të re, që i takon tipit ekspansiv të strukturës së popullsisë sipas moshës. Pas viteve të 90-ta ndodh një thyerje e madhe lidhur me natalitetin, kur shkalla e tij zbritet deri në rreth 20 promil në vitet 1995 - 1996, ndërsa shtimi natyror rreth 16 promil. Kjo thyerje ndodh si pasojë e rrethanave të vështira socio-ekonomike dhe politike që ishin krijuar.

Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2009 janë vlerësuar duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Enti i Statistikës së Kosovës për vitin 2009 në tërë Kosovën dhe për komunat.

Gjatë vitit 2009 në komunën e Rahovecit janë shënuar 1255 lindje² dhe 205 vdekje³. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje për komunën e Rahovecit.



Grafiku 4. Shtimi natyror i popullsisë

Siç shihet edhe nga grafiku, shkalla e natalitetit në komunën e Rahovecit është 17.5 promil apo 1.75 %. Shkalla e mortalitetit është 2.3 promil apo 0.29 %. Në bazë të këtyre

² ESK, Statistikat e lindjeve në Kosovë 2009.

³ ESK, Statistikat e vdekjeve në Kosovë 2009

shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 14.6 promilë apo 1.46 %.


I.4.4. STRUKTURAT E POPULLSISË

Struktura e popullsisë është e lidhur ngushtë me lëvizjen natyrore dhe mekanike të popullsisë. Kjo strukturë mund të shqyrtohet nga aspekti biologjik, ekonomik, social, nacional, fetar etj.

STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS MOSHËS DHE GJINISË

Komuna e Rahovecit në aspektin e zhvillimit demografik ka veçorit e sajë edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktor demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Rahovecit ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë të zgjeruar të piramidës sipas moshës, edhe pse periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja.


Deri në vitet e 90-ta në komunën e Rahovecit ka dominuar plotësisht tipi progresiv i popullsisë, ku shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit kanë ndikuar drejtpërdrejtë në krijimin e këtij tipi të popullsisë. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëherit edhe me ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, piramida e popullsisë së komunës së Rahovecit kishte bazë të zgjeruar me dominimin e grup-moshave 0 deri 4 vjeç. Gjatë analizës së të dhënave demografike, vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë. Këto ndryshime mund ti dallojmë më çart përmes piramidës së popullsisë.



Grafiku 5. Piramida e popullsisë për komunën e Rahovecit


Të dhënat për grup-moshën janë marr nga vlerësimi i komunës për vitin 2003 dhe gjithashtu janë analizuar edhe numri i lindjeve në periudhën e fundit ku vërehet një rënie e tyre në krahasim me vitet e më parshme. Forma e piramidës ndryshon duke u ngushtuar baza e sajë dhe kjo si pasojë dy faktorëve: migrimeve dhe të tendencave të zvogëlimit të natalitetit. Nga piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 4 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup-moshën 5 deri 9 vjeç dhe 10 deri 14 vjeç.

Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.

**Grafiku 6.** Tri grup-moshat e popullsisë në komunës e Rahovecit

Mbi 40 % të popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç, ndërsa grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël me 8.8 % të popullsisë së përgjithshme.

Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Rahovecit ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 1051, që do të thotë se mesatarisht ekzistojë 1051 meshkuj në çdo 1000 femra.




Grafiku 7. Përqindja e popullsisë sipas gjinisë në komunën e Rahovecit

Siç shihet edhe nga grafiku, ekziston një deballans i vogël gjinor në popullsinë e komunës së Rahovecit, ku popullsia mashkullore dominon me 51.3 përqind në krahasim me popullsinë femërore që ka 48.7 përqind të popullsisë së gjithmbarshme.

Struktura etnike e popullsisë

Në aspektin etnik komuna e Rahovecit ka një ka një popullsi mjaft homogjene ku mbi 95 % e popullsisë janë shqiptar.



Grafiku 8. Pjesëmarrja e etniteteve në komunë

Sipas vlerësimit të vitit 2003, që është realizuar nga Komuna e Rahovecit, popullsia shqiptare dominon me 96.68 % ndërsa etnitetet tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël, Serbet me 2.72 % dhe Romët me 0.5 %.

Struktura ekonomike e popullsisë

Fillimi i shekullit XX e gjen Kosovën me mbeturina të bollshme të shoqërisë feudale në shumë segmente të jetës familjare dhe prodhuese. Pas tërheqjes së Turqisë në vitin 1912 gjendja e përgjithshme në Kosovë dhe rreth saj jo vetëm që nuk ndryshoi, por sikur u keqësua edhe më shumë nga okupimi serbë; Marrëdhëniet feudalo-çifligare nuk u suprimuan. Pushteti i instaluar serb ua morri tokën agallarëve dhe bejlerëve, por nuk ua dha fshatareve të varfër shqiptar; ky pushtet në kuadër të politikës kolonizuese që e zbatoi anëmbanë Kosovës, tokën ua ndau kolonëve serbë.⁴

Gjendje të njëjtë kishte edhe komuna e Rahovecit, dhe kjo gjendje nuk ndryshoi as pas Luftës së Dytë botërore, sa që kjo periudhë krahasohej me gjendjen e fillimit të shekullit. Një zhvillim inicial fillon pas viteve të 60-ta, por deri në përfundim të shekullit XX zhvillimi ekonomik dhe shoqëror në komunën e Rahovecit sikurse edhe në tërë Kosovën karakterizohej me tri probleme të mëdha: struktura jo e volitshme e ekonomisë, aftësia e dobët akumuluese dhe papunësia. Në vitet e 80-ta dhe të 90-ta komuna e Rahovecit sikurse edhe tërë Kosova u shëndrrua në koloni dhe zonë të okupimit klasik serb.

Krahas këtyre rrethanave të zhvillimit ekonomik, edhe struktura ekonomike në komunën e Rahovecit ka karakteristikat e veta.

Popullsia agrare dhe karakteristikat e sajë - Komuna e Rahovecit menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore trashëgoi një përqindje të lartë të popullsisë bujqësore, si pasojë e lënies krejtësisht padore të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore kalimi i popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore vazhdimisht rritej në komunën e Rahovecit, gjë që është ligjësi e përgjithshme në kuadër të zhvillimit ekonomik. Transferi i popullsisë nga bujqësia dhe të shumtën edhe nga fshati në veprimtari jobujqësore dhe në qytet zhvillohej në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa përgatitje profesionale dhe arsimore, në një anë, dhe në mënyrë indirekte, përmes shkollimit të gjeneratës së re dhe të ndryshimit të pozitës socio-ekonomike të popullsisë, në anën tjetër. Është karakteristik e përgjithshme se bujqësinë e braktis popullsia e re, vitale dhe e arsimuar. Por është e vështirë të konstatohet numri i saktë i kalimit të popullsisë agrare në veprimtari joagrarë.

Ndryshimet në strukturën profesionale dhe në atë të moshave të popullsisë ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë së aftë për punë, që paraqet ofertën disponuese të fuqisë punuese.

Viti 2003, sipas strukturës së moshave të Komunës së Rahovecit është kjo:

Numri i popullsisë aktive është 32.000 e prej tyre 16.744 janë meshkuj dhe 16.304 femra.

Në këto kushte të pamjaftueshme në zhvillimin ekonomik ndikon në rritjen e fuqisë së aftë punuese duke shkaktuar vështirësi të shfrytëzimit racional të fuqisë aktive punuese⁵.

Mundësit e rritjes së popullsisë aktive në Komunën e Rahovecit është privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore si dhe gjetja e tregut për plasimin e prodhimeve bujqësore si që janë: prodhimet e rrushit (raki; verat etj), pemë dhe perimet dhe ngritja e një objekti për përpunimin e perimeve që kultivohen në komunën e Rahovecit. Komuna e Rahovecit ka

⁴ Hivzi Islami, Studime demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008

⁵ Të dhënat nga Komuna e Rahovecit për vitin 2003

potencial bujqësor për kultivimin e prodhimeve sepse ka edhe sistemin e ujitjes (3.500 ha.).

Komuna e Rahovecit edhe sot e kësaj dite ka dominim të popullsisë agrare. pjesa më e madhe e popullsisë në komunë merret me veprimtari agrare dhe atë me rreth 50 %.

Familja dhe karakteristikat e sajë

Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomikë, social, demografik etj.⁶

Siç dihet, ekzistojnë dallime sipas komunave në Kosovë sa i përket madhësisë së familjes. Komuna e Rahovecit kryesisht karakterizohet me numër të madh të anëtareve të familjes, që është karakteristikë për vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale. Në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve për numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare në komunën e Rahovecit, del se mesatarja e madhësisë së familjes është 7.7 anëtar.

Ekonomi familjare me 1 - 3 anëtar ka mjaft pak dhe kjo është një dëshmi se, me gjithë transformimet socio-ekonomike dhe të tjera, proceset e modernizimit të shoqërisë në komunën e Rahovecit nuk kanë qenë të fuqishme për të kushtëzuar ndryshime rrënjësore në përbërjen e ekonomive familjare përmes shthurjes së ekonomive të zgjeruara tradicionale familjare në të ashtuquajtura familje nukleare, siç ka ndodhur në vendet e tjera të zhvilluara.

I.5. ÇËSHTJET SOCIALE

I.5.1. ARSIMI

Arsimimi është themeli i një shoqërie të shëndoshë, i cili garanton perspektivë për të ardhmen shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike në vend. Vitet e '90-ta, ishin të rënda për arsim në gjuhën shqip në Kosovë për arsye të largimit të dhunshëm nga objektet shkollore. Gjatë periudhës 90 - 99, shqiptarët organizojnë sistemin paralel të arsimit në Kosovë, ku në mënyrë mjaft të mirë e ruajtën arsimin nga asimilimi i gjithëmbarshtëm i shoqërisë në Kosovë. Lufta e fundit në Kosovë la pasojë të mëdha në infrastrukturën shkollore. Pas vitit 2000 (pas luftës), institucionet kosovare bënë përpjekje në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore. Në vitin 2002, krijuan një model të ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e re ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të mesëm të lartë. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re arsimit i obligueshëm është zgjatur për një vit nga 8 vite sa ishte në 9 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (fëmijët e moshës 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (klasët I - V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI - IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X - XII/XIII). Numri i objekteve shkollore gjithsejtë është 42, duke përfshirë edhe çerdhet dhe shkollat e mesme. Në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit


⁶ Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008.

janë të angazhuar rreth 846 punëtorë, prej të cilëve janë 710 mësimdhënës. Numri i nxënësve është gjithsej 14526, që do të thotë se kemi një raport prej 20.4 nxënës /mësimdhënës.

Arsimi para fillor

Çerdhe dhe kopshte – qyteti i Rahovecit posedon dy çerdhe

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar) – në tërë territorin e komunës mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 37 objekte shkollore ku mësimet i ndjekin rreth 11679 nxënës. Mesatarisht rreth 3 m² hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi në këtë nivel (shih rafikonin më poshtë). Me hapësirë shkollore të pamjaftueshme na paraqiten këto vendbanime: Drenoc (1.5 m² /nx.), Hoça e Vogël (0.9 m²), Kramovik (1.4 m²), Krusha e Madhe (1.4 m²), Pastasel (1.5 m²), Radostë (0.8 m²), Ratkoc (0.2 m²), Vrajakë (1.8 m²),



Grafiku 13. Hapësira shkollore në shkollat fillore

Pjesa dërmuese e vendbanimeve mësimin e zhvillojnë në dy ndërrime (25 shkolla), ndërsa shkollat që mësimin e zhvillojnë në një turn janë: Ajo e Dabidolit, Hoça e Madhe, Kaznikut, Mrasorit, Retisë së Ulët, Senocit dhe Zoqishtës. Sa i përket kualifikimit të mësimdhënësve, mund të thuhet se mesatarisht në të gjitha shkollat fillore të komunës 86% të personelit arsimor janë të kualifikuar dhe 14% të tjerë janë të pa kualifikuar. Në të gjitha shkollat kualifikimi i personelit kalon mbi 80% në përjashtim të vetëm dy shkollave: Pataqanit të Epërme me 70% dhe e Zatriqit me 70%.

Raporti nxënës/mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 18,7 nxënës mesatarja për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën. Përveç dy shkollave fillore që kanë më shumë se 20 nxënës për mësimdhënës (Sapniq 23.8 dhe Rahovec 22), të gjitha shkollat tjera kanë nga 20 e më pak nxënës për një mësimdhënës.

Arsimi i mesëm i lartë - përfshin tri dhe katër vite të shkollimit për nxënësit e grupmoshës 15 deri 18 vjeç. Në këtë komunë janë katër shkolla të mesme: 2 në Rahovec, një


në Krushë të Madhe dhe një në Ratkoc. Në këto shkolla numri i nxënësve që i ndjekin mësimet është 2844 nxënës, me një kuadër të mësimdhënësve prej 116 që janë të angazhuar në procesin edukativo-arsimor. Kualifikimet e personelit arsimor në këto katër shkolla të mesme sillet rreth 93.3% të kualifikuar dhe 6.7% të pakualifikuar. Numri më i madh i mësimdhënësve që nuk kanë kualifikim adekuat është në lëndën e matematikës dhe lëndët e gjuhëve të huaja, prandaj DKA-ja do të angazhohet që përmes konkurseve të kohëpaskohshme të hulumtojë dhe të gjejë kuadër të kualifikuar dhe të mjaftueshëm për këto lëndë mësimore. Ndërsa rreth 2.6 m² hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi, raporti nxënës/mësimdhënës në shkollën e mesme është 24.5. Mësimi zhvillohet në dy ndërrime në dy shollat në Rahovec dhe në atë të Ratkocit, ndërsa në shkollën e mesme të Krushës së Madhe mësimi zhvillohet në një ndërrim.

Në Shkollën e Mesme të Lartë në Ratkoc problem serioz është mospërputhja e orareve të udhëtimit të autobusëve me orarin mësimor në të dyja ndërrimet. Kështu që , është shumë e nevojshme që të bëhet një marrëveshje ndërmjet kompanive të autobusëve dhe institucioneve komunale, DKA-së dhe institucioneve të tjera, që të përshtatet orari i udhëtimit për nxënësit që vijnë në procesin mësimor në këtë shkollë. Përkrah të kësaj, Shkolla e Mesme e Lartë “12 Maji” nuk është në gjendje të mbajë orar të plotë mësimor në të dy ndërrimet, ashtu siç është paraparë me nga 45 minuta orë mësimore dhe me nga 7 orë maksimale në ditë.

Në Shkollat e Mesme të Larta të komunës sonë duhet të shikohet mundësia, sipas udhëzimit administrativ të MASHT-it, që në çdo shkollë të ketë roje.

(të vendoset tabela me numrin e nxënësve të shkollës së mesme të lartë)

Shkolla	SH.M.L “Xhelal Hajda – Toni” - Rahovec	SH.M.Serbe Rahovec	SH.M.L “12 Maji” - Ratkoc	SH.M.L “Ukshin Hoti” – Krushë e Madhe
Numri i nxënësve	1566	10	790	511


Harta 3. Rrjeti i shkollave në komunën e Rahovecit

I.5.2. SHËNDETËSIA

Sistemi shëndetësor në Kosovë pas përfundimit të luftës së vitit '99, u ballafaqua me vështirësi të shumta në çështje organizative, infrastrukturë si dhe në përkrahje financiare. OBSH, Banka ndërkombëtare, Bashkësia Evropiane dhe organizatat tjera ndërkombëtare me investime e tyre luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit shëndetësor. Gjatë kësaj periudhe pothuajse të gjitha objektet shëndetësore të dëmtuara gjatë luftës janë rinovuar dhe shumë objekte të reja janë ndërtuar. U ofruan ndihma në pajisje dhe aparatura mjekësore moderne të nevojshme dhe u organizuan trajnime në lëmi të ndryshme të mbrojtjes shëndetësore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve

kualitative dhe të leverdishme të kujdesit shëndetësor primar, sekondar dhe terciar në të gjitha institucionet shëndetësore.

Harta 4. Objektet shëndetësore në komunën e Rahovecit



Një pjesë e konsiderueshme e këtyre investimeve u përqendruan në reformimin e kujdesit parësor me inicimin e mjekësisë familjare si bartëse e këtij kujdesi dhe në këtë drejtim u organizua për herë të parë shkollimi superior i mjekëve dhe personeli shëndetësorë në këtë lëmi të mjekësisë. Angazhimi i strukturave vendore, edhe pse me shumë vështërsi, si dhe përkrahja dhe bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare sot e ngrenë konceptin e mjekësisë familjare në Kosovë, të paktën në pasurimin e njohurive teorike, në nivel të njëjtë me të gjitha vendet e tjera të rajonit. Gjithashtu edhe në Strategjinë shëndetësore të Kosovës 2005-2015, mjekësia familjare është sektor mjaft me rëndësi në zbatimin e synimeve dhe prioriteteve shëndetësore kryesore të identifikuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Edhe në komunën e Rahovecit, mjekësia familjare është shtylla kryesore e shëndetësisë e cila udhëhiqet nga Drejtoria e Shëndetësisë. DSH organizon punën në shërbimet primare shëndetësor, shërbimet sociale dhe shërbimet të inspektimit sanitar.

Në komunën e Rahovecit shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëvizshme të specializuara mjekësore. Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 10 objekte shëndetësore:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në qytetin e Rahovecit
- 6 QMF në vendbanimet: Ratkoc, Bellacerkë, Qifllak, Drenovc, Krushë e Madhe dhe Apterush

3 ambullanta në: Hoqë të Madhe, Lagjen për minoritete dhe Zoqisht

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Rahovec, si bartëse e kujdesit primar, është e vendosur në qytetin e Rahovecit dhe ka gjendje fizike të kënaqshme. Kjo qendër mbulon me shërbime territorin e Rahovecit dhe fshatrat përreth. Në këto institucion janë të punësuar gjithsej 87 punonjës, 28 mjek dhe 59 infermier - teknik.

I.5.3. SHËRBIMET SOCIALE

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Në komunën e Rahovecit funksionon edhe Qendra për punë sociale e cila merret me çështje të rëndësishme sociale siq janë: Banimi social, shëndeti mendor, shtresat e shoqëris si ata të moshuarit, integrimin e personave me çrregullime etj.

Banesat Sociale Kolektive – shërbejnë për familjet e pastrehë dhe që njëkohësisht janë raste të rënda sociale. Këto banesa tanimë janë ndërtuar në shumicën e komunave të Kosovës. Duke qenë se, komuna e Rahovecit ka një numër të konsiderueshëm të familjeve të pastrehë paraqitet nevoja për ndërtimin e këtyre banesave. Aktualisht nuk ekziston asnjë objekt me karakter të tillë në komunën e Rahovecit

Qendra e Shëndetit Mendor - Kjo Qendër është e një rëndësie të veçantë marrë për bazë personat me nevoja të veçanta respektivisht personat me retardime psikike të cilët kanë nevojë për trajtim ditor në këtë institucion. Duke qenë se dinamika e jetës familjare e cila është krijuar me shumë faktorë relevantë në gjendjen psiko-fizike të popullatës si pasojë e luftës, varfërisë ekstreme dhe problemeve të shumta familjare që reflektohen në relacione të ndryshme në popullatë, dukshëm kanë ndikuar në domosdoshmëri për një institucion të tillë ku do të trajtoheshin personat në nevojë.

Qendra për të moshuar – Në komunën e Rahovecit ekziston qendra për persona të moshuar po kjo qendër është në gjendje jo të përshtatshme për shfrytëzim dhe nuk i plotëson fare këkesat e kësaj shtrese të shoqërisë.

Shtëpia integruese – Stacionimi i përkohshëm e personave me probleme mendore deri në gjashtë muaj ku ata përmes punës së shëndetit mendor riaftësohen për rikthim në familje dhe ri-integrim në shoqëri. Një objekt i karakterit të tillë mungon në komunën e Rahovecit.

Shtëpia Edukuese - është një institucion në të cilin vendosen fëmijët pas shqyrtimit të masës nga ana e gjykatës apo organi i kujdestarisë, dërgimi në shtëpinë edukuese të të miturve me çrregullime në sjellje ose sjellje asociale. Objekti i tillë ka rëndësi të veçantë social dhe mungon në komunën e Rahovecit.


I.5.4. PAPUNËSIA NË RAHOVEC

Papunësia është një ndër problemet me të cilën më së shumti po përballlet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 44.4%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaj rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat (58.06%), pavarësisht nga shkalla shumë e lartë e jo aktivitetit për ato. Edhe pse, nuk ka të dhëna të sakta për shkallën e papunësisë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia është e lartë.

Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se shkalla e papunësisë në komunën e Rahovecit është e lartë (28.39%). Vlerësohet se rreth 80 % e të papunëve janë të papunë afatgjatë (të papunë për më shumë se 12 muaj).


Sipas analizës së të dhënave për punëkërkuesit e paraqitur në zyre të punësimit, në këtë komunë janë paraqitur si të papunë 7301 persona, që është rreth 8 % e papunësisë në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë. Mirëpo nese krahasohet kjo shifer me numrin e popullsisë aktive dhe kur merret parasysh se një numër i konsiderueshëm i të papunëve nuk paraqiten në zyrën për punësim, atëher del se përqindja e papunësisë në komunën e Rahovecit është shumë më e lartë.

Kjo shkallë e lartë e papunësisë ka prekur të gjitha grup moshat ku më pak e ku më shumë. Shih grafikun;



Grafiku 9. Punëkërkuesit sipas moshës dhe gjinisë

Papunësia më e lartë është e shprehur te grup moshë e popullsisë 25-39 vjeç (49.4%), me rritjen e moshës zvogëlohet shkalla e papunësisë. Te grup-moshat e reja (15-24) paraqitet numri i vogël i punë kërkuese kjo nga fakti se një pjesë e konsiderueshme e këtyre grup-moshave vijojnë studimet. Ndërkaj, numri i punëkërkuesve më së shumti është i shprehur te gjinia mashkullore, ku te të gjitha grup moshat gjinia mashkullore është me shkalla më të lartë të punëkërkuesve. Kjo nuk do të thotë se numri më i madh i të papunëve është te gjinia mashkullore, por më së shumti paraqiten në zyrën për punësim persona të gjinisë mashkullore, për deri sa numri i femrave që kërkojnë punë është më i vogël.



Grafiku 10. Numri i punëkërkuesëve


Me shkallë më të lartë të papunësisë paraqitet popullsia pa kualifikime (79.7%), më pas me shkallë të papunësisë më të vogël përfaqësohet popullsia me nivel të shkollimit të mesëm (14.4%) dhe me shkallë shumë më të ulët është e përfaqësuar popullsia me nivel të lartë të shkollimit (0.4%) por gjithsesi edhe përkundër kualifikimeve të larta (shkollë të lartë fakultet etj) është e prekur nga papunësia.

I.5.5. VARFËRIA NË RAHOVEC

E shkaktuar nga një mori faktorësh, varfëria është e përhapur gjerësisht në Kosovë. Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se mbi gjysma e popullsisë (50.3%) jetojnë në varfëri të përgjithshme, ndërsa rreth 13% e popullsisë jeton në varfëri ekstreme.

Largimet e dhunshme nga puna të popullsisë shqiptare nga pushtuesi serb, në fillim të viteve të '90-ta, shkallë e ulët e arsimimit, zhvillim i pa balancuar ekonomik, shkatërrimet e shtëpive, bizneseve dhe ndërmarrjeve nga lufta e fundit në Kosovë ('99), etj. ndikuan drejtpërsëdrejti në shkallën e lartë të varfërisë. Varfëria ka prekur të gjitha komunat e Kosovës ku më pak e ku më shumë është e theksuar.

Sipas hulumtimeve të bëra nga organizata të ndryshme përkatësisht UNDP-së, shkalla e përgjithshme e varfërisë në komunën e Rahovecit është 73.54 %. kemi këtë paraqitje të varfërisë;


**Grafiku 11.** Shkalla e varfërisë në Rahovec

Sipas hulumtimit të lartpërmendur 12.35% e popullsisë së kësaj komune jetojnë me një dollar në ditë për person, 69.57% e popullatës jeton me dy dollar në ditë për person, në varfëri ekstreme jetojnë 10.86% e popullsisë dhe me varfëri të përgjithshme jetojnë 72.20% e popullsisë.

Ndërsa, pas grumbullimit të dhënave nga Qendra për Punë Sociale për numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve nëna me asistencë sociale dhe analizave të bëra na paraqitet shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Këto të dhëna, na ndihmojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës.

Sipas të dhënave del se në komunën e Rahovecit ekzistojnë 2581 persona apo 590 familje që jetojnë me asistencë sociale, që nënkupton se kjo pjesë e popullsisë jeton në varfëri ekstreme. Ndërkaq, varfëria e përgjithshme përfshinë një përqindje më të madhe të popullsisë.

Me shkallë më të lartë të varfërisë është e prekur gjinia mashkullore me 75%, kurse me asistencë sociale 25% janë kryefamiljare nëna. Kjo shkallë e lartë e varfërisë është e shtrirë gjerësisht në tërë territorin. Për me tepër shih grafikonin;

**Grafiku 12.** Popullsia me asistencë sociale

Vendbanimet që kanë përqindje më të vogël të popullsisë me asistencë sociale janë: Bellacerka, Nashpalli, Radosti, Sapniqi, Zoqishta, Palluzha, Krusha e Madhe, Kramoviku, Brestovci dhe Bratotini. Ndërsa vendbanimet me përqindje më të madhe të popullsisë me asistencë sociale janë: Kazniku, Senoci, Zatriqi, Petkoviqi dhe Dabidoli.

Në shkallën e lartë të varfërisë kanë ndikuar një mori faktorësh: dëbimi i popullsisë shqiptare nga vendet e punës nga pushtuesi serb nga fillimi deri në fund të viteve të '90 -ta, shkatërrimet e luftës, shkalla e lartë e papunësisë, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, të ardhurat e vogla për kokë banori, arsimimi i pamjaftueshëm etj. Të gjitha këto kanë bërë që ky problem të jetë kaq madhor. Njerëzit në kategoritë e mëposhtme ka të ngjarë të jetojnë në varfëri: të papunët, ata në punë me orar të reduktuar ose punë të pasigurta, të moshuarit, të sëmurët, të paaftët, si dhe anëtarët e familjeve të mëdha ose të familjeve me një prind, pensionistet, familjet me kryefamiljare nëna, etj. Papunësia e lartë e viteve të fundit pas '99 nuk duket se mund të bjerë në të ardhmen e afërt, ndërsa papunësia e tej zgjatur po i shtyn gjithnjë e më shumë familjet drejt varfërisë.

I.6. VENDBANIMET, BANIMI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

I.6.1. Tipologjia e vendbanimeve sipas madhësisë

Vendbanimet janë njësi hapësinore antropogjene, të cilat karakterizohen me zonën e ndërtuar dhe territorin e përcaktuar administrativ. Tërë aktiviteti dhe organizimi i jetës së njeriut dhe shoqërisë njerëzore ka qenë dhe është i lidhur për to.

Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte. Pikërisht nga kjo arsye vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë populative dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejshëm të komunës apo edhe më gjerë.

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në:

Vendbanimet e vogla rurale, të mesme rurale, të mëdha rurale dhe vendbanimet e karakterit urban.

Vendbanimet sipas madhësisë në komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në këto grupe të madhësisë:

- I. Vendbanimet e vogla deri 500 banorë.
- II. Vendbanimet e madhësisë së mesme 500 – 999 banorë
- III. Vendbanimet e madhësisë 1000-1999 banorë.
- IV. Vendbanimet e mëdha rurale 2.000-4999 banorë.
- V. Vendbanimet e karakterit urban

Në bazë të këtij kategorizimi, në vitin 2010, në grupin e vendbanimeve të vogla, me më pak se 500 banorë janë vetëm 5 vendbanime, nga 36 sa janë gjithsej në territorin e komunës dhe një vendbanim është zbrazur plotësisht, Saroshi; Vendbanimet me më

pak se 500 banorë janë: Bërnjaku me 35 banorë, Kazniku 427 banorë, Mrasori me 312 banorë, Nushpali 318 banorë, dhe Zatriqi me 491 banorë.

Në kategorinë e dytë të vendbanimeve, të madhësisë 500-999 banorë, janë 10 vendbanime; Bratotin 687 banorë, Dabidol 699 banorë, Gexhë 563 banorë, Hoça e Madhe 624 banorë, Nagavc 917 banorë, Pataçan i Epërm 618 banorë, Pataçan i Ulët 954 banorë, Petkoviç 722 banorë, , Retijë e Ulët 688 banorë dhe vendbanimi Senoc me 950 banorë.


Në kategorinë e tretë të vendbanimeve, të madhësisë 1000-1999 banorë, janë 10 vendbanime; Çifllak 1490 banorë, Denjë 1731 banorë, Hoçë e Vogël 1600 banorë, Kramovik 1399 banorë, Pastasellë 1114 banorë, Polluzhë 1029 banorë, Reti 1820 banorë, Sapniç 1155 banorë, Vrajakë 1013 banorë dhe Zoçishtë 1118 banorë.

Në kategorinë e katërt të vendbanimeve, të madhësisë 2000-4999 banorë, janë 8 vendbanime: Bellacerkë 3462 banorë, Brestovc 2081 banorë, Celinë 2419 banorë, Drenoc 2098 banorë, Opterushë 2832 banorë, Radostë 2818 banorë, Ratkoc 4034 banorë dhe Xerxë 2943 banorë.

Në kategorinë e pestë, me mbi 5 mijë banorë radhiten 2 vendbanime: Rahoveci-qendër komunale me 21354 banorë dhe Krusha e Madhe 5004 banorë.

Vendbanimi Rahovec, si qendër komunale, shtrihet rrëzë shpateve të malit Opterushë, afër rrugëve të rëndësishme që lidhin dy qendrat më të rëndësishme të Kosovës; Prishtinën e Prizrenin dhe më gjerë. Pozita e volitshme e vendbanimit rrëzë kodrinave duhej të ishte atraktive për banim që nga lashtësia.

Harata 5. Vendbanimet sipas madhësisë



Në aspektin hapësinor Rahoveci si vendbanim i takon tipit të grumbulluar të vendbanimeve. Ndërsa në aspektin funksional është qendër e rëndësishme për territorin administrativ prej 275.5 km² dhe gravitimin e popullsisë prej 71522 banorë, të shpërndarë në 35 vendbanime.

Zona kadastrale e Rahovecit zë sipërfaqen prej 4887 ha, ndërsa zona e ndërtuar arrin në 254 ha, duke mbuluar 5.2% të territorit kadastral, me dendësinë e banimit prej 105.1 b/ha.

Rahoveci është qendër atraktive për banorët e rrethinës ndërsa këte e dëshmon pjesëmarrja e numrit të banorëve të qytetit në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë së komunës që ka ndryshuar dukshëm nga viti 1948 e deri sot. Derisa në vitin

1948 Rahoveci si vendbanim kishte 5600 banorë, ose 27.5% të popullsisë së territorit të njëjtë administrativ, në vitin 2010 pjesëmarrja e numrit të banorëve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë së komunës arrin në 29.8%.

Madhësia mesatare e vendbanimeve në komunën e Rahovecit është 1988 banorë, ndërsa nëse llogarisim vetëm numrin e popullsisë së vendbanimeve rurale, pa qytetin e Rahovecit, atëherë madhësia mesatare e vendbanimeve për nga numri i popullsisë është 1433 banorë. Dallimet në numrin e popullsisë të disa vendbanimeve janë të konsiderueshme, ndërsa nëse bëjmë krahasimet pa qytetin e Rahovecit atëherë dallimet sillen në mes maksimumit 5004 banorë (Krusha e Madhe) dhe minimumit 35 banorë (Bërnjak), që është dallim shumë i madh. Këto dallime janë të kushtëzuara nga pozita e vendbanimit dhe gjeomorfologjia e terrenit. Prandaj, është me rëndësi edhe analiza e shtrirjes së këtyre vendbanimeve sipas zonave të lartësisë mbidetare.

Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve.

I.6.2. Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë


Karakteristikë për komunën e Rahovecit është numri më i madh i vendbanimeve, i grupit të vendbanimeve të mëdha dhe të kategorisë së mesme, ndërsa rreth 20% e territorit (viset kodrinore-malore mbi 600 m) është e banuar më rrallë dhe me vendbanime të vogla. Në zonën e ulët nën 400 m ka më së shumti vendbanime që i takojnë kategorisë së vendbanimeve të mëdha (2000-5000 banorë) 12 vendbanime, ose 92.3% të kësaj kategorie dhe vendbanimet e kategorisë së mesme (1000-2000 banorë) 8 vendbanime ose 72.7% e kësaj kategorie të vendbanimeve shtrihen në këtë zonë.

Zona kodrinore-malore mbi 600 metra karakterizohet me vendbanime të vogla të kategorisë 500-999 banorë, në të cilën zonë shtrihen vetëm 3 vendbanime: Kazniku, dhe Zatriqi, ndërsa vetëm Drenoci i takon kategorisë së vendbanimeve të mëdha me 2098 banorë që shtrihet në këtë zonë. Pothuajse të gjitha vendbanimet në komunën e Rahovecit kanë pasur rritje nga viti 1991-2010 (përveç vendbanimit Zatriq që ka zvogëlim të numrit të popullsisë, ndërsa disa vendbanime që kanë terren të pa volitshëm kanë rritje të ngadalsuar të popullsisë.

Tabela 6. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë demografike, 1991-2010*

Vendbanimet sipas kategorive të madhësisë	Numri i vendbanimeve			
	1991	%	2010	%
0-499	7	20	6	16.6
500-999	10	28.6	10	27.8
1000-1999	10	28.6	10	27.8
2000-4999	7	20	8	22.2
Mbi 5000	1	2.8	2	5.6
Gjithsej	35	100.0	36	100.0

*Në tabelë dy vendbanime, në vitin 1991, janë përfshi në një zonë kadastrale



Grafiku 14. Ndryshimet në numrin e vendbanimeve sipas madhësisë demografike, 1991-2010

Nga tabela dhe Grafiku vërehen ndryshime shumë të rëndësishme pozitive në strukturën e vendbanimeve nga se vendbanimet e kategorisë së vogël deri në 500 banorë kanë pasur zvogëlim në numër, nga 7 sa ishin në vitin 1991, në 6 në vitin 2010.

Vendbanimet e kategorisë 500-999 banorë nuk janë shtuar në numër, nga 10 sa ishin në vitin 1991, mbetën sërish në 10 vendbanime në vitin 2010, por gjithashtu edhe vendbanimet e kategorisë 1000-1999 banorë mbetën në numër të njëjtë, nga 10 sa ishin në vitin 1991, në 10 vendbanime në vitin 2010.

Ndërsa, vendbanimet e mëdha të kategorisë 2000-5000 banorë e kanë rritë numrin nga 7 në vitin 1991 në 8 në vitin 2010, dhe në fund, numri i kategorisë së vendbanimeve mbi 5000 banorë është rritë nga 1 sa ishte në vitin 1991, në 2 në vendbanime në vitin 2010 (Rahoveci, Krusha e Madhe).

Pra në përgjithësi vërehet një rritje e përgjithshme e numrit të popullsisë pothuaj se në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Ky trend i zhvillimit është brenda rrjedhave normale të zhvillimit demografik bazuar në shkallën pozitive të shtimit natyror të popullsisë.

I.6.3. Karakteristikat morfologjike-urbanistike të vendbanimeve

Pothuajse të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit janë formuar në mënyrë spontane. Ndërsa forma e tyre e parregullt është si pasojë e kushteve natyrore në terren, por edhe faktorëve shoqëror-ekonomik dhe historik.

Rahoveci si qendër komunale dhe i vetmi vendbanim i karakterit urban vetëm me një pjesë të vogël mund të konsiderohet me plan. Shikuar në aspektin e strukturës morfologjike-urbanistike, dallohen këta tipa të vendbanimeve:

Tipi i grumbulluar i vendbanimeve–Strukturën e këtyre vebdbanimeve e karakterizon koncentrimi i madh i objekteve ndërtimore, oborreve ekonomike etj, kurse numri më i madh i parcelave për nga madhësia e sipërfaqeve është e vogël. Ky tip i vendbanimeve kryesisht është prezent në zonën e ulët të fushës. Oborret ekonomike janë të madhësive të ndryshme, por zakonisht me sipërfaqe të vogla. Ndërsa ato janë të shfrytëzuara në mënyrë maksimale, qoftë në pjesën e përparme, kah rruga, apo në pjesën e mesme të tyre. Në këto vendbanime është e theksuar çartë zona e ndërtimit që është e ndarë nga zona e punës.

Në bazë të konsultimit të hartave topografike dhe kadastrale, është vlerësuar se shumica e këtyre vendbanimeve kanë pozitë të përshtatshme në raport me zonat e tyre kadastrale dhe janë të lidhura mjaft mirë mes veti si dhe me qendrat tjera të rendit më të lartë.

Te këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë vijës së asfaltuar të vendbanimit me karakter rendor të objekteve. Kjo ndodh kryesisht për t'u liruar nga dendësia e madhe dhe afrimi në rrugën kryesore. Ky proces mund të quhet transferimi i fshatit nga tipi grumbullor në tip rendor ose zbritja e fshatit në rrugë. Te këto vendbanime në disa raste vërehet edhe procesi i aglomerimit ose bashkimit të tyre për shkak të zgjerimit dhe afërsisë së tyre, varësisht nga kushtet gjeomorfologjike të terrenit: Brestoc - Hoqë e Vogël - Nagavc-Krushë e Madhe - Celinë, pastaj Xerxë -Gexhë - Radost - Ratkoc - Dejnë - Dabidol, si dhe Drenoc - Senoc - Pastasellë. Për shkak të zgjerimit dhe formës aglomerative në hapësirë këto vendbanime në të ardhmen nuk mund ta ruajnë kuptimin e fshatit.

Lidhur me vendbanimet e tipit të dendur mund të konstatohet se ky tip i vendbanimeve në krahasim me tipin e shpërndarë të fshatit është shumë më i përshtatshëm sepse ato paraqesin mundësitë për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës me pajisje urbane dhe objekte të standardit shoqëror.

Tipi i zgjatur (linear)–Këto vendbanime i takojnë tipit të dendur rendor dhe shtrihen kryesisht në sipërfaqe të rrafshëta dhe përgjatë rrugëve magjistrale ose lokale në zonën e ulët: Drenoc, Senoc, Pastasellë, Brestoc, Hoqë e Vogël, Nagavc, Krushë e Madhe, Celinë, Xerxë, Gexhë, Radost, Ratkoc, Dejnë, Dabidol. Këto vendbanime karakterizohen me parcela të vogla ndërtimore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është se kanë tendencë të zgjerimit dhe bashkëngjitjes duke krijuar kështu korridore ndërtimore përgjatë rrugës. Një proces i tillë ka marrë hov sidomos kohëve të fundit, përkundër faktit se një trend i tillë në aspektin urbanistik dhe hapësinor është i pavolitshëm, ngase ato i përcjellin një mori problemesh e konfliktesh si dhe paraqesin pengesë në zhvillimin normal të komunikacionit ndër-urban

Një numër i vendbanimeve të tipit linear shtrihen në tokat pjellore me objekte të ndërtuara në dy fronte dhe me rrugën në mes.

Tabela 7. Popullsia dhe dendësia e banimit në zonat e ndërtuara, në hektar*

Zona	Nr.popull.	Zona e ndertuar	Dendësia
Zona e ulët nen 600 m		ha	ban/ha
1. Bellacerkë	3462	54.9	63.0

2. Bërnjak	35	11.8	3.0
3. Bratotin	687	9.4	73.0
4. Brestovc	2081	32.5	64.0
5. Celinë	2419	43.9	55.0
6. Çifllak-Sarosh.	1490	27.7	53.8
7. Dabidol	699	13.8	50.6
8. Dejnë	1731	29.4	58.9
9. Gexhë	563	21.1	26.8
10. Hoçë e M.	624	27.9	22.4
11. Hoçë e V.	1600	30.8	51.9
12. Kramovik	1399	29.8	23.7
13. Krushë e M.	5004	95	52.7
14. Mrasor	312	5.7	54.7
15. Nagavc	917	18.1	50.9
16. Nushpal	318	4.8	66.2
17. Opterushë	2831	45.7	61.9
18. Pastaselë	1114	23.4	47.6
19. Pataçan i Ep.	618	10.0	61.8
20. Pataçan i Ul.	954	25.8	37.0
21. Petkoviq	722	12.8	56.4
22. Polluzhë	1029	18.7	55.0
23. Radostë	2818	62.5	45.1
24. Rahovec	21354	254	85.0
25. Ratkoc	4034	86.3	46.7
26. Retij e U.	688	11.7	58.8
27. Retijë	1820	22.1	82.7
28. Sapniq	1155	17.9	64.2
29.Sarosh	0	0	0
30. Senoc	950	20.2	47.0
31. Vrajakë	1013	14.8	67.5
32. Xërxë	2943	116.1	25.3
33. Zoçishtë	1118	23.2	48.2
Zona kodri.-malore mbi 600 m			
34.Drenoc	2098	41.8	49.9
35.Kaznik	427	11.7	36.5
36.Zatriq	494	12.1	40.8

* Në tabelë dy vendbanime janë përfshi në një zona kadastrale

Nga tabela shihet se vendbanimet rurale kanë dendësi mjaft të lartë, sikurse Retija, Bratotini, Brestovci, Vrajaka, Sapniqi, Bellacerka, ndërsa Rahoveci si qendër e karakterit urban dallohet për nga dendësia e banimit nga shumë vendbanime të tjera, por megjithatë në këtë vendbanim urban ka vend për rritjen e dendësisë edhe për një shkallë që lejohet me standarde për qendra të nivelit të tillë.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, vetëm 1.3 km², ose 4.6 % e territorit është zonë e ndërtuar e mbuluar nga vendbanimet. Këto dispozita janë parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe mjaft funksional për komunën e Rahovecit.

I.6.4. Funksionaliteti i vendbanimeve


Sistemin e vendbanimeve në komunën e Rahovecit e përbëjnë: 1 qendër urbane, në të cilën gravitojnë 35 vendbanime dhe 7 qendra lokale, në të cilat gravitojnë mesatarisht nga 4 vendbanime pa funksione.

Vendbanimet e komunës së Rahovecit mund t'i klasifikojmë sipas funksioneve themelore në këto tipe:

- vendbanimet rurale primare,
- vendbanimet me qendrën rurale,
- qendra komunale.

Grupit të parë të vendbanimeve, të cilat janë pa funksione, i takojnë ato vendbanime në të cilat jeton popullsia që merret kryesisht me bujqësi, ndërsa funksionet eksetrne në këto vendbanime mungojnë. Këto vendbanime paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrës dhe në viset kodrinore, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë, transformimi i vogël, si dhe lidhje më e dobët me qendrën kryesore. Këto vendbanime në të ardhmen do t'i përcjellin ndryshimet më të ngadalshme nga se prioritet do të ken vendbanimet qendrore.

Harta 6. Organizimi funksional i vendbanimeve



Me qëllim të ngritjes së standardit jetësor në këto vendbanime duhet gjetur forma dhe mënyra për të stimulimuar prodhimtarinë bujqësore, zhvillimin e turizmit rural stimulimin e blegtorisë me organizim dhe teknologji bashkëkohore si dhe me ndryshimin e skemës së organizimit funksional përmes nominimit dhe zhvillimit të qendrave dhe bashkësive rurale. Ngritja e standardit jetësor mund të realizohet me lidhjen e vendbanimeve me ndërtimin e rrugëve nga se rruga është parakusht për ekzistencën e këtyre vendbanimeve, pastaj, pajisjen e këtyre vendbanimeve me funksione të domosdoshme me të cilat do të përmbushin nevojat e përditshme të popullsisë. Si vendbanime primare janë edhe një numër i fshatrave pranë qytetëse me numër të konsiderueshëm të popullsisë jobujqësore që punojnë në qytet dhe funksionojnë të lidhura me qytetin.

Vendbanimet me qendrën rurale-Janë ato vendbanime të cilat i bashkojnë dy e më tepër fshatra primare në një tërësi shoqërore-ekonomike dhe hapësinore. Në këto vendbanime, përveç funksioneve interne, janë të zhvilluara edhe funksionet e jashtme të cilat u shërbejnë edhe popullsisë së vendbanimeve përreth. Këto vendbanime njëherit paraqesin njësitë polarizuese të zonës në hapësirë. Nga funksionet shoqërore, në këto vendbanime ndodhet bashkësia lokale dhe zyra e vendit, shkolla fillore, ambulanca, shitoret me shumicë e pakicë për furnizimin e popullsisë, ndonjë veprimtari zejtare, etj. Këto vendbanime paraqesin tip kalimtar nga ato tradicionale-bujqësore, në të përziera, sepse në to jeton një numër i konsiderueshëm i popullsisë jobujqësore.

Një numër i konsiderueshëm i këtyre vendbanimeve ndodhet jo larg qytetit. Ato i karakterizojnë një shkallë mjaft e lartë e transformimit po edhe deagrarizimit. Numri i këtyre vendbanimeve në komunë arrin në 8, duke përfshi edhe qytetin e Rahovecit, ose 23.5% nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve rurale. Vendbanimet me funksione qendrore në komunën e Rahovecit janë: Çifllaku, Drenoci, Hoça e Vogël, Krusha e Madhe, Opterusha, Ratkoci dhe Xerxa. Në këto vendbanime tani janë paraqitur shenjat e semi-urbanizimit si pasojë e veprimit të faktorëve urban, në një anë dhe, prodhimtarisë së modernizuar të bujqësisë në anën tjetër. Shumica e këtyre vendbanimeve i takojnë kategorisë së vendbanimeve të mesme ose të mëdha (mbi 2000 banorë) Ratkoci, Krusha e Madhe, Drenoci, Opterusha, Xerxa, Hoça e Vogël, ndërsa të kategorisë mesme është vetëm Çifllaku me 1490 banorë. Në këto vendbanime gravitojnë mesatarisht 7166 banorë. Ndërsa, nëse e llogarisim edhe Rahovecin si qendër komunale atëherë në këto qendra gravitojnë mesatarisht 8940 banorë.

Në grupin e vendbanimeve urbane bën pjesë vetëm Rahoveci si qendër komunale në të cilën janë të vendosura funksionet shoqërore-ekonomike që i shërbejnë tërë territorit,

I.6.5. Rrjeti i vendbanimeve

Rrjetin e vendbanimeve në komunën e Rahovecit e përbëjnë 35 vendbanime, nga të cilat dallohet qendra komunale dhe 7 qendra tjera lokale, në të cilat qendra gravitojnë 27 vendbanime, prej të cilave vetëm Rahoveci është vendbanim i karakterit urban me 21354 banorë, ose rreth 30% e popullsisë së komunës, ndërsa vendbanimet tjera janë rurale, me numrin e popullsisë rurale prej 50168 banorë ose rreth 70% të popullsisë së komunës.

Tabela 8. Karakteristikat e rrjetit të vendbanimeve dhe dendësia e popullsisë në km


Nr.	Vendbanimet	Nr. i pop. 2010	Sip_k ^m ²	Banorë në 1 km ²
	Zona e ulët nën 600 m			
1	Bellacerka	3462	11	315
2	Bërnjak	35	4.5	8
3	Bratotin	687	3.1	222

4	Brestovc	2081	5.5	378
5	Celinë	2419	5.7	424
6	Çifllak	1490	4.8	310
7	Dabidol	699	3.5	200
8	Denjë	1731	6.4	270
9	Gexhë	563	3.2	176
10	Hoçë e Madhe	624	13.5	46
11	Hoçë e Vogël	1600	7	229
12	Kramovik	1399	10.3	136
13	Krushë e Madhe	5004	10.4	481
14	Mrasor	312	3.2	98
15	Nagavc	917	3.2	287
16	Nashpall	318	0.6	530
17	Opterushë	2832	9	315
18	Pastaselë	1114	5.4	206
19	Pataçan i Epërm	618	2.3	269
20	Pataçan i Ulët	954	5.5	173
21	Petkoviç	722	10	72
22	Palluzhë	1029	5.7	181
23	Radostë	2818	10.3	274
24	Rahovec	21354	49	436
25	Ratkoc	4034	11.3	357
26	Reti e Ulët	688		0
27	Reti	1820	9.8	186
28	Sapniç	1155	5	231
29	Sarosh	0		0
30	Senoc	950	4.4	216
31	Vrajakë	1013	5	203
32	Xërxë	2943	10.1	291

33	Zoçishtë	1118	5.2	215
	Zona kodrinore-malore mbi 600 m			
34	Drenoc	2098	8.1	259
35	Kaznik	427	8.3	51
36	Zatriq	494	15.2	33
	TOTAL	71522	275.5	260

Madhësia mesatare e vendbanimeve është 1988 banorë, ndërsa dendësia mesatare e popullsisë arrin në 260 banorë në km², por me dallime të konsiderueshme, varësisht nga karakteristikat gjeo-morfologjike të terrenit.

Harat 7. Rrjeti i vendbanimeve



Në zonën e ulët nën 400 metra të lartësisë mbidetare shtrihen 22 vendbanime ose 65.7% nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve të komunës, me dendësi mesatare prej 520.8 banorë në km². Kjo njëherit është edhe hapësira me dendësi më të madhe në komunë, 2 herë më e lartë se mesatarja e komunës dhe 10.3 herë më e lartë se në viset kodrinore malore. Madhësia mesatare e vendbanimeve në këtë zonë është 3391.7 banorë ose 1.4 herë më e madhe se mesatarja e komunës.

Ndërsa në hapësirën kodrinore-malore, mbi 600 metra të lartësisë mbidetare, shtrihen 3 vendbanime ose 8.6 % të vendbanimeve të komunës, me dendësinë e popullsisë prej 65 banorë në km² dhe, njëkohësisht, kjo zonë paraqet territorin më rrallë të banuar në komunë.

Me rëndësi të veçantë, në këtë rast do të ishte edhe analiza e dendësisë hapësinore të vendbanimeve dhe largësia mesatare e tyre. Dendësia mesatare e vendbanimeve në komunë është 12.7 vendbanime në 100 km² (në Kosovë 13,22 vendbanime në 100 km²). Në dendësinë e rrjetit të vendbanimeve janë të dukshme dallimet varësisht nga pozita apo gjeomorfologjia e terrenit. Në zonën e ulët nën 400 metra të lartësisë mbidetare, dendësia e vendbanimeve është 19 vendbanime në 100 km². Në zonën mbi 600 metra të lartësisë mbidetare dendësia e vendbanimeve arrin në 5.2 vendbanime në 100 km, ose rreth 3.5 herë më pak se në zonën e ulët. Dendësia e rrjetit të vendbanimeve shprehet edhe përmes largësisë hapësinore të vendbanimeve. Andaj në bazë të kësaj, largësia mesatare ndërmjet vendbanimeve në nivel të komunal është 2.8 km, që është pothuajse e barabartë me atë të Kosovës. Ndërsa, në zonën e ulët nën 400 metra largësia mes vendbanimeve është 2.2 km.

Tabela 9. Dendësia dhe distanca mesatare e vendbanimeve në komunë

Hapësira	Dendësia e vendbanimeve në 100 km ²	Distanca mesatare mes vendbanimeve
Hapësira kodrinore - malore	5.2	4.4
Hapësira nën 400 metra lartësi mbidetare	19	2.2
Komuna	12.7	2.8

Në viset kodrinore malore largësia mes vendbanimeve është 4,4 km dhe në hapësirën nën 400 metra të lartësisë mbidetare largësia është 2,2 km (në Kosovë 2,76 km).

Vendbanimet të cilat shtrihen në zonën e ulët nën 400 metra të lartësisë mbidetare kanë arritur një shkallë mjaft të lartë të zhvillimit dhe transformimit të tyre.

Në bazë të rezultateve të kalkuluara në tabelë vërehet se territori i komunës është i populluar në mënyrë të pabarabartë dhe me dallime të konsiderueshme mes zonave hipsometrike.


Hapësirën e komunës e përbëjnë tri tërësi morfologjike që dallojnë nga njëra-tjera në bazë të karakteristikave gjeografike natyrore:

zona fushore nën 400 metra lartësi mbidetare, me sipërfaqe prej 116 km² ose 42.2% të hapësirës së gjithmbarshme të komunës,

zona kodrinore 400-600 metra të lartësisë mbidetare, e cila përfshin sipërfaqen prej 102.3 km² ose 37.1% të komunës, dhe

zona kodrinore-malore mbi 600 metra lartësi mbidetare, me sipërfaqe prej 57.2 km² ose 20.7%.

Harta 8. Hipsometria e terrenit



Zona kodrinore-malore zë pozitën veriore të komunës, është kryesisht e pazhvilluar ekonomikisht dhe me infrastrukturë pak të zhvilluar.

Zona e ulët fushore ndodhet në jug, me veçori tjera demografike dhe kushte më të volitshme për zhvillim. Këto parametra tregojnë edhe për pozitën e volitshme të territorit të ekspozuar jugut dhe jug-lindjes, që është një komponentë e rëndësishme në planifikimin hapësinor.


Zona e ulët karakterizohet me dendësi të madhe të popullsisë në të cilën dominojnë vendbanimet e kategorisë së mesme dhe të mëdha (shumica e vendbanimeve kanë mbi 2000 banorë). Kjo tërësi hapësinore në kuptimin demografik është më stabile, sepse procesi i shpërnguljes së popullsisë së këtyre vendbanimeve drejt qendrave urbane është në rrjedhat normale. Në anën tjetër, rritja popullative e vendbanimeve dhe transformimi fizik i tyre është shumë më i shpejtë në krahasim me vendbanimet kodrinore-malore. Për të treguar vlerën e një hapësire, rëndësi të veçantë ka analiza e dendësisë së popullsisë.⁷

Në tabelën vijuese do të bëjmë krahasimin e dendësisë së popullsisë në mes tri hapësirave kryesore të territorit të Komunës.

Tabela 10 . Dendësia e popullsisë sipas zonave të lartësisë mbidetare në komunë, 2010

Zonat e komunës	Dendësia e popullsisë km ²	Sipërfaqja në km ² për një vendbanim	Dendësia mesatare e vendbanimeve në 100 km ²
Nën 400 m	520.8	5.3	19
400-600	112.6	10.2	9.8
Mbi 600 m	65	19.1	5.2
komuna	260	6.4	12.7

Vlerat e dhëna në tabelë tregojnë se dendësia e popullsisë së hapësirës kodrinore-malore është mjaft e vogël në krahasim me atë të zonës së ulët dhe në nivel të komunës.



Grafiku 15. Pjesëmarrja e sipërfaqeve, e popullsisë dhe e vendbanimeve në vitin 2010 sipas lartësisë mbidetare

Grafiku pasqyron raportet mes pjesëmarrjes së popullsisë, sipërfaqeve dhe vendbanimeve në zonat e territorit të komunës sipas lartësisë mbidetare. Në serinë e parë dominon popullsia në pjesëmarrje ndaj sipërfaqeve dhe vendbanimeve, ndërsa kjo është si pasojë e dendësisë së madhe të popullsisë me tendencë të rritjes së vazhdueshme. Ndërsa, në serinë e dytë e të tretë dominojnë sipërfaqet ndaj pjesëmarrjes

⁷ A. Pushka, "Aspekte gjeopopullative në Kosovë", f. 237. Shih edhe D. Simonovic, Uredjenje seoskih teritorija, f. 43

së popullsisë dhe vendbannimeve sepse hapësira është më pak atraktive për banim në krahasim me rastin e parë. Numri i popullsisë rritet ngadalë ose në disa zona të kësaj lartësie madje edhe stagnon.

Kjo analizë hapësinore tredimensionale na jep një pasqyrë në të cilën mund të shohim realitetin e zhvillimeve demografike dhe hapësinore në territorin e komunës së Rahovecit dhe përmes këtyre fakteve orientohemi drejtë zhvillimeve të ardhshme

I.6.6. Vendbanimet jo formale

Në komunën e Rahovecit janë identifikuar 9 vendbanime jo formale, një nga të cilat ndodhet në zonën urbane dhe 8 në zonat rurale. Në këto vendbanime jetojnë kryesisht banorë të komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe shqiptar. Karakterizohen me mungesë të infrastrukturës fizike dhe infrastrukturë sociale si dhe kanë ndikim negativ në mjedis. Sipërfaqja e përgjithshme e Vendbanimeve jo formale në Komunën e Rahovecit është 12.2 ha. Në të gjitha këto vendbanime jetojnë gjithsej 1556, me 293 ekonomi familjare.

Vendbanimet jo formale gjenden në këto vendbanime: Një pjesë e qytetit të Rahovecit, Dhe pjesë apo lagje të fshatrave Bellacërk, Xërxë, Gexhë, Radost, Ratkoc, Çifllak, Dabidol dhe dy pjesë të fshatit Drenoc.



I.6.7. Banimi

Në komunën e Rahovecit, sipas shënimeve më të reja, të siguruar nga institucionet komunale, jetojnë 71522 banorë në sipërfaqen prej 275.5 km².

Pjesa dërmuese e popullsisë në komunën e Rahovecit jeton në fshat, rreth 70 % e popullsisë. Vetëm 29.8 % e saj jeton në qendrën e vetme urbane të kësaj komune me qendër në Rahovec.

Banimi pothuajse në tërësi është i karakterit individual, pasi që në vet qendrën urbane ka numër të vogël të banesave të karakterit kolektiv, vetëm 13 blloqe banesore me nga pesë kate, që zë vetëm 0.5 ha të sipërfaqes së qytetit, ose rreth 3% të sipërfaqes së

përgjithshme të hapësirës së banimit në zonën urbane. Kjo është vetëm 1% e sipërfaqes urbane të Rahovecit. Numri i përgjithshëm i objekteve të banimit në kuadër të komunës së Rahovecit është 14288, nga e cila shumë, 10146 objekte, ose 71% janë të ndërtuara në zonat rurale, 4142 objekte të banimit, ose 29 % e tyre janë të ndërtuara në zonën urbane. Në zonën e ulët të fushës vendbanimet zakonisht janë të tipit të grumbulluar, prandaj edhe dendësia e banimit është më e madhe. Në viset kodrinore-malore shumica e tyre janë vendbanime të vogla dhe me dendësi më të vogël të banimit. Pra, faktorët natyror kanë ndikuar dukshëm në formën dhe dendësinë e vendbanimeve. Te vendbanimet që ndodhen afër qendrës urbane dhe, atyre afër rrugëve, vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative. Për këtë arsye, objektet e banimit dhe ato të bizneseve shtrihen në formë vargore. Kjo arsyetohet edhe me faktin se popullsia vazhdimisht po heq dorë nga bujqësia.

Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në zonën e ulët të fushës, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjes së hapësirës banuese, kjo hapësirë gjithashtu disponon me një fond më cilësor banesor.

Dendësia mesatare e banimit në territorin e komunës së Rahovecit arrin në 260 banorë në një km², në territorin e z. kadastrale të qytetit arrin në 522 banorë në km², kurse në vendbanimet rurale është 223 banorë në km². Hapësirat me dendësi më të madhe janë rreth qendrës komunale dhe në zonën e rrafshët (Celinë, Krushë e Madhe, Çifllak, Dejnë, Nushpal, Opterushë, Ratkoc, Retij, Xerxë, në të cilat dendësia e banimit arrin mbi 400 banorë në km² dhe tejkalon mesataren e dendësisë së hapësirës së komunës.

Objekte të vjetra banimi ka fare pak sepse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur t'i përballoj kohës. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime, varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit, vendbanimet kodrinore-malore. Shumica e objekteve të banimit janë të rrethuara me mure, ndërsa në oborre dallohen edhe objektet tjera ekonomike bujqësore.

Deri vonë objektet e banimit ndërtoheshin me material të dobët; qerpiçi dhe druri, që zakonisht forma e objekteve i ngjanë shkronjës L. Në këto dekadat e fundit objektet e banimit kanë ndryshuar tërësisht si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, që zakonisht kanë kulmet në dy ujëra, ndërsa janë të ndërtuara me material të fortë ndërtimor si; tulla, blloka të pjekur, betoni e hekuri. Kështu që objektet e ndërtuara të banimit në fshat fare pak dallojnë me ato në qytet. Nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit.

Dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar, në vendbanimet rurale, është mjaft e lartë dhe është e përafërt me shum qytete të vogla të Kosovës dhe këto vlera sillen rreth 50 banorë në ha. (shih tabelën ku paraqitet dendësia e banimit në hektarë për zonat e ndërtuara). Ndërsa, në qendrën e vetme urbane, në Rahovec, dendësia e banimit arrin në 85 banorë në ha, me mundësi të rritjes në të ardhmen, për të arritë në rreth 100 banorë për ha.

Gjendja e banimit në vendbanimet rurale dhe në vet qytetin e Rahovecit u dëmtua rëndë në luftën e fundit, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i madh i objekteve të banimit dhe ekonomike, ndërsa pasojat po evitohen me kalimin e kohës.

Hapësira e banimit në raport me sipërfaqet e ndërtuara është dominante, me rreth 90% në raport me zonën e ndërtuar në nivelin komunal, ndërsa në qytet ajo dominon me rreth 80 %. Kjo tregon se aktivitetet tjera janë në nivel shumë të ulët të zhvillimit, sidomos për qytetin, ndërsa në vendbanimet rurale, përveç objekteve të banimit, janë prezente edhe një numër i konsiderueshëm i objekteve përcjellëse ekonomike.

Numri i anëtareve për ekonomi familjare lëvizë nga 7.7 anëtarë në vendbanimet rurale, në 6.3 anëtarë në qendrën urbane. Këto parametra tregojnë për një gjendje jo të favorshme të standardit jetësor krahasuar me vendet e zhvilluara në të cilat numri i anëtarëve për ekonomi familjare sillet rreth 2 antarë. Në bazë të këtyre llogaritjeve del se nevojat për banesa në komunën e Rahovecit, krahasuar me vendet e zhvilluara të Evropës, janë shumë të mëdha dhe në bazë të këtyre standardeve numri i banesave së paku duhet dyfishuar.

Sipërfaqja e banimit për banorë është me sa vijon: 18.8 m² për anëtarë në nivel të komunës, 19.5m² për anëtarë në vendbanimet rurale dhe në 17.1 m² për anëtarë në qytet. Kjo gjendje është e pavolitshme në këto tri nivele.


Në komunën e Rahovecit ka familje me kushte ekonomike që nuk janë në gjendje të kenë shtëpi të përballueshme. Duke i'u referuar të dhënave mbi varfërinë, sipas paragrafit të mësipërm 12,35% e popullsisë jeton me 1 \$ ditë / për person dhe 69,57% e popullsisë jetojnë me 2 \$ ditë / për person. Përveç kësaj 590 familje janë nën asistencë sociale (përafërsisht 37% e popullsisë). Të dhënat e përmendura më sipër tregojnë nevojën për ofrimin e programeve e veçanta të banimit.

I.6.8. Shfrytëzimi i tokës

Bazuar në digjitalizimin e ortofotove dhe dokumenteve tjera, punës në terren, të dhënave që janë siguruar nga shërbimet zyrtare komunale, si dhe llogaritjeve tona, gjithnjë në kontekstin e shfrytëzimit dhe destinimit të sipërfaqeve në nivelin komunal, mund të konkludohet se territori i komunës së Rahovecit zë sipërfaqen prej 27550 hektar, në të cilin territor zhvillohen aktivitete të shumta humane.


Tabela 11. Shfrytëzimi i tokës ne hektar

Kategoria hapësinore	Sipërfaqe në ha	në%
Pyje	6933	25.3
Bujqësia	12020	43.8
Zonat e ndërtuara	1311	4.8
Varrezat	105	0.4
Livadhe	3956	14.4
Kullosa	252.5	0.9
Djerrina	326.3	1.2
Degradim	403.9	1.5
Vreshta	2416	8.8
Mbeturina ilegale	24.3	0.09
Gjithsej	27421.7	100.0



Grafiku 16. Shfrytëzimi i tokës në %

Në këtë territor jetojnë 71522 banorë, të organizuar në një qendër urbane dhe 35 vendbanime rurale që gravitojnë në 7 qendra lokale. Mbi gjysma e numrit të vendbanimeve shtrihen në zonën e rrafshët kurse zgjerimi i tyre bëhet në mënyrë të pakontrolluar, gjithnjë në dëm të sipërfaqeve bujqësore të kategorisë së lartë. Në tabelën e shfrytëzimit të tokës fondin më të madh të sipërfaqeve e zënë ato bujqësore me 43.8% të territorit të komunës.

Harta 9. Shfrytëzimi i tokës në komunën e Rahovecit

Vendin e dytë e zënë sipërfaqet pyjore me 25.3%, ndërsa sipërfaqet tjera kanë fond më të vogël. Sipërfaqet e ndërtuara kanë pjesmarrje mjaft të vogël, me vetëm 4.6% të territorit. Kjo tregon se situata e shfrytëzimit të tokës është dukshëm më e volitshme në krahasim me shumë komuna tjera të Kosovës duke dhënë mundësi të shfrytëzimit sa më racional të hapësirës. Zvogëlimi dhe degradimi i sipërfaqeve bujqësore nga ndërtimet dhe zgjerimi i vendbanimeve, që vazhdimisht mbulojnë sipërfaqe të konsiderueshme bujqësore të cilsisë së lartë, është brengë e cila kërkon trajtim adekuat. Andaj plani

zhvillimor komunal do të ofroj zgjidhje për shumë qështje duke përfshi edhe mbrojtjen e sipërfaqeve bujqësore si resurs vital për jetën e popullsisë së këtyre hapësirave. Duke llogaritur numrin e banorëve në raport me sipërfaqet bujqësore të kategorisë I -IV, del se për një banorë në komunën e Rahovecit bien vetëm 0.16 hektar, që tregon për një gjendje të pavolitshme andaj kujdesi ndaj tokave bujqësore duhet të jetë prioritet për shoqërinë.

I.7. KARAKTERISTIKAT FIZIKO - GJEOGRAFIKE DHE MJEDISI


I.7.1.NDËRTIMI GJEOLOGJIK

Ndërtimi gjeologjik ka kaluar në periudha të ndryshme gjeologjike dhe dy janë fazat kryesore të ndërtimit gjeologjik të nëntokës së komunës së Rahovecit

1. Detare, ku në këtë pjesë ka ekzistuar Deti (Deti Tetis) dhe liqenore ku liqenet neogjenë në hapësira të gjëra të pjesës jug-lindore të Gadishullit Ballkanik kanë qenë të lidhura mes veti
2. Kontinentale: njëra ka ekzistuar në periudhën e hershme gjeologjike në fund të mezozoikut dhe e dyta ku edhe tani ekziston nën ndikimin e fuqive endogjene dhe ekzogjene.

Formacionet gjeologjike të Komunës së Rahovecit janë të periudhave :

- Holocen, Pleistocen
 - Pliocen
 - Kretake dhe
 - Jurasike
1. Holocen-formacioni holocen ndërton fundin e luginës së Drinit të Bardhë. Kjo përmbanë material lumor (rërë, zhavorr dhe lym) duke krijuar rrafshe aluvijale përgjatë shtretërve të lumenjve.
 2. Pliocene-Formacionet e pliocenit ndërtojnë pjesën periferike të maleve Zatriq, Kaznik dhe Shkozë, ku përbëhen nga sedimentet liqenore(rërë, zhavorr dhe argjilë.
 3. Kreta-Formacionet e kretakut ndërtojnë pjesën lindore dhe veriore të malit Zatriq si dhe masivi i shkozës që shtrihet në veri, verilindje të qytetit të Rahovecit në drejtim të këtyre fshatrave Hoçë e Madhe, Zaqisht si dhe Apterushë . Ky formacion prezantohet me shkëmbijtë gëlqeror e si shembull është masivi te Ura e Fshejtë (Gradish si dhe në qytetin e Rahovecit).
 4. Jura- prezantohen formacionet diabazike, serpentine, gabrot, ku shkalla e serpentineve sillet rreth 70-80 %. Ky formacion përfshinë territor më të madh se formacione tjera, ku kanë shtrirje VVP-JJL.

Harta 10. Gjeologjia e komunës

I.7.2. TEKTONIKA

Ndonëse komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën qendrore të gropës së Dukagjinit, krijimi definitiv është i lidhur me lëvizjet e reja tektonike të cilat janë zhvilluar në orogjenezën alpine.

Gropa e Dukagjinit përfshihet në tri zona: Korabit, Gashit dhe e Mirditës. Në zonën e Mirditës shtrihen malet e Hasit, Horsti i Dukagjinit dhe malet qendrore të Kosovës në lartësinë absolute 800-1300 m.

Këto male paraqiten me shkarje dhe rrudhosje. Në këto shkarje aktiviteti tektonik është i shprehur edhe në shpërthime të materialit vullkanik nëpër plasa të tyre dhe janë formuar masivi ultrabazik i malit Zatriq dhe Kaznik.

Mali i Zatriqit, Kaznikut dhe i Shkozës ndërtojnë pjesën e Horsti t të Dukagjinit. Relievi i sotëm është formuar me ndikimin e lëvizjeve tektonike dhe të proceseve erozive. Vijat e përgjithshme morfologjike (lartësi, anët e rrëpijta, çarjet etj, me të cilën shprehet reliefi inicial i malit të krijuar me lëvizjet radiale në fazën e orogjenezës shkarje.

Në aktivitetin tektonik kanë dominuar lëvizjet tektonike zbritëse të zhvilluara përgjatë plasave të vjetra të cilat janë përcjellë me aktivitet vullkanik. Përmbysjet e kësaj zone kanë vazhduar deri në mbarim të kretakut dhe në fillim të paleogjenit dhe të miocenit të vonshëm. Në këtë kontekst është krijuar baseni i Pejës, Rahovecit si dhe të Mirushës, në drejtim të shtrirjes VVP-JJL me që rast është krijuar edhe Horsti i Dukagjinit

Mali i Shkozës, Zatriqit dhe Kaznikut paraqesin një renditje morfologjike të Horstit të Dukagjinit të maleve të gjëra 10 km dhe të gjata 20 km. Maje të thepisura janë të theksuara anëve të prera dhe në pjesën më të madhe janë të zhveshura. Janë të formuara nga formacionet gëlqerorë dhe serpentineve dhe dallohen me konfiguracion intensiv të shkëmbinjve dhe formave të ndryshme të çarjeve nëpërmjet të cilave bartet materiali rezidial, kështu që toka është në formë të skeletit, ndërsa terreni i thepisur në formë karstike dhe me mungesë të sasisë së mjaftueshme të ujit.

Komuna e Rahovecit disponon përbërje të shumëllojshme geomorfologjike. Në veri shtrihen malet e Zatriqit dhe Kaznikut, përbërja e të cilit është nga serpentinet dhe perioditet e serpentuara, diabazet, dollomitet, filetet nga periudha e Jurasikut. Gabrot, senoni, turoni, (në veri) dhe konglomeratet, zhavorri dhe rëra në teracat lumore të vjetërsisë pleistocene në të cilat paraqiten edhe mergele dhe argjila me thëngjill.

Vendbanimi i Rahovecit është i shtrirë në teracën liqenore në të cilën prroi Vrella ka formuar shtratin e tij dhe në këtë mënyrë ka formuar luginën e rrethuar nga të gjitha anët me shpatije, në të cilat sipërfaqe tani zhvillohet vreshtaria, dhe kulturat tjera, si dhe janë ngritur objekte banimi.

Terreni rreth Rahovecit është i përbërjes së ndryshme gjeologjike, ndërsa në pjesën veriore dhe veri-lindore shtrihen formacionet gëlqerore dhe sedimentet të shkumësit në malin e Shkozës.

Pjesa më e madhe e terrenit ku shtrihet vendbanimi i Rahovecit është e përbërë nga mergeli, argjila, rëra dhe zhavorri i vjetërsisë pliocene. Terrenet në afërsi të vendbanimit janë të përbërjes së njëjtë gjeologjike.

Nga pjesa e jugore terreni hapet nga Anadrini dhe lugina e Rrafshit të Dukagjinit, nga pjesa veri - lindore e mbyllë mali i Shkozës, ndërsa nga pjesa veriore maja e Zatriqit (1039 m).

Terrenet në të cilët është i vendosur vendbanimi si dhe ato në të cilët ai zgjerohet më tutje gjendet në zonën e ekspozicionit jug-perëndimor. Pjerrtësia e terrenit lëshohen kah jug-perëndimi (pjesën e re të vendbanimit) si dhe terrenet në të cilën do të zgjerohet më tutje, gradualisht lëshohen në drejtim të rrafshinës aluviale të përroit të Vrellës e në drejtim të lindjes dhe jugut të kësaj rrafshine.

Kushtet më të përshtatshme geomorfologjike për zgjerimin e mëtejme të vendbanimit shtrihen në pjesët e luginës dhe rrafshinës aluviale të përroit të Vrellës nga drejtimi jug-perëndimor.

Tabela 12.Karakteristikat e terrenit sipas vendbanimeve (të dhëna Komunale)

Nr.R.	Vendbanimet	Llojet e terrenit (% e sipërfaqes së terësishme)			
		E rrafshët luginore	Kodrinore	Malore	Gjithësej
1	Apterushë	20	80	-	100
2	Brestoc	5	95	-	100
3	Bërtatin	10	90	-	100
4	Bërnjak				
5	Celinë	50	50	-	100
6	Çifllak	100	-	-	100
7	Drenoc	-	100	-	100
8	Dejnë	50	50	-	100
9	Dabidol	40	60	-	100
10	Fortesë	90	10	-	100
11	Gexhë	100	-	-	100
12	Guri i Kuq	-	-	100	100
13	Hoça e Vogël	70	30	-	100
14	Hoça e Madhe	20	80	-	100
15	Kaznik	-	-	100	100
16	Kramovik	-	-	100	100
17	Krusha e Madhe	80	20	-	100
18	Mrasor				
19	Malësia e Vogël	100	-	-	100
20	Nagac				
21	Nashpall	10	90	-	100
22	Palluzh	-	100	-	100
23	Pastasel	-	100	-	100
24	Pataçan i Ulët	10	90	-	100
25	Pataçan i Epërm	10	90	-	100
26	Rahovec	20	80	-	100
27	Ratkoc	100	-	-	100
28	Retijë				
29	Retijë e Ulët				
30	Sanoc	-	100	-	100
31	Sapniq	80	20	-	100
32	Vrajak	20	80	-	100
33	Xërxë	100	-	-	100
34	Zatriq	-	-	100	100
35	Zaçisht	10	90	-	100
	Gjithësej	29,17	58,70	12,13	100

Tabela13.Hipsometria e terrenit në bazë të analizave me GIS

HIPSOMETRIA		
Lartesia m	Sip_ha	%
Deri 400	11600	42
400-600	10230	37
600-800	4020	15
mbi 800	1700	6

I.7.3. KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE

Territori i Komunës së Rahovecit ka llojllojshmërinë e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet me numër të madh të grupeve të llojeve të tokës, e në përbërjen e saj ka 8 lloje dhe 21 nënlloje, në formë të një mozaiku. Me përjashtim të tokave skeletore, tokat tjera janë nga supstratet e bartura. Ato janë formuar pjesërisht nga sedimentet liqenore dhe rrjedhjeve të ujërave.

Prezenca e llojeve të ndryshme të tokave ofron mundësi për zhvillimin e kulturave të shumllojshme.

Në këtë rast është me rëndësi ndikimi i njeriut në shfrytëzimin e tokës gjë që shpeshherë mund të shprehet negativisht nëse nuk i përshtatet lloji i kulturave llojit të tokës, sepse shfrytëzimi jo racional shkakton erozion dhe shkatërrim të tokave.

Në bazë të hulumtimeve në terren dhe hulumtimeve laboratorike të tokave në Komunën e Rahovecit dallohen këto lloje:

Tokat Aluvijale – kanë rëndësi të madhe për bujqësi në territorin e komunës së Rahovecit. Ky lloj i tokave është i përqendruar në luginën e lumit Drini i Bardhë. Këto toka janë formuar në teracet lumore të vjetërsisë aluviale. Duke u larguar nga shtrati i lumit këto toka ndryshojnë përbërjen duke i'u shtuar sasia e humusit. Këto toka janë të klasat të I-rë të bonitetit dhe bëjnë pjesë në tokat me produktivitet të lartë bujqësor. Gjatë vërshimeve dheu bartet me erozion, kështu që këto sipërfaqe duhet sanuar me masa gjegjëse hidroteknike. Në bazë të hulumtimit laboratorik dhe në terren këto toka ndahen në nënllojet të tokave aluviale: rëra, rëra deltinore, rëra argjilore.

Aluvijumi Rënor - këto toka shtrihen përgjatë shtratis të lumit Drini i Bardhë, ndërmjet fshatrave Kramovik dhe Gexhë.

Aluvijumi Argjilor - më së shumti është përqendruar në tërë gjatësinë e lumit të Drinit të Bardhë i cili kalon në territorin e komunës.

Tokat Deluviale – kanë pjesëmarrje të vogël në komunën e Rahovecit.

Tokat Deluviale Deltinore - shtrihen rreth këtyre fshatrave: Kaznik, Drenoc, Rahovec dhe Zatriq.

Aluviumi dhe deluvijumi deltinor – këto toka posaçërisht janë të përqendruara në luginat e ngushta të prrojeve, prroskave në pjesët kodrinore të komunës. Sipërfaqet kryesore të kësaj toke janë të përqendruara në ngastra të këtyre fshatrave: Bërnjak – Rahovec, Fortesë – Sapniq, Apterushë – Reti e Ulët.

Tokat livadhore – deltinore - sipërfaqet e tokës livadhore-deltinore shtrihen kryesisht në luginën e Drinit të Bardhë.

Rendëzinat – zënë sipërfaqe të konsiderueshme të komunës dhe posaçërisht në viset kodrinore-malore. Karakteristikë e këtyre tokave është thellësia e vogël e shtesës prej 0 50 cm dhe e pasur me humus (5 – 15%) ndërsa më së shumti janë të mbuluar me pyje dhe kullosa. Boniteti i këtyre tokave është i klasat të IV dhe VI-të dhe kërkojnë masa të posaçme për mbrojtjen nga erozioni. Redimentet janë të ulëta dhe kërkojnë masa përmirësuese në mënyrë që të mundësojnë një prodhim të sigurtë dhe racional.

Në komunën e Rahovecit janë prezentë edhe këto nënlloje të tokave:

- Rendzinë e hinjtë – kafe me substratet gëlqerorë të butë
- Rendzinë tipike – në substratate gëlqerore

- Rendëzinë e hinjtë – me supstratet gëlqerore
- Rendzinë tipike – mbi serpentine
- Rendzinë e hinjtë – kafe mbi serpentine
- Rendzina tipike dhe e hinjtë-kafe në serpentine

Këto llojet shtrihen ose janë në pjesët veri-perëndimore të komunës, rreth këtyre fshatrave; Drenoc, Zatriq, Kaznik, Guri Kuq, Mrasor e tjerë.

Tokat Smonicë. Ky tip i tokës përfshinë pjesën dërmuese të territorit të komunës së Rahovecit. Këto toka, së bashku me tokat aluvijale, paraqesin, sipërfaqet bujqësore të kësaj komune.

Smonicat e erodura- Sipërfaqet e këtyre tokave shtrihen në lindje të Rahovecit. Në pjesët kodrinore erozioni ka bartë pjesën më të madhe të tokës humusore. Këto toka janë të thellësisë mesatare dhe të cekta, me përbërje argjilore, me përbërje karbonatike të ndryshuar, me reaksion neutral e të dobët alkal, me përmbajtje të zvogëluar të humusit si dhe me përbërje të ndryshuar të formës aktive të fosforit dhe kaliumit. Këto sipërfaqe nuk mund të përdoren për të gjitha kulturat bujqësore. Këto sipërfaqet janë të bonitetit të klasës III-të dhe IV-të. Në territorin e kësaj komune dallohen këto nënllaje Smonicë e pakarbonizuar -Areali kryesor me Smonicë të pakarbonizuar shtrihet rreth fshatrave: Palluzh, Denjë, Bratotin, Dabidol.

Smonicë në proces të kafenjizuar dhe Smonicë e kafenjizuar- Përfshinë një pjesë të vogël të komunës në veri-perëndim, ndërmjet fshatrave Kramavik dhe Guri Kuq te Saroshi e tjerë. Areali kryesor i kësaj toke shtrihet në ngastrat e këtyre fshatrave: Nashpal, Sapniq, Bërnjak, Reti dhe komunën kadastrale të Rahovecit.

Smonicë e lesivuar me pseudoglej -Sipërfaqet kryesore shtrihen në perëndim të territorit të komunës, në lindje të fshatit Dabidol, Denjë, Ratkoc dhe Malsi të Vogël.

Smonicë e eroduar -Në teritorin e kësaj komune paraqiten së bashku me tokat të lesivuara, me proces të kafenjezuar. Sipërfaqet kryesore në këtë nënllaj të smonicës të eroduar janë rreth këtyre fshatrave: Pataçan i Epërm, Pataçan i Ulët, Bërnjakë, Reti, Nagac, Celinë etj

Tokë e Kuqe mbi formacionet gëlqerore - Kompleksi kryesor i këtyre tokave ndodhet në lindje të komunës, rreth fshatrave Apterushë dhe në Zatriq.

Toka e kuqe e cekët mbi formacione gëlqeror -Përfshinë një sipërfaqe të vogël në komunën e Rahovecit dhe atë në veri-lindje të fshatit Apterushë. Toka e kuqe e kafenjizuar mbi formacione të forta -Ky lloj i tokave paraqitet vetëm në Gradishtë te Ura e Shenjtë dhe zë sipërfaqe të vogël. Tokë e kuqëremtë rënore, deltinor mbi sedimentet të kuqërremt -Ky lloj i tokës është e përqendruar në vetëm disa hektarë në jug-lindje të Rahovecit, rreth fshatit Hoçë e Madhe. Paraqitet në pjesët kodrinore dhe atë në lartësitë mbidetare rreth 500 m. Tokë e kuqe kafe e lesivuar mbi sedimentet e kuqërremtë -Kjo lloj toke është e koncentruar në sipërfaqet e komunës së Rahovecit, rreth fshatit Krushë e Madhe. Tokë e kafenj të deltinore mbi argjilë liqenore-Kjo lloj toke përfshinë pjesët prej malit të Shkozës dhe duke zbritur kah Drini i Bardhë, posaqërisht përfshinë sipërfaqet e konsiderueshme kah jugu dhe jug-lindje e Rahovecit dhe Hoçës së Madhe deri te Fortesa dhe Celina. Lartësia mbidetare e këtyre tokave është rreth 450 m. Shkëmbinjtë ultrabazik -Kjo tokë nuk ka rëndësi të madhe për bujqësi për komunën e Rahovecit. Përfshinë

sipërfaqe të vogël dhe ate rreth fshatit Drenoc dhe Zatriq. Kjo hapësirë është e mbuluar me pyje dhe kullosa.

Tokë pseudogleje – podzol -Në territorin e komunës së Rahovecit kjo lloj toke përfshinë sipërfaqe të vogël në jug-perendim të komunës dhe ate në fshatin Xërxë.

Tokë pseudogleje – argjilore- Kjo lloj toke përfshinë pjesën më të vogël të komunës dhe ate rreth fshatit Kramovik.

Shkëmbinjë-Sipërfaqe nën shkëmbijë ka posaçërisht në pjesët kodrinore-malore të komunës, rreth fshatit Koznik dhe Zatriq. Këto janë sipërfaqe joproduktive.

Një pasqyrë më e çartë mbi shtrirjen e llojeve të tokave është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 14. Lloji i tokave


Vendban.	Lloji i tokës (% e sipërfaqes së tërësishme)							
	Tokë Aluviale	Tokë Deluvijale	Rendzina	Smonicë	Tokë Kuqe	Argjila Liqenore	Shkëmbij Ultrabazik	Shkëmbijt
Apterushë		20	08	35	15	30		
Brestoc	18			15	40	27		
Bratotin			100					
Bërnjak		20	80					
Celinë		20		30		50		
Çifllak	50	50						
Drenoc		45	18	12			25	
Denjë	30	40		30				
Dabidol	30	40		30				
Fortesë	15	40		20		15		
Gexhë	20	40		30	10			
Guri i Kuq		10	50	40				
Hoça e Vogël	10			80		10		
Hoça e Madhe				20	30	50		
Kaznik		25	20		18		17	20
Kramovik	10		60	20			10	
Krushë e Madhe	30	40		10	20			
Mrasor	10		80	10				
Malësia e Vogël	30	35		35				
Nagac	10			80		10		
Nushpal				100				
Palluzhë				100				
Pastaselë		30		50	20			
Pataçani i Ulët		10		90				
Pataçani i Epërm				100				
Rahovec		10	35	40	15			

Ratkoc	30	20		50				
Retijë		20		80				
Retijë e Ulët		20		80				
Sanoc		30		50	20			
Sapniq		10		90				
Vranjak				100				
Xërxë	20	60					20	
Zatriq			90					10
Zoçisht		10		35	20	35		

I.7.4. Boniteti i tokave

Në bazë të hulumtimeve dhe analizave të bazuara në Atllasin e Hidroekonomisë së Kosovës shkalla e bonitetit është me sa vijon :


BONITETI		
Klasa e bonitetit	Sip_ha	%
2	3807	13.8
3	17690	64.2
4	1560	5.7
5	485	1.7
6	191.6	0.7
7	3816	13.9
	27550	

Harta 11. Boniteti i tokave

I.7.5.KARAKTERISTIKAT SEIZMIKE

Sa i përket sizmitetit Kosova llogaritet si njëra prej zonave sizmike aktive, nga e cila rrjedhimisht, priten termete me shkallë të lartë. Duke u bazuar në të dhënat sizmike nga e kaluara e deri me sot, territori i Kosovës, por edhe i komunës së Rahovecit, kanë qenë të përfshira nga një mori tërmetesh të cilat përgjithësisht kanë pasur karakter autokton. Por, në raste të veçanta, lëkundjet janë ndier edhe nga territoret fqinjë të Kosovës kur ka pasur ndonjë vatër të tërmeteve.

Sipas Hartës sizmike të Kosovës komuna e Rahovecit bënë pjesë në dy shkallë të intensitetit sizmik prej VII - IX shkallë të Merkalit ose VI shkallë të Rihterit, që karakterizohet me intezitet mjaft të fortë me shkatërrim të mureve bazave të ndërtesave etj.

Harta 12. Seizmika e komunës Rahovecit

I.7.6.EROZIONI

Erozioni është njëri nga faktorët ekzogjen që duhet trajtuar për shkak se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori antropogjen. Kjo dukuri është prezente pothuajse në tërë territorin e komunës së Rahovecit, në forma dhe madhësi të ndryshme. Një rol të rëndësishëm në përshpejtimin e tij në shumë raste e ka luajtur edhe faktori antropogjen si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër është prezentë mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit dhe paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore, lugjeve


rrëkenore, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrojeve, etj. Procesi erozionit është i pranishëm në 60% të pellgut të Lumit Drini i Bardhë

Tabela 15. Shkalla e erozionit

Kategoria erozive	sip-ha
Sipërfaqet pa erozion	822.8
Erozion shumë i dobët	6935
Erozion i dobët	8103
Erozion i mesëm	11093.2
Erozion shumë i fortë	596

Territori i komunës së Rahovecit karakterizohet me pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët kapin një hapësirë prej 6935 /ha, të territorit të kësaj komune. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht në pjesën Lindore dhe Jug-lindore, përkatësisht në lokalitetet Kramovik, Qiflak, Sarosh,, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xerxë, Bellacerk, Celinë, Nagavc, Krushë e Madhe. Keto sipërfaqe shtrihen në releiev të ultë përgjatë shtratit të lumit të Drinit të Bardhë dhe janë kryesisht toka aluviale deluviale dhe livadhore. Territoret me erozion të dobët kapin sipërfaqe 8103 ha. Shtrihen në pjesën qendrore te komunës dhe përfshinë vendbanimet, Rahovec, një pjesë Brestovc, nje pjesë Hoqë e vogel, Bërnjak, Sapniq, Pataqan i Ultë dhe i Epërm, Nushpal, Vrajakë, Bratotin, Drenoc, një pjesë, Senoc, Pastasellë, Polluzhë, Petkoviq etj. Erozioni i mesëm shtrihet në sipërfaqe prej 11093.8 /ha. Ka shtrirje te madhe në hapësirë. Ky lloj erozioni shtrihet kryesisht në Veri dhe në Perëndim të Komunës.

Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Rahovecit kapin sipërfaqe prej 596 ha. Ka shtrirje në pjesën JL të komunës. Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet Hoqë e Madhe, Hoqë e Vogël dhe Brestovc. Ndikimet me të larta erozive janë në viset e larta, në toka të zhveshura, me rreth 3200 ha, nga të cilat, 2700 ha janë të pershtateshme per pyllëzim.

Harta 13.Erozioni i tokave**I.7.7. VËRSHIMET**

Komuna e Rahovecit është e pasur me burime ujore. Nëpër territorin e komunës së Rahovecit kalon Drini i Bardhë i cili mbledh të gjitha rrjedhat burimore të këtij territori. Kjo zonë është e rrezikuar nga vërshimet si pasojë e faktorit natyror dhe atij antropogjen. Degradimet e shtratit të lumit, si pasojë e nxjerrjes ilegale të rrës nga shtati i lumit, si dhe nga tokat bujqësore përreth shtatit të lumit janë direkt të ekspozuara vërshimeve. Bimët e vetritura në pellgun lumor si dhe hedhja e mbeturinave të ngurta krijojnë rrezik permanent të të mirave materiale të bujqësisë infrastrukturës dhe vendbanimeve . Nga Kramoviku e deri ne Krushë të Madhe Janë identifikuar një numër i madh i pikave të nxehta që janë në rrezik të vërshimeve të tokave bujqësore.

Me rreth 30 km gjatësi të Drinit të bardhë, sa kalon nëpër komunën e Rahovecit, rreth 1500 ha janë të rrezikuara nga vërshimet, pa llogaritur se kjo vijë ujore është edhe kufi ndarës në mes komunës së Rahovecit dhe komunave fqinje Gjakovë e Prizren, ku shtrihen edhe tokat më pjellore të Komunës së Rahovecit .

Zonat e rrezikuara nga vërshimet që shtrihen përgjatë shtartit të lumit Drini i Bardhë janë: Xërxa, Malsi e Vogël, Gexha, Denji, Qifllaku dhe Kramoviku.

Ndikimet në vërshime vijnë edhe nga degët e lumit të Drinit të Bardhë dhe prrojet për shkak reshjeve të shpeshta intensive. Të rrezikuara nga vërshimet janë këto vendbanime: Fortesa, Sapniqi, Drenovci, Rahoveci, Apterusha, Zoqishti, Retia, Brestovci, Hoqa e Vogel, Nagovci dhe Krusha e Madhe. (të dhëna Komunale)

I.7.8. KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE

Faktorët më të rëndësishëm të cilët ndikojnë në klimën e kësaj hapësire janë: pozita e përshtatshme gjeografike, largësia e vogël e Rahovecit nga Deti Adriatik (102 km deri te gryka e derdhjes së lumit Drinit të Bardhë në detin Adriatik), lartësia mesatare mbidetare (rreth 308 në luginën e lumit të Drinit të Bardhë te Krusha e Madhe dhe 1.039 në majen e Zatriqit, që do të thotë mesatarja 550 m në tërë sipërfaqen e komunës), barriera e malit të Shkozës, Zatriqit dhe Koznikut, zhvillimi i mirë i botës bimore dhe shtazore (livadhet, kullosat, të mbjellurat dhe pyjet) etj.

Klima me tipare të mesme mesdhetare ndihet rreth lumit Drini i Bardhë si dhe në këto vendbanime: Krushë e Madhe, Celinë, Fortesë, Xerxë, Gexhë, Ratkoc dhe Çifllak. Ndikimet vërehen gjithashtu edhe rreth luginave të lumenjve, teracave liqenore, lumore dhe të cilat kodrat i mbrojnë prej erërave dimrore të veriut, ndërsa këto vendbanime janë: Reti, Apterushë, Hoça e Madhe, Hoça e Vogël, Brestoc, Rahovec, Bratotin, Dejnë, Pataçan i Epërm dhe i Ulët. Këto janë edhe pjesët më të ngrohta të Anadrinit.

Klima me ndikim kontinental ndikon në malet e Koznikut, Zatriqit dhe Shkozës.


Pasqyra e shkurtër e të dhënave meteorologjike për komunën e Rahovecit

Në Komunën e Rahovecit temperaturat mesatare vjetore janë 11,68 °C. Maksimumi absolut paraqitet në muajin Korrik prej 38,5 °C, ndërsa minimumi në muajin shkurt me -14,5°C.

Reshjet maksimale në Rahovec janë 1.047,2 mm, ndërsa minimale janë 609,9 mm. Mesatarja e reshjeve është 707.7mm. Të reshurat e dëborës janë më të mëdha në Rahovec dhe atë në muajin Janar. Ditë me borë në Rahovec janë mesatarisht 15,7 ditë. Rahoveci ka mesataren vjetore me mjegull prej 19.7 ditë apo 5,4 %.

5.7.1. Erërat

Në Rahovec më së shpeshti fyejnë erërat prej veri-lindjes (62 %), perëndimit (50%), nga lindja (17%), jugut (14 %) dhe ndërsa më së paku fryjnë nga veriu (11,8 %), dhe jug-lindja (4 %).



Grafiku 17. Shpejtësia mesatare e erës në m/sek në Rahovec

Është me rëndësi të theksohet se ky territor është nën ndikimin e klimës mesdhetare e cila depërton përmes luginës së lumit Drini Bardhë. Klima është mjaftë e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturën e ajrit gjatë vitit.

I.7.9. HIDROGRAFIA

Në komunën e Rahovecit rrjeti hidrografik është relativisht i dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe aktiviteteve njerëzore. Rrjetin hidrografik të komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, puset, burime rrjedhëse dhe të qëndrueshme, si dhe projet. Burimet – janë format të rëndësishme hidrografike. Në territorin e komunës së Rahovecit ka disa qindra burime periodike dhe të përhershme. Numri i madh i burimeve janë ato burime që burojnë në luginat e prockave – projeve dhe rrëzë kodrinve. Më së shumti ka burime në luginën e Rimnikut, lumit të Hoçës, Apterushës etj. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatet e luginave dhe shtratit të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Hulumtimet tregojnë se më së shumti ka burime karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtilla gjenden në jug-perëndim, veri dhe veri-perëndim, në rrëzë të malit Shkozës, Zatriq dhe Kaznik.

Shtrirja e vendbanimeve është kryesisht përgjatë ujrrjedhave si dhe burimeve ujore si: Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaçishtit, Apterusha, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastasella, Kramaviku e tjerë.

Tabela 16. Vendburimet


Emërtimi	Lartësia mbidetare	Lit./sek.	Temp.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8	13
Burimi i Zatriqit	920	5	13
Burimi i Apterushës	400	40	13
Burimi i Zaçishtit	415	15	13
Burimi i H.Madhe	420	10	14
Burimi i Sopotit	380	6	13

Lumi Drini i Bardhë, edhe pse nuk buron në komunën e Rahovecit, të gjitha përroskat dhe lumenjtë derdhen në të. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedhë me një gjatësi prej 30 km dhe në pjesën më të madhe është edhe si kufi administrativ i komunave si: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës.

Lumenjtë-përroskat të cilat derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Ratkoc, Rimnik, Palluzhë, Hoçë etj.

Për shkak të konfiguracionit të terrenit lugina e Drinit në komunën e Rahovecit është e gjerë rreth 2 deri 5 km. Ndërsa gjerësia mesatare e shtratit të lumit prej 50 deri 100 m, thellësia e shtratit të lumit është 1 deri 5 m. Hapësira nëpër të cilën kalon lumi është emru. Lumi Drini i Bardhë ka prerë masivin gëlqeror Gradishin, duke formuar Grykën (Kanjonin) epigjenike atraktive në gjatësi prej 450 m. Në kanjon është ndërtuar Ura e Fshenjtë e cila është e gjatë 70 metra dhe lartësia prej harkut deri te shtrati i ujit është 30 m.

Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë të Madhe, në lartësi mbidetare 420 m, dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, por para fshatit Brestoc bashkohet me degën e Babindolit dhe disa burime, ndërsa dhe derdhet në Drinin e Bardhë.



Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë, me gjatësi 3 km, prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë. Lumi Duhle buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhlee, Vrellë dhe Sopot) dhe bashkohet me lumin e Rimnikut. Në harta topografike ky lum është i shënuar me emrin Gjogjoja që do të thotë për popullin e kësaj ane është i pa njohur. Lumi Rimnik buron në rrëzë të malit Gërgavicë dhe në rrjedhjen e saj i merr disa burime të tjera. Ky lum ka rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimnik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me rrjedhën Duhlllo dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit duke formuar kështu lumin Bellaja. Lumi Sopniq burimin e ka në

rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nushpal, Sopniq. Ky lum gjatë stinës së verës thahe dhe mund të quhet si lumi i Thatë. Duhet cekur se janë edhe disa lumenj-procka si: Ratkocit, Kramovikut, Palluzhës e tjera.

1.7.10. BOTA BIMORE DHE SHTAZORE

Në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjve dallohen pyjet gjetherënëse si: qarri (*quercus cerris*), dhe bungu me rreth 80 %, ahu

(*fagus sylvatica*), shkoza (*carpinus orientalis*). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri, dëllinja etj.

Janë prezente edhe tipet tjera që janë të ulëta, lloji i shkurreve, si: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spinosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj.

Prej bimëve barishtore ka lloje të ndryshme, si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjtëve, si dhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bimë të çajit që njihen si çaji i malit (*origanum vulgare*), kantarioni (*hypericum perforatum*), kamomili (*matricaria chamomila*), dredhëza (*fragaria vesca*) etj. Në territorin e kësaj komune ka fare pakë pyje gjethembajtëse.

Hapësira e rrafshët e komunës është shumë pak e mbuluar me druj, ndërsa zakonisht rritet shëlgju (*salix alba*) në brigje të lumenjve. Bimë të ulëta ka mjaft si: lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (*papaver rhoeas*), hithi (*urtia dioica*), formacionet e livadheve (tërfilli) dhe shkurre të rralla. Livadhe ka pakë në këtë komunë.

Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë ujku (*canis lupus*), dhelpra, lepuri (*lepus europaeus*), iriqi (*ernaceus europeus*) etj. jeton gjarpri i ujit (*natrix natrix*), gurit (*vipera ammodytes*), bollujca (*tropidonatus natrix*), kërmilli i vreshtës (*helix pomatia*), breshka e rëndomtë (*testudo bernardini*). Llojet e peshqve janë të shumtë. Në lumin Drini i Bardhë jetojnë 18, ndërsa llojet më kryesorët janë: trofta, mustaku, mlyshi, ngjala, krapa etj.

Insekte ka shumë lloje si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje, merimanga, kaçadreri (*lucanus cervus*) etj.

Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si: trishtili kokëzi (*parus major*), zogë i malit, pëllumbi i egër (*columba livia*), qukapikthi (*dryobates major*), laraska (*pica pica*) qyqja (*cuculus canorus*) etj. Shpezët grabitçare që jetojnë në këtë territor janë shqiponja e zezë (*aquilachyretos*), petriti (*malco tinnunculus*). Shpezët shtegtare që jetojnë janë dallëndyshja, lejleku etj.


Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në dy sektorët është rreth 10800 ha, ku sektori privat ka rreth 1500ha dhe ai publik 9300 ha.

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Rahovecit është e mbuluar me pyje rreth 6065 ha, ndërsa 3205 ha janë sipërfaqe malore e zhveshur.

Degradimet e pyjeve janë dukuri sikur në çdo pjesë të Kosovës, e sidomos prerjet ilegale, ku rreth 2200 ha në bazë të dhënave komunale rezultojnë si të degraduara.

Pasuritë pyjore shtrihen në veri - perëndim të komunës (Zatriq, Petkoviq, Kaznik etj.) Dallohen me formacione ahu (*fagus sylvatica*), qarri (*quercus cerris*), bungu, shkoza (*carpinus orientalis*), brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri etj.

Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta lloji i shkurreve si: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spinosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj.

Harta 14. Pyjet, kullosat dhe livadhet në komunën e Rahovecit**I.7.11. LIVADHET DHE KULLOSAT**

Livadhet dhe kullosat janë me sipërfaqe të mjaftueshme sa i përket mundësisë së shfrytëzimit për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale dhe bletare .

Rreth 15% të sipërfaqes së përgjithshme i takon livadheve dhe kullosave ose rreth 4208ha. Është bazë e mirë për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale e sidomos në viset kodrinore malore. Sipërfaqet pyjore, kullosat, livadhet , janë bazë ekonomike shumë e favorshme për zhvillimin e blegtorisë dhe bletarisë.

Sipërfaqet bujqësore-Bazë e mirë për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore janë sipërfaqet bujqësore me bonitet të mirë si dhe mundësi të mira për ujë. Faktorët fiziko - natyror e dallojnë këtë zonë për aktivitete bujqësore si në perimtari, drithëra, bimë foraxhere,

vreshtari dhe pemëtari. Sipërfaqja e përgjithshme e tokave bujqësorë zë rreth 12020ha ose 43% e sipërfaqes së përgjithshme .

Shtrirja hapësinore përgjatë Drinit të Bardhë si dhe degëve të tija, në territorin e Komunës kanë rendësi jetike për popullsinë që dallohen sidomos me perimtarë jo vetëm në Kosovë por edhe me gjer.

Vreshtat - Me rreth 2416 ha, si dhe përpunimin e saj të verës Komuna e Rahovecit dallohet në Kosovë dhe rajon. Kultivohet edhe rrushi i tryezës. Faktorët fiziko natyror janë të përshtatshëm për kultivimin e kësaj kulture . Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të kultivuara është me tepër në viset kodrinore me ekspozicion të kthyer kah lindja. Kualiteti i rrushit është i standardit të lartë .

Zonat e ndërtuara – Me rreth 1313ha ose 5% e sipërfaqes së përgjithshme janë zona të ndërtuara (Objekte banimi,objekte ndihmëse, administrative, industriale etj). Gjatë hulumtimeve në terren janë vërejtur edhe dukuri negative të shtrirjes së objekteve të ndryshme në tokat bujqësore të kategorisë shumë të lartë.

Varrezat- Secili vendbanim ka varrezat e veta . Sipërfaqet me varrezat janë rreth 105ha ose 0.5% të territorit.

I.7.12. NDOTJA E UJIT

Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës, sikurse edhe në Komunën e Rahovecit, është si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në ambientet ujore. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në viset e ulëta fushore aty edhe ku ka shtrirje aktiviteti njerëzor.

Në bazë të klasifikimit të cilësisë së ujërave në komunën e Rahovecit janë prezentë tri shkallë të ndotjes.

Harta 15. Ndotja e lumenjve




Në shkallën e parë që, nuk ka ndotje kimike dhe biologjike, janë lumenjtë që shtrihen nga burimet deri në vendbanime.

Shkallës IIa të ndotjes i takojnë të gjithë lumenjtë dhe prroskat e komunës së Rahovecit dhe shkallës IIb i takon Drini i Bardhë.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit. Mesatarisht çdo banor shkarkon 16.46 m³/vit ujëra të zeza.

Në bazë të statistikave demografike numri i banorëve në Komunë është 90439 banorë (sipas të dhënave të Komunës për vitin 2010) atëherë $90439 \times 16.46 = 148626 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra të zeza ose 46 litër/sek pa llogaritur objektet industriale.

Harta 16. Vërshimet dhe degradimi i lumenjve



Vendbanimet nuk kanë të rregulluar kanalizimin, përveç 9 prej tyre, por fatkeqësisht edhe ato vendbanime pa trajtim paraprak ujërat e zeza i shkarkojnë në mjedise të pastra. Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka. Përveç ndotjes kimike të ujërave, ku ndotësit hynë si

përbërës i ujit, është ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike, ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe parazitëve që janë të dëmshëm për jetën e njeriut, florën dhe faunën që shtrihet përgjatë shtratit të lumit. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet për botën e gjallë natyrore të ujërave.

Shkarkimi i mbeturinave të ngurta është dukuri tjetër negative e lumenjve të Kosovës, por edhe të vendbanimeve të komunës. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime ku nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave.

Degradimi i lumenjve

Në bazë të dhënave komunale nxjerrja e inerteve ka shkaktuar degradim të shtretërve të lumenjve dhe, si pasojë ka ardhur deri të ndërrimi i rrjedhës natyrore të lumit, pastaj ndotjen dhe shkatërrim e biosferës në shtratin e lumit dhe përreth tij. Pasojat e shfrytëzimit të inerteve në mënyrë të pa planifikuar në shtretërit e lumenjve shkaktojnë edhe vërshime në tokat bujqësore. Operatorët legal dhe ilegal që veprojnë përgjatë shtratit të lumit Dri nga hyrja e lumit në zonat katastrale të Rahovecit në Mrasor e deri në dalje të saj në Krushë të Madhe, përveç në epigjeninë e kanjonit të Urës së Fshejtë, kanë degraduar sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore si dhe është shkatërruar shtrati i lumit me 403.9 ha

si dhe mbeturina të ngurta me rreth 25 ha jo vetëm në shtretërit e lumenjve por edhe në zonat lumore.



Figura 1. Eksploatimi i inerteve

Vet rritja e bimëve të larta, pengesat natyrore dhe ato antropogjene, kanë ndikuar negativisht në rrjedhën natyrore të lumit.

Sipërfaqja ujore në komunën e Rahovecit, në bazë të vërtetimeve dhe në bazë të analizave të bëra në GIS, si dhe nga burimet e Agjencionit Katastral të Kosovës është: sipërfaqja ujore e lumenjve rreth 490 ha prorskave 2.5 ha dhe kanaleve ujore 2.2 ha. Këto sipërfaqe ujore kanë pësuar ndryshime për shkak të uzurpimeve të shtratit të lumenjve, shkatërrimit inteziv nga nxjerrja e zhavorreve dhe për shkak të mbjelljes së bimëve të larta nga fermerët që kanë pronat përgjatë shtratit të lumit.

Krijimi i fyteve shkakton edhe vërshime të tokave bujqësore. Mbeturinat janë prezent në të gjithë lumenjtë e Komunës

I.7.13. NDOTJA E AJRIT

Komuna nuk disponon me mjete për matjen e sasisë së ndotjes, prandaj si nevojë e ngutshme shtrohet nevoja për pajisje me qëllim të matjes së ndotjes që shkaktojnë operatorët industrial gurëthyesit si dhe qarkullimi i automjeteve në zonën urbane dhe përgjatë magjistrales Pejë-Rahovec-Prizren.

I.7.14. DEGRADIMI I TOKËS

Degradimet janë dukuri edhe në komunën e Rahovecit në forma të ndryshme : Nxjerrja e inerteve përgjatë shtratit të Lumit Drini i Bardhë, Gurthyesve si dhe hedhja e mbeturinave të amvisrisë si dhe ato të ngurta në pjesë të ndryshme të territorit të komunës. Degradimet me të ndjeshme në komunën e Rahovecit janë prezentë përgjatë shtratit të Lumit Drini i Bardhë. Operimet ilegale dhe legale në nxjerrjen e zhavorrit kanë shkaktuar dëme si në tokat bujqësore ashtu edhe ndotje të ujërave dhe në habitatin e shtratit të lumit. Sipërfaqet e tokave që kanë pësuar degradim, si pasojë e shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte ka pasoja të rënda mjedisore.

Në bazë të vizitave në terren janë identifikuar këto dukuri në këto vendbanime: Kramovik, Qiflak, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Xërxë dhe Krush e Madhe.

Në këto zona kadastrale janë degraduar rreth 400 ha tokë buke.

Dukuri e degradimit të mjedisit janë edhe gurthyesit që operojnë në veri të Rahovecit, përgjatë magjistrales Rahovec-Malishevë.



Figura 2. Gurthyes

Dukuri negative e dëmtimit dhe degradimit të pyjeve është edhe prerja ilegale e pyjeve, që si pasojë rritë sipërfaqet e zhveshura dhe inicon proceset negative të erozionit dhe vërshimeve. Përkujdesja e vogël ndaj pyjeve ka për pasojë edhe paraqitjen e sëmundjeve dhe insekteve, pastaj kalbja e drunjtëve në formacionet e bungut etj.

Mjedisi jo i pastër dhe hedhja e mbeturinave të ngurta janë prezent në vendbanimet e komunës ku janë krijuar deponi ilegale që kanë pasoja për botën bimore dhe shtazore, si dhe në vetë mjedisin ku jeton njeriu. Gjatë hulumtimeve në terren janë vënë re pika degradimi edhe pranë shtretërve të lumenjve dhe në pjesë të ndryshme të tokave.

I.7.15. TRASHËGIMIA KUL TURE

Në bazë të hulumtimeve arkeologjike mund të konkludojm se në territorin e komunës së Rahovecit janë zbuluar disa fakte arkeologjike, të cilat tregojnë se këto vise janë përplot me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romake-ilire (E. Çershkov). Kështu p.sh në fshatin Reti janë gjetur dy epitafe-pllaka mermeri nga koha romake ku është bërë shkalitja e tekstit latin, në njërin pllakë qëndron ky mbishkrim "D (is) ma (anibus) Aur (elia) Catulla vixit annis XX Popaj F (iliae) b (ene) M (erenti)". Në pllakën e dytë është shënuar teksti sa vijon: "D (is) M (anibus) Scerviae-dus Sita es Vix(it) an (nis) XXX interfectus a llatromibus si ta Dasi p(pater) f (ilio) p (iissimo) et Sibi et Caiae Dasi coniugi b (ene) m (erenti) Vius F (aciendum) C (uravit)". M. Krasniqi në punimin e tij mbi Rahovecin thekson se përveç këtyre epitafeve, pllakave të mermerit në ngastrën e fshatit të përmendur Reti, është gjetur edhe një pllakë e thyer nga koha Romake ku është skalitur teksti ...et Sitae F (ilio) sumi cor (niculario) c (o) hor (tis) pri (mae)Dardanorum V (i) ixit an (nis) XXX b (ene) m (erenti) P (osuit). Dy mbishkrimet e para janë familjare dhe nuk tregojnë se çka kanë qenë ata për të cilët janë ngritur këto lapidar, ndërsa nga përshkrimi i tretë i pllakës së thyer shihet se ajo është e ngritur "i Siti të birit Sume flamurtarit të kohortës së parë të Dardanëve". Me rastin e gërmimit të terrenit më 1953, kur është ndërtuar bodrumi i verës në Rahovec, gjithashtu është gjetur një numër sendesh arkeologjike (dy qypa të mëdhenj, njëri nga këto ka vëllimin 400 litra, monedha metali, maje të shtizave, elefanti i bronzës e tjera për të cilën mendohet se ka prejardhjen nga epoka e hershme romake (M. K.). Mu në afërsi të Rahovecit në Bërnjakë duhet të jetë vendbanimi nga periudha Romake, e më vonë ka qenë i ndarë në dy vendbanime si Bërnjaka e Ulët dhe Bërnjaka e Epërme. (Duhet të bëhen gërmime arkeologjike rreth pronit të Rimnikut në afërsi të Bërnjakës). Edhe në fshatin Çifllak është gjetur "Altari Romak i sakrificës", eksponati i është dorëzuar Muzeut Arkeologjik të Prizrenit. Edhe gjatë mesjetës në shek. XIV (me 1348) Rahoveci përmendet si vend i cili kufizohet me disa fshatra përreth si territor vreshtar.

Po i cekim disa vendbanimet të cilat përmenden e këto janë: Shtavica, Bërnjakë, Krusha, Kobilloqllava, Babindoli, Hoça, Maja e Shkadrumit, Bjeshka e Shkozës (M. K.). Po ashtu Rahovecin mund ta gjejmë edhe në hartat e vjetra të vitit 1689. Në pjesën e dytë të shekullit XVIII, Rahoveci përmendet si qytezë, në vitin 1770 si qytezë "Ravac" por ka edhe emra të tjera që gjinden në harta të vjetra si që janë: Rahuaz, Rahuiz, Rahova, Ravaz, Rahovc etj., ndërsa në vitin 1911 për herë të parë shkruhet në hartë si Orahovac sipas J. Cvijiqit.

Në pjesën e dytë të shekullit XIX ku në këtë territor bëhet themelimi i bajraqeve në kazën e Rahovecit, të Palluzhës dhe Hoçës së Vogël që i kanë takuar regjionit të Prizrenit. Prej asaj kohe Rahoveci bëhet si qendër Administrative e bajrakut të dikurshëm të Hoçës së Vogël dhe Palluzhës. Mirëpo duke bërë analizimin e burimeve të shkruara që nga periudha e Osmanlive në Gadishullin Ballkanik mund të konstatojmë se kjo tërësi në pikëpamje të organizimit administrativ të Prizrenit, i cili shpeshherë e kanë ndryshuar madhësinë territoriale të funksioneve të tija administrative, varësisht nga ngjarjet

historike dhe riorganizimit administrativ-ushtarak, në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane.

Sipas regjistrimit të vitit 1528 kuptojmë së Sanxhaku i Prizrenit kishte tri kaza: Prizrenit, Trgovishtën dhe Hoça e Vogël. Gjatë këtij intervalit kohor nahija e Hoçës, të cilat i përfshinte shumicën e vendbanimeve të komunës së sotme të Rahovecit, kanë qenë të përfshirë në Sanxhakun e Prizrenit.

Gjatë vitit 1591 të gjitha vendbanimet e Anadrinit kanë qenë nën sundimi Administrativ të Nahisë së Hoçës së Vogël në të cilin kanë ekzistuar 96 fshatra (S. Rizaj).

Në gjysmën e shekullit XVII sipas shënimit udhëpërshkruesit turk Haxhi Kallfës, Hoça e Vogël ka qenë Kadillëqi që i ka takuar Sanxhakut të Prizrenit. Sipas Ali Çaushtit me 1653 Sanxhaku i Prizrenit gjendej në kuadrin e Vilaetit të Rumelisë, kurse sipas një burimi Osman nga viti 1667 Sanxhaku i Prizrenit kishte këto Kadillëqe: Prizrenin, Rahovecin, Suharekën dhe Hasi i Prizrenit.

Gjatë shekullit XIX me themelimin e Vilajetit të Kosovës, Prizreni ka ngelur si qendër Sanxhaku i cili ka përfshirë pesë kaza, respektivisht rrethe: Prizreni, Rahoveci, Tetova, Gostivari dhe Lumën (M. Kaleshi). Me themelimin e Vilajetit të Kosovës me seli në Shkup, duke filluar që nga viti 1888, Prizreni bëhet përsëri njëri nga gjashtë Sanxhaqet e Vilajetit të Kosovës në përbërjen e të cilit krijohen pesë kaza: Prizreni, Rahoveci, Tetova, Gostivari dhe Luma. Rahoveci bëhet si qendër Administrative e Anadrinit.

Trashëgimia kulturore në komunën e Rahovecit nga koha Ilire e deri tani është e larmishme po fatkeqësisht pa mbrojtje të duhur institucionale nga se shumë vlera të tilla janë shkatërruar dhe ju kanë ekspozuar kohës dhe faktorit njeri. Ky thesar i çmuar i kulturës duhet vënë nën mbrojtje si:

Sahat Kulla në Rahovec, që daton nga viti 1206, që dikurë ishte kështjellë e vogël Ilire, kullat e Anadrinit, Kalaja e Durmanit shek. III dhe IV, Kalaja e Kështjelles (Zatriq, Gexhë, Gurkuq, etj

Në bazë të dhënave komunale objektet sakrale që janë në vendbanimet e komunës së Rahovecit janë:

Tabela17. Objektet sakrale

Nr	Lokacioni	Objekti	viti ndertimit	vrejtje
1	Rahovec	Xhami e vjekter tani e re	1606	Ndretim I ri 2000-2005
2	Rahovec	Xhami e vjekter tani e re	1720	2006-2008
3	Rahovec	Xhamia e Kasumit	1826	
4	Rahovec	Xhamia e Haxhi Qamil Kasapit	1994/96	
5	Rahovec	Xhamia e Sokolit	1824	
6	Xërxë	Xhami	1797	
7	Fotesë		1810	
8	Krushë e madhe		XIX-XX	
9	Celinë		1919	
10	Hogë e vogël		1920	
11	Brestovc		1598	2007-2008
12	Apterushë		1860	

13	Reti		1945	
14	Reti e ultë		1947	
15	Drenovc		1710	
16	Rudinë9Pastasel)		1820	
17	Zoqishtë		1990	
18	Nagavcë		1997	
19	Malsi e vogël		2004-2005	
20	Ratkovc			
21	Gurakuq			

Nr	Lokacioni	Objekti	viti ndertimit
1	Rahovec	Teqe e Melamive Qarshi	XIX
2	Rahovec	Teqe e Helvetive	1732
3	Rahovec	Teqe e Rufai	XX

Nr	Lokacioni	Objekti	viti ndertimit
1	Rahovec	Tyrbe	
2	Potoqan I Ultë	Tyrbe	XVIII
3	Palluzhë	Tyrbe	XIX
4	Hoqë e Vogël	Tyrbe	
5	Denjë	Tyrbe	
6	Dabidol	Tyrbe	

Nr	Lokacioni	Objekti
1	Rahovec	Kishë - 1
2	Bërnjak	Kishë - 1
3	Hoqë e madhe	Kishë - 7
4	Zoqishtë	Kishë - 1

Tabela 18.Objektet me status mbrojtës në bazë të MKRS

KOMUNA E RAHOVECIT			
Monumentet me status të mbrojtjes			
nr.	objekti / tërësia	vendbanimi	viti i shpalljes
1	Vendbanim Romak në vendin e quajtur "Pozhig",shek.II-IV nr.nr.V.E.K.02-460/58	Xërzë	
2	Shpellat Uluricë,shek.XIV,nr.V.E.K.02-231/62	Mirushë	1962
3	Mbeturinat e Qytetit "Qyteza" shek.I-XIV, nr.V.E.K.998/67	Zatriq	1967
4	Mbeturinat e qytezës Ilire në kodrën "Qytezë", shek.VIII. p.e.s. dhe shek.V. të erës sonë, nr.V.E.K.02-251/68	Gexhë	
5	Kisha e Shortarisë, shek.XIV-XVI, nr.V.E.K.494/54	Zoqishtë	1954
6	Kishë varrore e Shën Nikollës, she.XIV-XV, nr.V.E.K.02-237/58	Hoqë e Madhe	1958

7	Kishë varrore e Shën Gjorit,	Hoqë e Madhe	
	shek.XIV-XVI,		
	nr.V.E.K.02-54/58		
8	Kisha Brnjaçë,	Bërnjak	
	shek.XIV,		
	nr.V.E.K.557/66		
9	Mbeturinat e kishës Shpëtimi i Shenjët (Shën Gjergji)	Apterushë	
	shek.XVI,		
	nr.V.E.K.558/66		
10	Mbeturinat e kishës së Shën Lukës,	Hoqë e Madhe	
	shek.XIV-XVI,		
	nr.V.E.K.199/67		
11	Teqja Halveti, rr.M.Tito 64,	Rahovec	1970
	shek.XIX,		
	nr.V.E.K.02-251/68		
12	Përmbledhje e këngëve të Sheh Maliqit,	Rahovec	1955
	shek.XIX,		
	nr.V.E.K.634/55		
13	Përmbledhje e dorëshkrimeve Sheh Ilmi Maliqit,	Rahovec	1961
	shek.XIX,		
	nr.V.E.K.02-377/61		
14	Ikonë sedefi e festave të mëdha dhe Pjata e bakrit nga kisha e Shën Shtjefnit,	Hoqë e Madhe	1968
	1601,		
	nr.V.E.K.02-249/68		

Sa i përket zonave të veçanta të mbrojtura për komunën e Rahovecit duhet respektuar dhe zbatuar: Ligji Nr. 03/L-039 PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçant të mbrojtjes :

1. Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë, dhe
2. Fshati Hoqë e Madhe, Hoqë e Madhe

Dispozitat e Veçanta për Fshatin Hoqa e Madhe:

Fshati i Heqës së Madhe, i përshkruar në pikën m) paragrafi 1 i nenit 7 të këtij ligji do të ketë të drejtën, në konsultim me komunën e Rahovecit, që të ushtrojë autoritet të kufizuar mbi aktivitetet nga fusha e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe fetare, dhe nga fusha e planifikimit rural duke respektuar Zonën e saj të Veçantë të Mbrojtur, në përputhje me dispozitat relevante të legjislacionit mbi Vetë-Qeverisjen Lokale dhe parimet e Deklaratës Universale të UNESCO-s mbi Diversitetin Kulturor. KZM-ja do të lehtësojë konsultime të tilla.

9.2. Aplikimi i nenit 6 të këtij ligji për çdo aktivitet të ri në Zonën e Veçantë të Mbrojtur për fshatin e Hoqës së Madhe do të përcaktohet me një Ligj.

Objektet e propozuara nga Drejtoria për kultur ,sport dhe rini

- Sahat Kulla, Rahovec
- Vendi i rënies së dëshmorëve Toni e Mici në Apterushë
- Varrezat e Dëshmorëve në Rahovec
- Përmendorja e Tonit e Micit në Rahovec
- Shtabi i UÇK-së në Drenoc
- Shtabi i UÇK-së njësi "Arti" në Rahovec
- Maja e Shkodranit në Rahovec
- Xhamia e Qarshisë në Rahovec

- Kulla e Meriqëve në Rahovec
- Kroi i Haxhinjve në Rahovec
- Kroi i në Sheshin e Republikës
- Kështjella (kalaja e Durmanit) në Rahovec
- Arti në gur në Zatriq
- Kisha Ortodokse në Rahovec
- Varrezat Bizantine në Reti
- Kulla e Mahmut Pashës dhe varrezat Bizantine në Opterushë
- Ura e Shenjtë në Drini i Bardhë
- Shtëpia muze e Ukshin Hotit në Krushë të Madhe
- Varrezat e Shtavicës
- Bodrumi i Vjetër në Rahovec
- Vendi ku u zhvillua beteja e Gradishit (Gegjë)
- Pika e vrojtimit të UÇK-së "Vlora" në Drenoc
- Vendi i fushëbetejës së UÇK-së në Guri të Kuq
- Fushëbeteja në Bratotin-Ratkoc (12 maj 1998)
- Beteja në Fortesë (18 korrik 1998) në Fortesë
- Shtabi i UÇK në Reti
- Beteja e Kramovikut (1998) në Kramovik

I.7.16. TRASHËGIMIA NATYRORE


Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik të Komunës së Rahovecut, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore, që kanë përhapje në territorin e komunës konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore.

Në territorin e komunës së Rahovecut shtrihet një pjesë e sipërfaqes së zonës së mbrojtur të Kanjonit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejt, Monument natyror me karakter hidro-gjeomorfologjik që është shpallur në vitin 1986, me sipërfaqe 126.5 ha

dhe Parku regional i Mirushes 198.77 ha 1983 Monnument natyre me ujvara te njepasnjëshme

Për shkak të vlerave natyrore janë propozuar për mbrojtje edhe këto monumente të natyrës

1. Nagavc- trung qarri
2. Drenovc-Trungjet e dushkut
3. Vëranjakë- Trungjet e vidhit
4. Dabidol- Trungjet e dushkut
5. Pataçan i Ulët-Trungjet e dushkut
6. Brestovc – trungjet e dushkut (lisi i Bajraktarit)

Harta 17. Tashëgimija kulturore dhe natyrore


I.8. ZHVILLIMI EKONOMIK

Komuna e Rahovecit me tërë historinë e pasur në prodhim të verës dhe tokën pjellore ka potenciale të mëdha për zhvillime në të ardhmen. Edhe pse industria e verës është vetëm një pikë në sektorin e bujqësisë së Kosovës, është potencial për të hyrë në tregjet Evropiane ku kërkesa për verëra të importuara është e madhe.

Zhvillimi ekonomik i Kosovës është fuqimisht i ndërlidhur me zhvillimet në komunën e Rahovecit, e shtrirë në jugperëndim të Kosovës, e kufizuar me komunat e Gjakovës, Klinës, Suharekës dhe Prizrenit.

Rahoveci është një qendër e vogël tregtare dhe ekonomike ku gjatë dhjetëvjeçarit dhe luftës ka trashëguar një ekonomi tërësisht të shkatëruar. Si pasojë e kësaj gjendje papunësia është e madhe, përderisa gjatë luftës janë shkatëruar ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë qenë bartësit e zhvillimit ekonomik si dhe ndërmarrjeve private të cilat kanë funksionuar gjithashtu.

Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perimkulturë. Afro 65% e popullatës është vlerësuar të sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2,500 - 3,000 €. Komuna plotësisht përfiton nga kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike, ku cca 13000 Ha sipërfaqe është tokë punuese, prej te cilave 3.500 Ha janë në sistemin e ujitjes.

Numri i farmerëve në komunë është 3.699 (numri i familjeve të cilat kanë më tepër se 0,50 Ha), përderisa gjendja ekonomike paraqitet mjaft e rëndë. Përpos tregut të redukuar (në të kaluarën ka funksionuar tregu unik i ish Jugosllavisë dhe produkte janë plasuar anekënd ish Jugosllavisë), kemi të bëjmë me një import të pakontrolluar dhe joselektiv të produkteve bujqësore gjë që i bjen prodhuesit tanë të pemëve dhe perimeve, në pozitë mjaft të rëndë.

Rahoveci paraqet bazën e prodhimtarisë së pemëve dhe perimeve në Kosovë, përderisa me të kaluarën e vet të pasur në prodhim të verës dhe me tokën e vet bujqësore pjellore, ka potencial të theksuar për zhvillim në të ardhmen. Rahoveci është komunë kryesisht bujqësore, ngase afro dy të tretat e banorëve të kësaj komune jetojnë në 35 fshatrat e saj.

Komuna e Rahovecit disponon me rreth 50 % të sipërfaqeve të vreshtave të Kosovës si dhe kapaciteteve përpunuese. Popullata e komunës së Rahovecit ka traditë të lashtë në kultivimin e rrushit dhe verës. Në këtë trevë rrushi kultivohet qysh nga koha ILIRE para mëse 2000 vitesh.

Sistemi i Radoniqit i cili mbulon një sipërfaqe prej 3.500 Ha, është ngritur në vitin 1989 (Kramavik, Qifllak, Dabidol, Dejn, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gegje, Xërxe, Ballacerk, Celinë, Krushë e Madhe) është i një rëndësie të veçantë ngase siguron ujë për ujitje dhe ujë të pijes për popullatën e fshatrave që kanë shtrirje për gjatë Drinit të Bardhë.

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thëngjilli), të cilat në të ardhmen do të

mund të shfrytëzoheshin për përpunime finale të cilat do të kontribonin poashtu në rritjen ekonomike të komunës dhe të Kosovës.

I.8.1. Bujqësia

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike⁸, klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.

Rreth 90% të tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtare. Toka e punueshme prej total cca 14000 Ha, është e mbuluar me sistem të ujitjes nga Drini i Bardhë në sipërfaqe prej 3500/Ha. Rreth 70% e popullsisë në qytet dhe fshat sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari dhe perimtari, etj.

Destinim i sipërfaqes	%
Pyje (6932 ha)	25.2
Kullosa (3921 ha)	14.2
Livadhe (252ha)	0.9
Degradim (403 ha)	1.5
Sip_bujqesore (12020 ha)	43.6
Vreshtat (2415 ha)	8.8
Zonat e ndertuara (1310 ha)	4.8
Lumi (193 ha)	0.7
Varrezat (104 ha)	0.4

Tab. 19. Destinimi i sipërfaqes

Numri i ekonomive familjare apo fermave mendohet të jetë rreth 4815. Sasia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të një ferme sillet prej 0.5 -2 Ha, ku kemi të bëjmë me parcelizimin e tokës, të disfavorshme për zhvillimin e një bujqësie intensive. Duke llogaritur që një familje ka mesatarisht 7 anëtarë, numri i përgjithshëm i banorëve që jetojnë vetëm nga të ardhurat nga puna në bujqësi (ekonomi për ekzistencë) rezulton të jetë rreth 33,700 banorë.

Rrushi industrial blihet nga ndërmarrjet dhe minipodrumet në Rahovec , përderisa rrushi i tryezës shitet në tregun e brendshëm në Kosovë si dhe jashtë saj si në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi. Prodhimi i perimeve përdoret kryesisht për konsum shtëpiak dhe shitje në tregjet e Rahovecit, Prishtinës, Gjilanit, Pejës, Mitrovicës dhe Prizrenit.

⁸ Tokë punuese - 14000 ha, të konfiguracionit të rrafshët -luginor/80.6 km² apo 29,17%; kodrinore 162,2 km² apo 58,70%

Prodhimtaria e rrushit dhe produkteve të tij ka traditë mijëvjeqare, Këto të dhëna vërtetojnë ekzistencën e kësaj prodhimtarie që në shekullin e parë të erës së re

Prodhimi i perimeve

Në komunën e Rahovecit kultivohen perimet si: karrota, hudhra, patëllgjani, spinaqi, pjepri, etj, përderisa si kultura; misri, fasulja dhe kungulli ku arrihen rezultate të larta sidomos në sipërfaqen e cila është nën sistemin e ujitjes.

Në regjionin e komunës së Rahovecit, gjithashtu kultivohen jongja, dhe soja, të cilat kanë një rëndësi të veçantë për blegtori, ngase paraqesin ushqim të pazëvendësueshëm për to. Sipërfaqja me këto kultura është diku rreth 800 Ha.

Lloji e perimeve	Sipërfaqja në Ha	Prodhimi në tonë/Ha
Specë	1.237	30
Domate	159	45
Patate	99,5	18
Lakra	9,8	25
Qepë	99,7	25
Shalqin	159	20
Tranguj	60	25
Të tjera	350	

Tab. 20. Lloji i perimeve




Fig.3. Lloji i perimeve

Prodhimi i drithërave:

Prodhimi i drithërave është gjithashtu aktivitet i rëndësishëm në komunën e Rahovecit, veçanërisht e kombinuar me fabrikën për prodhimin e miellit.

Po të krahasojmë vitin 2001 me fundin e vitit 2003 vëmë re se sipërfaqja e përgjithëshme e mbjellë me kultura lavërtare është pakësuar me 1963 hektarë, nga të cilat 1179 ha i përkasin kulturës së grurit, kjo për arsye se prodhimi i kësaj kulture nuk është i leverdishmëm për fermerët privatë. Sasia e grurit prodhuar në vitin 2003 ka qënë 7673.8 ton; kostoja e prodhimit për një ton ka qënë rreth 1118 Euro/ton, çmimi në treg rreth 1046 Euro/ton si dhe; të ardhurat potenciale nga shitja kanë qënë rreth 163,257 Euro në vit. Sipërfaqet me drithër/grurë në 5 vitet e fundit janë rreth 2200 ha per çdo vit, ndërsa për mizer poashtu sillen rreth 1800-2000 ha.

Fabrika e miellit dhe makaronave në Rahovec “SILLOSI-i” e blen gjithë prodhimin e grurit të fermerëve të Rahovecit dhe komunave përreth. Kjo fabrikë ka një kapacitet të madh prodhimi dhe detyrohet që 70% të grurit të importojë nga jashtë⁹ (para luftës ka importuar nga Vojvodina). Importet e drithërave janë dyfishuar nga 75,000 ton në vitin 2005 në 160,000 ton në 2006., përderisa çmimi i grurit është rritur vazhdimisht gjatë vitit 2006 për shkak të rënies së prodhimit në Amerikën Veriore, rënies në rezervat botërore dhe kërkesave të shtuara për drithëra për prodhimin e bio-karburanteve. Çmimi i grurit është rritur nga çmimet prej 12 në 15 cent për kg në 21 cent në mars 2007, dhe çmimet e misrit kanë kërcyer nga 14 cent për kg në 18 cent.

Prodhimi i rrushit dhe verës

Sipërfaqja e përgjithshme e vreshtave në komunën e Rahovecit është cca 2168 Ha, me trend të rritjes së këtyre sipërfaqeve, përderisa 630 ha është sipërfaqe e vreshtave në prodhim dhe cca 370 Ha, jashtë prodhimit. .

Edhe pse industria e verërave përbën vetëm një pjesë të vogël të sektorit bujqësor të Kosovës, ajo gëzon potencial të madh për qasje në tregjet evropiane, në të cilat kërkesa për verëra të importuara është e madhe.

Para vitit 1999, prodhimtaria vjetore ka qenë deri në 12.5 milionë €, me kapacitet të përpunimit prej 30,000 - 40,000 tonave të rrushit dhe 10 milionë litrave verë në vit. Para vitit 1990, 80% e prodhimeve të fabrikës janë eksportuar në tregjet e Evropës, SHBA dhe Kanadë. Në vitin 2001 është arritur një marrëveshje me kompani private gjermane për eksportin e 200,000 litrave të verës për 5 vitet e ardhshme, duke filluar nga viti 2002.

Në vitin 2004 janë prodhuar 2.4 milion kg rrush të kuq dhe të bardhë për verë sikurse dhe të tryezës; 1.1 milion litra verë të bardhë dhe të kuqe (Cabernet Sauvignon, Merlot, Pinot Noire, Game, Kosovo Red, Chardonnay, Italian Riesling, Rhine Riesling, Semignon); pije alkoolike si rraki rrushi dhe Brandy¹⁰.



Fig. 4. Pamje nga vreshtat dhe spërkatja e tyre

Ndërmarrësit rahovecjanë të verës dhe rrushit ballafaqohen me konkurrencë poashtu nga prodhuesit tjerë regionalë të verës, nga Bullgaria, Hungaria, Greqia

¹⁰ Fact Sheet NEËCO Rahoveci Ēinery & Vineyards LLC, rahoveci-eng, 15 November 2005

dhe shtetet e reja të dala nga ish Jugosllavia. Konkurentë poashtu janë dhe ndërmarrësit nga komuna e Suharekës dhe Prizrenit.

Kapacitetet për prodhim të verës

Kapacitetet për prodhimin e verës janë 50 M litër/vjet; për ruajtjen e verës 500,000 hectolitër/vjet, përderisa prodhimi i verës në vitin 2003 ishte 4.8 million litër, 1.1 million litër në vitin 2004. Prodhimi i rrushit në vitin 2003 ishte 7.3 million kg ndërsa në 2004 ishte 2.4 million kg. Vreshtat të pronësi të furnizuesve privatë janë 2,500 Ha.



Fig.5. Llojet e verërave të Rahovecit

Kapaciteti për prodhim të verës së bardhë “Brnjaka-I” është e ndërtuar më 1975, me bodrum të kapacitetit 18M litër, 2 njësi për grumbullim të rrushit, 16 njësi për fermentim, pjesën për distilim, për zbrazje në shishe, linjën e paketimit dhe laboratorin. “Brnjaka-II” e ndërtuar më 1982 për verë të kuqe është e kapacitetit të bodrumit 18M litër, përfshirë dhe 5 M litër për deponim në fuqi të drurit, 4 njësi për mbledhjen e grumbullimin e rrushit, 48 njësi për fermentim, 25 vagonë/njësi.

Tregu i shitjes - është ai lokal në Kosovë përfshirë supermarketet dhe restorantet për verë të ambalazhuar dhe atij rufuz, rrush të tryezës dhe alkool. Tregu i jashtëm përfshin fillimisht verën në fuqi/rufuz në tregun gjerman përmes distributorit Amselfelder. Historikisht tregu përfshinte Kosovën Gjermaninë, Serbinë dhe Malin e Zi, Bullgarinë dhe Hungarinë.

Konkurenca - Si pjesë e konkurrencës nga prodhuesit ndërkombëtar, poashtu dhe prej prodhuesve regionalë në Bullgari, Hungari, Greqi dhe shtete nga ish Jugosllavia. Konkurentë lokalë përfshirë ndërmarrjet e verës dhe të rrushit janë ata nga Suhareka dhe Prizreni sikurse dhe prodhuesit e vegjël.

I.8.2.BLEGTORIA DHE SHPEZTARIA

Industria e blegtorisë konsiderohet lëmi tjetër kyçe e bujqësisë në Rahovec. Ka karakter ekstensiv, pasi që kultivohet në numër të vogël nga fermerët. Rriten tri lloje të gjedheve, ku raca më e shpeshtë quhet Bushë e cila është më pak produktive në qumësht se të tjerat.

Prej blegtorisë kultivohen: gjedhet, delet, dhitë, kuajt, buallicat, etj. Kohëve të fundit ka tendencë të kalimit të kësaj dege të bujqësisë në blegtori intensive, me përmirësimin e racës së gjedhit, me racë simentale, montafone etj. Për mbarëvajtjen e blegtorisë në komunën e Rahovecit kujdeset stacioni i veterinarisë në Rahovec që nga viti 1960.

Lloji i blegtorisë	Numri
Gjedhe	6000
Dele	7000
Dhi	500
Kuaj	600
Qenë	1500
Buallica	500

Tab 21 . Fondi i blegtorisë




Fig.6. Lloji dhe numri i blegtorisë

Nga të dhënat më të reja nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të KK Rahovec, kemi: Gjedhe të imta 7084; Gjedhe të trasha 8892 dhe shpezë 38700 sosh.

Shpeztaria është poashtu e karakterit ekstensiv dhe përveq pulës e cila kultivohet në numër më të madh, llojet tjera të shpezëve janë më pak, përderisa disa prej tyre mund të hasen në natyrë në formë të egër. Sipas kërkimeve tona jo të plota, mesatarja e pulave për familje sillet rreth 10 pula për çdo familje. Viteve të fundit ka filluar kultivimi intensiv i shpeztarise, ku janë ndërtuar disa mini-ferma të pulave, si në fshatrat Celinë, Krushë të madhe, Apterushë, Qifllak etj.

I.8.3.TREGTIA DHE SHKËMBIMI I MALLRAVE

Në komunën e Rahovecit janë të regjistruara 454 subjekte afariste si subjekte ekonomike të veprimtarisë tregtare. Deri më 20.05.2001 jane të regjistruar në nivel komuna 1 817 subjekte afariste dhe shërbyese,të cilët i paraqesim në tabelë:

Siq shihet, shumica e subjekteve të regjistruara janë në lëminë e tregtisë apo të dëqaneve që punësojnë pak njerëz, ndërsa mungojnë subjekte të regjistruara në lëminë e prodhimtarisë.

E gjithë industria përpunuese e prodhimeve bujqësore si dhe ajo e prodhimeve tjera, më parë në sektorin shoqëror, është në gjendje të rëndë ekonomike,dhe pritët privatizimi i saj në mënyrë që t'i adaptohet ekonomisë së tregut. Në këto objekte ekonomike janë të punësuar shumica e punëtorëve në komunën e Rahovecit¹¹. :

¹¹ NBI "RAHOVECI - Meret me përpunimin e rushit dhe pijeve alkoolike, subjekt strategjik i komunes, sepse e tërë prodhimtaria primare e rushit në sektorin privat është i varur nga ky subjekt; SILLOSI - Meret me përpunimin e grurit dhe prodhimeve finale nga mielli; 18 NENTORI - Meret me përpunimin e masave plastike dhe prodhimin e produkteve të gatshme nga masa plastike; TERMOSISTEMI - Meret me prodhimin e këmbësve termik dhe vitrinave ftohëse, ndërmarje kjo freski për industrinë e komunes se Rahovecit; EKOPLASTI - Meret me regjenerimin e mbeturinave të masës

Në komunën e Rahovecit ka rritje të numrit të ndërmarrjeve sikurse dhe në tërë Kosovën, porse jo rritje lineare dhe prej vitit në vit (Shih Tab. x)

Seksionet e aktiviteve ekonomike	Bujqësia, gjyhetia dhe pylltaria	Peshkimi	Industria e minierave dhe ekstraktuese	Industria përpunuese	Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë	Ndërtimtaria	Tregtia me shumicëq dhe pakicë, Riparimi i automjeteve motorike, motocikletave mallrat personale	Hotelet dhe restorantet	Transporti, depotë dhe telekomunikacioni	Aktivitetet financiare	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit	Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale	Arsimi	Shëndetësia	Aktivitetet tjera shoqërore (sociale) dhe personale	Ekonomitë shtëpiake me p. të punësuar
Kosovë	22	1	5	158	6	128	741	187	218	13	156	12	15	37	109	
Rahovec	41	-	29	191	1	75	738	158	107	4	39	-	6	20	77	-

Tab. 22 .Numri i ndërmarrjeve të reja sipas seksioneve të aktiviteve ekonomike në komunën e Rahovecit T4 2009¹²

Qyteti i Rahovecit ka vetëm një treg të gjelbërt, i cili funksionon cdo të shtunë në vend dhe ambient jo përkatës përderisa ekziston një sipërfaqe e rregulluar për tregti të bulmeteve, porse nuk i plotëson nevojat e banorëve të komunës. Vlen të theksohet se tregu kryesisht frekuentohet nga banorët e qytezës me rrethinë.

Në nivel të komunës, ekzistojnë edhe dy tregje të tjera lokale në dy fshatra të komunës Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Ambientet e të dy tregjeve pothuajse janë të pa sistemuara dhe jo të rregulluara sipas kriterëve.

Gjithsej	Vitet					
	2004	2005	2006	2007	2008	2009
	40917	50540	56472	60818	67950	74436
Rahovec	809	1015	1152	1247	1362	1486
Përqindja e rritjes së numrit të ndërmarrjeve		2.06%	1.37%	0.95%	1.15%	1.24%


plastike; 1 MAJI – Ndërmarrje ndërtimore e cila meret dhe me prodhimin e elementeve të betonit; PODRIMJA - Ndërmarrje tregtare me shumicëq dhe pakicë;

¹² Burimi ESK

prej vitit në vit						
-------------------	--	--	--	--	--	--

Tab. 23. Krahasimi në rritjen e ndërmarrjeve në Kosovë dhe Rahovec

Sipas aktiviteteve ekonomike numri më i madh i ndërmarrjeve të reja në komunën e Rahovecit janë ato të tregtisë me shumicë dhe pakicë, përderisa menjëherë më pas janë ato të aktiviteteve financiare.



I.8.4. PUNËSIMI

Në komunën e Rahovecit veprojnë 1000 biznese private, dhe veprimtaria e tyre është prodhuese, industriale, shërbyese dhe tregtare.

Problemi i nivelit të lartë të papunësisë në nivel të Kosovës, reflektohet edhe në Komunën e Rahovecit. Të punësuar në subjektet ekonomike janë 3.501 apo në 1.000 banorë të aftë për punë rreth 110 të punësuar në ekonomi.

Nr.	Vendbanimi	Nr i biz tregtare	Nr i të punësuarve	Private	Shoqërore
1	Bellacërkë	38	67	38	
2	Bërnjak	2	280	2	
3	Bratotin	2	1	1	
4	Brestovc	4	4	4	
5	Celinë	9	9	9	
6	Çiflak	16	25	16	
7	Dabidol	3	3	3	
8	Dejnë	15	26	15	
9	Drenoc	12	11	12	
10	Gexhë	9	23	9	
11	Hoçë e madhe	-	-	-	5 punëtorë PTK
12	Hoçë e vogël	10	9	10	
13	Kaznik	-	-	-	
14	Kramovik	20	29	20	
15	Krushë e Madhe	86	150	86	5 punëtorë PTK"
16	Mrasor	-	-	-	
17	Nagavc	5	5	5	
18	Nushpal	1	1	1	
19	Opterushë	11	9	11	
	Pastaselë	2	4	2	
20	Pataçan i epërm	1	1	1	
21	Pataçan i ulët	4	4	4	
22	Petkoviq	3	2	3	
23	Polluzhë	6	7	6	
24	Radostë	6	8	6	
25	Rahovec	699	1398	699	70 punëtorë "Ambienti, "
26	Ratkoc	69	114	69	
27	Reti e ulët	-	-		

28	Retijë	4	4	4	
29	Sapniq	4	4	4	
30	Sarosh	-	-	-	
31	Senoc	7	13	7	
32	Vrajakë	2	2	2	
34	Xërxë	121	275	121	
35	Zatriq	1	1	1	
36	Zoçishtë	4	5	4	

Tab.24 . Numri i bizneseve private dhe numri i të punëausrve

Në tabelat e mëposhtme janë të paraqitura numri i bizneseve tregtare dhe numri i të punësuarve në komunën e Rahovecit përpos vetë qytetit .




Fig. 7. Numri i bizneseve private tregtare dhe numri i të punësuarve

Vendbanimi	Nd. industriale/ Nr i të punësuarve	Nd. Ushqimore/ Nr i të punësuarve	Nd. Ndërtimore/ Nr i të punësuarve	Drurit/ Nr i të punësuarve	Industri e metaleve dhe kimike/ Nr i të punësuarve	Degët tjera të industrisë
Hoçë e madhe		1/7				
Krushë e Madhe		2/20				
Rahovec	12/351		2/17	1/4	2/22	6
Xërxë	4/140	1/70	30/100	10		

Tab.25 . Numri i ndërmarrjeve sipas veprimatrive dhe të punësuarit

Imigrimi nga zonat rurale për në qytet, u shfaq sidomos në periudhën gjatë dhe pas luftës. Ky fenomen ishte i lidhur me shkatërrimet e bëra gjatë luftës, si dhe me

perspektivat më të mira për shkollim dhe punësim që mund të ofronte qyteti i cili i shpëtoi shkatërrimeve masive. Punësimi jolegal dhe puna joformale e bëjnë ekonominë të qëndrojnë, përderisa shumë biznese të vogla janë inicuar në mungesë të mundësive të tjera të punësimit, edhe pse nuk kanë gjasa për të mbijetuar. Biznesi familjar që ka shtrirje të madhe, duket të jetë më tepër ekonomi për mbijetesë.

Bankat komerciale gjithnjë e më shumë po e orientojnë këtë potencial drejt subjekteve afariste vendëse. Mirëpo, kushtet e kreditimit nuk janë të favorshme, pasi që normat mesatare të kamatës janë 11-14%, kurse afatet e kthimit të kredisë janë kryesisht të shkurtra dhe pa grejs periudhë. Si të tilla, ato janë tëjet të pavolitshme për kreditim të bizneseve prodhuese dhe programeve të bujqësisë.

Privatizimi i ndërmarrjeve

Privatizimi i ndërmarrjeve të komunës së Rahovecit konsiderohen si ndër më të suksesshmet¹³) në punën e tyre pas privatizimit¹⁴.

Ndërmarrja	Veprimtaria	Kapaciteti	Punëtorë
NBI "RAHOVECI"	Përpunimin e rrushit dhe pijeve alkoolike	50 mil. lit. verë	506
IMBB "SILOSI" - XËRXE	njësia për bluarjen e grurit në Xërxe, njësia për prodhimin e brumrave në Xërxe, njësia për prodhimin e bukës në Prizren.	Kapaciteti i bluarjes së mullirit është 200 tonë në 24/h., ndërsa kapaciteti i tertores është 1.200 tonë në 24/h.	300
"18 Nëntori"	përpunimi i masave plastike;	7.500 tonë prodhime plastike	177
TERMOSISTEMI"	prodhimi i këmbyesve termik, vitrinave kolektorëve solar, ftohësve horizontalë dhe vertikalë	BPV-1 mil.Euro	60
"EKOPLAST"	Regjenerimi i mbeturinave nga masa plastike	1.500 t/vit	35
"1 MAJI"	ndërtimi dhe prodhimi i elementeve të betonit si dhe separimi i zhavorit	BPV- 250.000 Euro	60

13 Stone Castle" dhe ndërmarrja e përpunimit të grurit "Sillo; Edhe pse ka probleme rreth privatizimit, si ndërprerje dhe stagnim shumëmuajsh, duke krijuar vështirësi të mëdha në zbatimin e reformës ekonomike dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë socio-ekonomike. Pasojat negative janë duke u shprehur në: Dekurajimin e investitorëve potencialë dhe dëmtimin e imazhit afarist të Kosovës; Dëmtimin e pronarëve të ri të ndërmarrjeve të privatizuara;

¹⁴ P. Acda, UNMIK, 2005 (<http://ëëë.scrapercity.com/showthread.php?t=543010&page=9>)

NTP KORENICA	Përpunim i ambalazhit nga masat plastike, prodhues i parketit nga druri etj.	0.75 m Euro	25
FETOSHI	Prodhimi i fertmbajtësve, ferttrajeve; tregtia me pakicë dhe shumicë Prodhimi i Stiropor pllakave	8-10 t/24 h prodhimi i ferttrajeve 5 t/24 h	30
AGROFER	Kompletimi dhe Servesimi i motokultivatorëve bujqësorë Tregtia me pakicë dhe shumicë e mekanizmave bujqësore dhe pjesë rezerv	200 njësi për një vit	12
HAXHIJAH	Montimi dhe servisimi i motokultivatorëve; tregtia me pakicë dhe shumicë	400 motokultivatorë për një vit.	18
Vellezerit MORINA	Separacion dhe prodhues betoni,kryerja e shërbimeve te ndryshme ndertimore dhe transport	60 t/24 h	12
Qlirimi	Perpunues te Amb.Plast.-Arka,Ulese,Qese najloni etj	10t/24 h	
FADRI	Perpunues i Ambalzhit,Gota,pjata dhe en tjera nga Plastika	15t.plast/24 h	16
Bodrumi iVjeter	Perpunues i rrushit ne Vere dhe alkoole te forta	5 mil/litra	14
Stone Castle	Perpunues i rrushit ne Vere dhe alkoole te forta	43.5 mil/litra	35
NBT"Rahovec"	Perpunues i rrushit ne Vere dhe alkoole te forta	100.000/litra	6
Shpk"Iliria"	Perpunues i rrushit ne Vere dhe alkoole te forta,dhe prodh.tjera Ushqimore	100.000/litra	20

EKO VENA	Perpunues i rrushit ne Vere dhe alkoole te forta	100.000/litra	6
Perpunues te veres ne Eko.Familjare	Perpunues i rrushit ne Vere dhe alkoole te forta	1.000.000/litra	100
Shpk"Shulina"	Perpunues i rrushit ne Vere dhe alkoole te forta	100.000/litra	6
Fatmiri Comerc	Prodhues i Sungjerit - Tabaka 2.4x1.5		12
Frigo Star	Perpunimi metalit ,frigo,dhe termo paisjeve	5 t/24 h	8
Shpk"PLASTIKA-AV"	përpunimi i masave plastike;	7.500 tonë prodhime plastike	22
TERMOSISTEMI"	prodhimi i këmbyesve termik, vitrinave kolektorëve solar, ftohësve horizontalë dhe vertikalë	BPV-1 mil.Euro	32
IMBB "SILOSI" - XËRXE	njësia për bluarjen e grurit në Xërxe, njësia për prodhimin e brumrave në Xërxe, njësia për prodhimin e bukës në Prizren.	Kapaciteti i bluarjes së mullirit është 200 tonë në 24/h., ndërsa kapaciteti i tertores është 1.200 tonë në 24/h.	70
"EKOPLAST"	Regjenerimi i mbeturinave nga masa plastike	1.500 t/vit	15
"1 MAJI"	ndërtimi dhe prodhimi i elementeve të betonit si dhe separimi i zhavorit	BPV- 250.000 Euro	10
NPT"GEZIMI"	Prodhues dhe përpunues i Kartonit	15.000 m2/24 h	22
Perp.Xhamit "Malesi e vogel"	Prodhuesi i tabakve te Xhamit	500m2/24 h	12
Shpk"DAKA"	Perpunues i rrushit ne Vere dhe alkoole te forta	50.000/litra	4
NTP"Arbuloni"	Prodhues i ufulles se venes,dhe lengjeve tjera	10 t/24 h	6

	joalkoolike si dhe Energjike		
Perpunuesi i XHamit "Tara"	Perpunues i Tabakave te Xhamit		4
ZYKA	Prodhiimi i gypave plstike për kanalizim, për ujë të pijes dhe ujitje	Prodhiimi i 60 tonëve të gypave për 60 ditë	24

tab. 26. Ndërmarrjet e privatizuara në komunën e Rahovecit

NSH-Podrima në Rahovec është ndermarje shoqërore në fazën e privatizimit e cila menagjohet dhe mbikëqyret nga AKP

I.8.5. ZHVILLIMI I INDUSTRIË DHE BIZNESEVE

Sektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjinë për ngrohje dhe ftohje, artizanatet, tregun, shërbimet etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorit dhe argjilës, evidente me një shkatërim jo selektiv të resurseve.

Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazur në ekonominë e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore. Rritja e bizneseve kërkon dhe qasje të re, si nga ana e themeluesve të tyre, sistemi bankar, institucionet të cilat duhet të merren më seriozisht lidhur me qasjen e përkrahjes, sidomos me infrastrukturën si dhe me legjislacionin, i cili do të jetë i favorshëm për investuesit potencial. Ruajtja e shpirtit ndërmarrës duhet të stimulohet dhe konsiderohet si vlerë për ekonominë kosovare. Për zhvillimin e ardhshëm, duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ruajtjes dhe zgjerimit të këtij lloji të aktiviteteve ekonomike, të cilat kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, si dhe në kualitetin e jetës urbane.

Në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekziston një asistencë e konsiderueshme e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë përkushtuar për stabilizim dhe profesionalizim të ekonomisë. Organizatat ofrojnë asistencë për të zhvilluar prodhimet të reja, si dhe tregun për to. Përkrahja gjithashtu vjen edhe nga institucionet gjegjëse të nivelit institucional me qëllim të krijimit të një mjedisi favorizues për zhvillimin ekonomik. Kjo i referohet, sikur është përmendur më parë, arsimimi profesional, certifikimi të standardeve profesionale, standardeve për kualitet në menaxhim, prodhimtarisë, prodhimeve, etj. Të gjitha këto aktivitete kontribuojnë në stabilizimin e NVM-ve si bazë e rëndësishme të ekonomisë së Kosovës, gjegjësisht qytetit të Prishtinës, duke sjellur sa më shumë prodhimet kosovare në treg dhe duke ofruar mundësi të reja punësimi.

Gjendja ekonomike e bujqve është mjaft e rëndë. Përpos tregut të redukuar¹⁵, kemi të bëjmë me një import të pakontrolluar dhe joselektiv të produkteve bujqësore gjë që i bjen prodhuesit tanë të pemëve dhe perimeve në pozitë mjaft të rëndë.

Resurset minerale

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thengjilli).

Gurët dekorativë: - gjenden në afërsi të fshatit Drenovc, në një largësi prej 5,5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat mendohet të jenë rreth 207.386 m³. Shtresat e lezolitit dekorativ janë sipërfaqësore, të mbuluar me shtresë humusi prej 0,5 m.

Gurët gëlqerorë: - gjenden në Hudhrat e Danit, një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km larg tij. Ato shtrihen në formë blloqesh me trashësi që varion nga 0,3 në 2 metra, dhe janë 1,5 metra poshtë sipërfaqes së tokës. Gurët gëlqerore paraqiten në ato të kuq dhe murrëm. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerorëve mendohet të ketë një volum prej 382.913 m³.

Azbesti: -Shtresat e lezolitit të azbestit janë të përqëndruara në afërsi të fshatit Rudin/Pastasel në perëndim të Rahovecit, në një largësi prej 8 km. Në bazë të hulumtimeve (janë bërë 4 shpuarje) është përcaktuar sipërfaqja e shtresës prej 100.000 m² dhe mendohet që rezerva të kapë shifrën prej 10.000.000 Ton. Kjo e dhënë është e përafërt dhe kërkon hulumtime të hollësishme gjeologjike.

Kobalti, Nikeli dhe Bakri: -Në rrethinën e Gurit të Kuq janë konstatuar shtresa e xeheroreve të Nikeli-Kobaltit. Përberja mesatare e këtij xeherori sipas hulumtimeve të bëra vite më parë për mineralin në formë të ngurtë është (Nikeli 0,18 %, Kobalti 0,13 % dhe Bakri 2,73 %). Sasia e rezervave të këtij xeherori nuk dihet.

Kromi - mendohet të gjendet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e prroit Rimnik, Delja, Shipi në Zadriq, Sharnica mbi Qëndresë, Drenovci, Guri i kuq, Kanzniku, etj.

Thëngjilli- gjendet në lokalitetet e Hoçës së Madhe, Krushës, prroit të Nagacit, Drinasi, etj. Për të përcaktuar sasinë e rezervave dhe cilësitë kalorifike të thëngjillit duhen bërë hulumtime të thella gjeologjike.

Së fundi, sipas Komunës ekziston mundësia që të gjenden shtresa naftëmbajtëse në territorin e Komunës së Rahovecit. Vëndodhja e tyre mendohet të jetë në fshatin Kramovik dhe përgjatë rrjetjes së Drinit të Bardhë deri në Krushën e Madhe.

I.8.6. TURIZMI

¹⁵ Plasimi i produkteve në kohën e funksionimit të tregut unik Jugosllav.

Turizmi është më pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire¹⁶.



Figura 8. Shtëpi tradicionale, fillimi shek 19-të



Figura 9. Shën Xhoni, shek 14-të

Në përgjithësi zona e Dukagjinit është përplot me trashëgimi arkitekturore, shpirtërore, fetar, etnologjike etj. Poashtu resurse për një turizëm rekreativ ekzistojnë në kanjonin e Drinit të Bardhë. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik,¹⁷ shpella, hamame, trashëgimi arkitekturore dhe fetare në Hoçën e Madhe¹⁸, e cila tashmë është edhe e mbrojtur me pakon e Ahtisarit¹⁹ nga e cila derivon dhe Ligji për Mvrotjen e Zonave të Veçanta të Mbrojtura²⁰ dhe në hartim e sipër përderisa flasim është Ligji për Hoçën e Madhe.

Në qendër të qytetit janë të vendosura monumentet historike të ndërtuara mbi 400 vite: Teqja e Madhe -Helvetive, Teqja Rufai; Teqja Melami; Sahat Kulla e ngritur në vitin 1791; pesë xhamitë si dhe teqet tjera si në qytet ashtu edhe në rrethinë.

Në fshatin Hoça e Madhe, në jug të qytetit të Rahovecit, të njohur për vreshtat dhe verërat e saj, objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Në vitin 1198 Duka i madh Stevan Nemanja dhuroi prodhimet e regjionit, manastirit të Hilandarit (Mt. Athos)., përderisa kjo zonë në mesjetë u bë qendër e madhe komerciale dhe kulturore. Në të janë 12 kishat; Shën Nikolla, Shën Xhoni, Shën Stefan - shekulli i 14-të, Kisha e Diellës së Shenjtë, Shën Parasku, Shën Ana, Shën Lluka dhe Shën Pjetri - shekulli i 16-të, Shën Virgjina dhe Shën Elia. Ekskluzive për nga rariteti, janë dhe depotë e mëdha të verës²¹, në qendër të fshatit me fuqitë e larta deri në 5 metra dhe 4 m të gjera.

¹⁶ E. Çerashkov

¹⁷ Në fshatin Zatriq- gjurmët e kalasë

¹⁸ "Velika Hoca Management Plan"

²⁰ Ligji Nr. 03/L-039 Ligji për Zonate Vecanta të Mbrojtura

²¹ Pronë e manastirit të Decanit



Figura 10. Shën Lluka shek. 16-të



Figura 11. Shën Nikolla shek 14-të



Figura 12. Kanjoni atraktiv në Drinin e bardhë



Figura 13. Ura e Fshejtë



Figura 14. Trashëgimi arkitekturore
në Hoçën e Madhe



Figura 15. Trashëgimi arkitekturore në qytetin e
Rahovecit

Poashtu duhet për të cekur se te Ura e Fshejtë është zonë turistike me kanjonin atraktiv Eupegjenik të lumit Drini i Bardhë. Në afërsi të kanjonit janë të ngritura 5 kamp-shtëpiza si dhe restorani.

I.9. INFRASTRUKTURA FIZIKE, LEVIZSHMËRIA DHE SHËRBIMET PUBLIKE**I.9.1. INFRASTRUKTURA RRUGORE**

Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas, ku në nivel të komunës administrative të komunës janë të shtrira gjithsejtë 297.6 km rrugë të të gjitha kategorive. Nëse analizohet niveli i mbulushmërisë së sipërfaqes së komunës me rrugë të të gjitha kategorive del se ato janë të shtrira në gjithsejtë **157.1** ha. Komuna e Rahovecit karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Shtrirja e rrugëve Regjionale kryesisht në pjesën qendrore dhe perëndimore të komunës ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësirë.


Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbehet nga:

- ✓ Rrugët magjistrale – **M9.1** (Gjakovë - Prishtinë)
- ✓ Rrugë regjionale - (**R107** Prizren-Gjakovë, **R117** Rahovec-Suharekë, **R111** Xerxë Ratkoc-Kramovik, **R204** Rahovec- Krushë e Madhe, **R110** Malishevë- Rahovec – Xerxë)
- ✓ Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 34 komuna kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)
- ✓ Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).

Tabela 21. Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia në km	%
1	Rrugë magjistrale	6.2	2.1
2	Rrugë regjionale	64.3	21.6
3	Rrugë Urbane	30.6	10.3
4	Rrugë lokale	114	38.3
5	Rrugë e pa kategorizuar	82.5	27.7
Total		297.6	100




Grafiku 20. gjatësia e rrugëve në km sipas kategorive në komunën e Rahovecit

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 297.6 km, sa janë në komunën e Rahovecit sipas gjatësisë, rrugë magjistrale janë 6.2 km (2.1%), rrugë regjionale 64.3 km (21.6%), rrugë lokale 114 km (38.3%), rrugë urbane 30.6 km (10.3%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 82.5 km (27.7%).

Duke iu referuar analizave të bëra në nivel të komunës, janë nxjerr edhe sipërfaqet e mbuluara me rrugë dhe aktivitete të tjera përcjellëse sipas kategorisë së tyre. Në tabelën në vijim do të paraqesim shtrirjen e rrugëve sipas gjatësisë në km dhe sipërfaqen e tyre në ha.

Tabela 22. Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive në komunën e Rahovecit

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia	%	Sip në ha me rrugë
		Km		
1	Rrugë magjistrale	6.2	2.1	4.5
2	Rrugë regjionale	64.3	21.6	38.5
3	Rrugë lokale	114	38.3	56.9
4	Rrugë urbane	30.6	10.3	20.9
5	Rrugë e pa kategorizuar	82.5	27.7	36.3
Total		297.6	100	157.1



Grafiku 21. Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive në komunën e Rahovecit

Bazuar ne grafikun e lartshënuar del se nga totali i përgjithshëm i sipërfaqes së rrugëve 157.1 ha sa janë në komunën e Rahovecit, rrugë magjistrale janë gjithsej 4.5 ha (2.9%), rrugë regjionale 38.5 ha ose (24.5%), rrugë lokale 56.9 ha (36.2%) rrugë urbane 20.9 ha (13.3%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 36.3 ha ose (23.1%).

Rrugë magjistrale M9.1 – Nëpër territorin e komunës së Rahovecit kalon rruga e rëndësishme në nivel nacional e cila i lidhë Prishtinën-Gjakovën dhe me Shqipërinë e Veriut (Nëpërmjet qafës së Morinës) e cila cilësohet si rrugë magjistrale. Kjo rrugë në komunën e Rahovecit ka një gjatësi prej 4.5 km, si dhe kalon në dy komuna kadastrale. Komunitat kadastrale (vendbanimet) në të cilat kalon rruga magjistrale M9.1 janë: Kramovik, Mrasor.

Pozita e mirë gjeografike i ka mundësuar kësaj komune lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor dhe hekurudhorë. Gjithashtu e karakterizon atë me komunikacion mjaft të dendur, si në transportin e mallrave po ashtu edhe atë të udhëtarëve. Rruga magjistrale e cila shtrihet në territorin e komunës është e asfaltuara dhe menaxhohet nga MTPT. Sipërfaqja e tokës e cila shfrytëzohet nga aktivitetet e rrugës magjistrale janë gjithsej 4.5 ha. Gjendja e rrugës magjistrale në komunën e Rahovecit, në përgjithësi është e mirë.

Karakteristikë e kësaj rrugë është shtrirja e urave (mbikalime) në raport me hekurudhën dhe me rrugë që e lidh Gjakovën me Klinën.

Rrugë regjionale – Rrugët e kësaj kategorie i mundësojnë komunës së Rahovecit lidhje shumë të mirë në nivel regjional dhe kanë shtrirje në pesë drejtime me gjatësi prej 64.3 km. Gjithashtu këto rrugë janë të asfaltuara dhe menaxhohen nga MTPT:

- a) Rruga **R-107**, Prizren-Xërxë- Gjakovë – me një gjatësi prej 11 km
 - b) Rruga **R-110**, Malishevë – Rahovec-Xërxë me një gjatësi prej 16.3 km
 - c) Rruga **R111**, Xërxë –Ratkoc-Kramovik me gjatësi prej 17 km
 - d) Rruga **R117**, Rahovec-Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë me gjatësi prej 7.6 km
 - e) Rruga **R204**, Rahovec – Krushë e Madhe me gjatësi prej 12.4 km
- ✓ **Rruga regjionale R-107**, Prizren-Xërxë- Gjakovë i mundëson komunës së Rahovecit lidhje të mirë me komunën e Prizrenit dhe të Gjakovës dhe rrugët regjionale R111 që lidhet me komunën e Klinës. Kjo rrugë i lidhë vendbanimet mjaft të rëndësishme si (Krushë e Madhe, Celinë, kalon në komunën kadastrale të fshatit Bellacerkë dhe Xërxë). Kjo rrugë ka gjatësi 11 km në territorin e komunës së Rahovecit.
- ✓ **Rruga regjionale R110**, – krijon lidhje të mira në mes të komunës së Rahovecit dhe Malishevës dhe pastaj nëpërmjet kësaj rrugë lidhet edhe me Prishtinën (Rahovec-Malishevë – Prishtinë)– kalon në pjesën qendrore të komunës së Rahovecit e deri në kufiri komunal i Malishevës. Kjo rrugë ka gjatësi prej 16.3 km, dhe i prekë komunitat kadastrale të: Xërxë, Bellacerkë, Bërnjak,dhe komunën kadastrale të qytetit të Rahovecit).
- ✓ **Rruga regjionale R111**, Xërxë –Ratkoc -Kramovik - shtrihet kryesisht në pjesën perëndimore të komunës me gjatësi prej 17 km.

Nëpërmjet kësaj rruge komuna e Rahovecit ka qasje në magjistralen Gjakovë- Prishtinë dhe me komunën e Klinës.

Vendbanimet të cilat preken direkt nga kjo rrugë janë: Kramovik, Çifllak, Dobidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë dhe Xërxë.

✓ **Rruga regjionale R117**, Rahovec-Opterushë - deri të kufiri me komunën e **Suharekës** - Krijon lidhje të mira në mes të dy komunave (Rahovecit dhe Suharekës), shtrihet në pjesën lindore të komunës së Rahovecit me gjatësi prej 7.6 km. Vendbanimet të cilat preken direkt nga kjo rrugë janë: Rahoveci, Hoqë e Madhe, Zoçishtë, Opterushë.

✓ **Rruga regjionale R204**, Rahovec - Krushë e Madhe - kjo rrugë shtrihet në komunën kadastrale të Rahovecit, Hoqë e Madhe, Brestovc, Hoqë e Vogël, Nagavc, Krushë e Madhe, ka gjatësi 12.4 km. Kjo rrugë e bënë lidhjen me rrugën regjionale R107, R110 dhe R117.


Pjesëmarrja e popullsisë në rrugë magjistrale dhe regjionale - Gjithsejtë numri total i vendbanimeve që kanë qasje në rrugët magjistrale dhe regjionale është 20, që d.m.th. se 55.6% e tyre kanë qasje direkt, ndërsa 44.4 % e vendbanimeve nuk kanë qasje direkte.

Tabela 23. Numri i banorëve me qasje direkt në rrugët magjistrale dhe regjionale

Nr	Vendbanimet	Numri i popullsisë
1	Kramovik	1399
2	Mrasor	312
3	Bellacerkë	3462
4	Bërnjak	35
5	Brestovc	2081
6	Celinë	2419
7	Çifllak	1490
8	Dabidol	699
9	Dejnë	1731
10	Gexhë	563
11	Hoqë e Madhe	624
12	Hoqë e Vogël	1600
13	Krushë e Madhe	5004
14	Nagavc	917
15	Opterushë	2832
16	Radostë	2818
17	Rahovec	21354
18	Ratkoc	4034
19	Sarosh	/
20	Xërxë	2943
Total:		56317
Totali i Popullsisë		71522
% e pop. me qasje në rrugë magjistrale dhe regjionale		78.7 %

Numri i banorëve që lidhen me rrugët magjistrale e regjionale dhe kanë qasje direkt në to, është 56317/b, ose 78.7% e totalit të popullsisë së komunës d.m.th. se pjesa me e madhe e popullsisë kanë qasje në këto dy kategori të rrugëve. Kjo nga fakti se ato vendbanime që shtrihen përgjatë këtyre dy kategorive të rrugëve janë kryesisht vendbanime me numër më të madh të popullsisë në nivel komune. Nga tabela mund të

konstatojmë së rreth 78.7%e popullsisë së komunës së Rahovecit kanë qasje direkt ne rrugët magjistrale dhe ato regionale, çka do të thotë se komuna e Rahovecit ka një përparësi të veçantë në infrastrukturën rrugore.



Grafiku 22. Pjesëmarrja e popullsisë në rrugë magjistrale dhe regionale

Rrugë urbane - konsiderohen rrugët të cilat i lidhin lagjet e qytetit të Rahovecit, gjithsej rrugë urbane në qytetin e Rahovecit kemi 30.6 km ose 10.3% nga totali i përgjithshëm i rrugëve.

Rrugë lokale - konsiderohen rrugët të cilat i lidhin të gjitha vendbanimet e komunës duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme të cilat mundësojnë lidhje të mira me to. Gjithsejtë rrugë lokale në komunën e Rahovecit janë 114 km ose 38.3% nga totali i përgjithshëm i rrugëve.

Rrugë të pa kategorizuara - konsiderohen të gjitha sipërfaqet të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të komunave kadastrale. Gjithsej rrugë të kësaj kategorie në tërë territorin e komunës së Rahovecit janë 82.5 km ose 27.7%, e totalit të rrugëve. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.

Gjendja e rrugëve në komunën e Rahovecit - nga të gjitha rrugët të cilat e përbëjnë rrjetin e rrugëve të komunës me gjatësi prej 297.6 km, rrugë magjistrale janë 6.2 km (2.1 %), rrugë regionale 64.3 km (21.6%), rrugë lokale 114 km ose (38.3%) dhe rrugë të pa kategorizuara 82.5 km (27.7%). Dy kategoritë e para të rrjetit të rrugëve janë të asfaltuara

dhe mirëmbahen nga MTPTK. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara të këtyre dy kategorive në komunën e Rahovecit është 70.5 km ose 23.7% . Ndërsa rrugët lokale të komunës të cilat kanë shtrirje prej 114 km (38.3%) vetëm 49.3 km (43.2%)²² e tyre janë të asfaltuara. Rrugët e kategorisë së katërt (të pa kategorizuara) nuk janë të asfaltuara dhe kanë shtrirje prej 82.5 km (27.7%). Tabela në vijim do të paraqet statusin e rrugëve sipas kategorisë.

Tabela 24. Kategorizimi i rrugëve në komunën e Rahovecit

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia	%	Rrugë të	%	Gjendja e rrugës
		Km		asfaltuara gjatësia km		
1	Rrugë magjistrale	6.2	2.1	6.2	100	e mirë
2	Rrugë regjionale	64.3	21.6	64.3	100	Mesatarisht e mirë
3	Rrugë lokale	114	38.3	49.3	43.2	Mesatarisht e mirë
4	Rrugë urbane	30.6	10.3	30.6	100	Mesatarisht e mirë
	Rrugë e pa kategorizuar	82.5	27.7	0	0.0	Jo e mirë
Total		297.6	100			


Nga tabela shihet se nga gjithsej 297.6 km, rrugë sa ka në komunën e Rahovecit vetëm 150.4 km (50.5 %) e tyre janë të asfaltuara. Në tabelën në vijim do të paraqesim vendbanimet sipas statusit dhe gjendjes së rrugëve.

Nga tabela mund të shihet se nga gjithsej 36 vendbanime (sipas komunave kadastrave) sa ka në komunën e Rahovecit, 31 prej tyre kanë rrugë të asfaltuara, përderisa 5 vendbanime nuk kanë rrugë të asfaltuara. Të gjitha rrugët qofshin ato të asfaltuara apo ato të pa asfaltuara janë të dëmtuara dhe niveli i dëmtimit të tyre është i ndryshëm. Duke u nisur nga parimi i pjesëmarrjes së popullsisë me qasje në rrugë të asfaltuara mund të konstatojmë se nga **71522** banorë sa ka në komunën e Rahovecit **67547 banorë ose (94.4%)** e popullsisë kanë qasje në rrugë të asfaltuar, çka do të thotë se pjesëmarrja e popullsisë në rrugë të asfaltuara është në gjendje të mirë e cila e tregon angazhimin e institucioneve qeveritare dhe atyre lokale në përmisimin e infrastrukturës rrugore si parakusht i zhvillimit ekonomik.


²² Të dhënat janë digjitalizuar nga ortofotot 2004 (Agjensia Kadastrale e Kosovës)

Tabela 25. Statusi i rrugëve në vendbanimet në komunën e Rahovecit

Nr	Vendbanimi	Numri i Popullsisë	Statusi i rrugës
1	Bellacerkë	3462	Asfalt
2	Bërnjak	35	Asfalt
3	Bratotin	687	Asfalt
4	Brestovc	2081	Asfalt
5	Celinë	2419	Asfalt
6	Çifllak	1490	Asfalt
7	Dabidol	699	Asfalt
8	Dejnë	1731	Asfalt
9	Drenoc	2098	Asfalt
10	Gexhë	563	Asfalt
11	Hoçë e Madhe	624	Asfalt
12	Hoçë e Vogël	1600	Asfalt
13	Kramovik	1399	Asfalt
14	Krushë e Madhe	5004	Asfalt
15	Mrasor	312	Asfalt
16	Nagavc	917	Asfalt
17	Opterushë	2832	Asfalt
18	Pastaselë	1114	Asfalt
19	Pataçan i Epërm	618	Asfalt
20	Pataçan i Ulët	954	Asfalt
21	Polluzhë	1029	Asfalt
22	Radostë	2818	Asfalt
23	Rahovec	21354	Asfalt
24	Ratkoc	4034	Asfalt
25	Sapniq	1155	Asfalt
26	Sarosh	0	Asfalt
27	Senoc	950	Asfalt
28	Vrajakë	1013	Asfalt
29	Xërxë	2943	Asfalt
30	Zatriq	494	Asfalt
31	Zoçishtë	1118	Asfalt
Total:		67547	
Totali i popullsisë		71522	
% e pjesmarrjes së popullsisë në rrugët e asfaltuara		94.4	

Harta 20. Rrjeti i rrugëve**I.9.2. RRJETI HEKURUDHOR**

Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regjional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regjional i cili i lidhë Prizren- kalon ne territorin e komunës së Rahovecit dhe e lidhë Klinen-Fushë Kosovë). Kjo linjë hekurudhore është një binarësh me gjatësi prej 10.4 km. Komunitat kadastrale të cilat preken nga rrjeti hekurudhorë, përkatësisht kanë qasje direkt ne këtë rrjet janë gjithsejtë 12, duke filluar nga (Mrasor,Kramovik, Çifllak, Dabidol,Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xërxë, në komunën kadastrale të Bellacerkës,Celinë dhe Krushë e Madhe).

Harta 21. Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit


Nga tabela mund të konstatojmë se nga totali i përgjithshëm i popullsisë së komunës vetëm 23412 banorë apo 32.73% e popullsisë kanë qasje direkt në hekurudhë.

Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se rrjeti hekurudhorë i cili është mjaft i hershem në këtë komunë është edhe si indikator për zhvillimin e vendbanimeve më të rëndësishme të komunës. Rrjeti hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Rahovecit por edhe tjerat sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe udhëtarëve. Linja hekurudhore për momentin nuk është në funksion dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes sajë.

Tabela 26. Pjesëmarrja e vendbanimeve dhe e popullsisë në rrjetin hekurudhor

Nr	Vendbanimi	Numri i Popullsisë
1	Celinë	2419
2	Çifllak	1490
3	Dabidol	699
4	Dejnë	1731
5	Gexhë	563
6	Kramovik	1399
7	Krushë e Madhe	5004
8	Mrasor	312
9	Radostë	2818
10	Ratkoc	4034
11	Sarosh	0
12	Xërxë	2943
Total:		23412
Totali i popullsisë		71522
% e pjesmarrjes së popullsisë në rrugët e asfaltuara		32.73%

URAT


Të gjitha urat, e identifikuar në tërë territorin e komunës së Rahovecit, i takojnë dy kategorive të komunikacionit: Komunikacionit rrugor 16 dhe komunikacionit hekurudhor (4)

1. Urat në komunikacionin rrugor - nga 16 ura të cilat janë të ndërtuara në rrjetin rrugor të komunës, 3 prej tyre shtrihen në rrugë magjistrale dhe 7 në rrugë regjionale. Urat e tjera shtrihen në rrugë lokale dhe ato të pa kategorizuara të cilat kanë gjatësi prej 5 deri 20 m. Në përgjithësi janë në gjendje të mirë. Disa prej tyre kanë qene të demtuara gjatë luftes se vitit 1999 mirepo, janë rindërtuar pas luftës.

a. Urat mbi magjistrale- Konfiguracioni i terrenit ka imponuar që në gjithsej 6.2 km rrugë magjistrale në komunën e Rahovecit të ndërtohen 3 ura mjaft të rëndësishme për komunikacionin e rrugës magjistrale (Kramovik 2 , Mrasor 1). Urat kryesore dhe më të rëndësishme mbi këtë kategori të rrugëve janë ato në fshatin Kramovik, njëra prej tyre mbi lumin Drin i Bardhë me gjatësi prej 131 m, e tjetra mbi hekurudhe me gjatësi 100 m.



b. Urat e tjera kryesisht konsiderohen të vogla me gjatësi prej 1 deri 10m, dhe shtrihen në rrugët lokale dhe të pa kategorizuara. Në përgjithësi janë në gjendje mesatarisht të mirë me përjashtim të disa urave të cilat karakterizohen me gjerësi të vogël dhe të pa mjaftueshme.

Harta 22. Rugët, Urat dhe Tuneli në komunën e Rahovecit


c. Urat mbi rrugë regionale – janë të vendosura në të dy drejtimet e rrugëve regionale, 1 është e vendosur në rrugën regionale Rahovec-Xërxë – Gjakovë (përkatësisht në komunën kadastrale të Xërxës me gjatësi prej 65 m, mbi lumin Drin i Bardhë (Ura e fshejtë) tjerat në komunën kadastrale të Ratkocit me 20 metra, dhe tjetra 15 m, dhe në komunën kadastrale të Qifllakut me gjatësi 18 metra në rrugën regionale Xërxë-Ratkoc-Kramovik).

2. **Urat në komunikacionin hekurudhor** – Në rrjetin hekurudhor të komunës së Rahovecit janë të ndërtuara gjithsejtë 4 ura prej të cilave 1 në komunën kadastrale të Mrasorit, 1 në Çifllakë, 1 në Ratkoc, 1 në komunën kadastrale të Bellacerkës,

TUNELET

Karakteristikë e komunikacionit hekurudhor është tuneli në mes të vendbanimit Gexhë dhe Xërxë (tuneli në komunën kadastrale të Gexhës dhe të Xërxës me gjatësi prej 730 m të ndërtuara në rrjetin hekurudhor).

I.9.3.TRANSPORTI PUBLIK


Në nivel lokal organizohet nëpërmjet të autobusëve dhe automjeteve të tjera të transportit i cili është mjaft mirë i organizuar. Shikuar nga numri i vendbanimeve që kanë transport publik, nga 36 vendbanime sa ka komuna e Rahovecit 31 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve, dhe 5 vendbanime nuk kanë transport publik.

Në tabelën në vijim do të paraqiten vendbanimet të cilat nuk kanë qasje në transportin publik, dhe atyre që kanë sipas numrit të banorëve.

Tabela 27. Vendbanimet pa qasje në transportin publik

Nr	Vendbanimi	Numri i Popullsisë	Statusi i rrugës
1	Kaznik	427	Pa transport publik
2	Nushpal	318	Pa transport publik
3	Petkoviq	722	Pa transport publik
4	Sapniq	1155	Pa transport publik
5	Zatriq	494	Pa transport publik
Total	71522 (100%)		
Numri i Popullsisë	68406 (96%)	Autobus	
Numri i Popullsisë	3116(4%)	Pa transport publik	

Duke iu referuar tabelës së lartshënuar konstatohet se 96% e popullsisë së Rahovecit kanë transport publik të organizuar nëpërmjet të autobusëve²³, dhe vetëm 4 % e qytetarëve të komunës së Rahovecit nuk kanë qasje në transport publik.

Grafiku 23. Pjesëmarrja e popullsisë në transport publik

Nga grafiku mund të vërejmë se transporti publik në komunën e Rahovecit është mjaft mirë i organizuar. Të gjitha vendbanimet të cilat shtrihen në pjesën më të frekuentuar të komunës kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve dhe kombi-busve, ndërsa pa transport publik janë të gjitha ato vendbanime të cilat janë në zona të thella të komunës, ku përthyeshmëria e relievit është mjaft e madhe, si dhe numri i popullsisë së atyre vendbanimeve është mjaft i vogël.

²³ Të dhënat janë nga komuna e Rahovecit, * Sqarim fshati Mrasor nuk ka transport publik të organizuar nga komuna e Rahovecit, por ky vendbanim ka qasje në rrugë magjistrale dhe nëpërmjet sajë banorët kanë qasje në transportin publik në relacion Gjakovë – Kline.

I.9.4. TELEKOMUNIKACIONI

Telefonia Fikse - Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Rahovecit është i lidhur nëpërmjet fibrës optike. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së, në Rahovec e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik. Kapaciteti total i centralit të postës në Rahovec është gjithsej 6000 qifte²⁴, prej të cilave 250 shfrytëzohen, ndërsa pjesa tjetër është e pa shfrytëzuar.

Nga gjithsejtë 36 vendbanime sa ka komuna administrative e Rahovecit, vetëm 5 vendbanime kanë qasje direkt në rrjetin e telefonisë fikse.

Tabela 27. Pjesëmarrja e popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse

Total banorë komuna e Rahovecit	71522 (100%)
Pop. me qasje ne tel. Fikse	33957 banorë
% e pop. Me qasje ne tel fikse	(47.5%)

Nga tabela mund të shohim se rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Rahovecit është i shtrirë në 13.9% të vendbanimeve me gjithsej 47.5% të popullsisë. Nga kjo mund të konstatojmë se pjesëmarrja e popullsisë në nivel të komunës nuk është e kënaqshme dhe se ky rrjet mbulon një pjesë të vogël të vendbanimeve, por kryesisht me nr. të madh të popullsisë.

Telefonia mobile - në territorin e Rahovecit është e mbuluar mjaftë mirë, të gjitha vendbanimet e Rahovecit kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobil sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunës është 12.


Shërbimet e Internetit - Ekzistojnë disa operator të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Rahovecit. Territori i komunës nuk është i mbuluar plotësisht me shërbime të internetit, kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore dhe disa pjesë të vendbanimeve rurale. Kryesisht interneti në zonat rurale është i shpërndarë në nivel të internet kafe-ve, të cilat ofrojnë shërbime në vendbanime të ndryshme, si dhe kanë qëllime komerciale. Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit në komunën e Rahovecit janë:

1. PTK - Darda NET, nëpërmjet të telefonisë fikse
2. IPKO - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale) dhe
3. KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale)

Radiotelevizioni – Rrjeta e Radiotelevizionit në komunën e Rahovecit është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës. Në këtë komunë ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

1. Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV21 dhe KTV
2. Radio - lokale –radio Rahoveci
3. Radio-televizionet nëpërmjet antenave Satelitore.
4. Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve kabllore.

Harta 23. Shpërndarja e antenave të telefonisë mobile



I.9.5. RRJETI ENERGJETIK

Rrjeti i Energjetikës në komunën e Rahovecit është i mbuluar mirë shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, mirëpo gjendja e këtij rrjeti në drejtime të caktuara nuk është e mirë dhe kërkon intervenime. Nga gjithsejtë 36 km, sa ka gjatësi rrjeti energjetik i tensionit të lartë 34.3 km e rrjetës energjetike i gjendet në zonën kopshteve. Në

përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kv në 20 kv.

Tabela 28. Drejtimet e rrjetit të energjisë elektrike në komunën e Rahovecit

Drejtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti në kv	Trafitot	Individuale	Kolektive	Nr. konsumatoreve
Drejtimi Qyteti I	10KV	4		4	1197
Drejtimi Qyteti II	10kv	5		5	1422
Drejtimi Nëntori II	10kv	1	1		1
Drejtimi Nëntori III	10kv	2	2		2
Drejtimi i Komunës	10kv	4		4	941
Drejtimi i Hidrosistemi	10 kv	20	20		34
Drejtimi Shkolla e Mesme	10kv	2		2	623
Drejtimi i Shkozës		14	11	3	200
Drejtimi i Optrushës		26	4	22	1539
Drejtimi i Potoçanit		24		24	1077
Drejtimi i Stone Castle		1	1		6
Drejtimi i Podrumit		4	3	1	42
Drejtimi i Bellacerkës-Fortesës		8		8	375
Drejtimi i Ratkocit		19	3	16	1021
Drejtimi i Dejnit		34	6	28	985
Drejtimi i 18 Nëntorit		2	2		2
Drejtimi i Silosit 1		1	1		1
Drejtimi i Silosit 2		1	1		1
Drejtimi i Xërxës		18	13	5	450
Drejtimi i Matresit		3	2	1	23
TOTALI		193	70	123	9942

Përmirësimi i rrjetës së energjisë elektrike në përgjithësi në nivel komune duhet të bëhet edhe në segmentin e përmirësimit të infrastrukturës fizike me shtylla elektrike.


Tabela 29. Rrjeti i energjisë elektrike, sipas kapaciteteve të propozuara

Drejtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti i propozuar në kv	Numri i trafistacioneve të propozuar	Statusi fizik
Drejtimi Qyteti I	20 KV	2	Përmirësim solid
Drejtimi Qyteti II	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi i Komunës	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi Shkolla e Mesme	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi i Optrushës	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Potoçanit	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Bellacerkës-Fortesës	20 KV		Përmirësim solid
Drejtimi i Shkozës	20 KV		Përmirësim solid

Drejtimi i Ratkocit	20 KV	2	Përmirësim selektiv
Drejtimi i Dejnit	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Xërxës	20 KV		Përmirësim selektiv
TOTALI		7	

Ky segment i infrastrukturës energjetike të komunës propozohet që në të gjitha drejtimet e shpërndarjes së energjisë elektrike të kapacitetit 20KV, të bëhen në shtylla të betonit me gjatësi standarde (sipas standardeve të BE-së), ndërsa në zonën urbane është e preferueshme të ketë kablllo nëntokësore. Është e rëndësishme të theksohet se rrjeti fizik i energjetikës në nivel të vendbanimeve në mënyrë selektive duhet të përmirësohet me shtylla plotësuese nga druri ose betoni.

Harta 24 Rrjeti primar dhe sekondar i energjisë elektrike në komunën e Rahovecit



I.9.6. FURNIZIMI ME UJË

Bazuar në rëndësinë e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, për kualitetin e jetës, mirëqenien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të komunës, rrjedhimisht planet zhvillimore dhe urbanistike duhet të harmonizohen me planet e


investimeve kapitale për rehabilitimin dhe zgjerimin infrastrukturës në territorin administrativ të komunës. Padyshim që edhe Komuna e Rahovecit ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, po ashtu dhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me këto shërbime. Qytetarët e komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:

1. sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi i Radoniqit
2. sistemet e vogla -ujësjellësit lokal (sistem të pompimit)
3. pusët individuale

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit e sidomos gjatë periudhës së nxehtë kur në shumë raste uji pijës keqpërdoret edhe për ujitjen e tokave.

Tabela 30. Mënyra e furnizimit me ujë në komunën e Rahovecit.

Vendbanimi	Numri i Popullsisë	Sistemi	Menaxhohet
Bellacerkë	3462	Publik	HS " Radoniqi"
Bërnjak	35	Publik	HS " Radoniqi"
Brestovc	2081	Publik	HS " Radoniqi"
Celinë	2419	Publik	HS " Radoniqi"
Dejnë	1731	Publik	HS " Radoniqi"
Gexhë	563	Publik	HS " Radoniqi"
Hoçë e Madhe	624	Publik	HS " Radoniqi"
Hoçë e Vogël	1600	Publik	HS " Radoniqi"
Krushë e Madhe	5004	Publik	HS " Radoniqi"
Nagavc	917	Publik	HS " Radoniqi"
Nushpal	318	Publik	HS " Radoniqi"
Pataçan i Epërm	618	Publik	HS " Radoniqi"
Pataçan i Ulët	954	Publik	HS " Radoniqi"
Radostë	2818	Publik	HS " Radoniqi"
Rahovec	21354	Publik	HS " Radoniqi"
Ratkoc	4034	Publik	HS " Radoniqi"
Reti e Ulët	688	Publik	HS " Radoniqi"
Sapniq	1155	Publik	HS " Radoniqi"
Vrajakë	1013	Publik	HS " Radoniqi"
Xërxë	2943	Publik	HS " Radoniqi"
Sarosh	0	Publik	HS " Radoniqi"
Senoc	950	Natyror-Pusi	
Bratotin	687	Publik	HS " Radoniqi"
Çifllak	1490	Publik	HS " Radoniqi"
Dabidol	699	Publik	HS " Radoniqi"
Drenoc	2098	Natyror-Pusi	
Kaznik	427	Natyror-Pusi	
Kramovik	1399	Publik	HS " Radoniqi"
Mrasor	312	Natyror-Pusi	
Pastaselë	1114	Natyror-Pusi	
Petkoviq	722	Natyror-Pusi	
Polluzhë	1029	Publik	HS " Radoniqi"
Reti	1820	Natyror-Pusi	



Sistemi i ujësjellësit të Radoniqit e furnizon me ujë qytetin e Rahovecit dhe vendbanimet Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xerxë, Bellacerkë, Bërnjakë, Krushë e Madhe, Celinë, Brestovc, Hoqë e Vogël, Hoqë e Madhe, Dejnë, Nushpalë, Sopniq, Potoçan e Epërm, Potoçan i Poshtëm, Reti e Ulët, Vrajak dhe Nagavc dhe tash se fundi fshatrat Dabidol, Çifllak, Kramovik, Polluzhe. Në këtë sistem kanë qasje 74500 banorë ose 83 % të popullatës të përgjithshme në komunë.

Nga ky sistem, në bazë të sasive të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banor vlerësohet të jetë përafërsisht 200-250 litra në ditë. Krahasuar me nivelet e BE-së, konsumimi i ujit për kokë banori është i mirë. Përkundër këtij kapaciteti të madh të ujit nga Hidrosistemi i Radoniqit, gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë sidomos në pikat kritike të sistemit (zonat e larta dhe pikat e largëta). Arsyet kryesore për probleme të tilla konsistojnë me faktin se humbjet e ujit në sistemin distributiv janë në një shkallë mjaftë të lartë-rreth 57%. Problem në veti paraqesin edhe keqpërdorimi i ujit të pijes, të cilin e shfrytëzojnë për ujitje, Faktorët tjerë që ndikojnë në këtë shkallë të lartë vlerësohet të jenë: kyçje ilegale, mosmatja e saktë e ujit etj. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Inkasimi për vitin 2010 vlerësohet të jetë 65-70%. Trajtimi i ujit të pijes bëhet me sistemin e dezinfektimit/klorizimit. Aktualisht klorizimi bëhet me klor të gazët. Cilësia e ujit për pije nga ujësjellësi i Rahovecit kontrollohet nga IRSHP-Prizren. Frekuenca dhe numri i pikave të testimit përcaktohet në përputhshmëri me standardet e parapara me IA 2/99. Shpërndarja e ujit bëhet përmes rrjedhjes së lirë me gravitacion.

Furnizimi në vendbanimet tjera rurale - Pjesa e tjetër e popullatës, e cila nuk është e kyçur në ujësjellësin e Radoniqit, furnizohen me ujë nga bunarët e cekët dhe të pambrojtur (7-8m thellësi dhe shtyllë ujore 2-3m). Këta bunarë të pambrojtur nuk janë të ndërtuar sipas standardeve për bunarin higjienik. Kjo flet se uji në bunarë është sipërfaqësor me mundësi të madhe të ndotjes dhe me keqësimin e cilësisë së ujit për pije. Nga aspekti shëndetësor këta bunar janë faktor rreziku permanent dhe e rëndon situatën epidemiologjike.

I.9.7. SISTEMI I KANALIZIMIT

Në komunën e Rahovecit, kanalizimi i ujërave të ndotura është shumë pak i zhvilluar, përkatësisht ky sistem është i shtrirë në zonën urbane dhe në disa vendbanime.

Tabela 31. Qasja e popullsisë në kanalizim

Nr	Vendbanimi	Numri i Popullsisë	Kanalizimi
1	Bellacerkë	3462	po
2	Hoçë e Madhe	624	po
3	Krushë e Madhe	5004	po
4	Nagavc	917	po
5	Radostë	2818	po
6	Rahovec	21354	po
7	Reti e Ulët	688	po
8	Vrajakë	1013	po
9	Xërxë	2943	po
10	Zoçishtë	1118	po
11	Opterushë	2832	po
12	Reti	1820	po
13	Reti e Ulët	688	po
14	Brestovc	2081	po
15	Hoqë e Vogël	1600	po
16	Nagavc	917	po
17	Gexhë	563	po
18	Radostë	2818	po
	Total	53260	
	Totali i popullsisë	71522	
	% e pjesmarrjes së popullsisë	74.46%	

Nga tabela e mësipërme shihet se 53260 banorë kanë qasje në kanalizim ose 74.46% e popullsisë së komunës së Rahovecit.

Rreth 25.54 % e popullatës së komunës nuk kanë qasje në rrjetën e kanalizimit, por ujërat e zeza i derdhen në mënyrë të egër në lokacione të ndryshme në vendbanimet ku jetojnë, përkatësisht në shtratin e përroskave dhe lumenjve.

Sistemi i kanalizimit të ujërave të ndotura, gjendja e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të ndotura në Komunë, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës ashtu edhe për mjedisin në tërësi. Ndërtimi i impiantit për përpunimin e ujërave të ndotura do t'i eliminonte të gjitha rreziqet dhe brengat.

I.9.8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Në komunën e Rahovec shërbimin e menaxhimit të mbeturinave e kryen, Ambienti " njësia operative në Rahovec.

Kjo kompani i kryen shërbimet në zonën urbane Në bazë të analizave të bëra ky shërbim është ende në shkallë të ultë sepse vetëm zona urbane ka qasje në menaxhim të mbeturinave ose 30 % të popullatës në komunë kanë qasjes në këtë shërbim.

Kjo sasi e mbeturinave e cila paraprakisht nuk klasifikohet dhe nuk ndahet, transportohen në deponinë regjionale të Prizrenit (në Landovicë).

Gjatë vitit 2011 disa operator privat kanë filluar shtrirjen në shumicën e vendbanimeve të komunës së Rahovecit në mbledhjen dhe mirëmbajtjen e vendbanimeve nga mbeturinat.

I.10. KAPACITETET INVESTIVE

Komuna e Rahovecit për vitin 2009 me buxhet prej 6.5 M Euro, kishte 2 M Euro investime kapitale, në vitin 2010, prej buxhetit prej 7.9 M Euro për investime kapitale të parashikuara janë 3.1 M Euro, ndërsa për vitin 2011 me buxhet të parashikuar prej 8.2 M Euro, për investime kapitale janë parashikuar 3.3 M Euro.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur projektet e financuara:

Tabela 32. Investimet kapitale në Rahovec gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës Sarosh.-Palluzhë.-Pastasellë	€108,092
2008	Asfaltimi i rrugës magjistrale Celinë	€100,000
2008	Asfaltimi i rrugës G. Hamza	€40,000
2009	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Dobidol	€50,000
2009	Ndërtimi i ujësjellësit në fshatrat Dobidol-Qifll.-Kramov.	€90,000
2009	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Retkoc (faza e II-të)	€120,000
2009	Ndërtimi i ujësjellësit në fshatrat Drenoc- Senoc-Pastasellë	€100,000

Kuvendi Komunal i Rahovecit në miratimin e buxhetit të komunës për vitet 2010- 2012, sipas vlerësimeve do të ketë në dispozicion 10 M Euro për investime kapitale.

Tabela 33. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Rahovecit 2010-2012

Buxheti i komunës së Rahovecit	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në Euro	7.937.913	8.127.711	8.412.496
Të hyrat vetanake në Euro	913.728	942.736	969.931
Investimet kapitale në Euro	3.176.454	3.356.365	3.619.719

Nëse mund të ipet një vlerësim i përafërt përt periudhën kohore 2010- 2013²⁵, mund të konstatohet se komuna e Rahovecit për mandatin katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 13 milion euro për investime kapitale.

I.11. Vlerësimi i gjendjes në komunë

²⁵ Duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012,

Vlerësimi i gjendjes në komunën e Rahovecit është bërë përmesë SWOT analizës. SWOT analiza është punuar në katër pjesë, duke u bazuar në katër fushat tematike që është hartuar profili komunal. Në fillim është bërë SËOT analiza për fushën e popullsisë, zhvillimit social dhe vendbanimeve, pastaj në fushën e mjedisit dhe shfrytëzimit të tokës, zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës. Bazuar në gjendjen ekzistuese dhe të dhënat nga këto fusha tematike janë identifikuar veç e veç përparësitë, mundësit, dobësitë dhe rreziqet.

Popullsia, gjendja sociale dhe vendbanimet

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë • Popullsi në moshë të re (nën 30 vjeç) • Popullsi e orientuar drejt vlerave arsimore • Popullsi e shëndoshë • Tipi i vendbanimeve të grumbulluara	Mundësitë • Programe speciale-profesionale për të papunët sipas kërkesave të tregut • Zgjerimi i edukimit para fillor në të gjitha shkollat fillore • Ndërtimi i objekteve shëndetësore në vendbanimet me numër më të madh popullatës • Ngritja profesionale e personelit mjekësor dhe arsimor (programe profesionale)
	Dobësitë • Mungesë e kuadrit mjekësor në disa QMF • Shkalla e lartë e papunësisë kryesisht te të rinjtë • Shkalla e lartë e varfërisë së përgjithshme dhe asaj ekstreme • Mungesë e sipërfaqeve banesore për kokë banori • Tipi i vendbanimeve të zgjatura • Jo funksionaliteti i vendbanimeve • Mungesa e infrastrukturës në disa vendbanime • Prania e numrit të madh të vendbanimeve jo formale • Migrimi	Kërcënimet • Mungesa e donacioneve në programe profesionale; papunësinë, sigurimin social, ndërtimin e objekteve shëndetësore, programe profesionale për personelin arsimor dhe shëndetësor etj. • Ndërtime ilegale në toka produktive • Ndërtimi individual dhe rrezikimi i korridoreve

Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë - Toka bujqësore cilësore për perimtari dhe pemëtari - Toka bujqësore për kulturën e vreshtarisë - Shfrytëzimi i inerteve konform standardeve - Faktorët klimatikë të përshtatshëm - Resurset ujore - Trashëgimi kulturore dhe natyrore	Mundësitë - Shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokat bujqësore) - Peizazhe të përshtatshme për pushim dhe rekreacion (ura e Fshejt dhe Kanjoni i Mirushes) - Vetëdijësimi i popullatës për mbrojtjen e ambientit. - Harmonizimi i zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit - Favorizimi i vreshtarisë, perimtarisë dhe pemëtarisë - Shfrytëzimi i inerteve sipas rregullave - Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe shpallja e zonave mbrojtëse
	Dobësitë - Degradim i shtretërve të lumenjve - Shfrytëzimi i pa kontrolluar i inerteve - Mosekzistimi i sistemit për trajtimin e ujërave të zeza; - Hedhja e paplanifikuar e mbeturinave në mjedise të ndryshme; - Ndotja e lumenjve nga hedhja e mbeturinave dhe nxjerrja e inerteve . - Shfrytëzimi i tokave bujqësore për ndërtim - Mbrojtja jo e mirë nga vërshimet dhe erozioni - Degradimi i pyjeve - Mungesa e sistemit të kompletuar të ujitjes	Kërcënimet - Degradimi i tokave bujqësore përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë - Fatkeqësitë e mundshme natyrore: erozionet e pakontrolluara dhe vërshimet. - Dëmtimi i vazhdueshëm i pyjeve - Ndërrim destinimi i tokave bujqësore në ato ndërtimore - Shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i inerteve - Përhapja e epidemive për mungesë të sistemit të kanalizimit qendror fekal, të ujërave të zeza dhe mbeturinave. - Mungesa e monitorimit - Prania aktuale dhe zgjerimi i vendbanimeve në zona me ekspozim të lartë ndaj fatkeqësive sizmike

Zhvillimi ekonomik

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë • Resurset natyrore për bujqësi dhe blegtori, • Resurse natyrore mineralogjike, • Kushte të volitshme klimatike, • Privatizim i sukseshëm i ndërmarrjeve shoqërore, • Shpirt ndërmarrësie, • Komunë tradicionalisht e pasur me ndërmarrje bujqësore, • Numri i madh i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, • Traditë mijëvjeçare në kultivimin dhe përpunimin e rrushit dhe verës, • Traditë në eksportimin e verës, • Afërsi e Rahovecit/Kosovës me tregun e Evropës, • Historik i lashtë i vendbanimit/trashëgimi e pasur kulturore dhe arkeologjike.	Mundësitë • Përdorim i metodave të reja shkencore në rritjen e prodhimtarisë, • Mbështetje financiare në ngritjen e kapaciteteve private përpunuese në bujqësi, industri ushqimore, • Mbështetje në krijimin e konkurrencës me prodhime finale, ekologjike, • Bashkëpunimi më efikas me prodhuesit bujqësorë të sektorit privat, • Plasim i sigurtë në tregun Evropjan i prodhimeve bujqësore, produkteve ushqimore të gatshme, prodhimeve të rrushit, • Depërtim në tregjet e reja, • Rritje ekonomike lokale bazuar në turizëm kulturor, ekologjik
NEGATIVË	Dobësitë • Zvogëlimi i shpejtë i sipërfaqeve punuese, • Humbje e vullnetit për vazhdimin e aktivitetit për kultivim të bujqësisë; • Mungesë e kapaciteteve përpunuese të prodhimeve bujqësore, • Mungesë e mbështetjes së vazhdueshme financiare për fermerët dhe përpunuesit e prodhimeve bujqësore; • Infrastruktura fizike e dëmtuar dhe jo e nivelit të duhur, • Mos bashkëpunimi dhe mos përfitimet ekonomike të qytetit të Rahovecit • Aktivitetet ekonomike të Hocës së madhe • Kredimarrje me kamata të mëdha, të pafavorshme	Rreziqet • Vazhdim i parcializimit të tokës, • Hapje e pa kontrolluar e tregut të Kosovës, • Moszbatim i ligjit për tokën bujqësore, • Mos zgjidhje e vazhdueshme e pronësisë; • Mosmbështetje e vazhdueshme në përtëritjen e teknologjisë së vjetëruar, • Mosekzistimi i ligjit për ushqim, • Rënie e donacioneve dhe mungesa e burimeve afatgjata për përballimin e investimeve publike; • Mungesa e strategjisë për gjenerimin e investimeve nga burimet e vendit, • Mungesa e kohezionit socio-ekonomik ndërmjet akterëve kyç (sindikatave të punëtorëve, Qeverisë, bizneseve) si parakusht për suksesin e reformave ekonomike;

Infrastruktura

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë - o Lidhje të mira përmes rrugëve magjistrale dhe regionale, si dhe atë të rrjetit hekurudhor - o Qasja e vendbanimeve në infrastrukturë të asfaltuar - o Qasja e popullsisë në transport publik mbi 96% - o Qasja e vendbanimeve në telefoni mobile mbi 95% - o Qasja e popullsisë në rrugë të asfaltuara 93%	Mundësitë - o Mirëmbajtja e rrugëve lokale të asfaltuara - o Menaxhimi adekuat i rrjetit të ujit të pijes - o Menaxhim adekuat i transportit publik - o Shtrirje e internetit në të gjitha vendbanimet - o Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike - o Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanime ku mungon - o Ndriçimi i rrugëve në zona të frekuentuara me popullsi të dendur
	Dobësitë - o Gjendja fizike jo e mirë e rrugëve lokale - o Mos menaxhimi i të gjithë rrjetës së furnizimit me ujë - o Menaxhimi i dobët i linjave të transportit publik në viset rurale - o Mungesa e qasjes së shumicës së vendbanimeve në internet - o Gjendja fizike jo e mirë e rrjetit të energjisë elektrike. - o Funksionim jo adekuat i linjave hekurudhore - o Mungesa e qasjes së shumicës së popullsisë në sistem të rrjetit të kanalizimit - o Mungesa e qasjes së shumicës së popullsisë në menaxhim të mbeturinave	Kërcënimet - o Popullata nuk ka qasje në infrastrukturë teknike (rrjetit të kanalizimit, ujit të pijes, telefonisë mobile dhe fikse, etj..) - o Mungesa e investimeve kapitale në infrastrukturë

I.12. SFIDAT E IDENTIFIKUARA

Bazuar në gjendjen ekzistuese komunale janë identifikuar problemet kyçe të cilat e rëndojnë situatën në këtë komunë:

1. Nivel jo i kënaqshëm në administratë
2. Mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve në arsim dhe shëndetësi
3. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë
4. Mungesa e qendrave sekondare dhe infrastrukturës urbane
5. Ndotja dhe degradimi i mjedisit
6. Degradimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
7. Humbja e tokës bujqësore nga zhvillimet e pa kontrolluara
8. Aspekti i legjislacionit
9. Aspekti i import/eksportit
10. Aspekti i mbështetjes financiare
11. Infrastrukturë jo cilësore dhe e pa mjaftueshme

SFIDA 1. Nivel jo i kënaqshëm në administratë

Shërbimet administrative në Komunën e Rahovecit nuk janë në nivelin e kënaqshëm.

SFIDA 2. Mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve në arsim dhe shëndetësi

Në Komunën e Rahovecit ekzistojnë numër i konsiderueshëm i objekteve arsimore dhe shëndetësore por gjendja e tyre fizike nuk është e kënaqshme. Gjithashtu mungojnë pajisjet teknike për arsim dhe shëndetësi. Problem tjetër mjaft i theksuar sa i përket shërbimeve arsimore dhe shëndetësore është edhe mungesa e infrastrukturës së nevojshme në këto objekte siç janë ujësjellësi, kanalizimi etj. Në një pjesë të konsiderueshme të vendbanimeve paraqitet si problem edhe mungesa e hapësirës shkollore.

SFIDA 3. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë

Në Komunën e Rahovecit ekziston shkallë shumë e lartë e papunësisë dhe varfërisë. Papunësia më e lartë është e shprehur te grup moshat e popullsisë 25-39 vjeç. Krahas shkallës së lartë të papunësisë paraqitet edhe shkallë mjaft e lartë e varfërisë. Të dhënat tregojnë për një përqindje të lartë të varfërisë së përgjithshme në komunë, ndërsa shkalla e varfërisë ekstreme arrin në rreth 17 % të popullsisë së përgjithshme.

SFIDA 4. Mungesa e qendrave sekondare dhe infrastrukturës urbane

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme urbane si dhe mungesa e qendrave sekondare paraqet vështirësi në realizimin e kërkesave të qytetarëve.

SFIDA 5. Ndotja dhe degradimi i mjedisit

Problemet mjedisore janë prezente pothuaj se në tërë territorin e komunës. Shfrytëzimi i pa kontrolluar dhe pa plan i mjedisit po përcillet me probleme të natyrave të ndryshme. Shfrytëzimi i inerteve dhe degradimi i tokës.

SFIDA 6. Degradimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Komuna e Rahovecit është shumë e pasur me trashëgimi natyrore dhe kulturore, mirëpo kujdesi jo i mjaftueshëm ndaj tyre po ndikon në degradimin e saj.

SFIDA 7. Humbja e tokës bujqësore nga zhvillimet e pa kontrolluara

Ndërtimet po ndikojnë në shoqëri dhe mjedis në shumë mënyra- shkatërrimi i zonave të gjelbra, shfrytëzimi i tokës bujqësore të kategorisë II-IV, deformimi i linjave të ndërtimit dhe uzurpimin pronës publike etj.

SFIDA 8. Aspekti i legjislacionit

Moszbatimi i Ligjit për tokën bujqësore; Ligjit për verërat; Ligjit për pronësinë; Ligjit për ushqim.

SFIDA 9. Aspekti i import/eksportit

Mungesa e masave të favorshme për hapje të kontrolluar të tregut të Kosovës; Import dhe eksport të rrushit dhe të verës; Prodhimeve bujqësore tjera; Plasimit të sigurtë në tregun Evropian të prodhimeve bujqësore; depërtimit në tregjet e reja.

SFIDA 10. Aspekti i mbështetjes financiare

Mungesa e mbështetjes së vazhdueshme financiare për ngritjen e kapaciteteve private përpunuese në bujqësi, industri ushqimore; Mungesa e mbështetjes së vazhdueshme financiare për përtëritjen e teknologjisë së vjetruar dhe përdorim të metodave të reja shkencore në rritjen e prodhimtarisë; Mungesë e mbështetjes në krijimin e konkurrencës me prodhime finale, ekologjike

SFIDA 11. Infrastrukturë jo cilësore dhe e pa mjaftueshme

Në infrastrukturë arritjet janë të dukshme, mirëpo akoma mbetet shumë punë për tu bërë. Qasja e popullsisë në rrugë të kualitetit të lartë, rrjet të kanalizimit, shërbime të internetit, në valët e TV-së kombëtare, etj, të gjitha këto arritje po reflektohen në standardin jetësor të qytetarëve.

I.13. POTENCIALET LOKALE TË IDENTIFIKUARA

1. POPULLSI E RE DHE E SHËNDOSHË
2. AFËRSIA E VENDBANIMEVE ME QENDRËN URBANE
3. SIPËRFAQE KUALITATIVE TË TOKËS PËRGJATË LUMIT
4. SIPËRFAQE KUALITATIVE TË TOKËS NË PELLGUN E DRINIT TË BARDHË
5. SHFRYTËZIMI I SHKËMBINJVE PËR GURTHYES SIPAS STANDARDEVE
6. FUQIA PUNËTORE
7. TRADITË NË AKTIVITETE AGRARE
8. SIPËRFAQE KUALITATIVE NË PËRHAPJEN E KULTURËS SË VRESHTARISË
9. FOND I KONSIDERUESHËM I TOKËS BUJQËSORE SIDOMOS PER PERIMTARI
10. SHFRYTËZIMI I POTENCIALEVE NATYRORE PËR TURIZËM MONUMENTI
GJEOMORFOLOGJIK TE URA E FSJHEJT DHE KANJONI I MIRUSHES.
11. MUNDËSI ATRAKTIVE PËR VENDOSJE TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME
(KRYESISHT TREGTARE)
12. GATISHMËRIA E PARTICIPIMIT TË QYTETARËVE NË PROJEKTET E PËRBASHKËTA ME
KOMUNËN

II. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET - FAZA E DYTË

II.1. PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) është dokument i cili jep orientimet dhe përcakton shtrirjen hapësinore të zhvillimeve në të ardhmen (deri në vitin 2020) në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. PHK shërben edhe si udhëzues në hartimin e planeve zhvillimore komunale.

Me qëllim të paraqitjes së kaheve të zhvillimeve hapësinore, duke marrë parasysh edhe karakteristikat gjeografike, natyrore, veprimtaritë socio- ekonomike etj, PHK identifikon katër zona të cilave u janë dhënë ngjyrat dhe emrat në bazë të tipareve karakteristike të zonës.

- o Thesari i Kosovës „Zona e gjelbër” zonë industriale, shërbyese tregtare, agroindustriale me qendër kryesore Mitrovicën.
- o Porti i Kosovës „Zona e kaltërt ” zonë administrative, arsimore, shërbyese, tregtare, agroindustriale, turistike me qendër kryesore Prishtinën
- o Kopshtet e Kosovës „Zona e portokalltë” zonë kulturo-turistike, agro-industriale dhe shërbyese tregtare. Qendrat kryesore: i, Peja.
- o Urat e Kosovës, „zonat e verdha”


Karakteristikat për zonën e verdhë

Kjo hapësirë zë pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe përbëhet nga komunat: Deçani, Rahoveci, Malisheva dhe Gjakovën si qendër më e madhe komunale. Kjo zonë shtrihet në pjesën e mesme të rrafshit të Dukagjinit të rrethuar me male, lartësi mbidetare prej 365m – 2656m, klimë të mesme kontinentale me ndikim të dobësuar të klimës mesdhetare, kohëzgjatje të vegjetacionit 200-250 ditë, rrjetë të pasur hidrografik, trashëgimi natyrore dhe kulturore, tokë bujqësore të kualitetit të lartë, kullosa, livadhe, traditë në kultivim të pemëve e vreshtave, bletarisë e shpezëtarisë, e dalluar për kultivimin e zejeve tradicionale.

Rahoveci si komunë i takon zonës së verdhë.

Vizioni për Zonën e Verdhë:

Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agroindustriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.



Qëllimet e përgjithshme për zonën e verdhë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brendaurbane, ndërrurbane me 6 hapësirat e tjera dhe më gjërë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja e zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ,
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë,
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agroindustriale dhe turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të ardhshëm të hapësirës së verdhë

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
• Burimet njerëzore, mosha e re e popullsisë (55% nën 26 vjet) • Vetëdije kolektive e lartë, • Përvoja në udhëheqje, • Pozita e mirë gjeografike, zonë kufitare, • Shndërrimi dhe shfrytëzimi i aeroportit ushtarak të Gjakovës në atë civil, • Tradita në kultivimin e zejeve tradicionale, • Përvoja në industri, • Sektori joqeveritar dhe diasporë e fortë dhe përkrahëse e zhvillimeve, • Sipërfaqet e punueshme dhe nën ujtitje, • Resurset natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit, • Zhvillimi i tregtisë, shërbimeve,	• Nivel i ulët i decentralizimit fiskal komunal, • Mungesa e vetiniciativës, • Vonesa e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore nga AKM, • Migrimi i popullatës – posaçërisht të moshës së re, • Ndërmarrjet e mëdha industriale në pronësi shoqërore jo aktive , • Degradim i konsiderueshëm i resurseve natyrore (shfrytëzimi i rërës dhe prerja e pyjeve), • Mungesa e kooperimit socio-kulturor,

- Zhvillimi i eko-bujqësisë,
- Kooperimi me qytete tjera brenda dhe jashtë Kosovës,
- Hapja e shkollave profesionale,
- Shfrytëzimi i TIK në shërbime,
- Zhvillimi i sektorit të shëndetësisë

Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të Hapësirës së Verdhë:

Konfliktet:

- Shtrirja e vendbanimeve me tokën bujqësore,
- Zhvillimi i industrisë ndërtimore me degradimin e lumenjve dhe pyjeve,
- Zhvillimi i zonës së aeroportit me tokën bujqësore,

Sinergjitë:

- Zhvillimi i turizmit kulturor, rekreativ, tradicional fshatar me ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore e kulturore,

Zonat hapësinore me interes të veçantë për Kosovën

- Aeroporti i Gjakovës,
- Kanjoni i Drinit të Bardhë me Urën e Fshejtë,
- Parku rajonal i Mirushës,
- Miniera e kromit në Devë,
- Liqeni akumulues - Radoniqi
- Manastiri i Deçanit,
- Çarshia e Madhe - Gjakovë,
- Kullat e Dukagjinit,
- Kalimet kufitare (Prush e Morinë).

II.2. VIZIONI PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

Gjatë përshkrimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese – profilit komunal, janë grumbulluar dhe analizuar të dhëna të shumta për fusha të ndryshme. Në bazë të këtij vlerësimi janë identifikuar edhe sfidat kryesore të komunës. Faza e dytë e planit parasheh zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve hapësinore me të cilat përballlet komuna e Rahovecit. Që në fillim është përshkruar deklarata e vizionit e cila në pika të shkurtra e përmbledh tërë parashikimin e këtij plani për zhvillimin e komunës në të ardhmen. Faza e dytë e planit (Vizioni, parimet dhe caqet) përfshinë parashikimet e favorshme të zhvillimeve të ardhme në fusha të ndryshme si: Zhvillimi ekonomik, social, kulturor, mjedisor, të infrastrukturës etj. Përmes kësaj deklarate prezantohet zhvillimi i ardhshëm i komunës në formë të përmbledhur si në vijim:

Komunë me sistem të avancuar administrativ, trende pozitive në punësim dhe zvoglim të varfërisë, duke e avancuar sistemin arsimor dhe shëndetësor, zhvillim të vendbanimeve me plan, zhvillim të qëndrueshëm mjedisor duke mbrojtur edhe vlerat e trashëgimisë kulturore, me ekonomi stabile duke avancuar vreshtarinë dhe perimtarinë, infrastrukturë të planifikuar e bashkëkohore.

Deklarata qartëson qëllimet e përgjithshme që duhet të arrihen në të ardhmen. Gjithashtu, përmes kësaj deklarate vërehen qartë qëllimet kryesore sipas fushave tematike dhe sektorëve. Përmes këtij vizioni, njëkohësisht ofrohen zgjidhje për sfidat e identifikuar në fazën e parë.

Vizioni për Komunën e Rahovecit parasheh zhvillime konkrete dhe të realizueshme si:

- o Avancim të administratës publike
- o Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë
- o Ngritje të nivelit në arsim dhe shëndetësi
- o Zhvillim të vendbanimeve dhe ndertime me plan
- o Mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë
- o Ekonomi të zhvilluar dhe
- o Infrastrukturë e planifikuar bashkëkohore

Në të gjitha këto fusha ekzistojnë probleme të theksuara të cilat do të gjejnë zgjidhje në të ardhmen.

II.3. PARIMET E PËRGJITHËSHME TË ZHVILLIMIT

Parimet e përgjithshme të Planit Zhvillimor Komunal bazohen në dokumentet të rëndësishme për planifikim hapësinor:

- **Ligji për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor.**
- **Parimet Udhëzuese për Zhvillimin e Qëndrueshëm Hapësinor të BE – ESDP**
- **Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm –Agjenda 21**
- **Parimet e qeverisjes së mirë urbane – Agjenda e Habitatit**

Parimet bazë mbi të cilat do të fokusohen zhvillimet e përgjithshme të komunës së Rahovecit në raport me parimet ndërkombëtare janë:

- o Promovimin e interesave të përbashkëta të komunës duke mbrojtur dhe zhvilluar resurset natyrore dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.
- o Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike.
- o Promovimin e transparencës së plotë në planifikim dhe procesin e marrjes së vendimeve duke iu lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme.
- o Promovimin e të drejtave të barabarta ekonomike dhe shoqërore për të gjithë qytetarët.
- o Promovimin e formave të balancuara të zhvillimit të vendbanimeve, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetesës.
- o Promovimin e harmonizimit me parimet dhe planet e vazhdueshme të zhvillimit hapësinor Evropian.

II.4. PARIMET E QEVERISJES SË MIRË

- **QËNDRUESHMËRIA** - të ketë qasje të integruar e cila përfshin elementet hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunë.
- **SUBSIDIARITETI** – marrja e vendimeve mbi baza të hierarkisë nga niveli qendror në atë lokal dhe zbatimi sa më efikas.
- **BARAZIA** - plani duhet të merr parasysh aspektet e barazisë: minoritetet, femrat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara (adresimi i nevojave të grupeve të tilla përmes pjesëmarrjes publike) të ketë në konsideratë aspektet e ndjeshmërisë gjinore.
- **EFIKASITETI** - ti prijë zhvillimit strategjik në territorin e komunës dhe të trajtojë çështjet e rëndësisë strategjike për fushat përkatëse.
- **TRANSPARENCA** – të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të kenë arsyen dhe personat përgjegjës duhet të jenë transparent për zhvillimet në hapësirë.
- **PJESËMARRJA** – në këtë rast plani zhvillimor komunal, si projekt shumë i rëndësishëm për të ardhmen e komunës, të përfshijë pjesëmarrje të gjerë me qëllim të përfaqësimit të interesave të të gjithëve pa dallime.
- **PËRGJEGJSHMËRIA** – për të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të jemi të përgjegjshëm. Kjo duhet të arrihet si nga sektori publik, privat dhe deri te qytetari më i thjeshtë.

II.5. QËLLIMET AFATGJATE TË ZHVILLIMIT

Në këtë pjesë janë prezantuar të gjitha qëllimet e përgjithshme që duhet të arrihen në zhvillimin e ardhshëm të komunës. Në kuadër të këtyre qëllimeve të përgjithshme janë specifikuar edhe qëllimet konkrete.

Qëllimi 1. Administratë funksionale dhe efikase

- Q1S1. Decentralizimi i administratës*
- Q1S2. Avancimi i sistemit elektronik*
- Q1S3. Ndërtimi i sistemit të adresave*

Qëllimi 2. Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë

- Q2S1. Organizimi i programeve dhe trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut*
- Q2S2. Sigurimi i punës sezonale*
- Q2S3. Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme*
- Q2S4. Stimulime të vazhdueshme në veprimtari bujqësore*

Qëllimi 3. Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi

- Q3S1. Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shërbimet arsimore dhe shëndetësore*
- Q3S2. Përmirësimi i infrastrukturës teknike në objektet arsimore dhe shëndetësore*
- Q3S3. Krijimi i kushteve për edukim të vazhduar të personelit profesional në arsim dhe shëndetësi*

Qëllimi 4. Zhvillim të vendbanimeve dhe ndertime me plan

- Q4S1. Lidhje funksionale me qendrën urbane*
- Q4S2. Formimi i qendrave të reja sekondare*
- Q4S3. Hartimi i planeve rregulluese urbane*
- Q4S4. Zgjidhje për ndërtimet ilegale dhe vendbanimeve joformale*

Qëllimi 5. Mbrojtje e mjedisit dhe shfrytëzim racional

- Q5S1. Parandalimi dhe largimi i mbeturinave ne trupat uxor dhe mjedise tjera*
- Q5S2. Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale ne Lumenj si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim te ujërave të zeza*
- Q5S3. Ndërmarrja e masave anti-erozive*
- Q5S4. Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve*
- Q5S5. Shfrytëzimi racional i zhavorrit dhe gurthyesve për një zhvillim të qëndrueshëm*
- Q5S6. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore*
- Q5S7. Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve.*
- Q5S8. Ripyllëzimi i hapësirave të zhveshura dhe krijimi i brezave të gjelbëruar*

Qëllimi 6. Ekonomi e zhvilluar

- Q6S1. Zhvillimi i bujqësisë dhe prodhimeve bujqësore*
- Q6S2. Zhvillimi i prodhimitarisë vreshtare dhe plasim i sigurtë në tregun Evropjan dhe më gjërë*
- Q6S3. Zhvillimi i turizmit bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore,*

Qëllimi 7. Infrastrukturë e planifikuar bashkëkohore

- Q7S1. Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët*
- Q7S2. Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes*
- Q7S3. Qasje e përgjithshme e popullsisë ne rrjetin e kanalizimit*
- Q7S4. Shtirja e rrjetit të kanalizimeve për ujëra të bardha (atmosferae)*
- Q7S5. Përmirësim të rrjetit të energjetikës*
- Q7S6. Organizim i grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre*
- Q7S7. Ndriçimi i rrugëve në zona të frekuentuara*
- Q7S8. Funksionalizim i vijës hekurudhore*
- Q7S9. Qasje ne rrjetin e internetit për të gjithë*
- Q7S10. Shtirja e telefonisë fikse në vendbanimet e dendura.*

II.6. PRIORITETET STRATEGJIKE

- ✓ Zhvillimi i bujqësisë
- ✓ Zhvillimi i prodhimitarisë vreshtare dhe plasim i sigurtë në tregun Evropjan dhe më gjërë

- ✓ Mbrojtje e mjedisit dhe shfrytëzim racional
- ✓ Infrastrukturë e planifikuar bashkëkohore
- ✓ Zhvillim të vendbanimeve dhe ndertime me plan
- ✓ Ngritje të nivelit në arsim dhe shëndetësi
- ✓ Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë
- ✓ Zhvillimi i turizmit bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore
- ✓ Avancim të administratës publike

III. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË KOMUNËS

Duke u bazuar në procesin e planifikimit hapësinor dhe në Ligjin për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor të Republikës së Kosovës, faza e tretë e planit përmbanë kornizën e zhvillimit hapësinor. Në këtë fazë të planit shprehen parashikimet zhvillimore për territorin e komunës së Rahovecit. Ndërsa, njëkohësisht përcaktohet edhe koncepti hapësinor i strategjive për implementim, planet e veprimit dhe të vendimmarjes.

Korniza e zhvillimit hapësinor në Komunën e Rahovecit përmban:

1. Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor
2. Strukturën dhe lokacionin hapësinor për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm, ku do të adresohen çështjet si:
 - a) Zhvillimi ekonomik, rigjenerimi, përfshirë turizmin, rekreacionin, tregtinë dhe veprimtaritë tjera ekonomike.
 - b) Infrastrukturën – transportin komunal, komunikimet, etj.
 - c) Popullsinë, banimin, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgiminë, etj.
 - d) Mjedisin, përfshirë trashëgiminë natyrore dhe resurset, peizazhet etj.
3. Shënjimi i zonave urbane ekzistuese dhe të propozuara për të ardhmen dhe zonave tjera jashtë zonës urbane.
4. Shënjimi i ndërtimeve të rëndësishme, projekteve strategjike ose zonave të veçanta të cilat veç janë aprovuar në Planin Hapësinor të Kosovës.
5. Vlerësimi i ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor i kornizës së propozuar.

III.1. KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Në bazë të analizës së gjendjes ekzistuese, në fazën e parë (profili) të planit zhvillimor komunal, konkludohet se Komuna e Rahovecit ofron mundësi për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe perspektivë për banorët e saj.

Në Komunën e Rahovecit, në bazë të kushteve fiziko-gjeografike, dallohen dy tërësi kryesore hapësinore që dallohen për kah morfologjia e terrenit dhe faktorët tjerë natyror, ndërsa në bazë të këtyre faktorve kushtëzohet edhe niveli zhvillimor në hapësirë. Pra, dallohet hapësira e rrafshët me tokë bujqësore të cilësisë së lartë dhe hapësira kodrinore-malore me pyje e kullosa.

Hapësira kodrinore-malore, në anën veriore të komunës, paraqet ambient të përshtatshëm për pushim dhe rekreacion si dhe aktivitete tjera me karakter ekonomik. Ndërsa, pjesa jugor e komunës ofron mundësi të mira për sektorin e agrikulturës, zhvillimin e bizneseve, vendbanimeve dhe infrastrukturës moderne. Vlerat e kësaj tërësie hapësinore i'a shton lumi Drini me disa degë të tija që kalon në anën jugore. Zona fushore paraqet perspektivë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, ku dominon agrobiznesi si dhe aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe shërbyese. Kjo zonë, e cila më vonë do të quhet "Zona Aktive Zhvillimore" karakterizohet me zhvillim të gjithmbarshëm të llojit të përzier, me përqendrim të madh të popullsisë, aktivitete tregtare-industriale të cilat qëndrojnë ngushtë të lidhura edhe me zhvillimin e komunikacionit e transportit, si dhe zhvillimit të përgjithshëm të bujqësisë, por njëkohësisht edhe me ndikime të theksuara mjedisore. Kjo zonë është

edhe zona më e ndërlikuar në kuptimin e planifikimit dhe menaxhimit hapësinorë në Komunën e Rahovecit, prandaj duhet kushtuar vëmendje e veçanet gjatë procesit të hartimit të PZHK-së, si dhe duhet llogaritur në fleksibilitetin e implementimit të PZHK-së.

Hapësira veriore e komunës së Rahovecit dallohet me karakteristika tjera natyrore dhe të aktiviteteve, dendësi të vogël banimi, rrjet të dobët të infrastrukturës lokale si dhe ambient të qetë dhe të pastër. Mbrojtja, zhvillimi dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe potencialeve të kësaj zonë mundëson hapjen e perspektivës për zhvillimin e komunës, me theks të veçantë në turizëm.

Qyteti i Rahovecit ofron mundësi për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Ndërsa në zonat rurale propozohet ofrim i shërbimeve dhe infrastrukturës me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së jetës. Kjo do të reflektohet në ngritjen e standardit jetësor të popullsisë dhe hapjen e mundësive të reja për zhvillim në fshat.

Në këtë rast, rëndësi të vecantë ka përcaktimi i pikave më të përshtatshme dhe të favorshme për ofrimin e shërbimeve, ndërsa kjo do të reflektohet në koncentrimin e popullsisë e jo në dezintegrim të saj. Me formimin e disa qendrave sekondare dhe lokale do të zvogëloheshin distancat mes banimit dhe shërbimeve.

III.1.1. Skenarët e zhvillimit hapësinor

Në bazë të analizës së gjendjes ekzistuese –profilin, ofrohen edhe skenarët e mundshëm të zhvillimit hapësinor, sipas kriterëve dhe standardeve të planifikimit, (sociale, ekonomike, koncentrimin, fuqisë gravituese të qendrave, pozitës, infrastrukturës, produktivitetit të tokave etj) që do të vlerësohen si alternativë e zhvillimit dhe organizimit të ardhshëm të komunës,


Skenari A: Zhvillim Monocentrik

Qendra urbane zhvillohet gjithnjë e më tepër në raport me rrethinën, ndërsa vendbanimet rurale edhe më tej ngecin në zhvillimin ekonomik dhe social.

Veprimtaritë ekonomike koncentrohen kryesisht në qytet dhe në disa vendbanime tjera më të mëdha. Zona urbane dhe vendbanimet tjera shtrihen kryesisht përgjatë korridoreve të rëndësishme rrugore. Tokat bujqësore të cilësisë së lartë vazhdimisht mbulohen dhe humbin nga ndërtimet e pakontrolluara.

Zonat rurale vazhdon ti përcjell edhe më tej në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik dhe me infrastrukturë të zhvilluar të dobët. Niveli i shërbimeve mbetet i ulët për shkak të lidhjeve të dobëta me qendrën kryesore. Qendrat lokale mbesin të dezintegruara në sistemin urban. Vendbanimet rurale stagnojnë dukshëm në të gjitha aspektet e zhvillimit. Kjo formë zhvillimore ka tendencë të stagënit dhe boshatisjes së shumë vendbanimeve dhe zonës ku këto vendbanime shtrihen, kryesisht si rezultat i mungesës së infrastrukturës bazë fizike dhe sociale. Si rrjedhojë e kësaj shtohet edhe më tej shkalla e mosinteresimit për të investuar, punuar dhe jetuar në këtë zonë.

Zbrazja e vendbanimeve kodrinore-malore humbë efektin dhe bazën e valorizimit ekonomik në këto zona me rëndësi.

Harta 41. Koncepti monocentrik

Përparësitë:

- Bizneset zhvillohen spontanisht.


Dobësitë:

- Centralizimi i institucioneve,
- Lidhje e dobët e vendbanimeve rurale me zonën urbane,
- Qasja e dobët e fshatrave në infrastrukturën sociale,
- Fluksi i shtuar i migrimit të popullsisë nga zonat rurale drejt qytetit,
- Zhvillim i pakontrolluar i vendbanimeve në tokat bujqësore,
- Zhvillim i pakontrolluar i ndërtimeve në zonën urbane,
- Vështërsi në përcjelljen e trendeve të urbanizimit në zonën urbane nga zgjerimi i pakontrolluar,
- Humbje e kontaktit dhe lidhjeve me peizazhet e bukura malore,
- Humbje e mbështetjes së shfrytëzimit të pasurive natyrore në viset malore.

Konkluzion: Bazuar në vlerësimin e përparësive dhe dobësive, ky skenar nuk është i favorshëm për tu aplikuar.

Skenari B: Zhvillim linear

Koncepti linear i zhvillimit përcjell kryesisht linjat ose korridoret rrugore të karakterit shtetëror, por edhe të disa rrugëve të rëndësishme lokale që lidhin vendbanimet mes veti. Zhvillimet për gjatë rrugëve marrin karakter linear më të theksuar, por kanë edhe një lloj kombinimi linear – koncentrik, duke mos lënë anash edhe zhvillimet lineare përgjatë rrjetit brenda vendbanimeve. Kjo formë e zhvillimit linear ka të bëjë me shtrirjen gjatë sërë të vendbanimeve, aktiviteteve ekonomike-shërbyese, përqendrimit të popullsisë etj.



Harta 40. Koncepti linear

Koncepti linear nuk ë shtë i pë rshtatshë m dhe krijon shumë probleme duke rritur shkallën e investimeve, rrezikon sigurinë e banorëve, ndikon drejtpërdrejt në keqësimin e mjedisit jetësorë të banorëve, rritë koston e transportit, rritë koston e mirëmbajtjes së infrastrukturës së përgjithshme fizike si dhe krijon vështirësi në zhvillimin dhe menaxhimin e çështjeve me të cilat përballet komuna.

Përmes këtij skenari zhvillimet kanë këto orientime:

- Të gjitha aktivitetet ekonomike zhvillohen përgjatë rrugëve nacionale, pa marr parasysh kategorinë e tyre,
- Vendbanimet zhvillohen përgjatë rrugëve duke formuar korridore dhe duke marrë formën e zgjatur,
- Bashkimi i vendbanimeve mes veti dhe humbja e identitetit,
- Shpërndarja e shërbimeve bazë vështirësohet.

Përparesitë:

- Qasje e mirë në infrastrukturë rrugore,
- Zhvillimi i zonave rurale përgjatë korridoreve.

Dobësitë:

- Disa zona të komunës mbeten të pazhvilluara,
- Zhvillimi i dobët i qendrës urbane,
- Zhvillimi i vendbanimeve përgjatë rrugës,
- Zënia e tokës bujqësore,
- Shpenzime të larta për kycje në infrastrukturë,
- Rritje e distancave ndaj shërbimeve,
- Rrezikim i banorëve nga zhvillimi komunikacionit,
- Pengesa në zhvillimin e komunikacionit, etj.

Konkluzion: Ky skenar nuk është i favorshëm për tu aplikuar.

Skenari C: Zhvillim policentrik

Skenari C ofron mundësi më të mira dhe më bashkëkohore për zhvillim të më tejme të komunës. Koncepti i zhvillimit të ardhshëm i komunës është koncepti policentrik dhe i qëndrueshëm. Ky koncept për qëllim kryesorë ka zhvillimin e tërë hapësirës komunale, bazuar në shfrytëzimin racional të të gjitha mundësive dhe resurseve lokale, si dhe në ruajtjen e vlerave mjedisore për gjenerata të ardhshme. Në bazë të kësaj, zhvillimet lineare nuk do të favorizohen, ndërsa ato ekzistuese duhet të monitorohen dhe rehabilitohen aq sa të jetë e mundur.

Zhvillimi policentrik ka për qëllim shpërndarjen e aktiviteteve brenda vendbanimit ose disa vendbanimeve, ndërtimin, rehabilitimin dhe pajisjen me infrastrukturë të nevojshme, qasje në transport, qasje të mirë në shërbime sociale dhe krijimin e kushteve të favorshme për punë dhe rekreacion në të gjitha vendbanimet. Gjithashtu ka për

qëllim që stagërimi i zhvillimeve në vendbanimet malore të ndërpritet përmes ofrimit të infrastrukturës elementare dhe shfrytëzimit të resurseve lokale për zhvillim të mëtutjeshëm.

Zhvillimi i qëndrueshëm është model i shfrytëzimi të resurseve që ka të bëjë jo vetëm me plotësimin e nevojave të tanishme por edhe për gjeneratat e ardhshme. Me fjalë të tjera, zhvillimi i qëndrueshëm tenton ti kënaq nevojat apo kërkesat e tanishme, duke mos rrezikuar mundësitë dhe perspektivën e gjeneratave që vijnë.


Përmes këtij koncepti do të realizohen zhvillime të dëshiruara në fushat, si:

1. Administratë efikase dhe të decentralizuar
2. Infrastrukturë adekuate me qasje të mirë
3. Ekonomi të zhvilluar dhe të balancuar
4. Mbrojtje efikase e tokës bujqësore dhe zhvillim i bujqësisë
5. Vendbanime kompakte dhe funksionale
6. Mjedis të pastër dhe atraktiv

Efektet konkrete të këtij skenari janë:

- Zhvillim i balancuar në mes qytetit dhe zonave rurale të komunës
- Qendrat sekondare; Krushë e Madhe, Xërxe dhe Ratkoc zhvillohen vazhdimisht,
- Qendrat sekondare duhet të sigurojnë tokë të mjaftueshme për banim, industri dhe tregti,
- Në vendbanimet me funksione qendrore duhet të vendosen shërbimet kryesore publike; administrata publike, shkollat dhe qendrat shëndetësore,
- Qendrat duhet të ofrojnë shërbime dhe produkte të nevojshme për përdorim afatshkurtër dhe afatmesëm,
- Qendrat sekondare do të jenë nyje të rrjetit të infrastrukturës rrugore lokale.
- Qendrat sekondare dhe lokale u ofrojnë të gjitha vendbanimeve tjera shërbime institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale,
- Zonat rurale fitojnë perspektiva zhvillimore në bazë të qendrave sekondare dhe resurseve natyrore që disponojnë,
- Zonat e vendbanimeve përkufizohen qartë, ndërsa vendbanimet ndahen mes veti me gjelbërim,
- Fluksi i largimit të banorëve nga fshatrat do të zvogëlohet ose edhe ndërpritet,
- Zonat e rrafshëta zhvillojnë bujqësinë moderne, ndërsa në viset kodrinore-malore zhvillohet blegtoria dhe turizmi,

Harta 42. Koncepti policentrit



Përparësitë:

- Avancim dhe zhvillim i qendrave sekondare,
- Zhvillim ekonomik i zonave rurale,
- Minimizim i shpenzimeve në infrastrukturë,
- Zvogëlim i distancave brenda vendbanimeve,
- Lidhje e mirë e vendbanimeve me qendrën urbane,
- Shpërndarje e volitshme e institucioneve dhe e infrastrukturës teknike dhe sociale,
- Koncentrim i burimeve përmes qendrave sekondare

- Zhvillim kompakt dhe dendësim i ndërtimeve,
- Ruajtja e tokës bujqësore,

Dobësitë:

- Zonat urbane dhe qendrat sekondare ndiejnë nevojë për plane rregulluese,
- Ngadalësim i zhvillimit të qytetit nga se vjen në shprehje ndarja e mjeteve në mënyrë të barabartë.


Konkluzion: Në bazë të vlerësimit të përparësive dhe dobësive, ky skenar konsiderohet *i favorshëm për zhvillim* të mëtejme.

III.1.2. ZONAT DHE FUNKSIONET E TYRE

Në Komunën e Rahovecit, në bazë të kushteve fiziko-gjeografike, dallohen dy tërësi kryesore hapësinore që dallohen për kah morfologjia e terrenit dhe faktorët tjerë natyror, por edhe në aspektin ekonomik, social, mjedisor, të infrastrukturës dhe shërbimeve.

a) Zona Jug perendimore -kopshtet

b) Zona Veri lindore -Kodrinat dhe Natyra



Harta 43. Zonat zhvillimore

a) Zona Jug perendimore -kopshtet

Kjo zonë shtrihet në pjesën jugore dhe jug perëndimore të komunës së Rahovecit, në lartësi mbidetare deri në 600m. Në këtë zonë përfshihen edhe sipërfaqet shumë produktive të tokave përgjatë lumit Drini që karakterizohen me prodhimtari të lartë të perimtarisë. Në brezin e lartësisë mbidetare 400-600 metra shtrihet relievi pak i valëzuar me kushte shumë të përshtatshme për zhvillimin e vreshtarisë dhe vendbanimeve në të cilën hapësinë zhvillohen aktivitete të rëndësishme. Në këtë zonë janë koncentruar gati të gjitha aktivitetet, vendbanimet, popullsia, shërbimet, infrastruktura etj, për çka edhe është quajtur zona aktive. Zë sipërfaqen prej 21830 ha që përfshin rreth 79 % të territorit komunal. Në këtë zonë gjenden 32 komuna kadastrale, nga 35 sa ka gjithsej komuna e Rahovecit, ose rreth 91 % e vendbanimeve, ndërsa në të jetojnë 68503 banorë ose rreth 96 % e popullsisë së komunës.

b) Zona Veri lindore-Kodrinat dhe Natyra

Shtrihet në pjesën veri-lindore të komunës, nga 600 metra deri në mbi 800 metra të lartësisë mbidetare. Tërë kjo hapësirë formon zonën e dytë që karakterizohet me reliev kodrinor-malor, me vlera të rëndësishme natyrore dhe për këtë arsye është quajtur edhe zona e kodrinave dhe natyrës. Kjo zonë përfshinë sipërfaqen prej 5720 ha apo 26.2 % të territorit të komunës. Për shkak të veçorive fiziko-geografike, kjo zonë është e pasur me vlera natyrore, por është më pak e banuar në krahasim me zonën aktive. Në tërë këtë hapësirë ekzistojnë vetëm 3 vendbanime (Drenoc, Koznik, Zatriq) dhe jetojnë 3019 banorë ose rreth 4 % e popullsisë së komunës.

III.1.3. Qendrat dhe organizimi funksional

Analiza e gjendjes ekzistuese tregon për një organizim jocosilësor dhe të pa harmonizuar në hapësirë në aspektin e hierarkisë së qendrave të cilat duhet të ofrojnë shërbime. Andaj, me qëllim që të arrihet një organizim më efikas i shërbimeve, planifikohet të realizohet një zhvillim i ri i qendrave dhe organizimi funksional i tyre. Një organizim i tillë do të mbështetet në zhvillimet aktuale, ku do të krijohen edhe qendra tjera me rendësi për një funksionalitet më cilësor. Përmes zhvillimit të këtyre qendrave mundësohet shpërndarja e funksioneve dhe shërbimeve në territorin e komunës. Një sistem i tillë hierarkik u mundëson banorëve të komunës të kenë qasje më të lehtë në shërbime. Arritshmëria është një nga komponentët e rëndësishme të planifikimit që ndikon në përmirësimin e standardit jetësor të banorëve.

Plani Zhvillimor propozon sistemin hierarkik të vendbanimeve në tri kategori, por në asnjë rast nuk lejon destimulimin dhe humbjen e rëndësisë së qendrës komunale.

Plani Zhvillimor Komunal e sugjeron një sistem hierarkik me tri nivele:

- Qendra komunale
- Qendrat sekondare
- Qendrat lokale

Qendra komunale është e vendosur në qytetin e Rahovecit. Qyteti do të zhvillohet sipas objektivave në vijim:

- ✓ Zhvillim të industrisë dhe tregtisë,
- ✓ Zhvillim të tregtisë me shumicë e pakicë, që ofrojnë produkte të karakterit afatgjatë e afatshkurtër,
- ✓ Infrastrukturë për shëndetësi, arsim, kulturorë, sport e rekreacion, të sigurisë etj

Qendrat sekondare – Propozohet avancimi i tri vendbanimeve në funksion të qendrave sekondare të cilat janë:

1. Krushë e Madhe
2. Xërxe
3. Ratkoc

Qendrat sekondare do të zhvillohen në bazë të këtyre objektivave:

- ✓ Qendrat sekondare do të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për banim, tregti dhe industri, me qëllim të plotësimit të kërkesave të banorëve që gravitojnë në këto qendra.
- ✓ Shërbimet dhe prodhimet e karakterit afatshkurtër dhe afatgjatë.
- ✓ Shërbimet publike themelore, si: shkolla, qendrat e shëndetësisë, zyrat për administratë, duhet të vendosen në qendrat sekondare.

Qendrat e bashkësive lokale janë: Çifllaku, Drenoci, Hoça e Vogël, Opterusha, Zatriqi. Këto qendra ofrojnë shërbime për rrethinën e tyre, si: shkollën e plotë fillore, zyrën e ofiqarisë, tregtinë me pakicë, etj.

III.1.4. Rrjeti i trafikut

Rrjeti i trafikut në Komunën e Rahovecit karakterizohet me zhvillimin e kategorive të ndryshme të komunikacionit i cili përbehet nga rrjeti i rrugor dhe ai hekurudhor.

Rrjeti rrugor – është i zhvilluar nëpërmjet të trafikut nacional, përkatësisht rrugës nacionale M9.1 (Gjakovë-Prishtinë) dhe rrugës regjionale R107 (Prizren-Xërxë-Gjakovë), trafikut regional nëpërmjet rrugëve regjionale R110 (Malishevë-Rahovec-Xërxë-Gjakovë), R-111 (Xërxë - Ratkoc - Kramovik), dhe R117 (Rahovec - Opterushë - Suharekë) pastaj trafikut lokal nëpërmjet të rrugëve lokale që lidhin gjithsejtë 34 komuna kadastrale me 35 vendbanime.

Rrjeti hekurudhorë – është i zhvilluar nëpërmjet të hekurudhës me karakter shetëror, regional dhe lokal, e cila kalon në pjesën qendrore të komunës dhe lidhë Prishtinë dhe Shkupin.

Vërejtje: është e rëndësishme të përmendet se në pjesën kryesisht qendrore të komunës kalojnë korridoret ajrore të komunikacionit ajror internacional.

III.2. STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR


III.2.1. Zhvillimi ekonomik

Në këtë kaptinë do të elaborohet koncepti i zhvillimit ekonomik të komunës së Rahovecit duke qartësuar dhe skematikisht përshkruar se ku dhe cka do të ndodhë nga aktivitetet ekonomike në komunën e Rahovecit, përderisa më tutje në kaptinën e strategjisë do të elaborohet se “SI” do të arrihet ky zhvillim ekonomik, përmes cilave instrumente, cilës formë.

Përshkrimi i konceptit të zhvillimit hapsinor do të fillojë sipas hierarkisë prej më gjërë në më ngushtë në kuptim fizik hapsinor, porse dhe duke përdorë dokumente statutorë si Planin Hapsinor të Kosovës 2010-2025+, duke përshkruar pozitën e komunës në kontekst më të gjërë ndërkombëtar, kontekst ndërshtetëror dhe ndërkomunal.

Hapi i dytë do të jetë elaborimi i në kontekst më të ngushtë komunal në raport me komunat fqinje, orientimet strategjike për zhvillim ekonomik dhe së fundi organizimin brenda komunës në kontekst ekonomik.

Aktivitetet ekonomike janë ato për të cilat flasim duke paramenduar karakterin e zhvillimit të tyre, dhe të plasimit sikurse të mallrave, poashtu dhe të shërbimeve.



Rangimi i komunave të Kosovës sipas nivelit të zhvillimit ekonomik, sipas PHK 2010-2025

Sipas Planit Hapsinor të Kosovës 2010-2025+, komuna e Rahovecit është e ranguar në komunat me potencial -të mesëm zhvillimor ekonomik, prandaj të gjitha qëllimet e planifikuara për të ardhmen e komunës janë në favor të mbërritjes së nivelit të zhvillimit

të kënaqshëm apo dhe rritjes ekonomike maksimale bazuar në potencialet zhvillimore të komunës së Rahovecit.

Struktura dhe koncepti i zhvillimeve hapësinore në të ardhmen do të jenë në përputhshmëri me caqet madhore sipas Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2025+, të cilat orientojnë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, bazuar në resurse natyrore, humane, teknologji bashkëkohore, treg konkurrues dhe zbatim të standardeve mjedisore, duke bashkërenditur politikat dhe veprimet e të gjithë sektorëve relevant;

-  *Vendosjen e zhvillimit të qëndrueshëm policentrik që nënkupton zhvillimin e balancuar në tërë komunën,*
-  *Forcimin e karakteristikave zhvillimore të vendbanimeve dhe shfrytëzimin e potencialeve;*
-  *Ofrimin e mundësive komplementare për zhvillimin e zonave rurale, të ndërlidhura në rrjet me poliëndrat e komunës së Rahovecit.*

Mëpastaj synimet e përgjithshme për rritjen ekonomike të komunës së Rahovecit, janë të bazuara në potencialet zhvillimore si rajon apo "Zonë e Verdhë" - "Urë e Kosovës" sipas PHK 2010-2025+ , zhvillime të përcaktuara në rajon më të gjërë dhe të cilat zhvillime janë bazuar në:

-  *Ndërlidhjet zhvillimore ekonomike, tregtare, kulturore, shoqërore etj me rajonin, qoftë në këtë rast me komunat fqinje, regionit më të gjërë ndërkombëtar.*
-  *Ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, resurseve natyrore dhe trashëgimisë kulturore;*
-  *Zhvillimin dhe integrimin e infrastrukturës dhe komunikimit;*
-  *Bashkëpunimin regional/ndërkombëtar.*




Fig.x.

Orientimet strategjike zhvillimore të Kosovës

Nga orientimet zhvillimore të Kosovës shohim se komuna e Rahovecit është në drejtim linear me kahjen e zhvillimit të drejtëpërdrejtë për në Shqipëri porse dhe përmes qytetit të Pejës në Mal të zi.

Me të qenë e kategorizuar në “Zonën e Verdhë”, komuna e Rahovecit do të jetë e përkushtuar për lidhje dhe komunikim jashtëkomunal dhe ndërkombëtar i cili fillimisht do të varet nga potencialet fizike të komunikimit, linjat hekurudhore dhe ato rrugore porse dhe ato institucionale.


Orientimi zhvillimor Jugperëndim/Gjakovë - nis me linjën përmes Gjakovës me të cilën arrihet deri tek porti i Shëngjinit, me të cilën komuna e Rahovecit do arrijë shumë shpejtë dhe për kohë shumë të shkurtër mundësinë për shkëmbim të mallrave, përmes transportit ujqor deri tek tregjet e reja në botë, portet e reja evropiane dhe botërore.

Orientimi zhvillimor Jug/Prizren - nis me linjën përmes Prizrenit/autoudhës Merdare - Durrës me të cilën arrihet deri tek porti i Durrësit. Duke qenë komuna e Rahovecit, e para në distancën më të shkurtër nga autoudha, pas qytetit të Prizrenit do të mund të përfitojë më së shumti për shkak të afërsisë apo lidhjes daljes direkte për në port detar të Durrësit, port shumë më i madh dhe me renome përmes së cilës do të transportojë mallrat prej dhe për në botë.

Orientimi zhvillimor Perëndim/Pejë - nis me linjën përmes Pejës me të cilën arrihet deri tek Mali i Zi si port ndërkombëtar tokësor, me të cilën komuna e Rahovecit do arrijë shumë shpejtë dhe për kohë shumë të shkurtër mundësinë për shkëmbim të mallrave ushqimore drejt tregjeve të rivierës së adriatikut.

Orientimi zhvillimor përmes- lidhjes hekurudhore - do jetë ndihmesë e madhe në realizimin e strategjisë për komunikim, bashkëpunim dhe shkëmbim të mallrave përmes transportit efikas dhe të sigurtë hekurudhor dhe poashtu rrugor.

Këtë përparësi, komuna e Rahovecit duhet ta shfrytëzojë për plasimin e prodhimeve ushqimore dhe ato të rrushit dhe verës, me të cilën do të sigurohet cmim shumë më i lirë i transportit, me ç’rast për shkak të distancës, transporti tokësor do të jetë shumë më i vogël për dallim nga komunat e tjera.



Zona e verdhë e zhvillimit ekonomik "Urat e Kosovës", sipas PHK 2010-2025+

Koncepti për zhvillimin hapësinor të komunës së Rahovecit në kontekst të zhvillimit ekonomik, fillon me bashkëpunimin duke nisur nga qelula më e vogël – fshatit të komunës së Rahovecit si qendër lokale sipas administrimit territorial të komunës, qendrës sekondare dhe mëpastaj qendrës primare të qytetit të Rahovecit, të ndihmuar nga dy poliqendra tjera (Retkoc dhe Krushë të madhe) dhe Xërxës në mes.

Për komunën e Rahovecit, bazuar në resurse natyrore është bërë zonim territorial: i) Kodrinore malore/natyrore në pjesën verilindore të komunës së Rahovecit dhe ii) Rrafshinore apo të kopshtit në pjesën jugperëndimore.


Lidhjet zhvillimore sipas parimit të zhvillimit policentrik në komunën e Rahovecit, kryesisht do të mund të përkufizohen si lidhje trekëndore për zhvillimin ekonomik ndërmjet qytetit të Rahovecit dhe dy poliqendrave Retkoc dhe Krushë të Madhe.

Xërxa si qendër sekondare vetëm sa fuqizon trekëndëshin hapësinor dhe institucional të zhvillimit ekonomik të tërë komunës së Rahovecit.

Qyteti i Rahovecit është i përkrahur nga Hoca e madhe si potencial zhvillimor kulturor e turistik, e cila së bashku me poliqendrat zhvillimore urbane, përmbledhin në mënyrë sinergjike tërë potencialet nga zonat rurale përreth.

Përmbledhje - Komuna e Rahovecit synon zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, të bazuar në resurse natyrore, resurse njerëzore, teknologji bashkëkohore, treg konkurrues dhe zbatim të standardeve mjedisore përderisa veprimtaritë ekonomike do të bazohen në prodhimtari bujqësore, vreshtari, industri përpunuese vreshtare dhe bujqësore, industri të turizmit rekreativ, kulturor, ekologjik dhe fshatar.

Tregtia si veprimtari ekonomike duhet të jetë në nivelin më të lartë e organizuar si instrument për plasimin për të gjitha prodhimet vendore. Të gjitha këto do të detajohen me strategjinë e përpiluar dhe të testuar për komunën e Rahovecit dhe mëpastaj duke detajuar masat dhe veprimet për zbatim.



Skema e zhvillimit ekonomik të komunës së Rahovecit

Kjo si tërësi e orientimeve zhvillimore ekonomike është paraqitur në mënyrë skematike në skemë-diagramin ku sipas ngjyrave përshkruhen orientimet dhe aktivitetet ekonomike në komunën e Rahovecit.

Aktivitetet kryesore ekonomike të cilën e shquajnë komunën e Rahovecit dhe të cilat janë paraqitur dhe në skemën e zhvillimit ekonomik janë: Aktivitetet bujqësore; Vreshtaria; Industria e përpunimit të rrushit; Industria përpunuese ushqimore; Tregtia; Industria e turizmit rekreativ dhe turistik.

III.2.2. POPULLSIA DHE VENDBANIMET

III.2.2.1. Parashikimet demografike

Bazuar në elementet bazë të zhvillimit demografik në komunën e Rahovecit, janë dhënë edhe rezultatet e parashikimit demografik. Këto rezultate japin vlera për rritjen e popullsisë dhe parashikimin demografik për të ardhmen deri në vitin 2020.

Gjatë vlerësimit të popullsisë për fshatrat dhe qytetin e Rahovecit deri në vitin 2020 janë llogaritur dy komponentët themelore që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen demografike siç janë: shtimi natyror dhe migrimi. Në vazhdim do të paraqitet ky parashikim sipas formulës:

$$P_a = P_o \times [(S_n + S_m) \times V/100] + 1$$

Shpjegimet e simboleve:

P_a = parashikimi i popullsisë për vitin 2020

P_o = vlerësimi i popullsisë për vitin 2010

S_n = shkalla vjetore e shtimit natyrorë

S_m = shtimi vjetorë nga migrimi

V = vitet e llogaritura deri në vitin 2020

Parashikimi i numrit të popullsisë për qytetin e Rahovecit për vitin 2020:

$$P_a = P_o \times [(S_n + S_m) \times V/100] + 1$$

$$P_a = 21354 \times [(1.15 + 1.3) \times 10/100] + 1 =$$

$$= 21354 \times 1.24 = 26479$$

Sipas këtyre llogaritjeve del se numri i popullsisë vetëm për qytetin e Rahovecit do të jetë 26479 banorë në vitin 2020.

Parashikimi i numrit të popullsisë për të gjitha fshatrat e komunës së Rahovecit pa qytetin për vitin 2020:

$$P_a = P_o \times [(S_n + S_m) \times V/100] + 1$$

$$P_a = 50168 \times [(1.15 + 1.3) \times 10/100] + 1 =$$

$$= 50168 \times 1.24 = 62208$$

Sipas llogaritjeve del se numri i popullsisë për të gjitha fshatrat e komunës së Rahovecit pa qytetin do të jetë 62208 banorë në vitin 2020.

Në fund del se numri i përgjithshëm i popullsisë në komunën e Rahovecit, duke e përfshirë qytetin dhe të gjitha vendbanimet tjera rurale, do të jetë 88687 banorë në vitin 2020.

III.2.2.2. Zhvillimi i vendbanimeve

Plani Zhvillimor Komunal propozon shfrytëzim racional të tokës, me rritje të dendësisë së banimit, ndërsa kjo do të arrihet me shfrytëzimin racional të zbrazëtirave brenda zonave të ndërtuara. Kjo do të ndikonte në zhvillimin efikas të infrastrukturës, uljen e kostos për investime në infrastrukturë, si dhe qasjen më të lehtë të banorëve në këtë sistem, ndërsa në anën tjetër do të zvogëlohen distancat në shërbime tjera si: shkolla, institucione shëndetësore, administratë, etj. Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet ruajtjes

së tokës bujqësore, aty ku ato vendbanime tangojnë me sipërfaqet produktive, pastaj zhvillimit të infrastrukturës dhe aktiviteteve tjera. Për minimizimin e konfliktit në mes tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të ndërtuara dhe atyre në zhvillim vendbanimet do të zhvillohen brenda kufirit të zonës së ndërtuar, ose në tokat joproductive. zhvillimi kompakt i vendbanimeve mund ta kursej sipërfaqen e kufizuar të tokës nga ndërtimet, ndërsa në këtë kontekst vendbanimet shndërrohen në zona tërheqëse dhe funksionale.

Vendbanimet në komunë në Rahovec do të zhvillohen edhe me tej në bazë të shtimit natyror dhe proceseve tjera demografike. Në bazë të analizave të gjendjes ekzistuese-profil, konkludohet se dendësia e banimit, edhe pse është mesatare, ajo mund të rritet, duke përfshirë edhe disa lagje të qytetit të Rahovecit, ndërsa kjo do të reflektohet në ruajtjen e tokës. PZHK definon zonat e zhvillimit të ardhshëm, brenda së cilave është i lejuar ndërtimi dhe zhvillimi i aktiviteteve brenda këtyre zonave. Parashikimet demografike nuk paraqesin nevojën për zgjerimin e sipërfaqeve të ndërtuara jashtë zonave aktuale nga se vendbanimet disponojnë hapësira të zbrazta brenda zonave aktuale ndërtimore. Shumica e vendbanimeve shtrihen në zonën e ulët, ndërsa pjesa dërmuese e popullsisë së komunës jeton në këtë zonë e cila karakterizohet me tokën më cilësore bujqësore, që njëherit është edhe hapësira më vitale për zhvillimin e ardhshëm të komunës. Nga kjo arsye, vendbanimet do të zhvillohen në konceptin e dendësisë, gjegjësisht në plotësimin e zbrazëtirave brenda zonave të ndërtuara. Për arritjen e këtyre qëllimeve duhet marrë për bazë elementet në vijim: dendësia e popullsisë, parashikimet dhe proceset demografike, sipërfaqet e ndërtuara ekzistuese, Kategoria e tokave.

Kërkesat dhe nevojat për tokë ndërtimore deri në vitin 2020 bazohen në prognozatat demografike dhe zhvillim ekonomik:

- **Qyteti** do të zhvillohet sipas PZHU-së, duke plotësuar zbrazëtirat e sipërfaqeve të pa ndërtuara, ndërsa zhvillimet tjera do të parashihen në sipërfaqet joproductive të tokës. Në këtë plan gjithashtu do të përcaktohet edhe kufiri i ri i zonës urbane dhe destinimi i sipërfaqeve me të gjitha parashikimet sipas kërkesave për zhvillim. Tërë sipërfaqja e zonës kadazstrale të qytetit të Rahovecit është 48.8 km². Në këtë sipërfaqe do të përcaktohen të gjitha parashikimet për zhvillimin e ardhshëm dhe parashikimet për zgjerimin apo përkufizimin e zonave të ndryshme si: zona e ndërtimit, transportit, gjelbërimit, zonave të veçanta etj. Strukturën urbane do ta përbëjnë njësi të caktuara urbane, përmes të cilës do të shihet qartë destinimi i sipërfaqeve.

- **Qendrat sekondare** si dhe vendbanimet përreth do të sigurojnë tokë të mjaftueshme banimi për banorët lokal. Sigurimi mesatar i tokës për banim prej 2 ha për vendbanime pa funksione dhe nga 5 ha për qendra sekondare llogaritet të jetë i mjaftueshëm për zhvillim të mëtejshëm. Shuma e përgjithshme e nevojës për tokë për zhvillimin e vendbanimeve rurale dhe qendrave sekondare do të arrijë në rreth 60 ha. Shumica e tokës së siguruar për ndërtim janë sipërfaqe të lira brenda zonës ndërtimore.

Shuma e përgjithshme e nevojës për tokë ndërtimore për zhvillimin e të gjitha vendbanimeve, duke përfshirë edhe qytetin e Rahovecit, do të arrijë në rreth 120 ha

Për shfrytëzim racional të tokës (me rastin e zgjerimit jashtë kufirit të zonave ndërtimore) rekomandohet ti jepet prioritet zhvillimit në tokë djerrinë.

Zhvillimi i politikës për sigurimin e tokës ndërtimore dhe aktiviteteve tjera lidhur me zhvillimin e vendbanimeve do të realizohet në faza.

III.2.2.3. Administrimi territorial

Në komunë në Rahovecit do të avancohen edhe tri qendra sekondare, krahas qytetit të Rahovecit, të cilat qendra do të jenë pika të rëndësishme që do të kontribuojnë në decentralizimin e funksioneve. Krusha e Madhe, Xërxa dhe Ratkoci, do të jenë qendra të rëndësishme ku ofrohen shërbime themelore për banorët, si dhe do të zhvillohen veprimtaritë kryesore ekonomike. Kjo u mundëson qendrave sekondare të avancojnë veprimtaritë shërbyese dhe në këtë mënyrë të zvogëlojnë distancat mes banorëve dhe shërbimeve.

Nga aspekti i shërbimeve administrative parashihen këto zhvillime:

- ✓ Qendra kryesore administrative dhe politike për tërë Komunën do të jetë vet qyteti i Rahovecit. Në këtë qendër do të funksionoi administrata qendrore komunale, strukturat udhëheqëse dhe politike, shërbimet kryesore komunale etj.
- ✓ Decentralizimi i shërbimeve kryesore u mundëson qendrave sekondare të ngrisin veprimtaritë shërbyese dhe në këtë mënyrë të përmirësojnë qasjen e banorëve në shërbime. Rahoveci si qendër kryesore, Krusha e Madhe, Xërxa e Ratkoci si qendra të rëndësishme të sistemit, do të jenë vendbanime të rëndësishme ku zhvillohen veprimtaritë kryesore ekonomike dhe ofrohen shërbimet kryesore të komunës.

Decentralizimi dhe struktura organizative e shërbimeve propozohet si në vijim:

Rahoveci – Vendbanimet, si: Rahovec, Zatriq, Pastasellë, Senoc, Drenoc, Nushpal, Pataqan i Epërm, Bërnjak, Hoçë e Madhe, Zoqishtë, Opterushë.


Krusha e Madhe – Vendbanimet, si: Krushë e Madhe, Reti e Ulët, Reti, Brestovc, Hoçë e Vogël, Nagavc, Celinë.

Xërxa- Vendbanimet, si: Xërxë, Bellacerkë, Sapniq, Gexhë, Potoçan i Ulët,

Ratkoci-Vendbanimet, si: Ratkoc, Radostë, Dejnë, Bratotin, Vrajakë, Dabidol, Polluzhë, Sarosh, Çifllak, Petkoviç, Kaznik, Kramovik, Mrasor.

Qendrat sekondare do të ushtrojnë funksionet publike administrative dhe ofrojnë hapësirë për kulturë, shërbime postare, shërbime financiare (njësi bankare), asociacione dhe klube shoqërore, të sigurisë publike, etj.

Qendrat lokale si: Çifllaku, Drenoci, Hoça e Vogël, Opterusha, Zatriqi, duhet të kenë qendrat e bashkësisë (komunitetit) që janë në shërbim të vendbanimeve përreth. Këto qendra ofrojnë shërbime për rrethinën e tyre, si: shkollën e plotë fillore, zyrën e ofiçarisë, tregtinë me pakicë, etj. Këto paraqesin mikroqendra funksionale për rrethinën e tyre të ngushtë.



Harta 45. Organizimi administrativ

III.2.3. INFRASTRUKTURA SOCIALE DHE TRASHËGIMIA

III.2.3.1. Arsimi

Rahoveci përfaqësohet me dy zona zhvillimore, atë të kopshteve ku janë të përqëndruara pjesa më e madhe e objekteve shkollore si dhe planifikimi i projekteve në fushën e arsimit dhe zona e kodrave dhe natyrës ku gjenden vetëm dy vendbanime me nga një shkollë fillore.

Hapësira e brendshme shkollore sillet rreth 3 m² për një nxënës dhe mesatarisht rreth 18.7 nxënës/mësimdhënës. Objektet shkollore në aspektin fizik në disa vendbanime nuk janë në gjendje të mirë fizike. Vendbanimet të cilat kërkojnë urgjentisht hapësirë shkollore janë: Drenoc (1.5 m²/nx.), Hoça e Vogël (0.9 m²), Kramovik (1.4 m²), Krusha e Madhe (1.4 m²), Pastasel (1.5 m²), Radostë (0.8 m²), Ratkoc (0.2 m²), Vrajakë (1.8 m²). Në të ardhmen do të ndërtohen ose t'i shtohen anekse të veçanta objekteve shkollore të lartë përmendura, po ashtu ti kushtohet një rëndësi edhe gjendjes fizike të objekteve ku pjesa dërmuese e shkollave nuk janë në gjendje të mirë. Gjithashtu, do të instalohet sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit në ato shkolla ku nuk ekziston.

Komuna e Rahovecit ka katër shkollat të mesme të larta mikse. Prandaj, në këtë periudhë planifikohet të hapen shkolla profesionale me kabinete përkatëse për lëmi të caktuara, të cilat do të hapen sipas nevojës së tregut të punës.

Gjatë kësaj periudhe do të investohet, përveç objekteve shkollore edhe në objektet përcjellëse si: hapësirat e mbyllura dhe të hapura, gjegjësisht sallat e edukatës sportive dhe terrenet sportive, në ndërtimin e depove për lëndë djegëse, instalimin e ngrohjeve qendrore, rrethimin shkollave, gjelbërimin e oborreve shkollore, si dhe investime në eficiencë.

Kuadri i mësimdhënësve në pjesën më të madhe të shkollave është i kënaqshëm, në përjashtim të shkollave Pataqan i Epërm (me 70%) dhe e Zatriq (me 70%). Në këto tri shkolla do të organizohen trajnime dhe kurse të fushave të ndryshme për qëllim të efikasitetit dhe ngritjen së cilësisë së mësimdhënësve drejt zbatimit të teknikave të reja të përcaktuara nga ana e MASHT-it. Mungesa më e madhe e kuadrit të kualifikuar është e mësimdhënësve të gjuhës Angleze, edukatës muzikore dhe e mësimi parashkollor. Po ashtu, duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për kompjuterizimin e shkollave dhe pajisjen e tyre me mjete didaktike, biblioteka të furnizuara me literaturë shkollore, pajisje konkretizuese dhe laboratorike, sidomos në shkencat ekzakte dhe ato të natyrës.

Drejtorja Komunale e Arsimit dhe ajo e Shëndetësisë, ashtu siç e ka filluar, edhe në të ardhmen është mirë që të vazhdohet me kontrollin e gjendjes shëndetësore të nxënësve në të gjitha nivelet, në mënyrë të kohëpaskohshme.

Çerdhe – kopshte

Në komunën e Rahovecit për dhjetë vitet e ardhshme do të ndërtohet edhe një çerdhe tjetër, pasi që ato ekzistuese nuk do ti plotësojnë kushtet për zhvillimin e këtij niveli të edukimit, kur kihet parasysh se grupmoshat e reja 0-4 vjet kanë një përfaqësim të gjerë

të popullsisë. Për këtë çështje do të shikohet mundësia e organizimit të këtij niveli arsimor edhe në vendbanimet tjera rurale, në objektet ekzistuese të shkollave apo edhe të zgjerohet hapësira e objekteve ekzistuese shkollore edhe për këtë çështje. Do të ndërtohen hapësira për lojë për fëmijë në hapësira publike dhe në oborre të shkollave aty ku ka sipërfaqe të mjaftueshme, duke u kujdesur që procesi mësimor të mos pengohet.

III.2.3.2. Institucionet shëndetësore

Në komunën e Rahovecit, mjekësia familjare është shtylla kryesore e shëndetësisë e cila udhëhiqet nga Drejtoria e Shëndetësisë. DSH organizon punën në shërbimet primare shëndetësor, shërbimet sociale dhe shërbimet të inspektimit sanitar dhe gjithashtu, sektori privat si mundësi plotësuese organizative në zhvillimin e sistemin shëndetësor. Institucionet shëndetësore janë të shpërndara dhe mbulojnë me shërbime gjithë territorin e komunës.

Në komunën e Rahovecit veprojnë 12 institucione shëndetësore siç janë: Qendra kryesore e mjekësisë familjare në qytetin e Rahovecit dhe 11 ambullanta ku 5 janë në qytet dhe tjerat në vendbanimet rurale.

Për të ofruar shërbimeve shëndetësore cilësore për këtë popullatë është e nevojshme:

- ↳ Renovimi i objekteve shëndetësore dhe zgjerimi i tyre sipas nevojës
- ↳ Kyqja në sistem të mbikqyrur të ujësjellësit dhe kanalizimit e të gjitha atyre institucioneve shëndetësore ku mungon
- ↳ Në të gjitha qendrat shëndetësore të arrihet raporti 1 mjek dhe 2 infermjer për 2000banor

III.2.3.3. Shërbimet sociale

Banesat Sociale Kolektive – Ekziston një numër i konsiderueshëm të personave të pastrehë të cilët sipas planit Republikan dhe standardeve për riatdhesim do të jetë në shërbim të këtyre grupeve. Ky planifikim është i arsyeshëm dhe duhet të jetë afatshkurtër dhe afatmesëm në mënyrë që i njëjti të realizohet posaçërisht për faktin se do të vijnë familjet nga jashtë të cilët do të riatdhesohen në komunën tonë.

Sipas mundësisë objekti në fjalë ta përqendrohet në vend të përshtatshëm- lokacion sa më

racional dhe infrastrukturë të duhur në mënyrë që inkorporohet me sukses në planin detaj

urbanistik.

Qendra e Shëndetit Mendor - Duke u nisur nga fakti se deri më tani kemi mbi 120 persona të cilët pjesërisht janë duke u trajtuar në Gjakovë por, kjo nuk mjafton për ata, për sigurinë e popullatës dhe të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut. Këtë propozim e arsyeton edhe fakti se një numër i konsiderueshëm i personelit shëndetësor nga komuna e Rahovecit janë në papunë ku pas trajnimeve paraprake do të kyçen në këtë institucion.

Ndërtimi i këtij institucioni është urgjent dhe përcaktimi i lokacionit dhe hapësirës së përafërt 1

ha duke mos e dëmtuar tokën pjellore por të ketë hapësirë të mjaftueshme për aktivitetet që do të

kryhen si terapi e programuar nga ekspertët që do të punojnë në këtë lëmi. Vendi i ndërtimit duhet të jetë në drejtim të fshatit Zatriq ku ka vende piktoreske dhe mjaft të

përshtatshme për këtë lloj institucioni, njëkohësisht në këtë drejtim është e rregulluar infrastruktura rrugore dhe ambientale. Një objekt i tillë është i planifikuar nga plani afatmesëm i Ministrisë së Shëndetësisë së të Republikës së Kosovës i cili është planifikuar për ndërtim në vitin 2012.

Qendra për të moshuar - Qëndrimi ditor i të moshuarve – Kjo qendër, mendojmë se duhet të ndërtohet në Rahovec me ndonjë pozicion piktoresk duke mos e dëmtuar tokën punuese. Shumica e pensionistëve të tanishëm dhe të ardhshëm janë intelektual dhe kanë nevojë për qëndrim ditor ku mund të kenë një vend pushim për të kaluar kohën dhe afrohen njëri me tjetrin duke kaluar një pleqëri të rehatshme dhe të civilizuar. Supozohet se mjetet materiale për këtë objekt mund të sigurohen nga objekti ekzistues i pensionistëve i cili është dhënë me qera dhe është i papërshtatshëm dhe jo funksional për pensionistët. Me një kredi të cilën do ta arsyetonte qeraja e tanishme do të ishin siguruar mjetet për fillimin e menjëhershëm të punimeve në lokacionin të cilin do ta lejonte kuvendi komunal dhe i cili do të përfshinte të gjitha kushtet e parapara për një objekt të tillë (Bibliotekën, Dhomën e qëndrimit, dhoma e mjekimit, dhoma e rekreacionit-fizioterapi).

Shtëpia integruese – Qysh tani, po të ekzistonte një institucion i tillë do të vendoseshin (sipas rregullores përkatëse) 12 persona në nevojë për trajtim. Sepse të gjitha kapacitetet të shtëpive tjera të njëjta nëpër Kosovë janë të plotë dhe nuk ka vend. Mendojmë se edhe për të ardhmen do të ketë nevojë për këtë shtëpi transitore për personat në fjalë të cilët i shohim shpesh nëpër rrugë pa përkujdesje dhe trajtim duke shqetësuar qytetarë dhe rrjedhimisht paraqitet një presion ndaj QPS-së për vendosjen e tyre. Vlen të ceket se në këtë institucion të arsyeshëm do të punësoheshin së paku 10 punëtorë profesional në lëmin e shëndetësisë dhe shërbimeve sociale.

Shtëpia Edukuese - është një institucion i cili do të jetë në përkujdesje regjionale ku vendosen fëmijët pas shqyrtimit të masës nga ana e gjykatës apo organi i kujdestarisë, dërgimi në shtëpinë edukuese të të miturve me çrregullime në sjellje ose sjellje asociale. Këtë propozim e arsyeton fakti se Komuna e Rahovecit është një komunë relativisht e qetë por në nivel regjional do të kishte përkrahje funksionimi i një institucioni të tillë sepse kërkohet një infrastrukturë dhe terren i përshtatshëm për ndërtimin e një kompleksi arkitektonik për qëndrimin e fëmijëve- të miturve të cilëve i shqiptohen masa dërgimi dhe qëndrimi në shtëpinë edukuese ku të përmendurit do të ri-socializohen, ri-edukohen dhe përgatiten për ri-integrim në shoqëri. Për këtë lloj të institucionit nevojitet një hapësirë prej 3ha me një konfiguracion të përshtatshëm sikur që është pjesa e djathtë e rrugës Rahovec-Malishevë, larg qytetit 3-4 km ku edhe ekziston infrastruktura e duhur. Në shumë konsulta në nivel Republikan dhe Regjional të ekspertëve të Shërbimeve Sociale si dhe me ekspertët gjyqësor është ardhur në përfundim se në Regionin e Prizrenit dhe në Republikën e Kosovës është i domosdoshëm një institucion i tillë por për shkak të konfiguracionit dhe mungesës së hapësirës janë dështuar tentimet në qytetet e mëdha sikur Prizreni apo Prishtina ku hapësira është e stërngarkuar me objekte të ndryshme. Me ndërtimin eventual të këtij objekti Rahoveci do të përfitonte punësimin e afërsisht 100 punëtorëve në të ardhmen.

III.2.3.4. Zvogëlimi i papunësisë dhe varfërisë

Hapja e vendeve të reja të punës do ta ketë efektin e vet duke tentuar në zbutjen e papunësisë, e cila do të arrihet përmes ngritjes së gjithmbarshme të zhvillimit ekonomik. Stimulimi i bujqësisë, përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, do të përmirësojnë situatën sociale. Tërheqja e investitorëve për të investuar në këtë territor gjithashtu do të zbus problemet sociale. Organizimi i trajnimeve profesionale, sipas

kërkesave të tregut, do të ndikoj pozitivisht në shkallën e papunësisë dhe varfërisë. Sigurimi i punës sezonale brenda dhe jashtë vendit për mesë binjakëzimit me ndonjë komunë, ndërmarrje, etj. jashtë Kosove, të cilës i duhet fuqi punëtore do të jetë e mirëseardhur.

Në zonën e kopshteve, zbutja e papunësisë dhe varfërisë do të arrihet duke krijuar kushte të favorshme për bizneset e vogla dhe të mesme të cilat duhet inkurajuar maksimalisht në punimin e tokës dhe rritjen e prodhimeve, pastaj në krijimin e kushteve për tregtarët që kryejnë veprimtaritë e tyre dhe stimulimin e bujqësisë në përdhithësi. Në zonën kodrat dhe natyra, është shumë me rëndësi që të ofrohet një infrastrukturë më e mirë dhe shërbime adekuate me qëllim që këto pjesë të mos zbrazen apo shpopullohen. Gjithashtu nevojitet të stimulohen zhvillimi i disa sektorëve ekonomik bazuar në resurset natyrore që ka kjo zonë si: Zhvillimi i blegtorisë, posaçërisht asaj të imët, Pemëtarisë, veçanërisht asaj autoktone, Turizmi (turizmi rural dhe rekreacioni) dhe Sigurimi i punës sezonale. Me zhvillimin e këtyre veprimtarive do të krijohen kushte më të mira për jetë, duke e zvogëluar shkallën e papunësisë, varfërisë dhe duke i bërë këto vendbanime përditë e më shumë joshëse për qytetarët.

III.2.4. MOBILITETI DHE RRJETI I TRAFIKUT**III.2.4.1. Rrjeti rrugor**

Mbi 94.6% e rrugëve të të gjitha kategorive të cilat gjenden në komunën e Rahovecit gjenden në Zonën e Kopshteve të cilat i mundësojnë komunës lidhje të mira me komunat për rreth, si dhe i mundëson mbi 98.7% të popullsisë së komunës të kanë qasje në këto rrugë.

Tabela 00. Rrjeti i rrugëve sipas kategorisë

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia total në	Zona e kopshtëve	Kodrina dhe Natyra
		Km		
1	Rrugë magjistrale	6.2	6.2	0.0
2	Rrugë regjionale	64.3	60.5	3.8
3	Rrugë Urbane	30.6	30.6	0.0
4	Rrugë Lokale	114	107	7.0
5	Rrugë e pa kategorizuar	82.5	77.2	5.3
Total		297.6	281.5	16.1
%		100	94.6	5.4

Rrugët Magjistrale - e gjith rrugët magjistrale shtrihen në Zonën e Kopshteve dhe paraqesin arterie të rëndësishme të zhvillimit të komunës.

- 1) **Segmenti i rrugës magjistrale Gjakovë - Klinë- Prishtinë (M9.1)**, në këtë segment nevojitet të rritet kualiteti i asfaltit duke filluar nga kufiri me komunën e Gjakovës deri te kufiri me komunën e Klinës).

Në këtë segment duhet të intervenohet me:

- o Rregullimin dhe mirëmbajtja e segmentit të rrugës me asfalt kualitativ në rrugën magjistrale M9.1 (Gjakovë -Prishtinë)
- o Vendosja dhe rregullimi i anësorëve të rrugës M9.1 përgjatë shtrirjes së vendbanimeve Kramovik dhe Mrasor
- o Plotësimi dhe mirembajtja e shenjave të sinjalizimit përgjatë segmentit të rrugës magjistrale M9.1
- o Kufizimi i të gjitha aktiviteteve socio ekonomike përgjatë segmentit të rrugës magjistrale M9.1 me distancë minimale prej 60 m në të dy anët e rrugës.
- o Mirëmbajtja e kanaleve kulluese të segmenteve të rrugëve magjistrale, M9.1
- o Vendosja e mbishkrimeve për hyrje në Komunën e Rahovecit në disa lokacione (në të dy anët e rrugës), përkatësisht në kufirin me komunën e Klinë-Rahovec, Rahovec - Gjakovë).

f) Rrugë regjionale - nga gjithsejtë 64.3 km të rrugëve regjionale sa ka në komunën e Rahovecit, të gjitha shtrihen në zonën kodrina dhe natyra. Në kuadër të këtyre rrugëve hynë rrugët regjionale:

- a) Rruga **R-107** , Prizren-Xërxë- Gjakovë – me një gjatësi prej 11 km
- b) Rruga **R-110**, Malishevë – Rahovec-Xërxë me një gjatësi prej 16.3 km
- c) Rruga **R111** , Xërxë –Ratkoc-Kramovik me gjatësi prej 17 km
- d) Rruga **R117** , Rahovec-Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë me gjatësi prej 7.6 km
- e) Rruga **R204**, Rahovec – Krushë e Madhe me gjatësi prej 12.4 km

Në segmentet e rrugëve regjionale duhet të plotësohen këto aktivitete:

- a. Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrugëve regjionale dhe sinjalizimi i tyre .
- b. Ri asfaltimi i rruges regjionale R 111, Ratkoc – Kramovik si dhe sinjalizimi
- c. Ndërtimi i rrugës transite e cila do të ketë gjatësi 4.5 km dhe do të lidhë rrugët regjionale (R110 dhe R117).
- d. Rregullimi i trotuareve në vendbanimin e Ratkoc me një gjatësi prej 3.7 km, Krushë e Madhe 2.1 km, Nagavc me 1.3 km, Hoqe e vogel 2.1 km, Brestoc 1.5 km, Gexhë 0.8 km,Dejnë 1.4 km, Radostë (1.2 km), Dabidol (1.4 km), Qifllak rreth 1.1 km, Kramovik 1.9 .
- e. Rregullimi i anësorëve mbrojtëse përgjatë segmentit të rrugëve regjionale në vendbanimin e Gexhë, Radostë, Ratkoc, Dejnë, Dabidol, Qifllak, Kramovik, Xërxë, Bellacerkë, Krushë e Madhe, Hoqë e Vogël, Nagavc, Brestovc.
- f. Rregullimi i sinjalizimit për vendkalim këmbësor (zebra), në lokacione dhe vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat sekondare (Krushe e Madhe, Ratkoc dhe Xërxe)
- g. Kufizimi i aktiviteteve socio-ekonomike përgjatë segmentit të rrugëve regjionale në një gjatësi prej 60 m.

Rrugë lokale – nga gjithsejtë 114 km të rrugëve të kategorisë lokale 107 km të rrugëve lokale shtrihen në Zonën e Kopshteve dhe 7 km shtrihen në zonën kodrina dhe natyra , të cilat mundësojnë lidhje direkte të vendbanimeve me rrugët magjistrale dhe regjionale. Nga të gjitha rrugët lokale të cilat shtrihen në territorin e komunës vetëm 49.3 km ose (43.2%) janë të asfaltuara. Është e rëndësishme të përmendet se rrugët lokale të cilat i lidhin vendbanimet që shtrihen në zonën aktive zhvillimore të komunës me qendrën komunale janë të asfaltuara, mirëpo statusi i tyre është i ndryshëm, duke u nisë nga fakti se një pjesë e madhe e tyre nuk janë në gjendje të mirë, përkatësisht janë shumë të dëmtuara.

Në bazë të kësaj gjendje propozojm që në të ardhmen në dy zonat e komunës së Rahovecit të bëhet asfaltimi i të gjitha rrugëve lokale.

Në vazhdim do të paraqesim tabelën e rrugëve lokale të cilat duhet të përmirësohen për nga kualiteti i asfalti, si dhe rrugëve të cilat duhet të asfaltohen.

Tabela 66 Mirëmbajtja e rrugëve lokale

Vendbanimi	Gjendja e rrugëve	Statusi në të ardhmen	km
------------	-------------------	-----------------------	----

Opterushë	Shumë e dëmtuar	mirëmbajtje selektive	0.7
Zoçishtë	Shumë e dëmtuar	mirëmbajtje selektive	0.8
Retijë	Shumë e dëmtuar	mirëmbajtje selektive	2.1
Zatriq	Pak e dëmtuar	mirëmbajtje selektive	3.4

Rruge lokale te cilat duhet të asfaltohen ne brendi te vendbanimeve në zonën e kopshtëve.


Tabela 67. Asfaltimi i rrugëve në të ardhmen

Vendbanimi	Statusi ne te ardhmen	Gjatësia_km
Sarosh – Kaznik	Asfalt i ri	3.8
Ratkoc-Baboc-Pastasel	Asfalt i ri	3.3
Celinë – Rahovec	Asfalt i ri	4.8
Tranziti afer qytetit të Rahovecit	Asfalt i ri	2.8
Bellacerkë – Celinë	Asfalt i ri	2.6
Ratkoc-Sapniq	Asfalt i ri	2.7
Brestovc – Reti	Asfalt i ri	2.2
Total		22.2

Vërejtje: Rrugët e pa asfaltuara të cilat shumica e tyre shtrihen në pjesë e strukturës se kopshteve duhet të kenë mirëmbajtje permanente me mbulesë të rërës dhe zhavorrit.

Vendbanimet të cilat nuk kanë qasje ne asfalt (Këto rrugë duhet të mirëmbahen)		Gjatësia km
1	Kaznik	3.8
2	Mrasor (nga rruga kryesore deri te qendra e fshatit)	0.4
3	Reti e Ulët	2.1
4	Retijë	4.2
5	Nushpal	0.7
	Total:	11.2
Pjesëmarrja e popullsisë në rrugët e pa asfaltuara në nivel komune		4.98 % e popullsisë

HARTA 00 KONCEPTI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS
RRUGORE



8.2. Rrjeti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regional i cili i lidhe disa komuna (Prizrenin,Rahovecin,Klinen etj). Kjo linjë hekurudhore kalon në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit është një binarësh me gjatësi prej 10.4 km. Sigurisht se shtrirja e rrjetit hekurudhor e nivelit regional ka një rëndësi shumë të madhe për komunën, si dhe ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin socio-ekonomik të saj. Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se rrjeti hekurudhorë i cili është mjaft i hershem në këtë komunë është edhe si indikator për zhvillimin e vendbanimeve më të rëndësishme të komunës. Rrjeti hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Rahovecit por edhe tjerat sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe udhëtarëve.Kjo linjë hekurudhore nuk funksionon dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes sajë.

Në rrjetin hekurudhorë i cili kalon në territorin e komunës së Rahovecit është e rëndësishme që të përmirësohet sinjalizimi i rrugëve ku mbikalohet hekurudha me sinjalizim dhe masa të sigurisë adekuate në vendbanimet: Krushë e Madhe,Celinë,Xërxë,Gexhë,Radostë,Ratkoc,Dejnë,Qifllak dhe Kramovik.

4.4.4. Rrjeti energjetik dhe telekomunikimit

Rrjeti i Energjetikës në komunën e Rahovecit është i mbuluar mirë shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, mirëpo gjendja e këtij rrjeti në drejtime te caktuara nuk është e mire dhe kërkon intervenime. Nga gjithsejtë 36 km, sa ka gjatësi rrjeti energjetik i tensionit të lartë 34.3 km e rrjetës energjetike i gjendet në zonën kopshteve. Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike ne të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kv në 20 kv.

Tabela 00. Drejtimet e rrjetit të energjisë elektrike në komunën e Rahovecit

Drejtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti në kv	Traftot	Individuale	Kolektive	Nr. konsumatoreve
Drejtimi Qyteti I	10KV	4		4	1197
Drejtimi Qyteti II	10kv	5		5	1422
Drejtimi Nëntori II	10kv	1	1		1
Drejtimi Nëntori III	10kv	2	2		2
Drejtimi i Komunës	10kv	4		4	941
Drejtimi i Hidrosistemi	10 kv	20	20		34
Drejtimi Shkolla e Mesme	10kv	2		2	623
Drejtimi i Shkozës		14	11	3	200
Drejtimi i Opterushës		26	4	22	1539
Drejtimi i Potoçanit		24		24	1077
Drejtimi i Stone Castle		1	1		6
Drejtimi i Podrumit		4	3	1	42
Drejtimi i Bellacerkës-Fortesës		8		8	375

Drejtimi i Ratkocit		19	3	16	1021
Drejtimi i Dejnit		34	6	28	985
Drejtimi i 18 Nëntorit		2	2		2
Drejtimi i Silosit 1		1	1		1
Drejtimi i Silosit 2		1	1		1
Drejtimi i Xërxës		18	13	5	450
Drejtimi i Matresit		3	2	1	23
TOTALI		193	70	123	9942

Përmirësimi i rrjetës së energjisë elektrike në përgjithësi në nivel komune duhet të bëhet edhe në segmentin e përmirësimit të infrastrukturës fizike me shtylla elektrike.

Tabela 00. Rrjeti i energjisë elektrike, sipas kapaciteteve të propozuara

Drejtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti i propozuar në kv	Numri i traktstacioneve të propozuar	Statusi fizik
Drejtimi Qyteti I	20 KV	2	Përmirësim solid
Drejtimi Qyteti II	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi i Komunës	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi Shkolla e Mesme	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi i Optrushës	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Potoçanit	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Bellacerkës-Fortesës	20 KV		Përmirësim solid
Drejtimi i Shkozës	20 KV		Përmirësim solid
Drejtimi i Ratkocit	20 KV	2	Përmirësim selektiv
Drejtimi i Dejnit	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Xërxës	20 KV		Përmirësim selektiv
TOTALI		7	

Ky segment i infrastrukturës energjetike të komunës propozohet që në të gjitha drejtimet e shpërndarjes së energjisë elektrike të kapacitetit 20KV, të bëhen në shtylla të betonit me gjatësi standarde (sipas standardeve të BE-së). Është e rëndësishme të theksohet se rrjeti fizik i energjetikës në nivel të vendbanimeve në mënyrë selektive duhet të përmirësohet me shtylla plotësuese nga druri ose betoni.

Telefonia fikse

Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Rahovecit është i lidhur nëpërmjet fibrës optike, i cili i përket linjës së Prizrenit. Ky rrjet menaxhohet nga njësi e PTK-së, në Rahovec, e cila posedon centralin e lidhur me fibrën optike dhe ka kapacitet total 5550 qifte. Momentalisht shfrytëzohen 1460 qifte. Kapaciteti momental është i mjaftueshëm edhe për periudhën e ardhme 10 vjeçare, mirëpo është e

rëndësishme që të bëhet shtrirja e rrjetit në aspektin fizik në vendbanimet e tjera të cilat janë me të mëdha për nga numri i popullsisë. Shtrirja e rrjetës së telefonisë fikse ekzistuese mundëson qasje të mbi 47.5% të popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse.

Foltore publike - Në funksion të ofrimit të shërbimeve të telefonisë fikse do të jetë edhe rritja e numrit të foltoreve publike në zonën urbane dhe në vendbanimet e propozuara si vendbanime sekondare dhe qendrat e bashkësive lokale. Gjithashtu propozohet që të vendosen foltore publike në të gjitha vendbanimet ku ka rrjet të telefonisë fikse, Numri i foltoreve publike në dy qendra sekondare (Ratkoc dhe Krushë e Madhe) duhet të jetë minimum dy për qendër sekondare.

Telefonia mobile - në territorin e Rahovecit është e mbuluar mjaftë mirë, pothuajse të gjitha vendbanimet e Rahovecit, kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil kanë të shpërndara antena individuale në lokacione të ndryshme të komunës, mirëpo duhet të bëhet koncentrimi i antenave në një ose dy lokacione të caktuara në bashkëpunim me operatorët e Telefonisë Mobile.

Shërbimet Postare - duhet të vazhdohet shpërndarja e shërbimeve postare në sistemin aktual të shpërndarjes në vendbanimet e dendura në komunën e Rahovecit.

Shërbimet e internetit - bashkëpunimi i ngushtë me operatorët e telefonisë mobile për stimulimin e qytetareve të Rahovecit në shfrytëzimin e mundësive për përdorim të internetit në nivel të vendbanimeve që shtrihen në zonën e kopshteve, duke ofruar paketa stimuluese, si dhe duhet të ndërmerret një kampanjë për informimin e qytetarëve për mundësitë e shfrytëzimit të shërbimeve të tyre.

Radiotelevizioni - Krijimi i mundësive për qasje në radiotelevizionet nacionale dhe lokale për të gjitha vendbanimet e komunës nëse paraqitet ndonjë problem e sidomos për vendbanimet të cilat janë në zonat e thella malore.

Ndriçimi Publik - është evident vetëm në zonën urbane si dhe në vendbanimet Krushe e Madhe dhe Dejnë dhe ka gjatësi prej 16.59 km²⁶ (Rahovec 12.89 km, Krushe e Madhe 1.2 km, Dejnë 2.5 km). Rrjeti i sistemit të ndriçimit është i përbërë prej shtyllave të drurit dhe disa prej tyre janë shtylla të betonit me lartësi deri në 8.5 m, Distanca në mes të shtyllave është 35 metra.

Është e nevojshme që rrjeti i ndriçimit publik të bëhet në vendbanimet e mëdha dhe të dendura me numër të popullsisë si dhe në qendrat Sekondare (Ratkoc, Xërxe, Bellacerkë, Radostë, Celinë, Drenoc dhe në Krushë të Madhe në pjesët e pa mbuluara).

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm

Në komunën e Rahovecit nuk ka rrjetë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, përafërsisht 83% e popullatës kanë qasje në sistemin e ujësjellësit kolektiv (ujësjellës qendror dhe lokal). Sistemi i ujësjellësit qendrorë të Rahovecit i menaxhuar nga sistemi i "Radoniqit" e merr ujin nga Liqeni i Radoniqit, dhe furnizon 83% të popullatës të përgjithshme në komunë. Një pjesë e

²⁶ Të dhënat janë nga Kuvendi komunal i Rahovecit - Zyra për shërbime publike

konsiderueshme e popullatës të komunës rreth 17%, kanë sisteme lokale, të cilat nuk menaxhohen nga “Radoniqi”. Këto sisteme marrin ujin nga burime natyrore dhe shpimet nëntokësore. Të gjitha këto resurse ndodhen në pjesën e identifikuar si ZONE KODRINA DHE NATYRA. Nga këto sisteme, në bazë të sasive të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banor, vlerësohet të jetë përafërsisht 200-250 litra në ditë. Përkundër këtij kapaciteti, humbjet e ujit në sistemin distributiv janë në shkallë mjaftë të lartë-rreth 57%. Faktorët kryesor që ndikojnë në këtë gjendje vlerësohet të jenë: rrjeti i vjetruar i ujësjellësit, kycje ilegale, mosmatja e ujit etj. Sa i përket cilësisë së ujit si dhe analizat behen nga Hidrosistemi i Radoniqit.

Gjithashtu edhe cilësia e ujit nga sistemet lokale është jo e mire, E tëra kjo është për arsye të mosfunksionimit të sistemit të klorizimit. dhe menaxhimit jo efikas të këtyre ujësjellësve.

Për përmirësimin e gjendjes në tërë zonën është e domosdoshme të investohet në;

- Rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit qendror në zonën urbane me qëllim të zvogëlimit të humbjeve
- Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit qendror në vendbanimin Qifllak, Polluzhe, Kramovik etj,
- Ndërtim i rezervuarit të ri për plotësimin e kërkesave të zonave të cilat shtrihen mbi 550 m lartësi mbidetare;
- Instalimin e sistemit të dezinfektimit të vazhdueshëm me klor gaz,
- Rritja e prodhimit të ujit
- Ndërtimi i ujësjellësve lokal në vendbanimet ku janë të evidentuar burimet natyrore: Drenoc, Senoc, Pastasel, Kaznik, Petkovic etj.
- Menaxhimi i ujësjellësve lokal nga Hidrosistemi i Radoniqit”

Rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura.- Në komunën e Rahovecit, kanalizimi i ujërave të ndotura është shumë pak i zhvilluar, përkatësisht ky sistem është i shtrirë në zonën urbane dhe në disa vendbanime rurale . Pjesa më e madhe e ujërave të zeza derdhen pa asnjë trajtim paraprak në shtratin e lumit Drin i Bardhë dhe në degët e tijë. Derisa pjesa tjetër e ujërave të zeza rrjedhin në sipërfaqe të hapura që rrezikojnë përhapjen e sëmundjeve ngjitëse. Vetëm 74.46% e popullsisë së komunës kanë qasje në rrjetën e kanalizimit kolektiv, dhe 25.54% e popullatës së komunës ujërat e zeza i derdhin në mënyrë të egër në lokacione të ndryshme në vendbanimet ku jetojnë, përkatësisht në shtratin e përroskave dhe lumenjve.

Sistemi i kanalizimit të ujërave të ndotura, gjendja e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të ndotura në Komunë, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor, andaj ndërtimi i impiantit për përpunimin e ujërave të ndotura do t’i eliminonte të gjitha rreziqet dhe brengat.

Si zgjidhje afat shkurte, sidomos në zonën e kopshtëve , propozohet ndërtim i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe gropave septike në zonat e qendrave sekondare në vendbanimet Krushe e Madhe dhe Ratkoc. Rrjeti i kanalizimit në këto territore do të përmbledhë ujërat e zeza në sipërfaqen më të madhe të vendbanimeve të zonës së kopshteve. Gjithashtu propozohet zgjerim i rrjetit në zonën urbane dhe në zonat sekondare si dhe ndërtimi i gropave septike adekuate. Në këtë drejtim duhet ndërtohet rrjetë i veçantë i ujërave të zonës industriale dhe të bëhet trajtim adekuat i tyre.

Për vendbanimet e ZONËS SË KOPSHTJEVE propozohet që të këtë sisteme me gropa septike individuale dhe kolektive, varësisht nga shpërndarja hapësinore e vendbanimeve dhe karakteristikat e terrenit.

Rrjeti i kanalizimit të ujërave atmosferik.- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit me sisteme të ndara , nga aspekti teknik është lehtë i realizueshëm dhe nuk kërkon investime të mëdha andaj edhe nga aspekti ekonomik është i qëndrueshëm.

Shtrirja e lumenjve në komunën e Rahovecit është një përparësi e madhe për organizimin e kanalizimit të ujërave atmosferik meqenëse këto ujëra nuk kërkojnë trajtim paraprak dhe mund të derdhen kudo në rrjedhjet lumore.

Menaxhimi i mbeturinave.- Menaxhimi i mbeturinave - Në komunën e Rahovecit shërbimin e menaxhimit të mbeturinave e kryen Kompania për mbeturina „Ambienti”, njësia operative në Rahovec, e cila kompani i kryen shërbimet në zonën urbane . Në bazë të analizave të bëra ky shërbim është ende në shkallë të ultë, vetëm 30% të popullatës në komunë kanë qasjes në këtë shërbim, andaj për të përmirësuar këtë gjendje është mase e nevojshme që ky shërbim të shtrihet së paku në lokalitetet e bashkësive lokale: Ratkoc,Xërxë,Krushe e Madhe, Drenoc,Qifllak etj. Kjo do të realizohet me vendosjen e kontejnerëve, grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave.

III.2.7. MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

Mjedisi në komunën e Rahovecit dallohet me llojllojshmëri andaj edhe shfrytëzimi i tij duhet të bëhet në mënyrë të qëndrueshme.

Në bazë të hipsometrisë së terrenit si dhe zhvillimeve aktuale, komuna e Rahovecit në aspektin fiziko natyror dhe socio-ekonomik ndahet në dy tërësi natyrore që janë të lidhura mes veti si dhe krijojnë atraktivitet ekonomik, social dhe mjedisor.

- ❖ **Zona Jug perëndimore - kopshtet dhe**
- ❖ **Zona Veri lindore -Kodrinat dhe Natyra**

Zona Jug perëndimore -kopshtet

Karakterizohet si zonë me vlera të mëdha ekonomike, dendësi të popullsisë dhe veçori mjedisore.

Zhvillimet në këtë zonë pas viteve 2000 kanë qenë të pa kontrolluara dhe në mjedis kanë lënë pasojë të shumta.

Probleme më të theksuara mjedisore Janë: Ndërrimi i destinimit të sipërfaqeve bujqësore të kategorisë I-IV, degradimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë, Mbetjet ilegale në mjedis, ndotja e ujërave të lumenjve nga ujërat e zeza, hedhja e mbeturinave dhe operatorëve ilegal të seperacioneve të zhavorrit etj.

Problem mjaft i theksuar është zënia e tokës bujqësore të kategorisë II-IV nga ndërtimet dhe zgjerimi i vendbanimeve të tipit të shpërndarë, si dhe bizneseve, sidomos përgjatë akseve rrugore.

Parandalimi i ndërtimeve në tokat bujqësore (të kategorisë II-IV);

Në bazë të analizave në terren dhe në bazë të të dhënave nga GIS- si dhe të dhënave nga Atlasi i Hidroekonomis së Kosovës është bërë zoonimi i tokave bujqësore të kategorisë I-IV

Zoonimi i vendbanimeve dhe kontrolli i zhvillimeve tjera në tokat bujqësore janë veprime të domosdoshme për ta ruajtur tokën cilësore.

Shtrirja e vendbanimeve dhe bizneseve në strukturën aktive zhvillimore është në konflikt me tokën bujqësore, sidomos me klasat II-IV. Për minimizimin e konfliktit në mes tokave bujqësore dhe zhvillimeve aktive duhet të bëhet zoonimi i sipërfaqeve të ndërtuara dhe parandalimi i shtrirjes disperse të vendbanimeve, si dhe përcaktimi i zonave të biznesit.

Prezenca e vendbanimeve të tipit të shpërndarë është karakteristik për këtë zonë .


Me PZHK jepen orientimet e zhvillimit të vendbanimeve si dhe zoonimi i sipërfaqeve bujqësorë që mbrohen edhe me ligj


Sipërfaqja e ndërtuar e vendbanimeve dhe ajo e lejuar për ndërtim





Nr.	Vendbanimet	Sip_kadastrale_ha	Sip_e_ndërtuar_ha	Zona e lejuar per ndërtim ne Ha
1	Bellacerkë	1094	54.9	31
2	Bërnjak	450.1	11.8	0
3	Bratotin	310.6	9.4	8.1
4	Brestovc	579.7	32.5	16.7
5	Celinë	571.6	43.9	14.5
6	çifllak	475.6	27.7	13.8
7	Dabidol	345	13.8	17.4
8	Dejnë	642	29.4	10.1
9	Drenoc	818	41.8	10.7
10	Gexhë	322.4	21.1	13.2
11	Hoçë e Madhe	1350	27.9	7.4
12	Hoçë e Vogël	703.7	30.8	14.5
13	Kaznik	832.9	4.7	0
14	Kramovik	1029	29.8	29.2
15	Krushë e Madhe	999	95	66.6


16	Mrasor	316.4	5.7	7.1
17	Nagavc	308.3	18.1	20.9
18	Nushpal	64.41	4.8	3.1
19	Opterushë	899.9	45.7	17
20	Pastaselë	538.9	23.4	17.5
21	Pataçan i Epërm	233	10	3.7
22	Pataçan i Ulët	553.3	25.8	5.3
23	Petkoviç	1001	12.8	10.7
24	Polluzhë	565.1	18.7	14
25	Radostë	1031	62.5	47.1
26	Rahovec	4887	254	76.8
27	Ratkoc	1181	86.3	38
28	Reti e Ulët	983	11.7	10.3
29	Retijë		22.1	23.8
30	Sapniç	493.9	17.9	33.7
31	Sarosh	se bashku me Qifllakun	0	0
32	Senoc	435.1	20.2	12.7
33	Vrajakë	493.4	14.8	8
34	Xërxë	1007	116.1	19
35	Zatriq	1513	12.1	0
36	Zoçishtë	520.6	23.2	26.8





Sipas të dhënave del se Sipërfaqja kadastrale e komunës së Rahovecit është 899 ha, ndërsa sipërfaqja e ndërtuar është 45.7 ha. sipërfaqja e lirë që parashihet për zgjerim është 17 ha. Në vazhdim janë paraqitë të gjitha vendbanimet përmes hartave duke përfshi sipërfaqen e ndërtuar si dhe vijën e lejuar për ndërtim.


























Zgjerimi i vendbanimeve në kufijtë e zoonimit të propozuar minimizon konfliktet në mes tokës bujqësore dhe vijës ndërtimore. Me këtë propozim janë plotësuar zbrazëtirat e sipërfaqeve tokësore brenda vendbanimit.

Mbrojtja e tokave në zonë në aspektin fiziko-natyror kërkon hulumtim të detajuar të terrenit: pjerrtësisë, mbulesës pedologjike, bonitetit, lartësisë mbidetare, gjeologjisë së terrenit etj. Shikuar nga aspekti i pjerrtësisë së terrenit në këtë zonë duhen të merren masat biologjike për ndërprerjen erozionit ose shpëlarjes së tokës. Në tokat për lavërtari, ku pjerrtësia e terrenit është më e madhe se 15%, duhet të përshtaten kulturat bujqësore adekuate (të përhershme) ose pyllëzim të asaj zone.

Vendbanimet kanë mundësi të zgjerimit të zonës banuese në tokat që kanë pjerrtësi terreni më të madhe se 12%.

Rekomandim : Të hartohet Plani rural i vendbanimeve

Pyjet, kullosat dhe livadhet- Kjo zonë edhe pse konsiderohet si aktive zhvillimore me toka bujqësore është e pasur edhe me pyje. Sipërfaqet pyjore konsiderohen si zona me diversitet të

llojlojshëm. Peizazhet natyrore të kësaj zone janë atraktive dhe mund të shfrytëzohen për rekreacion. Këto ekosisteme janë të rëndësishme dhe të nevojshme për ajrin e pastër, kanë jo vetëm rëndësi ekologjike, por edhe ekonomike, sociale dhe kulturore.

Kullosat janë me sipërfaqe të vogël në zonën e ulët dhe kanë efekte lokale sa i përket veprimtarisë blegtorale.

Livadhet përfshinë rreth 150 ha dhe konsiderohet si potencial ekonomik për aktivitetin blegtoral

Zona Veri lindore-Kodrinat dhe Natyra

Shtrihet në pjesën veri-lindore të komunës, nga 600 metra deri në mbi 800 metra të lartësisë mbidetare. Tërë kjo hapësirë formon zonën e dytë që karakterizohet me reliev kodrinor-malor, me vlera të rëndësishme natyrore dhe për këtë arsye është quajtur edhe zona e kodrinave dhe natyrës. Kjo zonë përfshinë sipërfaqen prej 5720 ha apo 26.2 % të territorit të komunës. Për shkak të veçorive fiziko-gjeografike, kjo zonë është e pasur me vlera natyrore, por është më pak e banuar në krahasim me zonën aktive. Në tërë këtë hapësirë ekzistojnë vetëm 3 vendbanime (Drenoc, Koznik, Zatriq) dhe jetojnë 3775 banorë ose rreth 4 % e popullsisë së komunës.

Sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve dhe kullosave shtrihen kryesisht në lartësi më të mëdha mbidetare (mbi 600m), ku shtrihet zona Veri lindore Kodrinat dhe natyra e pasur me pyje dhe kullosa me rreth 5720 ha me 3 vendbanime e rreth 3800 banor.

Në këtë zonë kryesisht shtrihen pyjet dhe kullosat si dhe fond i tokave bujqësore të kategorive V-VI-VII-VIII ndërsa ato nuk janë produktive për bujqësi.

Kategoria	IV-V	VI	VII-VIII
Sip.në ha	1485	2570	1700

Masat për parandalimin e shfrytëzimit ilegal të pyjeve dhe inerteve

MBPZHR- Agjencioni i Pyjeve administron me pyjet e Kosovës, andaj në bashkëpunim me komunën duhet të gjej forma dhe metoda të reja që të sigurohet menaxhim sa më i mirë dhe efikas i pyjeve kombëtare dhe aktiviteteve të gjuetisë.

Në bashkëpunim me MBPZHR gjegjësisht Agjencionin pyjor duhen të ndërmerren të gjitha masat për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve duke ju përmbajtur të gjitha rregullave. Para se të fillojë planifikimi për ndryshime në sektorin pyjor, duhet të bisedohet me të gjitha palët e interesit dhe të bëhet vlerësimi paraprak i të gjitha resurseve dhe rëndësinë që ato paraqesin.

Më e rëndësishmja është të bëhet analiza ekonomike e të gjitha ndryshimeve në strukturën pyjore. Kjo është mënyrë e veçantë e planifikimit ku do të dihen mundësitë financiare dhe burimet financiare për kryerjen e këtyre ndryshimeve. Duhet të parashikohet cili do të jetë qëllimi

ekonomik i çdo aktiviteti si dhe arsyeshmëria e planeve dhe veprimeve të tilla duke marrë për bazë funksionet specifike të pyjeve. Disa nga këto funksione janë mbrojtja e biodiversitetit, ruajtja e ujit, kundër erozionit, por edhe funksione sociale. Çfarëdo që të bëhet në pyje ato duhet të mbrohen edhe për shkak të traditave kulturore dhe historike. Me mënyrën e re për planifikim do të mund të përdoren më gjerë edhe produktet e tjera pyjore, si kërpudha, bimë kuruese, fruta pyjore, të cilat do të sjellin gjithashtu një pjesë të të ardhurave.

Mbrojtja pyjeve nga prerjet e pa kontrolluara, si dhe shfrytëzimi dhe ripyllëzimi i hapësirave pyjore është detyrë e institucioneve përgjegjëse. Këto zona kanë atraktivitet peisazhor dhe turistik .

Aktivitetet turistike, siç janë; pushimi, vikendi dhe format tjera mund të funksionalizohen në këtë zonë ku si atraktivitete dallohen malet e Zatriqit, Ujëvarat e Mirushës Kanioni i Urës së Fshejt si dhe potenciale tjera, që janë mjaft atraktive me llojllojshmëri të botës bimore dhe shtazore, relief të përthyer si dhe pasuri të burimeve ujore.

Dallohen peizazhe mjaft atraktive që mund të shfrytëzohen për rekreacion dhe zhvillim të aktiviteteve të ndryshme turistike dhe shëndetësore si: shëtitje, kampingje, gjueti, sport etj. Bimët mjekuese kanë përhapje në tërë zonën dhe shfrytëzimi racional i tyre mundëson zhvillimin e kësaj zone. Kjo zonë, përveç prerjeve ilegale të pyjeve për nevoja të ngrohjes, është e ruajtur si tërësi me veçori natyrore .

Ripyllëzimi i kontrolluar zëvendëson drunjtë e prerë duke ruajtur ekosistemin. Dëmtimet në një shkallë të gjerë ndaj ekosistemeve pyjore ndodhin si rezultat i prerjeve ilegale. Për ripyllëzim përdoren një sërë metodash të cilat synojnë jo vetëm të zëvendësojnë ato masa drusore të prera por edhe të ruajnë biodiversitetin. Në të gjitha programet e ripyllëzimit kujdes i veçantë i kushtohet konservimit pyjor.

Njeriu ndikon me veprimtarinë e tij në ekosistem. Efektet pozitive janë parandalimi i erozionit, si dhe rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese që kanë efekte mjedisore dhe ekonomike.

Erozioni si dukuri natyrore është prezentë në këtë zonë. Erozion shumë i fortë është paraqitur në shpatet e maleve të zonës gjegjësisht në mes fshatrave Zatriq-Drenoc, Zatriq- Senoc, Zatriq - Pastasell, Zatriq-Kaznik dhe në pjesën më veriore të zonës katasrale të Rahovecit.

Masat anti-erozive janë paraparë: në meliorimin e pyjeve të kësaj zone.

Mbrojtja e ujërave nga ndotja

Komuna e Rahovecit ka dy lloje të burimeve ujore:

- lumenjtë
- burimet e ujërave nëntokësore

Në komunën e Rahovecit rrjeti hidrografik është relativisht i mirë. Rrjeti hidrografisë së komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, puset, burime rrjedhëse të qëndrueshme dhe proçkat. Më së shumti ka burime në luginën e Rimnikut, lumit të Hoçës, Apterushës etj. Posaqërisht këto burime janë karstike të cilat paraqiten në fund të shtratit të lumit. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatet e luginave dhe shtratit të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Kërkime hidrografive tregojnë se më së shumti kanë burimet karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtilla gjenden në jug-perëndim, veriut dhe veri-perëndim, në rrëzë të malit Shkozës, Zatriqit dhe Kaznikut. Për hire të kësaj janë formuar edhe vendbanimet rreth këtyre burimeve si që janë : Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaçishti, Apterush, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastaselli, Kramaviki etj. Të gjitha këto burime janë larg ndotjeve urbane dhe të faktorit antropogjen dhe duhet mbrojtur si dukuri hidrologjike për nevojat e popullsisë dhe botes shtazore që i përdorin. Lumenjtë sipërfaqësor që kalojnë nëpër vendbanime janë në gjendej jo të mirë sa i përket ndotjes. Edhe pse mungojnë të dhënat, në bazë të hulumtimeve në teren të gjithë shtretërit e lumenjve janë kthyer në deponi të mbetjeve të amvisërisë dhe të tjera si dhe ju kanë ekspozuar edhe ndotjes nga shkarkimi i ujërave të zeza pa asnjë trajtim paraprak psh: lumi Drinas, Rimnik, Palluzhë, Hoçë, Sopniq, Duhlllo, Bellaja etj. Lumi Drini i Bardhë edhe pse nuk buron ne komunën e Rahovecit, por të gjitha përrockat dhe lumenjtë derdhen në të. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedhë me një gjatësi prej 30 km dhe pjesën më të madhe është edhe si kufiri administrative i komunave si janë : Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës. Të gjitha komunat e lartpërmendura i shkarkojnë ujërat e zeza në shtratin e luginës së Drinit të Bardh pa as një trajtim paraprak.

Menaxhimi efikas i mbeturinave të ngurta në vendbanimet që nuk kanë qasje në sistem ndikon pozitivisht në uljen e ndotjes.


Eliminimi i ndotjes së ardhur nga komunat fqinje, si dhe ajo e shkaktuar nga vendbanimet në komunë, kërkon projekte si dhe realizim të tyre në favor të përmasimit të cilësisë së ujit.

Planifikimi i ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza.

Kostoja e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza është mjaft e lartë por komuna e ka për obligim që në bashkëpunim me komunën e Gjakovës, të zgjedhin modalitet të realizimit të projektit për trajtim të ujërave të zeza.

Në bazë të strategjisë për trajtimin e ujërave të zeza nga Ministria e punëve të jashtme të Finlandës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Departamenti i ujërave, janë dhënë dy variante për trajtim të ujërave të zeza dhe ato variante janë të planifikuara në Planin Hapësinor të Kosovës.


Varianti 1 - Trajtim i decentralizuar i ujërave të zeza, sipas të cilës çdo komunë ka impiantin e vet për trajtimin e ujërave të zeza. Pika më e ultë për trajtim e ujërave të zeza në Komunën e Rahovecit është në Krushë të Madhe ku komuna duhet të parashoh ndërtimin e impiantit dhe ndarjen e parcelës për ndërtimin e tij.



Harta e Impiantit të decentralizuar në Krushë të Madhe

Varianti 2 - Trajtim i centralizuar i ujërave të zeza me vetëm një impiant në secilën prej shtatë kompanive regjionale ujore, ku më vonë mund të kyçen edhe zonat rurale për rreth impiantit. Në këtë variant, komuna e Rahovecit parashihet të përfshihet në impiantin regjional të Gjakovës ku planifikohet ndërtimi i saj. Konfiguracioni i terrenit e pamundëson lidhjen e përshtatshme të kolektorëve për bartjen e ujërave fekale për trajtim për impiantin e centralizuar, andaj propozohet që impianti i decentralizuar të ketë përparësi zi realizim i projektit.

Rekomandohet që çdo operator industrial duhet të ketë impiant për trajtim të ujërave të zeza.




Mbrojtja nga degradimet

Rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara është projekt që kushton dhe komuna me fondet që ka nuk mund ti realizoj këtë projekt, andaj paraprakisht ajo duhet të filloj me parandalimin e eksploatimit si masa preventive.

Emri	Sipërfaqja ha
Degradimet / inertet	403.9
mbeturinat Ilegale	24.3

Shfrytëzimi i këtyre inerteve mund të bëhet vetëm me projekte për shfrytëzim në qoftë se dëmet mjedisore janë të vogla dhe zona mund të rigjenerohet.



Sipërfaqe të degraduara të tokës janë prezent për gjatë tërë shtratit të lumit Drini i Bardhë ku në mënyrë të pa kontrolluar është shkatërruar shtrati i lumit dhe si pasoj janë edhe vërshimet në këtë zonë. Vendbanimet më të rrezikuara nga vërshimet si dhe tokat bujqësore që janë në kërcenim të


përhershëm janë: Kramovik, Qiflak, Dabidol, Dejnë, Ratkocë, Radostë, Gexhë, Xerx dhe Krushë e Madhe që një shtrihen përgjatë shtratit të lumit të Drinit të Bardhë.

Parandalimi i veprimtarisë së kompanive që merren me eksploatimin e zhavorreve është masë preventive. Duhet të bëhet monitorimi për shkak të degradimeve mjedisore që janë duke ndodhë në territorin e komunës si dhe në koordinim me MMPH-gjegjësisht inspektoratin për mjedis, duhet që sa më shpejt të marrin masa për parandalimin e kësaj veprimtarie.

Menaxhimi i dobët i mbeturinave në nivel komune ka ndikuar në krijimin e punkteve ilegale të deponive të plehrave të amvisërive dhe atyre të ngurta në një sipërfaqe prej 24.3 ha

Rekomandim:

- Të ndalohet çdo eksploatim ilegal
- Të taksohen kompanitë eksploatuese që kanë licencë, me qëllim krijimit të fondit për rehabilitim të zonave të degraduara.
- Çdo kompani t'i përmbahet projektit dhe licencës për shfrytëzim dhe rehabilitim apo rikthim i gjendjes së mëparshme.
- Në tri faza të parashihet me projekt rehabilitimi i shtratit të Drinit të bardhë për përudh 10 vjeçare në bashkëpunim me MMPH



III.2.8. Fatkeqësitë elementare dhe masat mbrojtëse

Parandalimi i vërshimeve

Komuna e Rahovecit ka probleme me vërshime nga se ujrrjedha e lumit të Drinit të bardhë por edhe te degëve të saj që janë në brendi të territorit të komunës, gjatë sezonës së shirave por edhe shkrirjes së borës shkatërrojnë të mira materiale si në bujqësi ashtu edhe në njësi banimi.

Sipas vlerësimeve në Hidroekonomin e Kosovës sipërfaqe që janë të rrezikuara nga vërshimet janë rreth 2554 ha, ndërsa në rrezik permanent janë 612 ha tokë të kualitetit të lartë .

Rregullimi i shtretërve të lumenjve do ti zvogëlonte dëmet. Në këto pjesë kërkohet që të bëhet zgjerimi i shtretërve të lumenjve aq sa do të përballonin vëllimin e ujit në këto raste. Masë tjetër është eliminimi i lakesave të forta të lumit dhe të përcaktohet vendi për menaxhimin e brigjeve të lumenjve. Pronarët e pronave duhet që të kujdesen për prerjen e shelgjeve dhe largimin e tyre pas prerjes që mos ti bartë lumi. Mbrojtja e lumenjve nga hedhja e mbeturinave, që në këtë rast paraqesin pengesa për lëvizjen e lirë të ujit.

Me qëllim të mbrojtjes së shtretërve të lumenjve, komuna, gjegjësisht inspektorati për mjedis duhet të ndërmarr masa ndaj personave fizik dhe juridik që të gjitha aktivitetet e nxjerrjes ilegale të inerteve ti parandaloj.


Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore, duhet të kufizohet me kullota të përhershme ose pyje përgjatë vijës ujore së paku 10 m nga vija ujore me qëllim të parandalimit të vërshimeve .

Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga mbeturinat dhe nga bimët e vet rritura është e domosdoshme si projekt në vete që të iniciohet nga Komuna dhe MMPH- Departamenti i ujërave.

Ndërtimet e objekteve të banimit si dhe atyre me karakter ekonomik ndalohen të ndërtohen buzë brigjeve të lumenjve së paku 10 m largësi nga shtrati i lumit (pikës ujore). Lumi që kalon pranë vendbanimeve duhet të urbanizohet me drunjtë dekorativ dhe të shfrytëzohet për atraksion peizazhor dhe të parandalohet hedhja e mbeturinave.

Pasi lumi Drini i Bardhë ka karakter regjional andaj duhet që me inicim nga komunat Pjesmarrëse: Pejë, Deçan, Gjakov, Klinë, Rahoveci dhe organeve qendrore siç janë MMPH dhe MBPZHR të hartohet projekti për urbanizimin e startit të lumit me qëllim të parandalimit të vërshimit dhe ndotjes.


Rekomandimi urgjent: Parandalimi i çdo lloj veprimtarie që ka të bëjë me shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit.



Mbrojtja nga erozioni

Erozioni është një prej komponentëve mjaft me rëndësi për ta trajtuar ngase rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është prezentë pothuajse në tërë territorin e komunës së Rahovecit në forma dhe madhësi të ndryshme. Përsheptimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka krijuar edhe faktori njeri si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por

edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër prezentë është mbi formacionet e buta si dhe në tokat e zhveshura apo të degraduara nga prerjet ilegale të pyjeve , vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëqe, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj.



MOLIERIMI I PYJEVE	4158ha
MBROJTJA NDERTIMI I TERRACAVE MUREVE REZISTUESE	132.4ha
ZONAT E ZHVILLIMI TE PUNEVE TE ANTIEROZIONIT	847.6ha

Rajonet në të cilat erozioni ka intensitet të madh e që sjellin pasoja të dëmshme në ujë rrjedha, tokë, pyje dhe objekte dhe paluajtshme, duhet të shpallen zona erozive ku sipas Ligjit të Ujërave të Kosovës i shpallë komuna.

Me qëllim të parandalimit të aktivitetit eroziv duhet të ndërmerren hapa konkret dhe të menjëhershëm:

1. Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve.
2. Ndalimi i mbi kullotjes
3. Ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë erozion

Veprimet antierozive

Për të penguar vazhdimin e këtij fenomeni negativ duhet të merren këto veprime hidroteknike, bujqësore dhe biologjike.

Masat hidroteknike

- Ndërtimi i teracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese.
- Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gërryerjes
- Mbjellja e fidanëve pyjore në shtretërit e lumenjve
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve

Masat bujqësore

- Të mirëmbahen tokat bujqësore
- Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore
- Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve
- Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.

Masat biologjike

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri
- Ndalimi i kullotjes në masivet e varfra me bimësi
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara
- Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë.
- Erozioni duhet të kufizohet në brigjet e lumenjve kryesor me mbjelljen e drunjtëve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi nga lumi
- Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesor duhet të kufizohet me kullota të përhershme ose pyje.

Lokacionet prioritare ku duhet të ndërmerren masat antierozive:

- Intervenimet në hapësirë, sipas shënimeve dhe të paraqitura në hartë, duhen të bëhen në rreth 5138 ha që rrezikohen nga erozioni i mesëm, erozioni i fortë

- Erozioni i mesëm shtrihet në një sipërfaqe prej 11093.8 /ha Ka shtrirje te madhe ne hapësirë Ky lloj erozioni shtrihet në lokalitetet Kryesisht ne Veri dhe ne Perëndim të Komunës .

Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Rahovecut kapin sipërfaqe prej 596 /ha Ka shtrirje në pjesën JL të komunës. Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet Hoq e Madhe Hoq e vogël, dhe Brestovc

Në bazë të analizave propozohen masat antierozive :

- o Ndërtimi i mureve rrezistuse 132ha
- o Meliorimi i pyjeve 4158ha dhe
- o Formave tjera antierozive simbas nevojës me rreth 850ha
- Propozohet që këto sipërfaqe të pyllëzohen në bashkëpunim me MBPZHR-Agjencionin e pyjeve, ku ekspertët e pylltarisë përcaktojnë varietetet e pyjeve që duhet të mbillen me qëllim që të parandalojnë rritjen e shkallës së erozionit
- Kombinimi i masave antierozive është i domosdoshëm. Hulumtimet detale të terrenit nga ekspertët e fushave të ndryshme: hidrologë, gjeologë, pylltarë, agronom, etj, janë të domosdoshme dhe në bazë të rekomandimeve të tyre duhet të merren masat antierozive.
- Qeveria komunale duhet ti shpallë zonat më të rrezikuara dhe të ndërmerren hapa konkret antieroziv në bashkëpunim me MMPH, MBPZHR, Agjencionin e pyjeve, MSHP, MEF etj.

Tërmetet

Rreth 43.5% të territorit të Rahovecit shtrihet në zonat me rrezikshmëri nga tërmeti 9 shkallë të rihterit, si dhe rreth 57.5% prej 8 shkallë të riterit.

Ndërtimet e infrastrukturës dhe objekteve të banimit duhet ti përmbahen shkallës së intensitetit të dridhjeve për minimizimin e fatkeqësisë në raste rreziku.

Kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+3, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, sidomos urave.

Zjarret

Zjarret konsiderohen si kategori e fatkeqësive që shkaktojnë shkatërrim të të mirave materiale dhe konsiderohen si fatkeqësi elementare .

Janë prezentë zjarret në mjediset e pyllëzuara si pasoj e pakujdesisë së faktorit njeri. Masat mbrojtëse parashihen konform situatave, ku qeveria komunale me institucionet adekuate formon shtabet e krizave në përkrahje të shërbimit të zjarrfikësve .

Masat mbrojtëse duhet të kryhen në bashkëpunim me institucionet gjegjëse të qeverisë (MMPH, MBPZHR, MSHP, MEF, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit, Agjencioni i Pyjeve etj, si dhe SHPK, FSK, KFOR, Qeveria komunale, Shtabet e krizave, Zjarrfikësit etj). Këto masa janë dhënë si

udhëzime për komunat, institucionet e qeverisë dhe institucionet tjera publike. Ato duhet të jenë të organizuara mirë dhe të koordinuara nga institucionet publike siç janë: Shërbimi Policor i Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, Zjarrfikësit. Këtu përfshihet edhe KFOR-i si një nga partnerët e komunës. Përgjegjësia e këtyre institucioneve është të ndërmarrin veprime të domosdoshme parapërgatitëse për sigurimin e mobilitetit të njerëzve të involvuar në veprimet që duhet të kryhen. Komuna është përgjegjëse të formoj mekanizma paraprak për raste rreziku dhe duhet të formohet Shtabi i Krizave si dhe të hartohen planet e veprimit në rast rreziku nga zjarri, tërmetet, rrëshqitjet e dheu, epidemitë, ndotje alarmante etj.

III.2.9. Trashëgimia natyrore

Masat mbrojtëse në bazë të Ligjit për mbrojtjen e natyrës janë në funksion të zhvillimit të turizmit si dhe në funksion të mbrojtjes së natyrës. Mbrojtja e monumenteve natyrore është përgjegjësi e komunës dhe MMPH nga se vlerat e veçanta të natyrës në këto pika janë vlera të trashëguara me gjenerata të tëra dhe janë në funksion të zhvillimit të më tutjeshëm si në aspektin mjedisor ashtu edhe atë ekonomik. Në territorin e komunës së Rahovecit shtrihet një pjesë e sipërfaqes së zonës së mbrojtur të Kanjonit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejt Monument natyre me karakter hidro-geomorfologjik që është shpallur në vitin 1986 me sipërfaqe 126.5 ha dhe Parku regjional i Mirushes 198.77ha 1983 Monument natyre me ujëvara te njëpasnjëshme Per shkak të vlerave natyrore janë propozuar për mbrojtje edhe këto monumente të natyrës

- Nagavc- trung qarri
- Drenovc-Trungjet e dushkut
- Vranjak- Trungjet e vidhit
- Dabidol- Trungjet e dushkut
- Potiqan i ultë-Trungjet e dushkut
- Brstuvc -trungjet e dushkut (lisi i Bajraktarit)

Rekomandim:

- Pjesëmarrja e Komunës në Hartimin e Planit Hapësinor „Ujëvarat e Mirushës" si dhe përmbajtja këtij plani
- Në bashkëpunim me MMPH dhe komunën e Gjakovës të bëhet Plani rregullues për zonën e mbrojtur „Kanjoni i Drinit të bardhë"(Ura e fshejtë)zonë me karakter geomorfologjik me qëllim të kontrollimeve të zhvillimeve në zonë si dhe mbrojtjen natyrore të këti monumenti.
- Ruajtja dhe mbrojtja e vlerave të lartpërmendura me qëllim të vazhdimësis së vlerave të natyrës .
- Varësisht nga kërkesat e qytetareve si dhe Drejtoratit të mbrojtjes së mjedisit të përpilohet lista me kërkesa të reja për mbrojtje të pikave tjera qe konsiderohen me rëndësi në territorin e komunës .

Trashëgimia kulturore

Si çdo pjesë të Kosovës edhe në komunën e Rahovecit nuk është i hulumtuar territori i saj sa i përket lashtësisë së vendbanimeve edhe pse në bazë të dhënave kjo trevë është e banuar që nga koha Ilire e deri sodë që i dokumentojnë mbetjet arkeologjike në shumë territore të komunës .

Në bazë të analizave të gjendjes ekzistuese në fazën e parë të projektit, sipas Institutit për mbrojtje të monumenteve të Kosovës si dhe të dhënave komunale janë identifikuar 14 monumente të trashigëmis kulturore

Propozohet që këto objekte të trashëgimisë të hynë nën mbrojtje institucionale si dhe ruajtja dhe konservimi i tyre.

Monumentet me statut mbrojtjes të shpallura janë :

	KOMUNA E RAHOVECIT - Monumentet me status të mbrojtjes		
nr.	objekti / tërësia	vendbanimi	viti i shpalljes
1	Vendbanim Romak në vendin e quajtur "Pozhig",shek.II-IV nr.nr.V.E.K.02-460/58	Xërzë	
2	Shpellat Uluricë,shek.XIV,nr.V.E.K.02-231/62	Mirushë	1962
3	Mbeturinat e Qytetit "Qyteza"	Zatriq	1967
	shek.I-XIV,		
	nr.V.E.K.998/67		
4	Mbeturinat e qytezës Ilire në kodrën "Qytezë",	Gexhë	
	shek.VIII. p.e.s. dhe shek.V. të erës sonë,		
	nr.V.E.K.02-251/68		
5	Kisha e Shortarisë,	Zoqishtë	1954
	shek.XIV-XVI,		
	nr.V.E.K.494/54		
6	Kishë varrore e Shën Nikollës,	Hoqë e Madhe	1958
	she.XIV-XV,		
	nr.V.E.K.02-237/58		
7	Kishë varrore e Shën Gjonit,	Hoqë e Madhe	

	she.XIV-XVI,		
	nr.V.E.K.02-54/58		
8	Kisha Brnjaçë,	Bërnjak	
	shek.XIV,		
	nr.V.E.K.557/66		
9	Mbeturinat e kishës Shpëtimi i Shenjët (Shën Gjergji)	Apterushë	
	shek.XVI,		
	nr.V.E.K.558/66		
10	Mbeturinat e kishës së Shën Lukës,	Hoqë e Madhe	
	shek.XIV-XVI,		
	nr.V.E.K.199/67		
11	Teqja Halveti, rr.M.Tito 64,	Rahovec	1970
	shek.XIX,		
	nr.V.E.K.02-251/68		
12	Përmbledhje e këngëve të Sheh Maliqit,	Rahovec	1955
	shek.XIX,		
	nr.V.E.K.634/55		
13	Përmbledhje e dorëshkrimeve Sheh Ilmi Maliqit,	Rahovec	1961
	shek.XIX,		
	nr.V.E.K.02-377/61		
14	Ikonë sedefi e festave të mëdha dhe Pjata e bakrit nga kisha e Shën Shtjefnit,	Hoqë e Madhe	1968
	1601,		
	nr.V.E.K.02-249/68		

Propozim:

- Të hulumtohen dhe të restaurohen në bashkëpunim me MKRS

1. Vendbanim Romak në vendin e quajtur "Pozhig",shek.II-IV Xërx
 2. Mbeturinat e qytetit „Qyteza shek .I.-XIV Zatriq
 3. Mbeturinat e qytezës Ilire në kodrën "Qytezë",shek.VIII. p.e.s. dhe shek.V. të erës sonë, Gexhë
 4. Mbeturinat e kishës Shpëtimi i Shenjët (Shën Gjergji) shek.XVI, Apterushë
- Gjendja fizike e pjesës së vjetër e qytetit - kërkohet ruajtja e bërthamës së qytetit.
 - Restaurimi dhe mirëmbajtja e Teqesë Halveti
 - Përmbledhje e këngëve të Sheh Maliqit,-Publikimi i këtyre përmbledhjeve në Katalogun turistik të qytetit (forma e shkurtuar)
 - Përmbledhje e dorëshkrimeve Sheh Ilmi Maliqit, Publikimi i këtyre përmbledhjeve në Katalogun turistik të qytetit (forma e shkurtuar)
 - Restaurimi ,mbrojtja dhe ruajtja e Objekteve të trashëgmis ortodokse si dhe urbanizimi i vendbanimit Hoqe e Madhe me qëllim të ruajtjes së vlerave
 - Të përpilohet katalogu i trashëgimisë kulturore në funksion të turizmit.

Shënjimi i zonave të rëndësishme strategjike, zonave të veçanta të aprovuara në Planin Hapësinor të Kosovës ose planet e zonave të veçanta sa i përket Mjedisit

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, projekte strategjike të aprovuara për rajonin janë:

- Impianti rajonal.
- Ujëvarat e Mirushës
- Kanjoni i Drinit të Bardhë
- Trashëgimi kulturore-Hoq e madhe

Këto projekte do të reflektohen pozitivisht në komunës, duke stimuluar zhvillimin ekonomik dhe krahas kësaj, kjo do të ndikoi edhe në rritjen e standardit jetësor të banorëve të komunës.

IV. STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

Faza e katërt e Planit zhvillimor për komunën e Rahovecit përmban strategjinë, përmes së cilës do të realizohet vizioni për të ardhmen e komunës si dhe do të arrihen synimet dhe objektivat e parapara gjatë procesit të planifikimit. Strategjia përfshin masat dhe veprimet që do të ndërmerren në të ardhmen për ta realizuar një zhvillim më kompakt dhe të qëndrueshëm të komunës së Rahovecit. Propozimet që janë dhënë në këtë strategji, janë parashikime që do të realizohen në periudhën kohore deri në vitin 2020. Të gjitha propozimet që përmban kjo fazë janë të arritshme dhe shprehin nevojat e qytetarëve të komunës.

Përmes kësaj strategjie, arrihet një zhvillim efikas në fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik, social, mjedisor, të infrastrukturës etj. Strategjia parasheh avancim të administratës komunale, të arsimit dhe shëndetësisë. Gjithashtu kjo strategji do të mundësoj krijimin e hapësirave të mjaftueshme rekreative për periudhat e ardhme kohore. Kërkesat për ndërtime të reja do të plotësohen duke bërë ndërtime të planifikuara, por njëkohësisht duke e mbrojtur mjedisin, me një përkujdesje të veçantë ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Element mjaft i rëndësishëm është edhe arritja e një zhvillimi të harmonizuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, ku bujqësia dhe aktivitetet tjera ekonomik do të jenë më të avancuar se që janë sot. Për ta realizuar zhvillimin e dëshiruar ekonomik, do të krijohen kushte më të mira për investitor dhe infrastruktura të jetë e përshtatshme dhe bashkëkohore.

IV.1. MASAT PËR PARANDALIMIN E NDIKIMIT NEGATIV SOCIAL

Qëllimi 1. Administratë funksionale dhe efikase

Shërbimet administrative luajnë një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore. Për të pasur shërbime administrative sa më cilësore duhet të krijohen këto kushte;

- Avancimi i sistemit elektronik, ku çdo qytetar të ketë mundësi të informohet me gjithçka që i intereson dhe të mund të plotësoj formular dhe parashitjet e kërkesa sipas nevojës së tij përmes sistemit elektronik si digjitalizimit të administratës.
- Decentralizimi i administratës – Funksionalizimi i shërbimeve administrative edhe në qendrat sekondare dhe ato të bashkësive lokale
- Ndërtimi i sistemit të adresave.

Ndërtimi i sistemit të adresave – krijimi i bazës së të dhënave mbi të gjitha ekonomin familjare dhe bizneseve përmes sistemit të GIS-it

Qëllimi 2. Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë

Në komunën e Rahovecit ekziston shkallë e lartë e papunësisë po ashtu krahas shkallës së lartë të papunësisë paraqitet edhe shkallë mjaft e lartë e varfërisë. Për ta përmirësuar këtë gjendje, kërkohet ndërmarrja e masave konkrete që kanë të bëjnë me rritjen e numrit të punësuarve dhe rritjen e të ardhurave për kokë banori, që do të ndikoj në ngritjen e standardit jetësor. Në zbutjen e shkallës së papunësisë dhe varfërisë hapja e vendeve të reja të punës do ta ketë efektin e vet duke tentuar që këtë zbutje ta arrijmë përmes ngritjes së gjithmbarshme të zhvillimit ekonomik. Stimulimi i bujqësisë, përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilët sektorë do të

përmirësojnë situatën sociale. Tërheqja e investitorëve për të investuar në këtë territor gjithashtu do të zbus problemet sociale. Organizimi i trajnimeve profesionale, sipas kërkesave të tregut do të ndikoj pozitivisht në shkallën e papunësisë dhe varfërisë. Sigurimi i punës sezonale brenda dhe jashtë vendit për mesë binjakëzimit me ndonjë komunë, ndërmarrje, etj. jashtë Kosove të cilës i duhet fuqi punëtore do të jetë e mirëseardhur.

Synimi 1. Organizimi i programeve dhe trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut

Në këtë komunë është e domosdoshme organizimi i disa kurseve dhe trajnimeve të fushave të ndryshme. Këto trajnime dhe kurse do të ndikojnë pozitivisht drejt përmirësimit të gjendjes ekonomike dhe ngritjes së standardit jetësor.

- Organizimi i kurseve të rrobaqepësisë
- Organizimi i trajnimeve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë
- Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e bizneseve të vogla
- Organizimin e trajnimeve apo seminareve për përdorimin e teknikave të reja

Zbatimi i këtyre masave gjegjësisht projekteve konkrete, për shkak të rëndësisë që kanë, do të realizohen në periudhën afatmesme, dhe si rrjedhojë në komunë do ketë zbutje të papunësisë dhe ulje të varfërisë dhe përfundimisht ngritje të standardit jetësor.

Synimi 2. Sigurimi i punës sezonale

Sigurimi i punës sezonale ndikon drejtpërdrejt në përmirësim të gjendjes ekonomike të banoreve të Rahovecit. Po ashtu do të ndikojë në uljen e papunësisë dhe varfërisë dhe në anën tjetër do të ndikonte në edukimin e rinisë drejtë një të ardhme më të mirë.

- Mbledhja e frutave, perimeve, qajrave etj.
- Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe parqeve.
- Lidhja e kontratës sezonale me ndonjë vend – shtet në rajon.

Sigurimi dhe implementimi i këtyre projekteve dhe bashkëpunimi me MPMS do të ndikonte në zbutjen e papunësisë dhe zvogëlimin e varfërisë.

Synimi 3. Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme

Përkrahja e këtyre bizneseve është një faktorë shumë i rëndësishëm dhe luanë një rolë kyç në zbutjen e papunësisë dhe zvogëlimin e varfërisë.

- Stimulimi i bujkut përmes lirimit të kostos së derivateve, plehrave artificiale, farërave etj.
- Kredi me kamata të ulëta dhe afatgjata për bujqësi dhe blegtori.
- Zvogëlimi dhe lehtësimi i taksave për bizneset e vogla dhe të mesme.

Synimi 4. Stimulime të vazhdueshme në veprimtari bujqësore

- Përkrahja e bujqëve përmes trajnimeve profesionale
- Përkrahja me farëra dhe teknikë bujqësore
- Stimulimi dhe mbrojtja e prodhimeve vendore

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË PAPUNËSISË DHE VARFËRISË							
Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Qëllimi 2. Zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë	S1. <i>Organizimi i programeve dhe trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut</i>	1. Organizimi i kurseve të rrobaqepësisë	K. Komunal,	K. Komunal	••	K. Komunal donatorët	10000
		2. Organizimi i trajnimeve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë	K. Komunal MBPZHR	K. Komunal	••	K. Komunal donatorët	10000
		3. Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e bizneseve të vogla	K. Komunal MT	K. Komunal	•	K. Komunal	10000
		4. Organizimin e trajnimeve apo seminareve për përdorimin e teknikave të reja	MSH,K. Komunal	K. Komunal	••	K. Komunal donatorët	10000
	S2. <i>Sigurimi i punës sezonale</i>	1. Mbledhja e frutave, perimeve, qajrave etj.	K. Komunal	K. Komunal	•	K. Komunal	
		2. Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe parqeve.	K. Komunal	K. Komunal	•	K. Komunal, donatorët	30000
		3. Lidhja e kontratës sezonale me ndonjë vend - shtet.	K. Komunal	K. Komunal	•	K. Komunal, donatorët	
	S3 <i>Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme</i>	1. Stimulimi i bujkut përmes lirimit të kostos së derivateve, plehrave artificiale, farërave etj.	K. Komunal	K. Komunal	•	K. Komunal MBPZHR	50000
		2. Kredi me kamata të ulëta dhe afatgjata për bujqësi dhe blegtori.	K. Komunal	K. Komunal	••	K. Komunal, donatorët	
		3. Zvogëlimi dhe lehtësimi i taksave për bizneset e vogla dhe të mesme.	K. Komunal	K. Komunal	••	K. Komunal, donatorët	

S4. Stimulime të vazhdueshme në veprimtari bujqësore	• Përkrahja e bujqëve përmes trajnimeve profesionale •	K. Komunal	K. Komunal	...	K. Komunal MBPZHR	
	• Përkrahja me farëra dhe teknikë bujqësore	K. Komunal	K. Komunal	...	K. Komunal MBPZHR	
	• Stimulimi dhe mbrojtja e prodhimeve vendore •	K. Komunal	K. Komunal	...	K. Komunal MBPZHR	

LEGJENDA • Afat shkurt (deri 3 vjet) •• Afat mesëm (deri 6 vjet) •+ Nga 1 - 10 vjet

QËLLIMI 3. Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi

Në komunën e Rahovecit ekzistojnë numër i konsiderueshëm i objekteve arsimore dhe shëndetësore. Shtrirja dhe shpërndarja hapësinore e objekteve shkollore nuk mundëson që me këto shërbime të mbulohet i tërë territori i komunës. Gjendja fizike e këtyre objekteve nuk është e kënaqshme. Në disa vendbanime paraqitet si problem mungesa e hapësirës, ndërsa në disa të tjera edhe mungesa e mësimdhënësve dhe kuadrit të kualifikuar. Problem tjetër mjaft i theksuar është edhe mungesa e infrastrukturës së nevojshme në këto objekte siç janë: ujësjellësi, kanalizimi etj. Gjithashtu duhet siguruar edhe pajisjet adekuate për arsim dhe shëndetësi me qëllim të avancimit të këtyre shërbimeve.

Synimi 1. Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shërbimet arsimore dhe shëndetësore

Përmirësimi i gjendjes fizike të objekteve arsimore dhe shëndetësore, rregullimi i infrastrukturës fizike dhe teknike, si rrjedhim do të ketë avancimin e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore në komunë e Rahovecit. Kjo arrihet me ndërmarrjen e masave konkrete dhe me investime-projekte adekuate në drejtime të ndryshme duke përfshirë:

- Ndërtimi i shkollave fillore apo anekseve në vendbanimet ku mungojn ato dhe numri i nxënësve është i tejkaluar
- Organizimin e transportit për nxënësit e vendbanimeve më të thella malore.
- Ndërtimi i ambulancave në vendbanimet ku mungojn dhe numri i popullsisë i plotëson kriteret.
- Renovimi i hapësirave-objekteve shëndetësore

Zbatimi i këtyre masave gjegjësisht projekteve konkrete, për shkak të rëndësisë që kanë, do të realizohen në periudhën afatmesme, dhe si rrjedhojë në komunë do ketë shërbime arsimore dhe shëndetësore të avancuar.

Synimi 2. Përmirësimi i infrastrukturës teknike në objektet arsimore dhe shëndetësore

Problem tjetër mjaft i theksuar sa i përket shërbimeve arsimore dhe shëndetësore është edhe mungesa e infrastrukturës teknike siç janë: ujësjellësi, kanalizimi etj.

- Kyçja ne infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjitha objektet shkollore të cilat nuk janë të kyçura.
- Kyçja në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit të objekteve shëndetësore ku mungon.

Përmirësimi i infrastrukturës teknike për objektet shëndetësore dhe arsimore (ujësjellësi dhe kanalizimi) janë të parapara në pjesën e infrastrukturës teknike. Në atë pjesë është shtjelluar në tërësi për Komunën dhe qytetin e Rahovecit kyçja në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit për të gjitha vendbanimet, në kuadër të cilës do të kyçen edhe objektet shkollore dhe shëndetësore

Synimi 3. Krijimi i kushteve për edukim të vazhduar të personelit profesional në arsim dhe shëndetësi

Faktorë tjetër me rëndësi për përmirësimin e shërbimeve në arsim dhe shëndetësi është edhe arritja e nivelit më të lartë kualifikues për kuadrin përkatës

- Plotësimi me kuadër përkatës arsimor
- Organizimi i trajnimeve profesionale dhe edukimi i vazhduar për kuadrin arsimor dhe shëndetësor.
- Rritja e numrit të mjekëve dhe mësime dhënëseve sipas kërkesave.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR DHE ARSIMOR							
Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Q3. Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi	S1. Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shërbimet arsimore dhe shëndetësore	1. Ndërtimi i anekseve dhe renovimi i objekteve shkollore	K. Komunal, MASHT,	K.Komunal	••	K. Komunal, MASHT-BKK donatorët	160000
		2.Ndërtimi i hapësirave të mbyllura – sallat e edukatës fizike dhe hapësirave të hapura – terrenet sportive	K. Komunal, MASHT,	K.Komunal	•+	K. Komunal, MASHT-BKK donatorët	200000
		3. Renovimi dhe zgjerim i objekteve shëndetësore	K. Komunal, MSH,	K.Komunal	••	K. Komunal, MSH-BKK	60000
		4.Ndërtimi i objektit me banesa sociale	K. Komunal, MSH,	K.Komunal	••	K. Komunal, MSH-BKK	100000
		5.Ndërtimi i qendrës së shëndetit mendor	K. Komunal, MSH,	K.Komunal	••	K. Komunal, MSH-BKK	100000
		6.Ndërtimi i qendrës për të moshuar	K. Komunal, MSH,	K.Komunal	••	K. Komunal, MSH-BKK	100000

		7.Ndërtimi i shtëpisë integruese	K. Komunal, MSH,	K.Komunal	••	K. Komunal, MSH-BKK	100000
		8.Ndërtimi i shtëpisë edukuese	K. Komunal, MSH,	K.Komunal	••	K. Komunal, MSH-BKK	100000
		9.Kyçja ne infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjitha objektet shkollore të cilat nuk janë të kyçura.	K. Komunal, MASHT,	Do të rregullohen në pjesën e infrastrukturës teknike (ujësjellësi dhe kanalizimi) në nivel të komunës			
		10.Kyçja në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit të AMF-ve të cilat nuk janë të kyçura	K. Komunal, MSH	Do të rregullohen në pjesën e infrastrukturës teknike (ujësjellësi dhe kanalizimi) në nivel të komunës			
	S2. <i>përmirësimi i infrastrukturës teknike në objektet arsimore dhe shëndetësore</i>	1. Krijimi i kabineteve dhe laboratorëve të fushave përkatëse (Fizikë, Kimi, Biologji, Informatikë) dhe pajisja e tyre me mjete didaktike dhe profesionale	MASHT, K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal,	?
		2.Rrethimet e shkollave, gjelbërimi i oborreve	MASHT, K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal,	?
		3.Investimet në eficiencë	MASHT, K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal,	?
		4.Organizimi i përshtatshëm i udhëtimit për nxënës të shkollave të mesme në përputhje me orarin	MASHT,	K. Komunal	•	K. Komunal,	

	mësimor	K. Komunal				
	5.Hapja e shkollës së ultë të muzikës	MASHT, K. Komunal	K. Komunal	•	K. Komunal,	
	6.Sigurimi i bocave kunder zjarrit në të gjitha objektet shkollore si dhe mbushja e tyre	MASHT, K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal,	
	7.Ndërtimi i një qerdhe të re	MASHT, K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal,	
	8.Hapja e shkollës jo formale	MASHT, K. Komunal	K. Komunal	•	K. Komunal,	
	9.Mësimi shtes për nxënësit e komunitetit RAE	MASHT, OJQ K. Komunal	K. Komunal	•	K. Komunal,	
	10. Paisja e QMF-ve me autoambulanca për shërbime të shpejta dhe cilësore për pacient	MASHT, OJQ K. Komunal	K. Komunal	•	K. Komunal,	50000
	11.Shërbimet e internetit në objektet shëndetëore	Qeveria e Luksemburgut	K. Komunal	•	K. Komunal	
	12.Pisaj e shkollave me kabinete stomatologjike	MASHT, OJQ K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal	50000

		13.Hapja e repartit të hemodializës – njesi satelite e e Prizrenit	MASHT, OJQ K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal	200000
		14. Pajisja me mjete teknike moderne e kryesisht ato për diagnostifikim të hershëm të sëmundjeve në të gjitha institucioneve shëndetësore	MSH,K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal,	?
	S3 Krijimi i kushteve për edukim të vazhduar të personelit profesional në arsim dhe shëndetësi	1. Në shumicën e shkollave fillore të mesme të ulëta dhe në shkollat e mesme të larta duhet siguruar kuadër të kualifikuar konform ligjit në fuqi	K. Komunal, MASHT	K. Komunal,	•	K. Komunal,	/
		2. Në të gjitha qendrat shëndetësore të arrihet raporti 1 mjek dhe 2 infermier për 2000 banor	MSH,K. Komunal	K. Komunal	••	K. Komunal,	/
		3. Në QMF-të arrihet raporti 1 stomatolog dhe 2 infermier për 6000 banor	MSH,K. Komunal	K. Komunal	••	K. Komunal,	/
	S3 Krijimi i kushteve për edukim të vazhduar të personelit profesional në arsim dhe shëndetësi	1. Hartimi i programeve për trajnim të vazhdueshëm si dhe licencimi dhe akreditimi i tyre	MASHT, MSH,K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal	?
		2. Organizmi i trajnimeve mitologjike dhe profesionale për kuadrin arsimor dhe shëndetësor.	MASHT, MSH, K. Komunal	K. Komunal	•+	K. Komunal	?

	3. Edukimi i vazhduar profesional për kuadrin arsimor dhe shëndetësor..	MASHT, MSH, K. Komunal	MASHT, MSH, K. Komunal	•+	MASHT, MSH,	?
--	---	---------------------------	---------------------------	----	----------------	---

LEGJENDA • Afat shkurt (deri 3 vjet) •• Afat mesëm (deri 6 vjet) •+ Nga 1 - 10 vjet

QËLLIMI 4. Zhvillim të vendbanimeve dhe ndertime me plan

Synimi 1. Lidhje funksionale me qendrën urbane

Zhvillimet kryesisht janë të përqendruara në qendrën urbane dhe rreth saj, ndërsa viset rurale në përgjithësi, e në veçanti ato në viset kodrinoro malore ngecin në zhvillim ekonomik dhe social. Për të arritur një zhvillim të baraspeshuar hapësinor duhet investuar në dy aspekte kryesore. Së pari kërkohet që të zhvillohet infrastruktura rrugore në këto vise dhe të sigurohen lidhje më funksionale në transport, ndërsa zhvillimi i disa zonave atraktive turistike duhet të ketë prioritet. Këto premisa do të reflektoheshin drejtpërdrejtë në ngritjen e standardit jetësor dhe komoditetit për të jetuar në këto vise. Investimet në zhvillimin e infrastrukturës dhe të turizmit në këto vise janë të parapara në strategjinë e infrastrukturës dhe transportit dhe atë të zhvillimit ekonomik.

Synimi 2. Formimi i qendrave sekondare

Kjo strategji parasheh ofrimin e shërbimeve për qytetarët e komunës. Sipas sajë shërbimet duhet të decentralizohen me qëllim që qytetarët të jenë sa më afër tyre. Për këtë arsye në strategji janë paraparë tri qendra sekondare: Ratkoci, Xërxa dhe Krusha e Madhe. Këto tri qendra do të ndikojnë në shkarkimin e administratës në vetë qytetin e Rahovecit ku tani të gjitha shërbimet administrative janë të përqendruara vetëm në këtë qendër komunale.

Synimi 3. Hartimi i planeve rregulluese urbane

Së pari duhet bërë hartimi i planit zhvillimor urban, përmes të cilit do të përcaktoheshin kahet zhvillimore të qytetit të Rahovecit dhe strategjitë për veprim. Pastaj, për ta realizuar një funksionalitet më të mirë të vendbanimeve është shumë me rëndësi të hartohen planet rregulluese për:

- Të gjitha zonat urbane të qytetit të Rahovecit dhe
- Qendrat sekondare: Ratkoc, Xërxe dhe Krushë e Madhe.

Qëllimi i këtyre planeve është orientimi i zhvillimit të ardhshëm përbrenda dhe përreth zonave përkatëse duke i'u përshtatur karakterit të veçantë të secilës qendër. Komuna do të bëjë investime në këto qendra sekondare dhe ato do të zhvillohen me qëllim të parandalimit të zgjerimit të pakontrolluar.

Zhvillimi i planifikuar i këtyre qendrave sjell deri te përmirësimi i cilësisë së jetës në këto vendbanime dhe vendbanimeve tjera përreth, nga se shërbimet do të jenë më afër popullsisë. Nga këto arsye, komuna duhet të vazhdojë me planet rregulluese në zonat urbane dhe qendrat sekondare, si dhe zonat e parapara për zhvillim jashtë zonës urbane.

Synimi 4. Zgjidhje për ndertimet ilegale dhe vendbanimet joformale

Gjatë rregullimit të vendbanimeve jo formale është e rëndësishme të përcaktohen prioritetet si projektet me rëndësi në përmirësimin e gjendjes së tyre, që njëkohësisht do t'u shërbente donatorëve të mundshëm për ofrimin e informatave të nevojshme për përkrahje financiare, njerëzore dhe teknike në kuadër të këtij rregullimi.

Çështjet e pazgjidhura pronësore duhen të zgjidhen në mënyrë që të sigurohet baza ligjore për inicimin e procesit të planifikimit. Kadastru dhe departamentet pronësore duhet të ofrojnë të dhëna dhe dokumentacion hartografik në mënyrë që të shmangen problemet me të dhëna gjatë planifikimit. Rregullimi i vendbanimeve joformale

duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësve t'u mundësohet ti shprehin kërkesat e tyre për mundësimin e një vendimmarrje transparente.

Nevojitet bashkëpunimi me akterët vendimmarrës me qëllim të shmangies së problemeve në raport me tokën publike. Diskutimet e ndërsjella janë të domosdoshme në mënyrë që të gjenden zgjidhje për sigurimin e infrastrukturës teknike dhe sociale.

Rregullimi i vendbanimeve joformale është pjesë e standardeve për Kosovën të hartuara nga PSSP. Andaj Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban duhet që në procesin e planifikimit të përfshijë vendbanimet joformale dhe të merret me joformalitetin në përputhshmëri me udhëzimet e publikuara nga MMPH. Veprimet e lartshënuara janë të nxjerra nga udhëzuesit për rregullimin e vendbanimeve joformale të hartuar nga DPH – MMPH bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 dhe Ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003-14

Zhvillimi kompakt dhe i qëndrueshëm i vendbanimeve							
Objektivi	Nr. i Aktivitetit	Aktiviteti	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Qëllimi 4. Zhvillim të vendbanimeve dhe nderime me plan	S1. Lidhje funksionale me qendrën urbane	Sigurimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në qendrat sekondare dhe vendbanimeve tjera me qëllim të përmirësimit të kushteve jetësore	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	**	Kuvendi Komunal dhe ndërmarrjet publike	e lartë
	2. Formimi i qendrave të reja sekondare	Hartimi i planeve rregulluese për qendrat sekondare; Ratkoc, Xërxe dhe Krushë e Madhe	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	**	Kuvendi Komunal dhe ndërmarrjet publike	100 000
	3. Hartimi i planeve rregulluese urbane	Hartimi i Planit Zhvillimor Urban	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	*	Kuvendi Komunal	100 000
		Hartimi i planeve rregulluese për qytetin: Zonën e qendrës, dhe zonat tjera.	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	**	Komuna dhe kompani të specializuara në planifikim	180 000
	4 Zgjidhje për ndërtime ilegale dhe vendbanimeve joformale	Rregullimi i vendbanimeve joformale dhe sigurim i banimit	Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	*	Komuna, MMPH, donator	200000

MASAT PARANDALUESE TË NDIKIMEVE TË DËMSHME NË MJEDIS

Qëllimi 5. Mbrojtje e mjedisit dhe shfrytëzim racional

Synimi 1. Parandalimi dhe largimi i mbeturinave ne trupat uhor dhe mjedise tjera

Hapësirat mjedisore të pa shfrytëzuara të cilat janë prona jo private shfrytëzohen pa kritere për deponimin e mbeturinave si në masat tokësore dhe ato të trupave uhor.

Sfera mjedisore paraqet disa prej sfidave më të rëndësishme me të cilat duhet të përballet komuna.

Vlerësimet e bëra në fazën e parë të profilit rezultojnë me probleme të shumta mjedisore ku deponime të mbeturinave ilegale ka në mjedise të shumta në hapësirë si rezultat i mos efikasitetit dhe mungesës së sistemit për grumbullimin e mbeturinave të amvisris dhe atyre industriale.

Për parandalimin sa ma efikas dhe largim të mbeturinave nga mjediset uhor dhe mjediset tjera komuna duhet ta parashoh hartimin e Planit për veprim në mjedis në përputhje me Planin e Kosovës për veprim ne mjedis. Ku njeherti kjo është parapar edhe me Ligjin për mbrojtjen e Mjedisit nr.03/L025. Ky plan do të ndihmoj në adresimin çështjeve mjedisore të evidentuara më poshtë.

Janë evidentuar një varg çështje të cilat kanë ndikuar në mjediset të cilat janë tani me deponime të mbeturinave e që komuna duhet ndërmarr hapa konkret në zgjedhjen e këtyre problemeve.

- Kapacitetet për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve janë të pamjaftueshme
- Nuk ka traditë të trajtimit dhe hedhjes së përshtatshme të mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike janë te pamjaftueshme;
- Mungon ndërgjegjësimi publik për dëmin e shkaktuar nga keqadministrimi i mbetjeve.

Sa më efikase të jetë **shërbimi i largimit publik të mbeturinave** për një komunë të pastër dhe të gjelbër, për një komunë me cilësi jetese më të mirë për qytetarët e saj, për një komunë më të shëndetshme dhe aktive, duhet të ndermirren një varg aktiviteteve dhe projekte të zbatueshme për Uljen e Shkallës së ndotjes duke hartuar Planin lokal për menaxhimin e mbeturinave në bazë të Ligjit për mbeturinat Nr 02/L30.

Një varg çështjesh të listuara do ta ndihmoj komunën që në harmoni me ligjin e lartpërmendur të jen sa ma efikase në menaxhimin e mbeturinave:

- Rritur shpenzimet dhe teknologjitë për mbledhjen e mbeturinave
- Vënien në funksion të procesit të riciklimit të mbeturinave
- Vazhdimin e rehabilitimit të sipërfaqeve me mbetje ilegale
- Ndërtimi i një fushe të re të depozitimit, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave me komunat fqinje
- Marrja e masave për mbledhjen, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve komunale
- Sigurimin e Partneritetit Privat-Publik për përpunimin e riciklimin e mbeturinave
- iniciativa fiskale për sjellje miqësore ndaj mjedisit

- Vazhdimi i mbjelljes së drunjëve dhe shtimin e hapësirave të gjelbra
- Marrja e masave për ruajtjen e hapësirave të hapura, bukurive natyrore
- Marrja e masave për rehabilitimin e zonave të ndotura të mjedisit dhe hapjen e zonave të reja gjelbëruese

Një ndër iniciativat që janë shumë të preferuara për një mjedis të pastër e që komuna ka mundësi ta organizoj në bashkëpunim me ndonjë OJQ-ë mjedisore si dhe ne bashkëpunim me MMPH-në është edhe: Fushata për reduktimin e mbetjeve 2011-2020 me moton

“Së bashku, për një mjedis të Shëndetshëm”

Fushata Mjedisore, përmban një paketë projektesh drejtuar grupeve të ndryshëm interesi në referencë të çështjeve mjedisore kryesore që ata përfaqësojnë.

Është orientuar në çështjen e Reduktimit të Mbetjeve, si një metodë e re alternative, por edhe si një nga çështjet që përbën problem në cilësinë e mjedisit dhe jetës.

- Programi **“Edukimi mjedisor”** nga subjektet e kontraktuara për shërbimin e pastrimit” synon të ndërgjegjësojë dhe sensibilizojë opinionin publik për sa i përket çështjes së depozitimit të mbeturinave në kontenjer, për të lehtësuar mbledhjen e tyre, si dhe menaxhimin e depozitimit, duke krijuar premisat për të prezantuar elemente të tjera të trajtimit të mbetjeve, nëpërmjet riciklimit. Po ashtu edhe çështje që kanë të bëjnë me pastrimin e rrugëve (fshirjes dhe larjes së rrugëve).

Hapat që duhen ndërmarr për riparimin e dëmeve mjedisore janë:

- Analiza e shtrirjes dhe natyrës së problemit – llogaritja e rrezikut
- Shqyrtimi i alternativave që qojnë në një metodë të pëlqyer – vlerësimi i alternativave
- Hartimi i detajuar i projektit që qon në një specifikim tenderi – përgatitja për programin e pastrimit.
- Lidhja e kontratës dhe zbatimi i saj për pastrimin e mbetjeve

Disa prej këtyre hapave tashmë janë ndërmarrë për sa i përket mbledhjes së mbeturinave por ka ende për tu bërë. Parimi bazë që duhet të respektohet është që toka dhe trupat ujor të ndotur duhet të rikthehet në gjendjen e mëparshme sipas përdorimit të planifikuar. Hapat që duhet ndërmarrë:

- Vetëdijësimi i qytetarëve për aktivitetet jo legale dhe pasojat
- Shtrirja e aktivitetit të Kompanisë për në vendbanimet e mëdha si dhe ndarja në faza deri sa të mbulohet i tërë territori i komunës
- Mënjanimi dhe grumbullimi i të gjitha mbetjeve ilegale
- Hartimi i rregullores komunale në bazë të Ligjit për Mbrojtje të mjedisit dhe funksionalizimi i Inspektoratit të Mjedisit në gjëritjen e veprimeve ilegale mjedisore.

Objektiv	NR	Projektet	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 1. Parandalimi dhe largimi i mbeturinave ne trupat uhor dhe mjedise tjera	A1	Rritja shpenzimeve dhe teknologjisë për mbledhjen e mbeturinave	K. Komunal dhe Zyra Regjionale	ZRM-, Komuna Inspektorati i mjedisit	E vazhduar	Buxheti Komunal,Zyra regjionale dhe Donatoret	50000 (përafërsisht)
	A2	Vënë në funksionim procesin e riciklimit të mbeturinave	Zyra regjionale e mbeturinave dhe partneriteti privat	Zyra regjionale e mbeturinave dhe partneriteti privat	**	Buxheti Komunal,Zyra regjionale dhe Donatoret	
	A3	Vazhduar rehabilitimin e sipërfaqeve me mbetje ilegale dhe mënjanimin e tyre në tërë komunën në masat tokësore dhe në mjediset ku trupat uhor kanë shtrirje	Qeveria lokale, ZRM partneriteti privat MMPH- mbështetëse e projekteve	Qeveria lokale ,ZRM partneriteti privat MMPH mbështetëse e projekteve	***	MMPH,Qeveria lokale dhe donatoret	130000
	A4	Studimi i mundësive për hapjen e impianteve për riciklim të mbeturinave dhe Sigurimi i Partneritet Privat-Publik për përpunimin e riciklimin e mbeturinave	MMPH,ZRRUM ZRM, K. Komunal	ZRRUM MMPH,ZRRUM, ZRM K. Komunal	***	Qeveritë: komunale dhe Kosovës, Donatoret partneriteti privat	
	A5	Iniciativa fiskale për sjellje miqësore ndaj mjedisit për krijimin e një eko-fondi	Kuvendi Komunal	Drejtori për mjedis	*	Taksa ekofond	taksa vjetore 10000-15000

	A6	Vazhduar mbjelljen e pemëve dhe shtimin e hapësirave të gjelbra	Qeveria komunale	Qeveria komunale komuniteti	Vazhdon procesi	komuna, komuniteti I biznesit donatoret	20000
	A7	Hartimi i rregullorës në bashkëpunim me MMPH për ruajtjen e hapësirave të hapura, bukurive natyrore	Qeveria komunale	Inspektorati komunal	*	Komuna - inspektorati komunal	1000
	A8	Marrë masa për rehabilitimin e zonave të ndotura të mjedisit dhe hapjen e zonave të reja	Qeveria komunale	Inspektorati komunal	***	komuna, komuniteti I biznesit donatoret	10000
	A9	Edukim mjedisor nga subjektet e kontraktuara dhe nga OJQ-të Mjedisore	Drejtorja e Arsimit dhe Drejtorja e mjedisit MMPH dhe MASHT	Drejtorja për arsim dhe mjedisit	**	K. Komunal, komuniteti I biznesit ZRM	5000
	A10	Shtirja e aktivitetit të kompanisë për pastrim në tërë territorin e komunës	Qeveria lokale	ZRRM	**	Qeveria komunale	10000
	A11	Hartimi i Planit i lokal për veprim në mjedis	Qeveria lokale, MMPH, OJQ	Qeveria komunale komuniteti	*	Qeveria komunale	1500

Pjesë e synimit të parë është edhe e masave që duhet ndërmarr me projekte konkrete për *Lumenj të pastër - Parandalimi i hedhjes së mbeturinave në lumenj*

Sfidë e madhe në tërë Republikën e Kosovës por edhe në Komunën e Rahovecit është hedhja e mbeturinave të amvisërisë dhe ato të tjera në shtretërit e lumenjve ku pasojat janë shumë të mëdha për ujërat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësorë, si dhe për botën bimore dhe shtazore.

Mbeturinat e ngurta (materiale ndërtimore), mbetjet e plehrave shtëpiake, mbetjet e amvisërisë etj. janë ndotësit shumë të mëdhenj. Nëpër çdo vendbanim ku lumenjtë kalojnë janë vërejtur dukuri të tilla negative.

Hapat që duhet të ndërmirën janë:

- Pastrimi i shtretërve të lumenjve
- Kontroll rigoroze nga inspektorati Komunal dhe pajisja e tyre me mjete të nevojshme.
- Angazhimi i aksionit vullnetar për pastrim të mbeturinave në lumenjë që janë brenda territorit të komunës organizuar nga OJQ-të mjedisore dhe Komuna, Drejtoria e Arsimit si dhe nga vet Komuniteti për vetëdijesim për ujëra.
- Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe ligjeve në fuqi nga inspektorati si dhe zbatimi i dënimeve për ndotësit.

Objekti vi	N R	Aktiviteti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Lumenj të pastër - Parandalimi i hedhjes së mbeturinave në lumenj	A1	Pastrimi i shtretërve të lumenjve që shtrihen në komunën e Rahovecit	MMPH, Komuna, Komuniteti, OJQ-ët etj	MMPH dhe Komuna	E vazhdua r	Qeveria e Kosovës dhe Komuna	40000 - 50000
	A2	Kontroll rigoroze nga inspektorati Komunal dhe pajisja e tyre me mjete të nevojshme .	K. Rahovec	Inspektorat i komunal dhe ai I MMPH	**	Buxheti Komunal, dhe MMPH	2000 euro ne vit
	A3	Angazhimi i aksionit vullnetar për pastrim të mbeturinave nga lumenjve dhe mbetjeve të ndryshme ne mjediset e ndotura organizuar nga OJQ-ët mjedisore dhe Komuna, Drejtoria e Arsimit si dhe nga vet Komuniteti, si dhe vetëdijesim për ujëra	MMPH, Komuna, Komuniteti etj	Qeveria lokale ,ZRM partneriteti privat MMPH mbështetës e e projekteve	**	MMPH, Qeveria lokale dhe donatoret	10000
	A4	Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe ligjeve ne fuqi nga inspektorati si dhe zbatimi i dënimeve për ndotësit.	Komuna dhe MMPH	Drejtoria për çështje mjedisore	*	Qeveritë komunale, Qeveria e Kosovës, Donatoret dhe partneriteti privat	5000

S2. Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale në Lumenj si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza

Sigurimi i mundësisë së furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë banorët si dhe ruajtja e të gjitha burimeve ujore mbi dhe nën tokësore konsiderohen ndër prioritetet kryesore. Kërkesat për një administrim të mirë të ujit, pa dëmtuar mjedisin, janë komplekse dhe mjaft të vështira si nga aspekti teknik ashtu edhe nga ai financiar.

Duke pasur parasysh varësinë e madhe nga uji i nëntokës, për sigurimin e ujit të pijshëm, është shumë e rëndësishme të mbrohen burimet e ujit nëntokësor si nga ndotja ashtu edhe nga shfrytëzimi i tepërt.

Rahoveci ka një rrjet hidrografik të pasur edhe pse sasi të janë të mjaftueshme për nevojat aktuale. Cilësia e tyre shpesh është problem për shkak të ndotjes, sidomos në zonat ku jetojnë pjesa më e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen aktivitetet kryesore. Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore është pasojë e të gjitha veprimtarive aktuale urbane, industriale dhe bujqësore. Ujërat e zeza urbane paraqesin problem të veçantë si pasojë e mungesës së trajtimit të tyre.

Pjesa më e madhe e qytetit, kombinon sistemet e kanalizimit të ujërave të zeza dhe mbledhjes së ujit të shirave që shkarkohen drejtpërdrejtë në ujin sipërfaqësor.

Ndotja e ujit nga aktivitetet si p.sh. pastrimi i automjeteve dhe servisi, mbetjet bujqësore, pesticidet e ruajtura keq apo të braktisura dhe kimikate të tjera, shkarkimi i ujërave të zeza në trupat ujor pa trajtim paraprak ndikojnë në cilësinë e dobët të ujit. Presione të tjera përfshijnë ndërtimet e pakontrolluara, ndotja dhe eutrofikimi që vjen nga ujërat e zeza të pa trajtuara që shkarkohen në lumenj dhe nga rrjedhja e plehrave kimike dhe pesticideve nga toka bujqësore në drejtim të lumenjve, rrëshqitje dhe gërryerje të tokës, praktikatat e gjuetisë në dëm të mjedisit etj.

Masat e parapara në këtë strategji:

- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në të gjitha zonat e banimit
- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanimet rurale,
- Përcaktimi i lokacionit varësisht se cili opsion është i përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza
- Ndarja e kanalizimit fekale nga ai i shirave
- Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza në përputhshmëri me standardet
- Identifikimi i lokacionit më të përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza në afërsi të fshatit Krushës

Te gjitha implikimet buxhetore janë paraparë në Infrastrukturë. Këto rekomandime janë konform rregullave mjedisore .

Synimi 3. Ndërmarrja e masave anti-erozive

Duke marr parasysh konfiguracionin e terrenit sipërfaqet e komunës janë të predispozura erozionit si pasojë edhe të faktorëve tjerë përveç asaj të pjerrtësisë së terrenit: Bimësia, pyjet, reshjet, faktori njeri siç janë shfrytëzimi i pa kontrolluar i pyjeve, inerteve etj, gjendja e tokave është e rëndësishme për bujqësinë, pylltarinë dhe biodiversitetin. Ato janë të rëndësishme për ekonominë, shëndetin publik dhe

turizmin. Dy janë problemet gjenerale më kryesore dhe më shqetësuese: Erozioni dhe prishja e cilësisë së tokës.

Erozioni është procesi natyror i veprimit të ujit dhe erës mbi tokën. Megjithatë, shkalla e erozionit mund të rritet shumë nga aktivitetet e papërgjegjshme të njeriut. Niveli i lartë i erozionit paraqet një sërë problemesh që janë të pranishme sot në Komunën e Rahovecit.

Në bazë të analizave propozohen masat antierozive:

- o Ndërtimi i brezave mbrojtës në shpatet e rrëpishme
- o Ndërtimi i mureve rrezistuse
- o Meliorimi i Kullosave
- o Meliorimi i pyjeve
- o Ndërtimi i formave tjera antierozive

Kostoja financiare për masat antierozive është shumë e lart nga se duhet të intervenohet në sipërfaqe prej 1400ha dhe duhet të intervenohet për parandalimin eroziv.

Pasojat:

- Prishja e cilësisë së tokës dhe humbja e pjellorisë
- Dalja e ujit nga shtretërit e lumenjve
- Është shtuar rreziku i rrëshqitjeve të tokës dhe humbjes së saj;
- Depozitimi i sedimenteve në lumenj, që ndryshon rrjedhën e tyre natyrore dhe problemet ekologjike;

Degradimi i pyjeve, mbi kullotja, zhdukja e sipërfaqeve me drunj dhe atyre frutore dhe ndërtimet, e sidomos i rrugëve, kanë zvogëluar sipërfaqet me bimësi dhe si pasojë rrisin erozionin.

Kontrolli i erozionit është kërkesa kryesore, e shoqëruar nga praktikrat e administrimit të baseneve të lumenjve dhe të cilat ulin efektet negative të transportimit dhe depozitimit të sedimenteve.

Në rastin e erozionit është bërë një dallim mes erozionit në zonat e larta malore dhe erozionit në zonat e ulëta fushore. Edhe pse kjo “ndarje” nuk është aspak e përsosur ajo duhet kuptuar si e tillë, që përfshin një dallim mes zonave me pjerrtësi të madhe dhe zonave me pjerrtësi më të vogël. Të parat, në përgjithësi përfshijnë zona pyjore kurse të fundit janë kryesisht bujqësore.

Masat që kërkohet të ndërmerren përfshijnë:

- Masat hidroteknike
- Masat bujqësore
- Masat biologjike

Ruajtja e cilësisë së tokës – Ndërtimet e pa kontrolluara, mbetjet e amvisërisë, mbetjet ndërtimore, mbetjet industriale, përdorimi jo i drejtë i plehrave kimike dhe pesticideve, mënyra e përdorimit të tokave, shkarkimi i ujërave të zeza, fatkeqësitë natyrore siç janë vërshimet etj. ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e tokës.

Duke marr parasysh një varg problemesh që shkaktohen nga faktori njeri duhet marr masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes nëpërmjet eksperteve të fushave bujqësore.

Masat parandaluese;

1. Organizimi i seminareve nga fusha e bujqësisë
2. Kontrolli i mbetjeve të natyrave të ndryshme
3. Kontrolli përdorimit të plehrave dhe pesticideve
4. Kontrolli dhe mënyra e përdorimit të tokave

Objekti	Nr .	Aktiviteti	Akterët vendimmarës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 4. Ndërmarrja e masave anti-erozive	A1	Anit erozioni-Kostoja financiare për masat anti erozive eshtë shumë e lart nga se duhet te intervenohet në sipërfaqe prej 1400 ha duhet të intervenohet për parandalimin eroziv.	MMPH Komuna,Komuniteti etj	MMPH dhe Komuna	E vazhduar	Qeveria e Kosovës K. Komunal	Çmimet ndryshojnë varësisht nga studimet në teren
	A2	Organizimi i seminareve nga fusha e bujqësisë në përdorimin e tokave që kanë pjerrtësi dhe janë të zhveshura apo edhe djerrina si dhe mënyra e drejt e punimit të tyre	K. Komunal MBPZHR	Drejtoria e bujqësisë MBPZHR	**	Buxheti Komunal, MBPZHR donatoret	5000 euro ne vit
	A3	Parandalimi i prerjeve ilegale te pyjeve	Agjencioni i pyjeve dhe pushteti lokal	Agjencioni i pyjeve dhe pushteti lokal,polici a gjykatat etj	vazhdue shum	Bugjeti komunal MBPZHR	
	A4	Kontrolli përdorimit të plehrave dhe pesticideve si dhe Kontrolli dhe mënyra e përdorimit të tokave	K. Komunal MBPZHR	Drejtoria për bujqësi	*	Kuvendi Komuna MBPZHR	5000

	A5	Plani zhvillimor rural ne nivel komunal per tokat e kategoris I-IV	Komuna MBZHR	Drejtoria per bujqësi	*	MMPH, MBPZHR, KOMUN A	80000
--	----	--	--------------	-----------------------	---	-----------------------	-------

Synimi 4. Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve

Komuna me kapacitetet e veta dhe në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Departamentin e ujërave, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës) duhet të ndërmarrë masat vijuese hidrologjike, në mënyrë që të parandalojë apo të zvogëlojë ndikimet nga rreziku i vërshimeve:

- Largimi i barrierave nga shtrati i lumenjve, qofshin ato natyrale apo të krijuara nga njeriu
- Të bëhet meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve si masa parandaluese
- Ndërtimi i kanaleve dhe / ose mureve mbrojtëse
- Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos për ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet.
- Komuna do të ndërmarrë masat përkatëse për mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve. Prerja e domosdoshme do të lejohet në zonat ku ato do të mund të shkaktonin ndikime negative. Komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e vlerave peizazhore të brigjeve të lumenjve përmes mbjelljeve dhe veprimeve për rregullim peizazhor për rekreim, si modelimi i terrenit dhe mbjellja e barit.
- Kontrollimi i eksploatimit të zhavorrit nga shtrati i lumenjve aty ku ka licencë për eksploatim, si dhe ndëshkimi i operatorëve ilegal të bëhet nga Inspektorati komunal me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujit, shkatërrimit të botës shtazore të lumenjve dhe dëmtimeve të shtratit që mund të shkaktojnë vërshime.
- Çdo ndryshim i rrjedhës së lumit do të ndalohet nga komuna dhe veprimet që mund të çojnë deri në rritjen e rreziqeve nga vërshimet do të kontrollohen në mënyrë strikte.

Parashikimet e kostos financiare janë në strategjinë: Synimi 2. Lumenj të pastër - Parandalimi i hedhjes së mbeturinave në lumenj, Aktiviteti: A1 minus aktivitetet S5 A1 A2 sa i përket kostos materiale. Ndërsa aktivitetet e parapara duhet zbatohen në përpikëri në hapësirë dhe kohë të caktuar gjatë periudhës së implementimit të PZHK

i	N R	Aktiviteti	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 5. Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve	A1	Largimi i nga shtretërit e lumenjve barrierat natyrale apo të krijuara nga njeriu	K. Komunal, MPMS, MMPH, Komuniteti	K. komunal, MMPH	**	Buxheti Komunal i Kosovës	50000
	A2	Të bëhet meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve si masa parandaluese të vërshimeve dhe të parandalimit të erozionit	Drejtoria e Bujqësisë, MBPZHR, MMPH dhe Inspektorati Komunal	Drejtoria e Bujqësisë MBPZHR MMPH Inspektorati Komunal	**	Buxheti Komunal dhe buxheti I Kosovës	60000
	A3	Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos për ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet	Drejtoria e Bujqësisë, MBPZHR dhe Inspektorati Komunal	Drejtoria e Bujqësisë, MBPZHR dhe Inspektorati Komunal	**	Buxheti Komunal dhe buxheti I Kosovës	40000
	A4	Komuna do të ndërmarrë masat përkatëse për mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve. Prerja e domosdoshme do të lejohet në zonat ku ato do të mund të shkaktonin ndikime negative. Komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e vlerave peizazhore të brigjeve të lumenjve përmes mbjelljeve dhe veprimeve për konstruktive peizazhore për rekreim si modelimi i terrenit dhe mbjellja e barit.	A2	A2	**	Buxheti Komunal dhe buxheti I Kosovës	A2
	A5	Kontrollimi i eksploatimit të zhavorrit nga shtrati i lumenjve aty ku ka licencë për eksploatim si dhe ndëshkimi i operatorëve ilegal të behët nga Inspektorati komunal me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujit, shkatërrimit të botës shtazore lumore dhe dëmtimeve të shtratit që mund të shkaktojnë vërshime.	K. Komunal	Inspektorati Mjedisor Komunal dhe Inspektorati mjedisor pran MMPH	*	Buxheti Komunal dhe buxheti I Kosovës	10000

Synimi 5. Shfrytëzimi racional i zhavorrit dhe gurthyeshve për një zhvillim të qëndrueshëm

Shfrytëzimi i shkëmbijve dhe zhavorrit në komunën e Rahovecit është prezentë sidomos në eksploatimin e inerteve si dhe gurthyeshve

Hapat që duhet ndërmarr:

- Operatorët duhet të pajisen me leje adekuate për eksploatim
- Përgatitja e elaboratit për shfrytëzim
- Taksimi për fondin mjedisor
- Rikthimi i gjendjes së më parme të sipërfaqeve të eksploatuara me metodën e rikultivimit të zonës
- Parandalimi i operatorëve ilegal
- Parandalimi i eksploatimit nga operimet ilegale

Për të gjitha këto aktivitete duhet ndërmarrë masa rigoroze si dhe fuqizimin e inspektoratit komunal për mjedis në zbatimin e aktiviteteve të parapara në PZHK.

Objektivi	Nr	Aktiviteti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 6. Shfrytëzimi racional i mineraleve për një zhvillim të qëndrueshëm	A1	Fuqizimi inspektoratit si dhe trajnimi i stafit për mënyrat e shfrytëzimit racional	Inspektorati Mjedisor Komunal	Inspektora ti Mjedisor Komunal	*	Buxheti Komuna l	55000
	A2	Rikultivimi i zonave të degraduara	MMPH, MPL, MPMS, Komuna, Donator, Komuniteti	MMPH, MBPZHR, KOMUNA	***	Buxheti Komuna l dhe buxheti i Kosovës	320000
	A3	Parandalimi i operatorëve ilegal	Inspektorati Mjedisor Komunal	Inspektora ti Mjedisor Komunal	*	Buxheti Komuna l	12000
	A4	Krijimi I fondit mjedisor (donator, shfrytëzuesit e mineraleve, komuniteti)	K. Komunal	K. Komunal	**	Buxheti Komuna l	5000

Synimi 6. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Komuna e Rahovecit ka vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ku në bashkëpunim me institucionet vendimmarrëse të Republikës së Kosovës ti vë nën mbrojtje dhe të njëjtat të shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit.

- Komuna së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të ketë efekte negative ndaj këtyre vlerave.
- Në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrin e Kulturës Rinisë dhe sporteve të hartoj planin rregullues për trashëgimin historike të Hoqës me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimis historike-kulturore
- Komuna në bazë të kërkesave të përpiloj planin rregullues për pikën turistike në gjeomonumentin „Kanjoni i urës së fshejt “
- Komuna në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të hartoj planet rregulluese për bregun e lumit si hapësirë publike që të mbrojë vlerën e peizazhit lumit „Drini i Bardhë“
- Komuna në bashkëpunim me MKRS, të inicioj me akt të veçantë vënien nën mbrojtje të lokaliteteve arkeologjike.
- Restaurimi i objekteve kulturo-historike
 - Pjesës së vjetër e qytetit - kërkohet ruajtja e bërthamës së qytetit.
 - Restaurimi dhe mirëmbajtja e Teqesë Halveti
 - Përmbledhje e këngëve të Sheh Maliqit,-Publikimi i këtyre përmbledhjeve në Katalogun turistik të qytetit (forma e shkurtuar)
 - Përmbledhje e dorëshkrimeve Sheh Ilmi Maliqit, Publikimi i këtyre përmbledhjeve në Katalogun turistik të qytetit (forma e shkurtuar)
 - Restaurimi ,mbrojtja dhe ruajtja e Objekteve të trashëgimis ortodokse si dhe urbanizimi i vendbanimit Hoqe e Madhe me qëllim të ruajtjes së vlerave
- Të përpilohet katalogu i hartave për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për nevojat e turizmit në nivel komunal.

Objektivi	NR	Aktiviteti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 7. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore	A1	Komuna, se bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sporteve, duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të afektoj vlerat e monumenteve.	K. Komunal, MMPH, MKRS	K. Komunal	*	B. Komunal	3500
	A2	Në bashkëpunim me MMPH dhe komunën e Gjakovës të hartoj planin rregullues për piken turistike Ura e Fshejt	K. Komunal, MMPH	K. Komunal, MMPH	**	B. Komunal MMPH	35000
	A3	Komuna të hartoj planin rregullues për zonen historike të Hoqes së Madhe duke rrespektuar: Ligji Nr. 03/L-039 PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA	K. Komunal, MMPH, MKRS	K. Komunal, MMPH, MKRS	**	B. Kosovës	35000
	A4	Komuna në bashkëpunim të ngushtë me MMPH-në do të hartoj planet rregulluese për bregun e lumit si hapësirë publike që të mbroj vlerën e peizazhit të lumit Drini i Bardhë	K. Komunal dhe MMPH	K. Komunal dhe MMPH	**	B. Komunal dhe MMPH	40000
	A5	Komuna në bashkëpunim me MKRS, të inicioj me akt të veçantë duhet ti vë nën mbrojtje: lokalitete arkeologjike. Në mbrojtje duhet ven edhe të gjitha monumentet historike e ushtarake të luftës UÇK	K. Komunal dhe MKRS	K. Komunal dhe MKRS	**	B. Komunal dhe MKRS	5000

	A6	- Restaurimi i objekteve kulturo-historike - Restaurimi e pjesës së vjetër e qytetit - kërkohet ruajtja e bërthamës së qytetit. - Restaurimi dhe mirëmbajtja e Teqesë Halveti - Përmbledhje e këngëve të Sheh Maliqit,- Publikimi i këtyre përmbledhjeve në Katalogun turistik të qytetit (forma e shkurtuar) - Përmbledhje e dorëshkrimeve Sheh Ilmi Maliqit, Publikimi i këtyre përmbledhjeve në Katalogun turistik të qytetit (forma e shkurtuar) - Restaurimi ,mbrojtja dhe ruajtja e Objekteve të trashëgmisë ortodokse si dhe urbanizimi i vendbanimit Hoqe e Madhe me qëllim të ruajtjes së vlerave	K. Komunal dhe MKRS	K. Komunal dhe MKRS	**	B. Komunal dhe MKRS	Është paraparë kostoja financiare në PZHU
	A7	Të përpilohet katalogu turistik për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore	K. Komunal	K. Komunal	**	B. Komunal dhe MKRS	15000
	A8	Bashkpunimi i ngusht me MMPH në hartimin e Planit Hapësinor „Ujvarat e Mirushes”	MMPH	MMPH	*	Ska shpenzime komuna	

Synimi 7. Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve.

Llojlojshmëria e ekosistemeve dhe habitateve përfshin ato malore, fushore, lumenjve, shkurret, pyjet gjetherënëse, halore dhe të përziera, kullotat, livadhet dhe zonat e larta malore.

Tërë ky vegjetacion ofron larmi të pasur speciesh në bime dhe kafshe.

Shumëllojshmëria është pasqyrim i gamës së gjerë të peizazheve që nga malet e larta tek fushat. Edhe pse informacioni i hollësishëm mbi speciet është i kufizuar, mendohet se në territorin e komunës gjenden të gjitha speciet e florës Kosovare dhe një llojlojshmëri të faunës.

Kjo shumëllojshmëri bimore dhe shtazore nuk është mbrojtur në nivelin e duhur nga njeriu dhe moskujdesi ndaj tyre ekziston edhe sot e kësaj dite. Edhe pse praktikrat bujqësore kanë mundësi të jenë më pak dëmtuese në raport me të kaluarën, modelet e tanishme të zhvillimit ekonomik dhe fizik përbëjnë një kërcënim madhor në shumë zona.

Problemet thelbësore janë praktikrat e papërshtatshme të ndjekura në zonat malore, sidomos shpyllëzimi si dhe degradimet mjedisore si pasojë e eksploatimit të rërës, zhavorrit, guroret etj.

Problemet lidhur me administrimin e pyjeve janë identifikuar qysh në fillim të viteve 1990. Këto probleme janë duke u trajtuar kohet e fundit nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës si dhe me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale ku nevojat e decentralizimit dhe nevoja për administrim më të mirë ja ka kaluar pronësinë e pyjeve pushtetit vendor, me kusht që të hartojnë e të marrin masa për zbatimin e Planeve për Administrimin efikas.

Masat që duhet ndërmarr komuna:

- Në bashkëpunim me MBPZHR/ Agjencionin e pyjeve të ndërmarr masa strikte për parandalimin e prerjeve ilegale.
- Në bashkëpunim me njësinë Zjarrfikëse, ShPK, FSK, Njësinë e Ujësjiellit, Agjencionin e pyjeve dhe të gjithë faktorët relevant të krijohet shtabi i emergjencës në rast të paraqitjes së zjarreve në pyje.
- Të bëhen vlerësime nga ekspertet e pylltarisë për nevojat e rrallimit dhe prerjes sanitare të pyjeve në mënyrë që shfrytëzimi i pyjeve do të plotësojë nevojat e qytetarëve
- Hartimi i planeve menaxhuese të pyjeve për periudha afatgjate.

Synimi 8. Ripyllëzimi i hapësirave të zhveshura dhe krijimi i brezave të gjelbëruar

Sipërfaqet e zhveshura në territorin e komunës janë prezentë sidomos në lartësitë mbidetare mbi 700m ku edhe aktiviteti eroziv është më i theksuar.

Masat që duhet ndërmerren për ruajtjen e këtyre zonave dhe peizazheve të mbetura e të cilat mbrohen me ligj, për qëllime argëtimi, çlodhjeje e turizmi por edhe për ruajtjen e biodiversitetit janë:

- Ripyllëzimi ose ripërtëritja e kullosave të sipërfaqeve që kanë pjerrtësi më shumë se 15%

- Sipërfaqet e identifikuar me erozion të mesëm, të lartë dhe shumë të lartë të pyllëzohen.
- Krijimi i brezave të gjelbër për gjatë shtretërve të lumenjve është masë parandalues erozive.
- Hulumtimet e tokës dhe përshtatja e fidanëve për pyllëzim dhe ripyllëzim.
- Krijimi i brezit të gjelbër përreth zonës industriale.

Objekti	Nr	Aktiviteti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Synimi 8. Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve	A 1	Parandalimi i prerjeve ilegale të pyjeve	Komuna ,APK	Rojet e pyjeve	*	Buxheti Komuna l dhe I MBZHR _APK	55000
	A 2	Rikultivimi i zonave të degraduara	MMPH, MPL, MPMS, Komuna, Donator, Komuniteti	MMPH, MBPZHR, KOMUNA	***	Buxheti Komuna l dhe buxheti i Kosovës	320000
	A 3	Hartimi i planeve menaxhuese të pyjeve në nivel komunal	MMPH, MPL, MPMS, Komuna, Donator, Komuniteti	MMPH, MBPZHR, KOMUNA	***	Buxheti Komuna l dhe buxheti i Kosovës	40000
	A 4	Krijimi i Task Forces për mbrojtje nga zjarri ,uji,rrëshqitjet etj	Komuna,SHPK, FSK,Sherbimi i zjarrfikësve dhe komuniteti	Komuna	I vazhdueshëm	Komuna	

IV.4. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Në këtë kaptinë do të elaborohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të komunës së Rahovecit ku në mënyrë skematike do të paraqitet mënyra se “SI” do të mbërrihet deri tek objektivat e caktuara për zhvillim, për të plotësuar synimet e përgjithshme për një vizion të përbashkët për komunën e Rahovecit.

Kjo strategji e zhvillimit hapësinor të paraqitur skematikisht në katinën e mëhershme si koncept do të elaborohet për specifikimit të objektivave, projekteve, masave dhe veprimeve të cilat do të ndikojnë dhe shtyejnë drejt zhvillimeve të përcaktuara.


Pas testimit të tri alternativave zhvillimore, sipas koncepteve zhvillimore në hapësirë: zhvillimi monocentrik, korridorral dhe policentrik me tendencë baraspeshe zhvillimore, është arritur deri tek rekomandimi për opsionin e tretë të zhvillimit multinodal apo policentrik me primesa të zhvillimit të baraspeshuar në komunën e Rahovecit.

Përparësitë dhe mangësitë e të trija koncepteve, janë analizuar, diskutuar dhe vlerësuar dhe është arritur deri tek konstatimet që sollën rekomandimin e lartëcekur për zhvillimin multinodal, të kontrolluar hapësinor, me tendencë të efekteve pozitive maksimale socio ekonomike në tërë territorin e komunës së Rahovecit.

Natyrisht se tendencat për këtë koncept zhvillimi, do të stimulohen përmes veprimeve dhe vendimeve të komunës porse dhe zhvillimet e padëshiruara do të monitorohen, mundësohet të minimizohen dhe/ose mënjanojnë. Kjo me qëllim të shmangies posaqërisht të zhvillimit korridorral i cili për nga primesat është me më së shumti pasoja negative për zhvillimin bujqësor, ndotjet dhe degradimet në hapsëirë.

Koncepti i zhvillimit nodal (në qendra, pika të caktuara)) nënkupton koncentrimin e zhvillimit të ardhshëm në tri qendrat e mëdha të komunës së Rahovecit, (Rahovec, Ratkoc dhe Krushë e Madhe) porse dhe në qendrat e mesme (Xërxë) të cilat në mënyrë hierarkike përmbledhin zhvillimet nga vendbanimet më të vogla rurale dhe shërbejnë si urë për qendrat më të mëdha.

Zhvillimet hapësinore përgjatë rrugëve e që paraqesin konceptin e korridorit, rekomandohet të monitorohen/kontrollohen duke mos lejuar degradimin e tokave bujqësore të kategorive I deri IV, përmes ndërtimeve dhe zhvillimeve tjera të paplanifikuara.




Skema e orientimeve zhvillimore të komunës së Rahovecit

Rritja ekonomike e komunës së Rahovecit garanton dhe mundëson sigurimin e të ardhmes së qëndrueshme për komunën, shërbimeve arsimore dhe shëndetësore më afër qytetarit. Forcimi i bujqësisë dhe industrisë përpunuese si sektorë të fortë për të promovuar zhvillimin e balancuar në kontekstin urban-rural, rehabilitimin e industrisë së rëndë (xehetari dhe industri përpunuese të metaleve) në favor të zhvillimit më të fuqishëm ekonomik, rritjen e konkurrencës në tregun rajonal përmes shërbimeve efikase tregtare, promovim dhe forcim të turizmit si sektor me rëndësi për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të komunës së Rahovecit është me rëndësi të veçantë të përcaktohen zonat ekonomike dhe hapësirat përkatëse për zhvillimin e veprimtarive të caktuara. Përmes këtij plani komunal, parashihen këto lokacione ku do të zhvillohen aktivitete të shumëllojshme ekonomike dhe gjithashtu këto zona paraqesin hapësirë të mjaftueshme për periudhen e paraparë kohore. Në kuadër të këtyre zonave janë paraparë këto lokacione të shënuara në tabelë dhe të paraqitura në hartë.

	Emri i zonës	Sipërfaqet ne ha
1	Industri_tregti	25.6

2	Zonë tregtare	34.5
3	Zonë Industriale	152
4	Zonë turistike	419
5	Zonë ekonomike	344
6	zgjerrim I vendbanimit Krushe e Madhe dhe Bellacerke	196
7	Shiriti mbrojtës Xerxe	34.6
8	Potencial i zones Industriale	16.5
9	Banim individual Opterushe	80.5



Një ndër fushat me të cilat ngarkohen komunat me Ligjin Nr. 03/L-040- për vetëqeverisjen lokale është edhe ajo që ato janë përgjegjëse për krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillim ekonomik lokal, me të cilën dhe komuna e Rahovecit do të duhej ta hartojë. Komuna e Rahovecit në parim ka të drejtë dhe obligim për zhvillimin ekonomik lokal, dhe se ajo do të duhej t'ë ofrojë më shumë mjedisit për biznese.

Edhe pse politikat e veçanta për nxitjen e investimeve vendase, por edhe atyre të huaja, i takojnë nivelit qendror (taksat, tatimet, doganat), komuna e Rahovecit do të duhej që të zhvillojë proceduara sa më të thjeshta në mënyrë që sadopak t'i mbështesë bizneset.

Pushteti lokal I komunës së Rahovecit rekomandohet të vazhdojë në krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e bizneseve, përderisa udhëheqësit komunal të synojnë thjeshtësimin e procedurave për marrjen e lejeve për fillimin e bizneseve të reja, ndërtimin e infrastrukturës komunale, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, dhe aplikimin e ngarkesave fiskale që janë të përballueshme për bizneset.

Zyrtarët e komunës së Rahovecit rekomandohet të bashkëpunojnë më tepër me projektet e jashtme që tangojnë dhe komunën²⁷, duke tentuar mbledhjen dhe shkëmbimin e përvojave të shumta në regjion dhe shtet, zbatimin e strategjive për zhvillimin ekonomik lokal.

Sipas dispozitave për synime dhe objektiva bazuar në gjendjen ekzistuese, mundësitë për zhvillim të komunës së Rahovecit janë:

- S1) Zhvillimi i bujqësisë dhe prodhimeve bujqësore
- S2) Zhvillimi i prodhimtarisë vreshtare dhe plasim i sigurtë në tregun Evropian dhe më gjërë
- S3) Zhvillimi i turizmi bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore,

Për të vazhduar me objektiva dhe projekte:

S1.O1. Mbështetje në aspekt financiar në krijimin e konkurrencës me prodhime finale bujqësore për tregun Evropian dhe më gjërë

- ✚ Mbështetje financiare fermerëve në përmirësimin e gjendjes së mekanizimit bujqësor dhe përdorim të metodave të reja shkencore në rritjen e prodhimtarisë,
- ✚ Mbështetje financiare fermerëve në përpunim të prodhimeve bujqësore,
- ✚ Mbështetje financiare fermerëve në shtimin e fondit blegtoral, si dhe përmirësimi i racave të kafshëve me raca me potencial të lartë të prodhimit,
- ✚ Mbështetje financiare fermerëve në ngritjen e fidanishteve dhe pemishteve me pemë të ndryshme,
- ✚ Mbështetje financiare fermerëve në ngritjen e serave për kultivimin e perimeve (eliminimi i karakterit sezonal në prodhimtarin perimore), dhe kultivimin e luleve.
- ✚ Mbështetje financiare fermerëve në organizim për grumbullim dhe përpunim të prodhimeve blegtorale (pika grumbulluese të qumështit)

S1.O2. Mbështetje në aspekt institucional teknik dhe human në krijimin e konkurrencës me prodhime finale bujqësore për tregun Evropian dhe më gjërë

- ✚ Mbështetje financiare në ngritjen e kapaciteteve menaxheriale private përpunuese në bujqësi, industri ushqimore,
- ✚ Mbështetje institucionale OJQ-ve në stimulimin e të rinjve për ruajtjen dhe kultivimin e bujqësisë;
- ✚ Mbështetje institucionale në zgjidhjet e pronësisë mbi tokën në komunën e Rahovecit

²⁷ Projekti DELTA

- ✚ Zgjerimi i sistemit të ujitjes (përfshirja e të gjitha sipërfaqeve komunale të tokës me ujtitje,
- ✚ Ngritja e depove bashkëkohore për ruajtjen e pemëve dhe përpunimit të tyre etj.
- ✚ Mbështetje institucionale në organizimin e bashkëpunimit efikas me prodhuesit bujqësorë të sektorit privat,
- ✚ Ofrimi i shërbimeve profesionale veterinare.
- ✚ Ngritja profesionale e fermerëve (organizimi i kurseve, trajnimeve për lëmit përkatëse të bujqësisë).

S2O1. Mbështetje për fermerët në krijimin e konkurrencës për prodhime finale të rrushit, sigurimin e kualitetit

- ✚ Mbështetje në ngritjen e vetëdijës në ruajtjen e shpirt ndërmarës, bazuar në traditën mijëvjeçare në kultivimin dhe përpunimin e rrushit dhe verës,
- ✚ Mbështetje financiare kultivuesve, fermerëve për kultivimin e rrushit,
- ✚ Mbështetje financiare në paisjen me teknologji adekuate në përpunimin e rrushit dhe verës,
- ✚ Mbështetje financiare në infrastrukturën fizike me mekanizëm për grumbullim deponim për ruajtje dhe përpunim të prodhimeve të rrushit dhe verës.
- ✚ Mbështetje institucionale në sigurimin e mekanizmit për eksport të prodhimeve bujqësore dhe vreshtare, verës.
- ✚ S2O2. Mbështetje në krijimin e konkurrencës për prodhime finale të rrushit, marketingut dhe eksportit
- ✚ Mbështetje financiare në krijimin e llogos unike të prodhimeve të Rahovecit/unifikimin për marketing,
- ✚ Mbështetje financiare dhe ofrim të lehtësirave për marketing jashtë shtetit të Kosovës për prodhimet e rrushit dhe të verës me brend unik.

S3O1. Mbështetje në zhvillimin e turizmit natyror, fshatar dhe ekologjik

- ✚ Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Ekonomik Lokal/Zhvillimit të turizmit për komunën e Rahovecit,
- ✚ Krijimi i imazhit vetanak, sistemit të informimit për komunën e Rahovecit,
- ✚ Bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar me komunat fqinje për zhvillime me interes të përbashkët zhvillimor në aspekt të turizmit (Gjakovë, Bajram Curr, etj)
- ✚ Hapja e Zyrës komunale për promovimin e zhvillimit të turizmit
- ✚ Mbështetje në ristrukturim dhe modernizim të ofertës së gjithëmbarshme turistike,
- ✚ Promovim i turizmit rekreativ të zonës së Rahovecit,
- ✚ Renovimi i kapaciteteve hoteljere dhe ngritja e standardit të tyre,

S3O2. Mbështetje në zhvillimin e turizmit kulturor

- ✚ Mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë arkitekturore/vernakulare; fetare për rritje ekonomike lokale
 - ✚ Ruajtja, mbrojtja dhe rehabilitimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe historike
 - ✚ Promovim i trashëgimisë kulturore të Hocës së madhe,
- Sa i përket ngritjes së kapaciteteve rekomandohet së pari;
- ✚ Aftësimi i zyrtarëve komunalë për hartimin e strategjive, projekteve dhe realizimit të tyre;
 - ✚ Krijimin e kanaleve të komunikimit dhe ndërtimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal dhe komunitetit të biznesit, pushtetit lokal dhe donatorëve;
 - ✚ Sensibilizimin e zyrtarëve komunalë për nevojat dhe brengat e komunitetit të biznesit;

✚ Krijimin e një ambienti miqësor për zhvillimin e NVMve;

Burimet e të hyrave komunale përcaktohen dhe me Ligjin për financat e pushtetit lokal NR. 03/L-049 me të cilën kuvendet komunale autorizohen që të nxjerrin buxhetin komunal i cili duhet të përmbajë planin për aktivitete dhe menaxhim ekonomik brenda vitit fiskal, duke përfshirë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimeve kapitale dhe të përgjithshme të komunës.

Në anën tjetër Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike parasheh që komunat të kenë pushtet mbi proceset buxhetore në komunë me adoptimin e standardeve unike të evidencës, raportimit dhe llogaridhënies, me mundësimin që menaxhimi i buxheteve komunale të jetë më i efektshëm dhe më transparent.

Të hyrat e veta komunat i realizojnë kryesisht nga këto burime:

- ✚ □ Tatimi në pasuri,
- ✚ □ Taksat administrative nga dhënia e licencave dhe pagesave të tjera që i cakton komuna,
- ✚ □ Të hyrat nga asetet e komunave
- ✚ □ Gjohat apo përqindja nga inkasimi i gjobave.

Komuna e Rahovecit rekomandohet të krijojë mjedis të përshtatshëm legjislativ dhe ekzekutiv në ofrimin e konkurrencës private në shërbim të qytetarëve, hapjen e tregut të shërbimeve publike në nivel lokal, por edhe në atë qendror ndaj konkurrencës që do të ndikonte në uljen e çmimeve dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore qytetarëve.

Megjithatë, me futjen e konkurrencës në treg në ofrimin e shërbimeve publike, pushteti lokal duhet të adoptojë edhe një numër të rregulloreve të cilat do të mbronin konsumatorët, siç janë normat maksimale të pagesës së atyre shërbimeve, standardet për cilësi dhe siguri, etj.

Rekomandimet

- ✚ Zhvillimi ekonomik lokal kërkon qartësimin dhe definimin e mëtejshëm të fushëveprimit dhe përgjegjësi të pushtetit lokal, shtimin e vazhdueshëm të efikasitetit të këtij pushteti në shumë fusha dhe ofrimin më të shpejtë dhe më cilësor të shërbimeve.
- ✚ Të vazhdojë ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të shërbimeve komunale për plotësimin më të mirë të kërkesave të qytetarëve;
- ✚ Zhvillimi i aktiviteteve dhe debateve profesionale për bartjen e shërbimeve më afër qytetarëve përmes decentralizimit të pushteti lokal mbi bazat e efikasitetit dhe racionalitetit;
- ✚ Ngritja e efikasitetit të shërbimeve publike përmes hapjes së tregut dhe konkurrencës së sektorit privat dhe rregullimit të standardeve të sigurisë dhe kontrollit të çmimeve me qëllim të mbrojtjes së standardit të qytetarëve;
- ✚ Shtimi i efikasitetit në menaxhimin e buxheteve komunale përmes ngritjes së nivelit të arkëtimit të tatimeve, sidomos atij në pronë, dhe racionalitetit të shpenzimeve publike;
- ✚ Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të administratës lokale me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore bizneseve;
- ✚ Ndërtimi i infrastrukturës së domosdoshme dhe sigurimi i zonave ekonomike të cilat do të nxitnin investimet vendore ekonomike dhe do të tërhiqnin investitorët e jashtëm.

Nga vlerat dhe atraksionet turistike që përbëjnë njërin nga komponentët më atraktive të ofertës turistike të Hocës së madhe::

- ✚ • *Trashëgimia e pasur dhe e shumëllojshme e monumenteve*

- Pasuria etnografike dhe folklorike
- Motivet interesante të mjedisit dhe peizazhet,

Sa i përket zhvillimit të ekonomisë turistike Rahovec janë rekomandohet :

- Përtëritja, revalorizimi i plotë, mbrojtja e potencialeve turistike dhe krijimi i imazhit të ri turistik,
- Ristrukturimi dhe modernizimi i ofertës së gjithëmbarshme turistike,
- Përzgjedhja dhe nxitja e zhvillimit të turizmit sipas kriterëve të hapësirave në dispozicion dhe cilësisë së tyre si resurse bartëse natyrore
- Nisma në respektimin e standardeve për mbrojtjen efikase të resurseve kulturore dhe natyrore,
- Nxitja e zhvillimit të rajoneve turistike me mundësi më të volitshme për zgjatjen maksimale të sezonit turistik dhe rritja e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve të ofertës turistike,

Në afat të shkurtër propozohen këto masa:

- Krijimi i imazhit
- Parandalimi i ndërtimit të pakontrolluar, të egër,
- Krijimi i sistemit të informimit,
 - Lidhja e kontratave për menaxhimin e resurseve kulturore turistike
 - Shkollimi i menaxherëve turistikë dhe zbatimi i metodave ndërkombëtare
 - Kooperimi me turoperatorë.

IV.5. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS

5.1. Rrjeti i rrugëve

Synimi 1. Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët –

Me qëllim të krijimit të mundësive për qasje të gjithë qytetarëve të Rahovecit në rrugë të asfaltuara të kualitetit të mirë është e nevojshme që të ndërmerren veprime konkrete në ngritjen e kualitetit të rrugëve në nivel të komunës. Për të realizuar këtë synim duhet që të ndërmerren këto masa:

1. Përmisimi i kualitetit të asfaltit në rrugët nacionale, përkatësisht rruga nacionale M9.1 Gjakovë - Klinë- Prishtinë është e nevojshme që të ketë kualitet të lartë të asfaltit duke filluar nga kufiri me komunën e Gjakovës e deri tek kufiri me komunën e Klinës , me gjatësi prej 6.2 km.
2. Përmisimi i kualitetit të asfaltit në rrugën regjionale nga gjithsejtë 64.3 km të rrugëve regjionale sa ka në komunën e Rahovecit, 60.5 km të tyre shtrihen në zonën e kopshtëve, ndërsa 3.8 km shtrihet në dy zonat tjera (Kodrina dhe Natyra). Përmisimi i kualitetit të rrugës regjionale në kuadër të këtyre rrugëve hynë rrugët regjionale: Rruga **R111** , Xërxë –Ratkoc-Kramovik, Rruga **R117** , Rahovec-Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë, Rruga **R204**, Rahovec – Krushë e Madhe.

Rrugët lokale – Pozita gjeografike e komunës i ka mundësuar një lidhje shumë të mirë të disa vendbanimeve nëpërmjet rrugëve regjionale, si dhe prioriteti i qeverisë lokale deri më tani ka qenë asfaltimi i rrugëve që lidhin vendbanimet, prandaj në këtë kategori të rrugëve është e nevojshme që të bëhet asfaltimi i disa rrugëve lokale brenda vendbanimeve, me qëllim që të iu mundësoj një numri të konsiderueshëm të qytetarëve qasje direkt në rrugë të asfaltuara. Vendbanimet të cilat kanë nevojë që të kenë rrugë të asfaltuara janë:

Tabela 49. Asfaltimi i rrugëve në të ardhmen

Vendbanimi	Statusi ne te ardhmen	Gjatësia_km
Sarosh – Kaznik	Asfalt i ri	3.8
Ratkoc-Baboc-Pastasel	Asfalt i ri	3.3
Celinë – Rahovec	Asfalt i ri	4.8
Tranziti afer qytetit të Rahovecit	Asfalt i ri	2.8
Bellacerkë – Celinë	Asfalt i ri	2.6
Ratkoc-Sapniq	Asfalt i ri	2.7
Brestovc – Reti	Asfalt i ri	2.2
Total		22.2

- a. Rregullimi i rrugës transit e cila do të ketë gjatësi 2.8 km dhe do të lidhë rrugët regjionale (R110 dhe R204).

- b. **Mirëmbajtja e rrugëve lokale** - Rrugët e pa asfaltuara të cilat, duhet të kenë mirëmbajtje permanente me mbulesë të rërës dhe zhavorrit janë rrugët të cilat shumica e tyre shtrihen në pjesën e strukturës së kopshtëve duhet të kenë mirëmbajtje permanente me mbulesë të rërës dhe zhavorrit mundësisht të shtrohen edhe me asfalt.

Tabela 50. Mirëmbajtja e rrugëve në të ardhmen

Vendbanimet të cilat nuk kanë qasje në asfalt (Këto rrugë duhet të mirëmbahen)		Gjatësia km
1	Kaznik	3.8
2	Mrasor (nga rruga kryesore deri të qendra e fshatit)	0.4
3	Reti e Ulët	2.1
4	Retijë	4.2
5	Nushpal	0.7
	Total:	11.2
Pjesëmarrja e popullsisë në rrugët e pa asfaltuara në nivel komune		4.54 % e popullsisë

Rregullimi i trotuareve, sinjalizimit, anësorëve dhe kufizimi i aktiviteteve socio-ekonomike – Me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe lehtësimit të qarkullimit të qytetarëve të vendbanimeve të cilat shtrihen përgjatë rrugëve nacionale dhe regionale, që të bëhet rregullimi i trotuareve për këmbësor, anësorëve, sinjalizimit, si dhe ndërprerja e aktiviteteve socio-ekonomike. Për realizimin e këtij synimi duhet të ndërmerren këto aktivitete:

- Rregullimi i trotuareve në vendbanimet:** Ratkoc me një gjatësi prej 3.7 km, Krushë e Madhe 2.1 km, Nagavc me 1.3 km, Hoqe e vogël 2.1 km, Brestoc 1.5 km, Gexhë 0.8 km, Dejnë 1.4 km, Radostë (1.2 km), Dabidol (1.4 km), Qifllak rreth 1.1 km, Kramovik 1.9 .
- Rregullimi i anësorëve mbrojtëse** përgjatë segmentit të rrugëve regionale në vendbanimin e Gexhë, Radostë, Ratkoc, Dejnë, Dabidol, Qifllak, Kramovik, Xërxë, Bellacerkë, Krushë e Madhe, Hoqë e Vogël, Nagavc, Brestovc.
- Rregullimi i sinjalizimit për vendkalim këmbësor (zebra), në lokacione dhe vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat sekondare (Krushë e Madhe, Ratkoc dhe Xërxë)
- Kufizimi i aktiviteteve socio-ekonomike përgjatë segmentit të rrugëve regionale në një gjatësi prej 60m.

S2. Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes

Sistemi i ujësjellësit qendrorë të Rahovecit i menaxhuar nga sistemi i "Radoniqit" e merr ujin nga Liqeni i Radoniqit, dhe furnizon 83% të popullatës të përgjithshme në komunë. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës të komunës rreth 17 %, kanë sisteme lokale, të cilat nuk menaxhohen nga "Radoniqi". Këto sisteme marrin ujin nga burime natyrore dhe shpimet nëntokësore. Të gjitha këto resurse ndodhen në pjesën e identifikuar si ZONE KODRINA DHE NATYRA.

Për përmirësimin e gjendjes në tërë zonën është e domosdoshme të investohet në;

- Rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit qendror në zonën urbane
- Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit qendror në vendbanimin Qifllak, Polluzhe, Kramovik etj,
- Rritja e prodhimit të ujit në zonat e mbuluara me ujësjellës,
- Ndërtimi i ujësjellësve lokal në vendbanimet ku janë të evidentuar burimet natyrore: Senoc, Pastasel, etj.

Në komunën e Rahovecit ka rrjetë të zhvilluar të ujitjes se tokave por është mirë që të zgjerohet ky rrjetë në mënyre që të ketë mundësi të me tutjeshëm për zhvillimin e bujqësisë në këtë komunë. Sistemi i ujitjes për komunën e Rahovecit është i menaxhuar nga sistemi i "Radoniqit".

Duhet të ndërtohet dhe zgjerohet sistemi i ujitjes në këto fshatra: Nagavc, Hoqë e Vogël, Brestoc, Hoqë e Madhe, Zoqishtë, Opterushë si dhe zgjerimi i këtij rrjetit në Krushë të Madhe.

Synimi 3. Qasje e përgjithshme e popullsisë në rrjetin e kanalizimit

Për përmirësimin e qasjes të banorëve në kanalizim, me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor të popullatës në komunë, është e nevojshme që të ndërmerren këto veprime:

- Rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit qendror në zonën urbane .
- Zgjerimi i shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në zonat sekondare
- Shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në vendbanimet ku mungon kanalizimi

Gjatë punës së hartimit të gjendjes ekzistuese (profilin) komunale është identifikuar edhe problemi i theksuar i shtrirjes së rrjetit dhe kyçja në sistem të kanalizimit, me të cilin aktualisht përballlet pjesa dërmuese e komunës së Rahovecit. Për përmirësimin e kësaj gjendjeje do të ndërmerren hapa konkrete:

- Zgjerimi i shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në tërë territorin e komunës,
- Zgjerim i rrjetit në zonën urbane të Rahovecit si dhe ndërtimi i gropave septike adekuate.

- Ndërtimi i rrjetit të veçantë të ujërave të zonës industriale dhe trajtim adekuat i tyre.

Në vendbanimet më të thella me numër më të vogël të banorëve dhe varësisht nga shpërndarja hapësinore e tyre dhe karakteristikat e terrenit, do të organizohen sisteme me gropa septike individuale dhe kolektive me sistem të vetëpastrimit të ujërave të ndotura.

Sistemi i kanalizimit të ujërave të ndotura, gjendja e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të ndotura në Komunë, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor. Si zgjidhje afat gjate do të ishte ndërtimi i impiantit regional për ujërave të zeza.

Sigurimi i ujit higjienik për pije dhe sistemi i organizuar i kanalizimeve për banorët e komunës do të ndikojnë në mbrojtjen e shëndetit të tyre si dhe në përmirësimin kualitetit të jetës të qytetarëve në komunë.

Synimi 4 Shtrirja e rrjetit të kanalizimeve për ujëra të bardha (atmosfera) –

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit me sisteme të ndara , nga aspekti teknik është lehtë i realizueshëm dhe nuk kërkon investime të mëdha andaj edhe nga aspekti ekonomik është i qëndrueshëm.

Shtrirja e lumenjve në komunën e Rahovecit është një përparësi e madhe për organizimin e kanalizimit të ujërave atmosferik meqenëse këto ujëra nuk kërkojnë trajtim paraprak dhe mund të derdhen kudo në rrjedhjet lumore.

Synimi 5 Përmirësim i rrjetit energjetikë – Pozita gjeografike e komunës i mundëson edhe një rrjet të rëndësishëm, të furnizimit me energji elektrike. Për përmirësimin e rrjetës energjetik në komunën e Rahovecit duhet të ndërmerren këto veprimeve:

Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10kv në 20kv:

Tabela 51. Rrjeti i energjisë elektrike, sipas kapaciteteve të propozuara

Drejtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti i propozuar në KV	Statusi fizik
Drejtimi Qyteti I	20 KV	Përmirësim solid
Drejtimi Qyteti II	20 KV	Përmirësim solid
Drejtimi i Komunës	20 KV	Përmirësim solid
Drejtimi Shkolla e Mesme	20 KV	Përmirësim solid
Drejtimi i Opterushës	20 KV	Përmirësim selektiv
Drejtimi i Potoçanit	20 KV	Përmirësim selektiv

Drejtimi i Bellacerkës-Fortesës	20 KV	Përmirësim solid
Drejtimi i Shkozës	20 KV	Përmirësim solid
Drejtimi i Ratkocit	20 KV	Përmirësim selektiv
Drejtimi i Dejnës	20 KV	Përmirësim selektiv
Drejtimi i Xërxës	20 KV	Përmirësim selektiv

b) Kualiteti i furnizimit me energji elektrike – sipas statistikave të furnizimit me energji elektrike, si dhe gjendjes së rrjetës energjetike në nivel të komunës administrative të Rahovecit mund të vërehet se ka një furnizim me energji elektrike jo në nivelin e kënaqshëm, prandaj duhet të përmirësohet kualiteti i energjisë elektrike në komunën e Rahovecit duke përmirësuar edhe rrjetin e energjisë elektrike, i cili do të ndikojë në zvogëlimin e humbjeve të energjisë.

Synimi 6. Organizim i grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre

Në komunën e Rahovecit shërbimin e menaxhimit të mbeturinave e kryen Kompania për mbeturina „Ambienti”, njësi operative në Rahovec, e cila kompani kryen shërbimet në zonën urbane. Në shumë vendbanime rurale të komunës ekzistojnë deponi të egra. Përmirësimi i shërbimit dhe të shtrirja e tij në tërë territorin e komunës është përgjegjësi e kuvendit komunal dhe atij regjional. Kjo do të realizohet me veprime konkrete:

- Shtrirja e shërbimit në vendbanimet ku mungon menaxhimi i organizuar, pastrimi i deponive të egra, sidomos në toka kualitative dhe të propozohet lokacioni për grumbullim në tokat me cilësi më të ultë.

Shtrirja e shërbimit në lokalitetet e qendrave të bashkësive lokale: Ratkoc, Xërxë, Krushë e Madhe, Drenoc, Qifllak etj. dhe krahas grumbullimit të mbeturinave njëkohësisht drejtorati komunal për mjedis duhet të aplikoj masat Ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Synimi 7. Ndriçimi i rrugëve në zona të frekuentuara

Është e nevojshme që rrjeti i ndriçimit publik të bëhet në vendbanimet e mëdha dhe të dendura me numër të popullsisë si dhe në qendrat Sekondare (Ratkoc, Krushe e Madhe, Xërxë, Bellacerkë, Radostë, Gexhë, Dejnë, Qifllak, Kramovik, Drenoc, Senoc, Pastaselë, Celinë, Hoqë e Vogël, Nagavc, Brestoc, Vrajak).

Synimi 8 Funksionalizim i vijës hekurudhore

Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regjional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, Kjo linjë hekurudhore është një binarësh me gjatësi prej 30.7 km. Linja hekurudhore nuk është në funksion dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes sajë.

Në rrjetin hekurudhorë i cili kalon në territorin e komunës së Rahovecit për të ardhmen kur të funksionon hekurudha është e rëndësishme që të përmirësohet sinjalizimi i rrugëve

ku mbikalohet hekurudha me sinjalizim dhe masa të sigurisë adekuate në vendbanimet: Kramovik, Qifllak, Dobidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xërxë, Celinë dhe Krushë e Madhe. Gjithashtu duhet të mirëmbahet linja e hekurudhës prej kufirit me komunën e Klinës deri tek kufiri me komunën e Prizrenit.

Synimi 9 Qasje në rrjetin e internetit për të gjithë

Bashkëpunimi i ngushtë me operatorët e telefonisë mobile për stimulimin e qytetareve të Rahovecit në shfrytëzimin e mundësive për përdorim të internetit në nivel të vendbanimeve që shtrihen në zonën e kopshtëve, duke ofruar paketa stimuluese, si dhe duhet të ndërmerret një kampanjë për informimin e qytetarëve për mundësitë e shfrytëzimit të shërbimeve të tyre.

Radiotelevizioni – Krijimi i mundësive për qasje në radiotelevizionet nacionale dhe lokale për të gjitha vendbanimet e komunës nëse paraqitet ndonjë problem e sidomos për vendbanimet të cilat janë në zonat e thella malore.

Synimi 10. Shtrirja e telefonisë fikse në vendbanimet e dendura - Për përmisimin e rrjetës së telekomunikimit në komunën e Rahovecit duhet të ndërmerren disa veprimeve, është e rëndësishme që të bëhet shtrirja e rrjetit në aspektin fizik në vendbanimet e tjera të cilat janë me të mëdha për nga numri i popullsisë .

- a) **Telefonia fikse** - Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Rahovecit është i lidhur nëpërmjet fibrës optike, i cili i përket linjës së trasesë së Prizrenit. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së. Shtrirja e rrjetës së telefonisë fikse ekzistuese mundëson qasje të mbi 47.5% të popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse.
- b) **Foltore publike** - Në funksion të ofrimit të shërbimeve të telefonisë fikse do të jetë edhe rritja e numrit të foltoreve publike në zonën urbane dhe në vendbanimet e propozuara si vendbanime sekondare dhe qendrat e bashkësive lokale (Ratkoc, Krushë e Madhe dhe Xërxë) duhet të jetë minimum dy për qendër sekondare.
- c) **Telefonia mobile** –Të dy operatorët mobil kanë të vendosura antena individuale në lokacione të ndryshme të komunës, mirëpo duhet të bëhet koncentrimi i antenave në një ose dy lokacione të caktuara në bashkëpunim me operatorët e Telefonisë Mobile.
- d) **Shërbimet Postare** - duhet të vazhdohet shpërndarja e shërbimeve postare në sistemin aktual të shpërndarjes

Objekti	Nr. Aktivitetit	Aktiviteti	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
	A1	Rruga Unazore (Tranzite) mbi Rahovec	Ministria e Transportit / K. Komunal	Ministria e Transportit / K. Komunal	2012-2014	Ministria e Transportit / K. Komunal	520.000,00
Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët	A2	Përmirësimi i kualitetit të asfaltit në rrugët nacionale, M9.1 Gjakovë - Prishtinë 6.2 km.	Ministria e Transportit	Ministria e Transportit / K. Komunal	2013-2019	Ministria e Transportit	?
	A3	Përmirësimi i kualitetit të asfaltit në rrugën regjionale : Rruga R111 , Xërxë -Ratkoc-Kramovik , Rruga R117 , Rahovec-Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë, Rruga R204 , Rahovec – Krushë e Madhe,	Ministria e Transportit	Ministria e Transportit	2012-2015	Ministria e Transportit	?
	A4	Rrugët lokale - asfalt i ri, Bellacerkë - Celinë	K. Komunal	K. Komunal	2012-2014	K. Komunal	300.000,00
	A5	Rregullimi i Rruges Sarosh – Kaznik	K. Komunal	K. Komunal	2012-2014	K. Komunal	350.000,00
		Opterushë - Reti	K. Komunal	K. Komunal	2012-2013	K. Komunal	95.000,00
		Rregullimi i rrugës Reti – Reti e Ulët	K. Komunal	K. Komunal	2012-2013	K. Komunal	290.000,00
		Rregullimi i rrugës Potoqan i Epërm - Nashpallë	K. Komunal	K. Komunal	2012	K. Komunal	40.000,00
		Ndertimi dhe asfaltimi i rrugës Ratkoc - Babovc - Pastasel	K. Komunal	K. Komunal	2012-2013	K. Komunal	180.000,00
		Ndërtimi dhe asfaltimi rrugës Ratkoc -	K. Komunal	K. Komunal	2013-2014	K. Komunal	150.000,00

		Sopniq					
	A6	Mirëmbajtje selektive të rrugëve:	K. Komunal	K. Komunal	2012-2014	K. Komunal	50.000,00
	A7	Mirëmbajtja e rrugëve lokale - Rrugët e pa asfaltuara më gjatësi prej 11.2 km, duhet të mirëmbahen me mbulesë të rërës dhe zhavorrit.	K. Komunal	K. Komunal	2012-2014	K. Komunal	20.000.00
		Rregullimi i anësorëve mbrojtëse përgjatë segmentit të rrugëve regjionale në vendbanimin e Gexhë, Radostë, Ratkoc, Dejnë, Dabidol, Qifllak, Kramovik, Xërxë, Bellacerkë, Krushë e Madhe, Hoqë e Vogël, Nagavc, Brestovc në të dy anët e rrugëve.	Ministria e Transportit	K. Komunal	2012-2015	Ministria e Transportit	100.000.00
		Rregullimi i sinjalizimit për vendkalim këmbësor (zebra), në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat sekondare (Krushë e Madhe,Ratkoc,Xërxë)	K. Komunal	K. Komunal	2012-2013	K.Komunal	5.000,00
		Vendosja e mbishkrimeve për hyrje në Komunën e Rahovecit në pjesën veriore në kufirin e komunës së Klinës dhe Malishevës.	K. Komunal	K. Komunal	2012-2013	K. Komunal	2.000,00
	A10	Rregullimi i trotuareve në vendbanimet: Ratkoc me një gjatësi prej 3.7 km, Krushë e Madhe 2.1 km, Nagavc me 1.3 km, Hoqe e vogel 2.1 km, Brestoc 1.5 km, Gexhë 0.8 km,Dejnë 1.4 km, Radostë (1.2 km),	K. Komunal	K. Komunal	2012-2014	K. Komunal	200.000,00

		Dabidol (1.4 km), Qifllak rreth 1.1 km, Kramovik 1.9					
	A11	Rregullimi i sinjalizimit për vijën hekurudhore, në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat (Qifllak,Dabidol,Dejnë,Ratkoc,Radostë, Gexhë Xërxë, Celinë, Krushë e Madhe).	Ministria e Transportit K. Komunal	Ministria e Transportit K. Komunal	2012-2013	Ministria e Transportit K. Komunal	10.000,00
Ndërtimi i sistemit të ujitjes	A1	<i>Ndërtimi i sistemit të ujitjes në fshatrat: Nagavc, Hoqë e vogël, Brestoc,Hoqë e Madhe Zoqishtë dhe Optrushë.</i>	K. Komunal, MBPZHR,Radoniqi	K. Komunal, MBPZHR Radoniqi	2012-2015	K. Komunal, MBPZHR,Ra doniqi	95.000.00
	A2	Ndërtimi i ujësjellësve lokal në vendbanimet ku janë të evidentuar burimet natyrore: ,Senoc,Pastasel	K. Komunal, ,Radoniqi	K. Komunal, ,Radoniqi	2012-2015	K. Komunal, ,Radoniqi	85.000.00
Rrjeti energjetik	A12	Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10kv në 20kv: - Drejtimi Drejtimi Qyteti I përmirësim solid	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2015-2018	K. Komunal KEK&MZHE	120.000,00
		Drejtimi Qyteti II përmirësim solid	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2013-2016	K. Komunal KEK& MZHE	120.000,00

	Drejtimi i Komunës përmirësim solid	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K. Komunal KEK& MZHE	110.000,00
	Drejtimi i Optrushës selektiv	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K. Komunal KEK& MZHE	170.000,00
	Drejtimi i Potoçanit, përmirësim selektiv	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K. Komunal KEK& MZHE	180.000,00
	Drejtimi i Bellacerkës-Fortesës përmirësim solid	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K. Komunal KEK& MZHE	120.000,00
	Drejtimi i Shkozës përmirësim solid	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K. Komunal KEK& MZHE	120.000,00
	Drejtimi Ratkocit përmirësim selektiv	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K. Komunal KEK& MZHE	200.000,00
	Drejtimi Xërxës përmirësim selektiv	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K. Komunal KEK& MZHE	170.000,00
	Drejtimi i Dejnit përmirësim selektiv	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K. Komunal KEK& MZHE	200.000,00
	Drejtimi shkolla e Mesme Rahovec përmirësim solid	K.Komunal/ KEK & Ministria e Zhvillimit Ekonomik	K. Komunal KEK&MZH E	2014-2019	K.Komunal/ KEK & MZHE	100.000,00

Shërbimet e telekomunikimit	A1	Telefonia fikse - Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse në disa vendbanime të mëdha ku mungon telefonia fikse.	K. Komunal / PTK	K. Komunal KEK&MZH E	2013-2018	PTK	Vlere e madhe
	A2	Foltore publike të propozuara në qendrat sekondare (Krushe e Madhe, Xërxe dhe Ratkoc si qendra sekondare) duhet të jetë minimum dy për qendër sekondare	K. Komunal / PTK	K. Komunal KEK&MZH E	2013-2018	PTK	30.000,00
Ndriçimi i rrugëve	A1	Ndriçimi publik në Rahovec dhe qendrat sekondare (Ratkoc, Xërxe dhe Krushë e Madhe) si dhe në disa vendbanime të dendura. (Rregullim, mirëmbajtje)	K. Komunal	K. Komunal KEK&MZH E	2012-2014	K. Komunal	155.000.00

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKËTURES BASHKËKOHORE							
Qëllimi.	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Infrastrukturë e planifikuar bashkëkohore	Synimi 3. Qasje e përgjithshme e popullsisë në rrjetin e kanalizimit	1. Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në Riti (Faza e dytë)	K. Komunal,	K. Komunal	2012	K. Komunal, donatorët	40.000,00
		2. Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat Potoqan të Ulët dhe të Epërm	K. Komunal,	K. Komunal	2012-2013	K. Komunal, donatorët, komuniteti	145.000,00
		3. Ndërtim i kanalizimit në fshatin Zatriq	K. Komunal	K. Komunal	2012	K. Komunal, donatorët, komuniteti	20.000,00
		4. . Kanalizimi në fshatin Dabidol	K. Komunal	K. Komunal	2012-2013	K. Komunal, donatorët, komuniteti	60.000,00
		5. Kanalizimi në fshatin Sopniq	K. Komunal	K. Komunal	2012-2013	K. Komunal, donatorët, komuniteti	55.000,00
		6. Kanalizimi në fshatin Brestoc	K. Komunal	K. Komunal	2012-2013	K. Komunal, donatorët, komuniteti	80.000,00
		7. Kanalizimi në fshatin Drenoc	K. Komunal,	K. Komunal	2013	K. Komunal, donatorët Komuniteti	50.000,00

		8. Kanalizimi në Hoqë të vogël	K. Komunal	K. Komunal,		K. Komunal, donatorët komuniteti	40.000,00
		9. Kanalizimi në Bellacerkë (Fortesë)	K. Komunal	K. Komunal,	2012-2013	K. Komunal, donatorët komuniteti	80.000,00
		10.Kanalizimi në fshatin Vranjak					40.000,00
		11.Kanalizimi në fshatin Bratotin					40.000,00
	Organizim i grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre	1. Shtrirja e shërbimit në vendbanimet ku mungon menaxhimi i organizuar, pastrimi i deponive të egra, sidomos në toka kualitative dhe të propozohet lokacioni për grumbullim në tokat me cilësi më të ultë.	K. Komunal, MMPH, Kompania regjionale	K. Komunal, MMPH Kompania regjionale	2012-2015	MMPH K. Komunal, Kompania regjionale, donatorët	100.000,00
2. Shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në lokalitetet e qendrave sekondar: Ratkoc, Xërxe dhe Krushë e Madhe		K. Komunal, Kompania regjionale	K. Komunal, Kompania regjionale	2012-2014	K. Komunal, Kompania regjionale, donatorët	?	
TOTALI							5.910.000,00

V. Dispozitat për zbatim

Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit është dokument bazë që parasheh zhvillimin e dëshiruar hapësinor për të ardhmen. Bazuar në gjendjen ekzistuese dhe sfidat kryesor që janë identifikuar, është përcaktuar vizioni për të ardhmen si dhe qëllimet që duhet të arrihen. Gjithashtu është propozuar korniza e zhvillimit komunal sipas të cilës do të realizohet një zhvillim policentrik dhe i qëndrueshëm. Strategjia e zhvillimit komunal parasheh fushat konkrete dhe mënyrën se si do të arrihet zhvillimi dhe mbrojtja në tërë territorin e komunës. Plani është shumë real dhe i zbatueshëm. Zbatimi konkret i këtij plani është prezantuar në këtë pjesë, ku përshkruhen dispozitat për zbatim, përmes të cilave përshkruhet mënyra më konkrete e zbatimit praktik të këtij plani. Pra, jepen udhëzimet dhe sugjerimet për realizimin e strategjisë së propozuar, me tërë përmbytjen e sajë, duke përfshirë afatet kohore, implikimet financiare dhe hapësirën përkatëse.

V.1. Dispozitat e përgjithshme

Në këtë pjesë jepen informata për parimet e përgjithshme të implementimit të planit, ku përfshihen afatet kohore dhe periudhat e revidimit të planit, përgjegjësit dhe kompetencat për revidimin e tij si dhe rëndësinë e këtij dokumenti në nivelin komunal.

- Plani Zhvillimor Komunal është hartuar për periudhën kohore 2010 – 2020 dhe jep mundësinë e vazhdimësisë së planifikimit.
- Rishikimi i Planit bëhet çdo pesë vite, por rishikimi dhe ndryshimet eventuale mund të bëhen edhe në periudha tjera kohore, varësisht nga vendimet politike apo kërkesat e caktuara të komunitetit lokal.
- Përgjegjës për revidimin e Planit është Qeveria komunale e Rahovecit, konkretisht Drejtoria për Urbanizëm.
- Plani është hartuar në pajtim me të gjitha konventat dhe parimet ndërkombëtare të fushës së Planifikimit Hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Plani gjithashtu është në përputhje të plotë me Ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003-14 dhe Udhëzimin Administrativ nr. 33 për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor të Komunës.
- Plani merr parasysh të gjitha projektet e përcaktuara për tu realizuar si nga niveli qendror ashtu edhe nga niveli komunal.
- Dispozitat për zbatim përcaktojnë mënyrën e rregullimit, zhvillimit dhe mbrojtjes së hapësirave sipas destinimit të përcaktuar.
- Plani përfshinë projekt-elaboratin me titull “Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit 2010 – 2020” që është hartuar në vitin 2011 nga Komuna e Rahovecit përmes kompanisë DataGIS Consulting, dhe përbëhet nga: pjesa tekstuale dhe ajo grafike (Harta, grafikone, tabela dhe foto të ndryshme).
- Ky plan është dokumenti kryesor për zhvillimin e ardhshëm hapësinor dhe planet tjera, si: Plani urban dhe planet rregullative i nënshtrohen këtij plani.

V.2. DETYRAT DHE MASAT PËR ZBATIMIN E PLANIT

- Qeveria komunale e Rahovecit është përgjegjëse për ta udhëhequr tërë procesin për realizimin e këtij plani brenda periudhës kohore 2011 -2020.
- Drejtoria për urbanizëm në komunën e Rahovecit është koordinator i realizimit të këtij plani, por gjithashtu edhe Drejtoritë tjera komunale do të jenë të involvuara drejtpërdrejtë, duke marrë për sipër zhvillimin e fushave përkatëse në harmoni të plotë me këtë dokument.
- Të gjitha zhvillimet e parapara në këtë plan parashihet të financohen, jo vetëm nga buxheti komunal, por edhe nga ai qendror, ndërkombëtar dhe nga biznesi privat, andaj

kërkohet nga qeveria komunale dhe konkretisht nga sektorët gjegjës që të kenë një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha këto institucione dhe akterët kyç për realizimin e planit.

- Drejtoria për urbanizëm vazhdimisht përcjell zbatimin e planit dhe rrjedhën e zbatimit të tij, duke nxitur dhe stimuluar të gjithë akterët kyç, gjithashtu realizon edhe hulumtime që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin urban.

V.3. KUSHTET PËR PËRCAKTIMIN E DESTINIMIT TË SIPËRFAQEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS

Vizioni për Komunën e Rahovecit përcakton shtyllat kryesore në të cilat zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i bazuar. Zhvillimi i çdonjërit nga këto shtylla ka dimensionin e vet hapësinor dhe ndikim në zonat e përcaktuara për zhvillim.

Në çdo vendbanim ekzistues, duke përfshirë edhe vendbanimet joformale, nevoja dhe mundësia e përcaktimit të hapësirave publike, si; fushat për lojë, zonat e gjelbëruara, tregjet, hapësirat sportive dhe hapësira për parkim do të përkrahen me plane rregulluese, aty ku hartimi i PRrU është prioritet. Ky vlerësim do të jetë pjesë e procesit të hartimit të këtyre planeve.

Parimet për zhvillim dhe mbrojtje formulojnë bazën për përcaktimin e kushteve për çështjet e shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit.

Zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i bazuar në vendime adekuate. Në PZHK, toka për zhvillim dhe rregullim është e destinuar për këto lloje të shfrytëzimit:

- Vendbanime
- Rekreacion
- Toka bujqësore
- Korridore të gjelbërimit
- Kullosa dhe livadhe
- Pyje
- Pyllëzim
- Gurëthyes
- Rrjedha të ujit

V.4. KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS

Ndërtimi do të jetë i lejuar vetëm në zonat e destinuar për ndërtim të përcaktuara me PZHK. Zhvillimi në qytetin e Rahovecit dhe në qendrat sekondare duhet të rregullohen me Plane Rregulluese Urbane. Infrastruktura publike do të ofrohet vetëm në zonat e destinuar për ndërtim. Në zonat ku Planet Rregulluese Urbane nuk janë të miratuara, duhet zbatuar hulumtimin për kërkesat, mundësitë dhe ofrimin e infrastrukturës.

Ndërtimi në tokën bujqësore do të jetë i lejuar vetëm në tokën e cilësisë së ulët, mbi klasën e IV, djerrina dhe vetëm në raste të veçanta për zhvillimin që përkrahin veprimtaritë bujqësore. Zhvillimet në hapësirën e lirë, peizazhi natyror, duhet bazuar në rregullat mjedisore për mbrojtjen e natyrës dhe peizazhit. Në mungesë të planit rregullues urban, komuna duhet të nxjerrë udhëzimet përkatëse të karakterit obligativ.

Në zonat ku zhvillimi është i lejuar, kushtet e lokacionit duhet të përcaktojnë:

- ✓ Formën dhe madhësinë e zonës së zhvillimit,
- ✓ Mënyrën e shfrytëzimit apo përdorimin e autorizuar për ngastrën tokësore,
- ✓ Rregullat e ndërtimit dhe distancën në mes të ndërtesave në ngastër,
- ✓ Rregullat për kyçjen e ndërtesës në rrjetin e infrastrukturës;
- ✓ Masat për mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.
- ✓ Përgatitja e lokacionit si: largimi i ndërtesave dhe rehabilitimi i dheut (tokës), hulumtimet gjeo-mekanike dhe të dheut.

V.5. ZHVILLIMI I VENDBANIMEVE DHE NDËRTIMET TJERA JASHTË TYRE

Zonat e ndërtimit përcaktohen me Planin Zhvillimor Komunal. Dispozitat e kontrollit të zhvillimit të vendbanimeve janë:

- Kompaktësia e zhvillimit,
- Ruajtja e tokës bujqësore të kategorisë prej I – IV,
- Kontrolli i zhvillimeve përgjatë korridoreve rrugore,
- Zonat me trashëgimi të pasur kulturore dhe natyrore të mbrohen,
- Në zonat me pasuri nëntokësore të mos ndërtohet,
- Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore të sigurohen me masa konkrete dhe të mos lejohen ndërtimet e pa planifikuara.
- Ndërtimi është i lejuar vetëm në zonat e përcaktuara për zhvillimin e vendbanimeve (tokën ndërtimore).
- Për të gjitha vendbanimet janë përcaktuar kahet e zhvillimit hapësinor.
- Pasi që zhvillimi në masë të madhe duhet të zë vend në vendbanimet ekzistuese, vetëm zhvillimi dhe ndërtimi plotësues duhet lejuar.
- Dendësimi i ndërtimit për shfrytëzim më racional të tokës do të aplikohet vazhdimisht.
- Planet rregulluese si instrument i planifikimit duhet përdorë për të arritur përshtatshmërinë ndërtimore me rrethinën.
- Infrastruktura dhe shërbimet duhet të ofrohen në zonat e reja për ndërtim.
- Mënyrat e financimit, sikur partneriteti publik-privat duhet akorduar me komunën.
- Për zonat ku nuk ka PRrU, ndërtimi i ndërtesave të larta do të kufizohet në përputhje me rregullat e përcaktuara me PZHU.
- Në zonat tjera, PRrU-të duhet të jenë të hartuara në përputhje me udhëzimet dhe synimet e përcaktuara dhe miratuara me PZHU.
- Jashtë zonës ndërtimore, sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 dhe Ligji L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor, do të lejohen këto objekte:
 - o Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore;
 - o Infrastruktura;
 - o Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile;
 - o Ndërtesat për mbrojtje nga zjarri dhe materialet të dëmshme, eksploziv, etj;
 - o Ndërtesa për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksploatuar;
 - o Rekreacion dhe turizëm;

V.6. Zhvillim social dhe administratë efikase

Për ta realizuar një zhvillim të qëndrueshëm social dhe shërbime cilësore administrative nevojitet plotësimi i disa kërkesave dhe kriterëve të domosdoshme. Shërbimet në administratë duhet të digjitalizohen dhe të krijohen mundësi që qytetari i thjesht ti kryej shërbimet më shpejt dhe të jetë i informuar me kohë për çështje të caktuara administrative dhe procedurale.

Për arritjen e shërbimeve cilësore në arsim dhe shëndetësi duhet të arrihen kriteret e caktuara në strategji për katër elementet bazë:

- Hapësira e mjaftueshme shkollore dhe shëndetësore
- Distanca jo e largët e objekteve shkollore dhe shëndetësore
- Kuadri i mjaftueshëm arsimor dhe shëndetësor dhe
- Kuadri adekuat në arsim dhe shëndetësi

Masat për realizimin e kriterëve:

- Të ndërtohen shkolla të reja apo tu shtohen anekse shkollave ekzistuese në ato vendbanime ku ka mungesë të hapësirës shkollore (të parapara në strategji)
- Të ndërtohen objektet shëndetësore (të parapara në strategji)

- Bartja e nxënësve me transport të organizuar (Për nxënësit larg shkollave)
- Trajnimin e mësimdhënësve dhe aftësimin e tyre

Për ta zvogëluar shkallën e papunësisë dhe të varfërisë duhet ndërmarrë këto masa:

- Dhenje të kredisë për bujq dhe ofrim i plehrave dhe preparateve tjera me qmime të volitshme si dhe kompenzim në raste të demtimeve nga fatkeqësit natyrore.
- Përkrahje prodhimeve vendore.
- Evidentimi permanent i të papunësuarve dhe trajnimi i tyre
- Hulumtimi dhe ofrimi i vendeve të reja të punës sipas përgatitjes profesionale.
- Ofrimi i punësimit edhe jashtë komunës.

V.7. Masat parandaluese të ndikimeve të dëmshme në mjedis

- Eliminimi i të gjitha vendgrumbullimeve ilegale të mbeturinave në të ardhmen.
- Organizimin e një sistemi funksional dhe mjaft efikas për menaxhimin e mbeturinave.
- Angazhimi i kompanive profesionale për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.
- Funksionalizimi i inspektoratit të mjedisit dhe ndërmarrja e masave të rrepta ndaj veprimeve ilegale mjedisore.
- Kontroll më të shpeshta dhe të veçanta përgjatë rrjedhave lumore me qëllim të mbrojtjes së tyre nga hedhja e mbeturinave.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe me donatorët privat për të gjetur mundësinë e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza sipas standardeve dhe gropave septike.
- Parandalimin e operatoreve ilegal të gurthyesve, grumbullimin e taksave mjedisore dhe ndalimin e furrave për pjekje të gëlqeres me materiale plastike.
- Mbrojtja e trashëgimisë përfshinë disa masa konkrete për të ardhmen, ku paraprakisht duhet kushtuar vëmendje të veçanët mbrojtjes së trashëgimisë ekzistuese nga degradimet eventuale deri në realizimin e projekteve të parapara në këtë strategji për fushën e trashëgimisë.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe donatorët tjerë për hartimin e planeve menaxhuese të pyjeve, si dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura.
- Për ta mbrojtur tokën kualitative bujqësore, organet komunale duhet ta respektojnë vijën e ndërtimit që është përcaktuar në fazën e koncepteve, ku të gjitha vendbanimet e komunës kanë drejtimit e zgjerimit dhe drejtimit kah nuk mund të zhvillohen për shkak të tokës kualitative.

V.8. Zhvillimi ekonomik i komunës

Për ti realizuar aktivitetet për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe të balancuar, komuna duhet ti kushtojë rëndësi këtyre dispozitave:

- Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe donatorët tjerë me qëllim të realizimit të projekteve të parapara në këtë planë e që ndërlidhen me zhvillimin e bujqësisë së komunës:
 - o Organizimin e trajnimeve për fermer
 - o Stimulime dhe grande financiar
 - o Realizimin e projekteve për sistemin e ujitjes
 - o Pajisje me teknologji më të avancuara bujqësore
 - o Sigurimin e farërave më kualitative

- o Mbrojtje të prodhimeve
- o Mbrojtje më efikase ligjore etj.
- Zonat e biznesit të ndërtohen me plan detaj rregullues dhe të sigurohen donatorët
- Aktivitetet mineraro-xehetare në të ardhmen duhet të funksionojnë në kuptimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, ku kompanitë të cilat degradojnë më shumë mjedisin duhet të paguajnë edhe taksë më të madhe si dhe të vihet një kontroll i plot i shfrytëzimit duke i kushtuar kujdes të veçantë ndotjes dhe degradimit.
- Ofrimin e shërbimeve për vizitor të ndryshëm në zonat turistike si dhe të intensifikohen aktivitetet dhe masat kundër ndotësve në këto zona.
- Stimulimi dhe përkrahja e vazhdueshme ligjore, financiare dhe të një tregu të qëndrueshëm për bizneset e vogla dhe të mesme

V.9. Kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve, sipërfaqeve komunikuese dhe sistemeve tjera të infrastrukturës

- ✓ Asfaltimi i rrugëve që kanë frekuentim më të theksuar të jetë prioritet
- ✓ Rregullimi i rrugëve të dëmtuara të përcaktuara në strategji
- ✓ Mirëmbajtja e vazhdueshme e rrugëve lokale të pa asfaltuara në drejtim të viseve rurale
- ✓ Sinjalizimi në rrugë dhe ndërtimi i trotuareve për siguri më të lartë në trafik
- ✓ Rregullimi i udhëkryqeve
- ✓ Rindërtimin dhe izolimin e kaptazhës së burimeve të ujit
- ✓ Rritja e kapacitetit të pompave
- ✓ Ndërtimi i sistemit të klorizimit
- ✓ Zgjerimi i shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit sipas strategjisë së propozuar krahas kërkesave të qytetareve
- ✓ Rritja e prodhimit të ujit dhe masat për shfrytëzimin racional të tij.
- ✓ Ndërtimi i gropave septike
- ✓ Rritja e kapacitetit të energjisë elektrike nga 10 në 20 KW.
- ✓ Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse sidomos në vendbanimet më të mëdha dhe afër qendrës urbane.
- ✓ Të shtohet numri i foltoreve publike në zonën urbane dhe në qendrat sekondare të komunës
- ✓ Rritja e numri i pikave për grumbullimin e mbeturinave organike sidomos në zonën ku gjendet qyteti dhe vendbanimet më të mëdha ku edhe numri i popullsisë është shumë më i madh dhe prodhimi i mbeturinave po ashtu është më i madh
- ✓ Lidhja e Qendrave Sekondare ndërmjet veti si dhe lidhja e tyre me fshatrat përreth.

V.10. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- **Hyrja e planit në fuqi:** Ky plan do të jetë i plotëfuqishëm pas aprovimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Ky plan do të jetë valid për 10 vitet e ardhshme
- **Vlerësimi**

PZHK do të vlerësohet rregullisht, një herë në çdo 2 vite.

Gjithashtu, do të shqyrtohen zhvillimet aktuale dhe të dhënat demografike të tanishme, nevojat për banim dhe zhvillimet ekonomike. Vlerësimet do të përcaktojnë serinë e zbatimit të planeve të veprimit dhe strategjive.

Procedura e rregullt e rishikimit është në periudhën prej 5 viteve.

Elementet dhe udhëzimet për hulumtim

Plani Zhvillimor Komunal ofron kornizë punuese për studime të mëtutjeshme në zhvillimin e komunës që lehtëson zbatimin e Planit.

Planet dhe politikat që duhet hartuar:

- Plani i politikave mjedisore, në veçanti mbrojtja e ujërave, pyjeve dhe tokës bujqësore,
- Kadastër të avancuar komunal,
- Plan të zhvillimit ekonomik,
- Plan për zhvillimin të turizmit,
- Politikat e mobilitetit,
- Hulumtim i burimeve energjetike, duke përfshirë studimin e burimeve të energjisë regjenerues.

ANEKS

RAPORTI I TAKIMIT TË PARË PUBLIK